

INSTITUTI I PAVLEFSHMËRISË SË VEPRIMEVE JURIDIKE. PASOJAT E PAVLEFSHMËRISË DHE ROLI I GJYKATËS NË ZBATIMIN E TYRE

Entela Abduli

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës në Shkenca Juridike, me profil E Drejtë Private, për marjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Mariana Tutulani-Semini

Numri i fjalëve: 61642

Tiranë, Mars 2016

**INSTITUTI I PAVLEFSHMËRISË SË VEPRIMEVE JURIDIKE. PASOJAT E
PAVLEFSHMËRISË DHE ROLI I GJYKATËS NË ZBATIMIN E TYRE**

Entela Abduli

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës në Shkenca Juridike, me
profil E Drejtë Private, për marjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Mariana Tutulani-Semini

Deklarata e Autorësisë

Deklaroj se ky studim është punë origjinale, i kryer në bazë të literaturës dhe burimeve parësore, për përmbushjen e qëllimit të studimit, sipas tematikës, hipotezës dhe pyetjeve kërkimore të tij. Të gjitha citimet e drejtpërdrejta nga autorë të ndryshëm, vendas dhe të huaj, janë të pasqyruara qartësisht në këtë punim, duke identifikuar autorin e tyre. Doktrina bazë, ligjet dhe ndryshimet ligjore, Vendimet Unifikuese të Gjykatës së Lartë, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe burime arkivore nga gjykata të shkallëve të ndryshme, si dhe vendimet e gjykatave të huaja të përdorura në këtë punim, janë të cituara dhe të pasqyruara në bibliografinë e tij.

Abstrakti

Veprimet juridike të pavlefshme dhe shkaktimi i tyre, si rezultat i shkeljes së kushteve të ligjshmërisë, të përcaktuara në legjislacion ose si rezultat i vesimit të vullnetit të palëve pjesëmarrëse, klasifikohen në veprime juridike absolutisht të pavlefshme dhe veprime juridike relativisht të pavlefshme.

Në varësi të llojit të pavlefshmërisë absolute apo relative, veprimet juridike në praktikën gjyqësore, konstatohen të pavlefshme ose shpallen të pavlefshme nga gjykata. Gjykata, nëpërmjet konstatimit ose shpalljes së pavlefshme të veprimit juridik, shprehet edhe për zgjidhjen e pasojave.

Ky punim ka studiuar konceptin e pavlefshmërisë së veprimeve juridike, si një institut i rëndësishëm i së drejtës, në aspektin historik dhe krahasues midis tre legjislacioneve të ndryshme, Kodit Civil të 1929, të 1981 dhe atij të 1994, por është fokusuar më tepër në praktikën gjyqësore dhe rolin e gjykatës në zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë.

Objektivat dhe qëllimi i këtij punimi qëndrojnë pikërisht në studimin dhe trajtimin e rolit të gjykatës në zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë. Nëse gjykata, kryesisht konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik dhe zgjidh pasojat e pavlefshmërisë, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme (*restitutio in integrum*), pa kërkesë të palëve, ajo shkel parimin që drejton një proces gjyqësor.

Për hartimin e këtij punimi, klasifikimin e pavlefshmërisë së veprimeve juridike e pasojave të tyre, si dhe vlerësimin e rolit të gjykatës në lidhje me këto pasoja, është përdorur literatura bazë, ligjet dhe ndryshimet ligjore, vendime të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendime të Gjykatës Kushtetuese, burime arkivore të gjykatave të ndryshme vendase, të gjykatave të huaja dhe burime interneti.

Abstract

Invalid juridical acts and their causes, as a result of violence of terms of legality defined in law or threaten of the will of involved parts are classified in absolutely invalid juridical acts and relatively invalid juridical acts.

Depending on the kind of invalidity juridical can be found invalid or declared invalid from the court. Besides declaration of invalidity the court can also resolve the consequences.

This paper analyses the concept of invalidity of juridical acts as a very important component of rights in three different juridical systems: Civil Code of 1929, of 1981 and 1994 in historical and comparative aspects. Nevertheless it is focused in court practice and court importance in invalidity consequences and aims to analyse the importance of the court in execution of invalidity consequences.

If the court notices invalidity of juridical act and resolve its consequences by turning the parts in previous state (*restitutio in integrum*), without the demand of parts, it violence principles of leading a process.

For the composition of this paper base literature is used, law and their changes, Sentences of Unified Tribunals of Supreme Court, Sentences of Constitutional Court, archival resources of various local courts, foreign courts and internet resources.

DEDIKIMI

Ia dedikoj këtë punim familjes sime, që më ka përkrahur dhe ndihmuar për realizimin e tij. Në mënyrë të veçantë, motrës sime Inës, që është dobësia ime.

FALËNDERIMET

Për realizimin e këtij punimi, dua të falënderoj në radhë të parë Profesore Marianën për ndihmën e saj të paçmuar.

Një falënderim të veçantë për miqtë e mi, pasi pa ata, nuk do t'ia kisha dalë mbanë. E ndiej veten të privilegjuar që ju kam pranë!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Kapitulli I: Hyrje	16
1.1 Konteksti teorik dhe problematika e studimit.	16
1.2 Specifikimi dhe kufizimet e studimit	23
1.3 Struktura e studimit	24
Kapitulli II: Metodologjia dhe Modeli Analitik	29
2.1 Literatura e përdorur.....	29
2.2 Qëllimi i studimit.....	32
2.3 Hipoteza dhe pyetjet kërkimore	33
2.4 Metodologjia e punimit	34
Kapitulli III: Pavlefshmëria e veprimit juridik në aspektin historik dhe krahasues (E Drejta Kanunore, Kodi Civil i 1929, Kodi Civil i 1981)	37
3.1 Kanuni i Lekë Dukagjinit	38
3.2. Kanuni i Labërisë	44
3.3 Kodi Civil i Zogut, 1929	46
3.4 Periudha socialiste dhe Kodi Civil i 1981	68
Kapitulli IV: Veprimet juridike të pavlefshme dhe pasojat e pavlefshmërisë në sisteme të ndryshme ligjore	79
4.1 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën angleze	82
4.2 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën amerikane.....	85
4.3 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën gjermane	87
4.4 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën zviceriane	91
4.5 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën franceze	92
4.6 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën rumune	95
4.7 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën Italiane	96
Kapitulli V: Pavlefshmëria e veprimeve juridike dhe llojet e pavlefshmërisë (doktrina, ligji dhe praktika gjyqësore)	106
5.1 Veprimet juridike absolutisht të pavlefshme.....	110
Veprimet juridike që kryhen duke shkelur formën e caktuar	113
Veprimet juridike që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit	120
Veprimet juridike që kryhen për të mashtruar ligjin	128
Veprimet juridike të cilat bëhen me marrëveshje të palëve, pa pasur si qëllim të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).....	129
Veprime juridike që kryhen nga të miturit nën moshën 14 vjeç.....	135
Veprimet juridike që kryhen nga persona të cilëve, për shkak të sëmundjeve psikike ose zhvillim mendor të metë, u është hequr zotësia për të vepruar	137
5.2 Veprimet juridike relativisht të pavlefshme, anulueshmëria.....	140


Veprime të kryera nga të miturit mbi 14 vjeç, kur veprimin e kanë kryer pa pëlqimin e prindit ose kujdestarit.....	142
Veprimet juridike të kryera nga personat, të cilëve, për shkak të sëmundjeve psikike ose zhvillimit të metë mendor, u është kufizuar zotësia për të vepruar.....	143
Veprimet juridike të kryera nga personat të cilët, në kohën e kryerjes së veprimit juridik, nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse nuk u ishte hequr zotësia për të vepruar	145
Veprime juridike që kryhen nën ndikimin e veseve të vullnetit	146
5.3 Pavlefshmëria e veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi	154
5.4 Pavlefshmëria e pjesshme e veprimit juridik.....	155
5.5 Pavlefshmëria e testamentit, parashikuar në pjesën e posaçme të Kodit Civil dhe raporti me dispozitat e përgjithshme.	156
Kapitulli VI: Klasifikimi i pasojave të pavlefshmërisë së veprimeve juridike sipas ligjit dhe praktika gjyqësore	158
6.1 Kalimi i ekzekutimit në të ardhurat e shtetit	162
6.2 Restitucioni i dyanshëm	167
6.3 Restitucioni i njëanshëm	172
6.4 Pasojat e pavlefshmërisë së veprimeve juridike në lidhje me personat e tretë.....	173
6.5 Pavlefshmëria e martesës si veprim juridik personal dhe pasojat e saj krahasuar me pavlefshmërinë civile.....	180
6.6 Pavlefshmëria administrative dhe pasojat e saj krahasuar me pavlefshmërinë civile.....	185
Kapitulli VII: Roli i gjykatës në trajtimin e institutit të pavlefshmërisë së veprimeve juridike dhe në zbatim të pasojave (risitë unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara).....	203
7.1 Praktika gjyqësore në lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike dhe pasojat.....	203
7.2 Mjetet procedurale të mbrojtjes nga pavlefshmëria e veprimit juridik	220
7.3 Legjitimimi i palëve në ngritjen e padisë	224
7.4 Parashkrimi i padisë për pavlefshmërinë e veprimit juridik.....	229
7.5 Rregullimi i pasojave të nulitetit absolut (rast përjashtimor në praktikën gjyqësore)	231
7.6 Vlefshmëria e dhurimit midis bashkëshortëve në raport me bashkëpronësinë, dhe vlefshmëria e dhurimit të së drejtës së parablerjes	233
7.7 Funkcioni i transkriptimit të veprimeve juridike në regjistrat e pasurive të paluajtshme.....	235
Kapitulli VIII: Konkluzione dhe Rekomandime.....	242

LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE

Tabela e numrit të padive civile në total dhe padive për pavlefshmëri në total sipas viteve.


Viti	Nr. i padive civile në total	Nr. i padive për pavlefshmëri në total
2006	7646	145
2007	9524	209
2008	11151	199
2009	11020	202
2010	10243	194
2011	10073	188
2012	12944	157
2013	13201	215
2014	12487	209
2015	9452	571

Tabela nr. 1




Grafiku nr. 1

Raporti midis llojeve të ndryshme të padive për pavlefshmëri.




Grafiku nr. 2

Raporti në lidhje me fatin e gjykimit të padive për pavlefshmëri.




Grafiku nr. 3

Raporti në lidhje me zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë.




Grafiku nr. 4

Raporti midis pasojave që janë zgjidhur kryesisht nga gjykata me ato për të cilat gjykata ka disponuar me kthim në të ardhurat e shtetit.




Grafiku nr. 5

Raporti midis padive për zgjidhje të martesës dhe padive për pavlefshmëri të martesës.



Grafiku nr. 6

Raporti midis shkaqeve që shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të veprimeve juridike.



Grafiku nr. 7

Kapitulli I: Hyrje

1.1 Konteksti teorik dhe problematika e studimit.

E drejta e shteteve të ndryshme e trajton në mënyrë të ndryshme konceptin e veprimit juridik dhe transferimin e së drejtës së pronësisë së pasurive të paluajtshme. Në disa shtete, si Franca, Italia, Norvegjia, Meksika, Portugalia, për kalimin e së drejtës së pronësisë, është e mjaftueshme shprehja e lirë e vullnetit të palëve kontraktore, pra, në këto vende zbatohet teoria konsensuale. Në vende të tjera, si Gjermania dhe Brazili, vendet e familjes ligjore gjermanike të së drejtës, përveç pëlqimit me vullnet të lirë të palëve dhe dorëzimit të sendit, kusht pa të cilin kontrata e kalimit të pronësisë është e pavlefshme, duhet edhe një marrëveshje kontraktuale e veçantë midis palëve, për kalimin e pronësisë nga shitësi te blerësi (kontrata reale abstrakte).

Gjithashtu, në Kodin Civil Italian dhe Francez nuk ka një trajtim të veçantë për veprimin juridik, në ndryshim nga Kodi Civil Gjerman, që i bën një trajtim të hollësishëm veprimit juridik, në pjesën e përgjithshme të tij. Në Kodin Civil Gjerman, veprimi juridik ka përparësi ndaj kontratës. Kodet Civile Franceze dhe Italiane, duke qenë se nuk janë të ndarë në dy pjesë, e njësojnë veprimin juridik me kontratat. Në këto vende, kontrata ka përparësi ndaj veprimit juridik, pasi kushtet dhe elementet e vlefshmërisë së veprimit juridik trajtohen në mënyrë specifike tek kontratat. Megjithatë, autonomia kontraktore private, si shprehje e vullnetit të subjekteve për të rregulluar marrëdhëniet e tyre nëpërmjet veprimit juridik, pranohet gjerësisht nga këto shtete. Është pikërisht veprimi juridik mjeti realizues i interesave të palëve kontraktore, në bazë të vullnetit të lirë dhe autonom, pa rënë ndesh me interesat e subjekteve të tjera dhe rendin juridik.

Në Kodin tonë Civil aktual, bëhet një trajtim i hollësishëm i veprimit juridik dhe elementëve të tij, në pjesën e përgjithshme, që përcaktohet si shfaqje e ligjshme e vullnetit të personit fizik apo juridik, që synon të krijojë ndryshojë apo shuajë të drejta ose detyrime civile¹. Ndërsa kontrata është veprimi juridik, me anën e të cilit, një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike². Në këtë analizë shohim se veprimi juridik është një koncept më i gjerë dhe e përfshin kontratën si një nënkategori të tij. Në dispozitat e Kodit Civil të 1994, nuk ka një përkufizim për marrëdhënien juridike, por neni 419 i Kodit Civil e përcakton detyrimin si një marrëdhënie juridike³. Gjithsesi, marrëdhënia juridike është një koncept që përfshin çdo lloj marrëdhënieje midis subjekteve, të rregulluar nga dispozitat ligjore, ndërsa objekti i detyrimit duhet të ketë patjetër një vlerë ekonomike⁴, pra, marrëdhënia juridike e përfshin marrëdhënien e detyrimit. Duke qenë se, në nenin 420 të Kodit Civil parashikohet se detyrimet lindin nga kontratat apo nga ligji, rrjedhimisht, kontrata përfshihet nga marrëdhënia juridike. Marrëdhënia juridike përfshin çdo lloj marrëdhënieje shoqërore pasurore ose jopasurore, kurse kontrata ka si qëllim të rregullojë marrëdhëniet pasurore midis palëve. Në ndryshim nga legjislacioni aktual, Kodi Civil i 1981 e përkufizonte marrëdhënien juridike si marrëdhënie shoqërore me karakter politik e ideologjik, që përcaktohet nga marrëdhëniet socialiste në prodhim dhe rregullohet nga legjislacioni civil⁵. Gjithsesi, marrëdhënia juridike, ashtu si dhe

¹Neni 79 i Kodit Civil.

² Neni 659 i Kodit Civil.

³ Detyrimi është një marrëdhënie juridike, me anën e së cilës, një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditori), i cili ka gjithashtu të drejtë të kërkojë t'i jepet diçka ose të kryhet apo të mos kryhet veprimi.

⁴Neni 421 i Kodit Civil: "Objekti i detyrimit duhet të ketë një vlerësim ekonomik dhe t'u përgjigjet interesave, qoftë dhe jo pasurore të kreditorit".

⁵Neni 11 i Kodit Civil të 1981.

kontrata, përfshihen nga koncepti i veprimit juridik, për vetë faktin që ai iu referohet të drejtave dhe detyrimeve civile në përgjithësi, si një koncept më i gjerë.

Kodi Civil aktual është i ndarë në dy pjesë, tipar ky i familjes ligjore gjermanike dhe trashëgimi e Kodit Civil të 1981. Duke qenë se veprimi juridik e përfshin kontratën, marrëdhënien juridike dhe detyrimin, elementet, kushtet dhe rregullat ligjore të përcaktuara në pjesën e përgjithshme për vlefshmërinë e veprimit juridik, janë të zbatueshme edhe për pjesën e posaçme, që u takon kontratave, marrëdhënieve juridike dhe detyrimeve. Përderisa veprimi juridik ka përparësi ndaj këtyre koncepteve, është e drejtë që Kodi Civil të bëjë një parashikim dhe një rregullim të veçantë për të, rregullim i cili duhet t'i shtrijë efektet edhe te konceptet që kanë si bazë veprimin juridik, konkretisht kontratat e parashikuara në pjesën e posaçme. Pikërisht, kjo shtrirje e normave të veprimit juridik edhe te pjesa e posaçme e Kodit Civil, siguron një garanci të dyfishtë ndaj informalitetit dhe mangësive të vërejtura në sistemin noterial, gjatë hartimit të kontratave, në funksion të mbrojtjes së autonomisë kontraktore të palëve. Në sistemin noterial aktual dhe në marrëdhëniet kontraktore në veçanti, vërehen mangësi dhe ndërthurje të pavlefshmërisë me falsifikimin, duke sjellë shkelje të dispozitave ligjore urdhëruese dhe vesim të konsensusit të palëve. Për këto arsye, është e drejtë që Kodi Civil aktual ka ruajtur në strukturën e tij elementin gjermanik të Kodit Civil të 1981, edhe pse është frymëzuar në hartimin e tij nga Kodi Civil Italian dhe Francez.

Gjithashtu, gjatë analizës së praktikës gjyqësore vërehet se, shqyrtimi i pavlefshmërisë së kontratave të ndryshme, i referohet si pjesës së përgjithshme të Kodit Civil dhe parashikimit që bën ai për pavlefshmërinë e veprimeve juridike, ashtu dhe bazës ligjore të parashikuar në pjesën e posaçme për kontrata të veçanta. Gjithsesi, praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrime të ndryshme në këtë rast, pasi gjatë konstatimit apo shpalljes së

kontratës së pavlefshme, në disa raste, i referohet vetëm parashikimit të bërë në dispozitat e posaçme të Kodit Civil dhe në raste të tjera, u referohet dispozitave të përgjithshme, në lidhje me pavlefshmërinë e veprimit juridik. Edhe në kërkesën drejtuar gjykatës, në disa raste, kërkohet konstatimi apo shpallja e pavlefshmërisë së veprimit juridik të specifikuar në kontratën përkatëse dhe në disa raste, kërkesa për pavlefshmëri i referohet vetëm kontratës.

Analiza e dispozitave ligjore të Kodit Civil përcakton kushtet që duhet të respektojnë palët gjatë kontraktimit të tyre, në mënyrë që veprimet e tyre konsensuale të mos jenë të vesuara dhe t'i rezistojnë kohës, duke plotësuar qëllimin për të cilin janë krijuar. Konkretisht, që një veprim juridik të konsiderohet i vlefshëm, duhet që:

- Palët kontraktore të kenë zotësinë për të vepruar.
- Veprimet juridike të hartohen në formën e përcaktuar me ligj.
- Vullneti i brendshëm i palëve kontraktore të përputhet me vullnetin e shfaqur, pra, të mos ketë mospërputhje të vullnetit.
- Shkaku i veprimit juridik duhet të jetë i ligjshëm.
- Objekti duhet të jetë i mundshëm, i lejuar, i përcaktuar ose i përcaktueshëm.

Veprimet juridike klasifikohen të pavlefshme, kur konstatohet një nga format e shkeljes së ligjshmërisë apo kur vullneti i palëve rezulton i vesuar. Kodi Civil bën dy klasifikime të veprimeve juridike të pavlefshme:

1. Ato të cilat konstatohen të pavlefshme (janë të pavlefshme)⁶.
2. Ato të cilat shpallen të pavlefshme⁷.

⁶ Neni 92 i Kodit Civil të 1994.

⁷ Neni 94 i Kodit Civil të 1994.

Veprimi juridik është absolutisht i pavlefshëm atëherë kur rezulton se, palët nuk kanë shprehur vullnet për të, por mund të ndodhë që palët shprehin vullnet për krijimin e veprimit juridik dhe ky vullnet është i paplotë. Në këtë rast, veprimi juridik ekziston, sepse palët e kanë shprehur vullnetin për të, por duke qenë se vullneti nuk është i plotë, veprimi juridik anulohet. Këto lloj veprimesh quhen relativisht të pavlefshme. Veprimet juridike që konstatohen të pavlefshme përbëjnë grupin e rasteve, të cilat janë konsideruar absolutisht të pavlefshme, ndërsa veprimet juridike që shpallen të pavlefshme, janë konsideruar relativisht të pavlefshme, edhe pse ky term nuk pasqyrohet në legjislacion. Ato sjellin pasoja juridike, deri në momentin e konstatimit të pavlefshmërisë së tyre nga gjykata. Nëse veprimi juridik konstatohet absolutisht i pavlefshëm, ai nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëvonshëm. Pavlefshmëria absolute nuk rregullohet, edhe nëse palët shprehin pëlqimin e tyre apo plotësohet afati i parashkrimit dhe zhduket shkaku i pavlefshmërisë.

Pavlefshmëria relative, në ndryshim nga pavlefshmëria absolute, ekziston dhe sjell pasoja, deri në momentin që njëra nga palët kërkon dhe realizon nga organet gjyqësore anulueshmërinë e tij. Kjo lloj pavlefshmërie e lë aktin pezull, derisa të plotësohet afati i parashkrimit, nëse nuk kërkohet anulueshmëria e aktit nga pala e interesuar. Veprimi juridik është i anulueshëm, por anulueshmëria eliminohet nëse plotësohet afati i parashkrimit dhe palët nuk e pretendojnë anulueshmërinë e aktit gjatë afatit të parashkrimit. Nëse veprimi juridik shpallet i pavlefshëm, ai nuk efektton më pasoja juridike për të ardhmen, madje dhe ato që ka sjellë, rrëzohen.

Në Kodin Civil aktual, kontrata përcaktohet si një nga veprimet juridike të dyanshme më të rëndësishme. Kushtet që duhet të plotësojë kontrata, që të jetë e vlefshme si veprimi juridik më i ndeshur në qarkullimin civil, janë:⁸

- Pëlqimi kontraktor i palëve.
- Të jetë mbështetur mbi një shkak të ligjshëm.
- Të jetë përcaktuar objekti që formon lëndën e kontratës.
- Të ketë formën e caktuar ligjore.

Sipas këtij parashikimi, një kontratë që nuk plotëson këto kushte, konsiderohet e pavlefshme. Pëlqimi kontraktor ka të bëjë me shprehjen e vullnetit të palëve në lidhjen e kontratës dhe me autonominë e vullnetit⁹. Mbështetja e kontratës në një shkak të ligjshëm ka të bëjë me atë që, veprimet juridike nuk duhet të kryhen në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe frymën e ligjit dhe të kenë të përcaktuar objektin që formon lëndën e kontratës, pasi një kontratë pa objekt nuk ekziston. Forma e caktuar e kontratës, u referohet veprimeve formale, të cilat, për të qenë të vlefshme, duhet të vishen me formën e kërkuar nga ligji, për shembull, shitja e sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt noterial. Nëse iu referohemi kushteve të vlefshmërisë së kontratës, kuptohet që kontrata është një nënkategori e veprimeve juridike dhe për vlefshmërinë e tyre duhet të plotësohen të njëjtat kushte.

⁸ Neni 663 i Kodit Civil: “Konditat e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës”.

⁹ Semini. M, “E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave”, Pjesa e Përgjithshme, 1998: 35.

Kushtet e një kontrate klasifikohen në tre lloje: thelbësore, të zakonshme dhe të rastit¹⁰. Zgjidhja e konflikteve që mund të kenë palët me njëra-tjetrën, në lidhje me detyrimet e marra përsipër në një kontratë, realizohet nëpërmjet paraqitjes në gjykatë të një padie themeli ose kundërshtohet me anën e një kundërpadie. Është gjykata ajo që shprehet për vlefshmërinë e kontratës dhe të veprimeve juridike në përgjithësi, si dhe për zgjidhjen e pasojave. Sipas arsyetimeve të bëra nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, një veprim juridik i dyanshëm, siç është kontrata e shitjes ose i njëanshëm, siç është kontrata e huasë, nuk mund të jetë titull ekzekutiv¹¹. Titujt ekzekutivë janë vendimet e gjykatës, si dhe në raste përjashtimore, akte të tjera të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile ose ligje të tjera, të cilat, për nga fuqia ekzekutive barazohen me vendimet gjyqësore. Kontratat janë shprehje vullneti dhe realisht zgjidhja e mosmarrëveshjeve që lindin në lidhje me to, duhet të shqyrtohet nga gjykatat civile. Një akt noterial, që të konsiderohet titull ekzekutiv, duhet të përmbajë në vetvete një veprim juridik me detyrim të njëanshëm dhe abstrakt për pagimin e një shume të caktuar në para. Një deklaratë noteriale që është titull ekzekutiv, mund të goditet vetëm për falsitet ose debitori mund të kërkojë që ky titull ekzekutiv të deklarohet i pavlefshëm, po që se detyrimi nuk ekziston¹². Akti noterial, si titull ekzekutiv, mund të përmbajë edhe detyrime që burojnë nga kontrata të mëparshme apo veprime juridike të mëparshme, por

¹⁰ Semini. M, “E Drejta e Detyrimeve dhe Kontratave”, Pjesa e Përgjithshme, 1998: 42-44. “a) Kushte thelbësore janë ato kushte, mungesa e të cilave e bën kontratën të pavlefshme. Kushtet thelbësore mund të jenë parashikuar shprehimisht nga ligji ose me marrëveshje të palëve. Kushtet thelbësore, duke qenë se nuk janë përcaktuar shprehimisht në dispozitat ligjore, nuk janë të njëjta në të gjitha kontratat, pasi një pjesë e tyre përcaktohen me marrëveshje të palëve. b) Kushte të zakonshme konsiderohen kushtet, të cilat parashikohen nga normat lejuese dhe gjenden në lloje të veçanta kontratash. Edhe nëse palët kontraktore nuk i kanë parashikuar këto kushte, presupozohet se ato janë të parashikuara, pasi janë dispozitat ligjore ato që i kanë parashikuar. c) Kushte të rastit janë ato kushte, të cilat parashikohen në një kontratë, pasi një gjë të tillë e kërkojnë vetë palët. Kushtet e rastit, mund të ndodhë që të jenë të ndryshme nga kushtet e zakonshme dhe kjo ndodh kur vetë ligji lejon që palët të parashikojnë kushte të ndryshme nga normat lejuese, në lidhje me kontratat specifike”.

¹¹ Vendimi nr. 980, datë 15.09.2000 dhe 29.09.2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹² Neni 609/1 i Kodit të Procedurës Civile.

që në momentin që detyrimi merret përsipër nga debitori, ky detyrim i ri është i pavarur nga i mëparshmi dhe për ekzekutimin e tij, shuma në fjalë mund të nxirret dhe nga burime të tjera pasurore të debitorit. Pra, sipas këtij arsytimi, kontratat në veçanti dhe veprimet juridike në përgjithësi, nuk janë tituj ekzekutivë, por janë marrëveshje të vullnetshme midis palëve pjesëmarrëse, mosmarrëveshjet e të cilave zgjidhen gjyqësisht.

1.2 Specifikimi dhe kufizimet e studimit

Ky studim ka trajtuar konceptin e pavlefshmërisë së veprimit juridik në aspektin e ndryshimeve në vite, duke krahasuar dhe analizuar në legjislacion dhe në doktrinën shqiptare, tajtimin që i është bërë veprimit juridik dhe kontratave të ndryshme, konkretisht në të drejtën zakonore shqiptare, Kodin Civil të 1929, Kodin Civil të 1981 dhe Kodin Civil të 1994. Gjithashtu, studimi ka analizuar konceptin e pavlefshmërisë së veprimit juridik në sisteme të ndryshme ligjore, kryesisht italiane, franceze, gjermane, zviceriane, por dhe të vendeve të common law dhe atyre lindore. Megjithatë, në përputhje me qëllimin, studimi është përqendruar dhe kufizuar më shumë në praktikën gjyqësore vendase dhe të huaj, si dhe në rolin e gjykatës në zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë. Punimi është fokusuar në trajtimin e rolit që disponon gjykata në rastin e konstatimit kryesisht të pavlefshmërisë së veprimit juridik, si dhe në rastin e zbatimit të pasojave të pavlefshmërisë, në mënyrë të veçantë asaj absolute, të kryer në kundërshtim me ligjin dhe në mashtrim të ligjit. Janë trajtuar rastet e pavlefshmërisë, kur gjykata duhet të shprehej me kthim në të ardhurat e shtetit, për veprimet juridike të kryera në kundërshtim të ligjit apo në mashtrim të ligjit, sipas nenit 106 të Kodit Civil.

Pjesë e këtij punimi është studimi sasior dhe analiza statistikore e krahasimore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, ku janë trajtuar 107 441 vendime civile themeli në total ndër vite, nga të cilat kanë rezultuar 2289 vendime gjykate për pavlefshmërinë e veprimeve juridike në total. Këto janë klasifikuar në formë statistikore, sipas llojit të pavlefshmërisë, zgjidhjes së pasojave nga gjykata dhe fatit të gjykimit të çështjes. Janë klasifikuar gjithashtu vendimet, pasojat e të cilëve janë konstatuar kryesisht nga gjykata, në raport me ato vendime ku gjykata, në lidhje me pasojat, është shprehur kryesisht me kthim në të ardhurat e shtetit, sipas nenit 106 të Kodit Civil. Është analizuar raporti midis konstatimit kryesisht të pavlefshmërisë absolute nga gjykata, me atë të kërimit nga palët. Kjo analizë është bërë e ndërvarur dhe nga qëndrimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke analizuar faktin sa ky qëndrim unifikues ndiqet nga gjykatat e ndryshme shqiptare gjatë arsyetimit dhe disponimit të tyre.

1.3 Struktura e studimit

Ky studim është strukturuar në tetë kapituj. Në zbatim të metodologjisë së përdorur, qëllimit, hipotezës dhe pyetjeve kërkimore, në tre kapitujt e parë është përdorur analiza përshkruese, sistematike dhe historike e doktrinës dhe kuadrit normativ, e kombinuar me analizën krahasimore të trajtimit të pavlefshmërisë së veprimit juridik në periudha të ndryshme historike. Në katër kapitujt në vijim është aplikuar analiza rishikuese dhe interpretuese e doktrinës dhe ligjit, e pasqyruar kjo në praktikën gjyqësore për çdo konstatim. Në këta kapituj, është aplikuar edhe analiza sasiore statistikore dhe krahasuese e praktikës gjyqësore me risitë e efektuara prej saj. Në kapitullin e tetë janë përfshirë konkluzionet dhe rekomandimet e këtij studimi.

Konkretisht:

Kapitulli I: “Hyrja” paraqet kontekstin e studimit, modelin teorik dhe argumentet kryesore të tij, problematikën e përgjithshme të trajtuar në këtë studim, specifikimin dhe kufizimet e literaturës, analizën e studimit, si dhe strukturën organizative të kapitujve të studimit.

Kapitulli II: “Metodologjia dhe modeli analitik” paraqet një përshkrim të hollësishëm të doktrinës së studiuar dhe të përdorur për realizimin e këtij punimi. Është pasqyruar në këtë kapitull qëllimi, hipoteza, pyetjet kërkimore, si dhe një përshkrim i hollësishëm i metodologjisë dhe metodave të aplikuara në këtë studim.

Kapitulli III: “Pavlefshmëria e veprimit juridik në aspektin historik dhe krahasues (E drejta Kanunore, Kodi Civil i 1929, Kodi Civil i 1981)”, pasqyron një analizë përshkruese, historike e sistematike të doktrinës së kohës dhe kuadrit ligjor përkatës, krahasuar me atë aktual, në lidhje me trajtimin që i është bërë institutit të pavlefshmërisë së veprimit juridik dhe pasojave të pavlefshmërisë gjatë periudhave të ndryshme në legjislacionin shqiptar.

Kapitulli IV: “Veprimet juridike të pavlefshme dhe pasojat e pavlefshmërisë në sisteme të ndryshme ligjore” përfshin një analizë përshkruese, interpretuese e krahasimore të doktrinës së vendeve të ndryshme, konkretisht gjermane, zviceriane, italiane, franceze, por dhe doktrinës së vendeve të common law, si angleze dhe amerikane, si dhe të vendeve lindore polake, bullgare e rumune. Janë studiuar dhe janë përfshirë në punim Kodet Civile përkatëse të këtyre vendeve, në lidhje me trajtimin që i bëjnë veprimit juridik dhe pavlefshmërisë së tij. Gjithashtu, janë trajtuar ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre, bazuar në origjinën e përbashkët apo të ndryshme të familjeve ligjore nga të cilat kanë rrjedhur, si dhe risitë e doktrinës së huaj në lidhje me trajtimin e

pavlefshmërisë së veprimit juridik dhe pasojave të tij, krahasuar me atë vendas. Është trajtuar praktika gjyqësore dhe janë përfshirë në këtë kapitull vendime të gjykatave të ndryshme italiane, franceze dhe gjermane, për faktin se Kodi ynë Civil është frymëzuar nga Kodet Civile të këtyre vendeve.

Kapitulli V: “Pavlefshmëria e veprimeve juridike dhe llojet e pavlefshmërisë (doktrina, ligji dhe praktika gjyqësore)” përfshin një analizë rishikuese dhe interpretuese të doktrinës dhe bazës ligjore, kombinuar kjo me atë krahasimore të praktikës gjyqësore, si dhe disponimin e gjykatës për secilin rast të pavlefshmërisë së veprimeve juridike. Është zbatuar analiza statistikore dhe klasifikuese e llojeve të ndryshme të pavlefshmërive, e nxjerrë nga studimi i kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (2006-2016).

Kapitulli VI: “Klasifikimi i pasojave të pavlefshmërisë së veprimeve juridike sipas ligjit dhe praktika gjyqësore” paraqet një analizë krahasimore dhe interpretuese të pasojave të pavlefshmërisë së veprimeve juridike, sipas doktrinës dhe parashikimeve të bëra në Kodin Civil, e shoqëruar me zbatimin konkret të këtyre pasojave, nga ana e praktikës gjyqësore. Është trajtuar dhe krahasuar qëndrimi dhe arsyetimi i gjykatave të ndryshme shqiptare dhe të huaja, në lidhje me zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë absolute dhe relative, analizuar kjo, në funksion të parashikimeve të dispozitave ligjore konkrete. Është aplikuar analiza sasiore e krahasimore, duke studiuar trendin e gjykatës në lidhje me zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë dhe fatin e gjykimit, si dhe është analizuar fakti sesa praktika gjyqësore u qëndron parashikimeve të dispozitave të Kodit Civil në lidhje me zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë. Kjo është realizuar me anën e studimit sasior dhe analizës statistikore e krahasuese të pasojave të pavlefshmërisë dhe

fatit të gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën (2006-2016), pasqyruar studimi në grafikët përkatës.

Kapitulli VII: “Roli i gjykatës në trajtimin e institutit të pavlefshmërisë së veprimeve juridike dhe në zbatimin e pasojave (risitë unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara)” përfshin një trajtim të analizës krahasimore e interpretuese të disponimeve të vendimeve të ndryshme gjyqësore, kryesisht ato të kuadrit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe Kasacionit Civil italian, për pavlefshmërinë dhe zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë së veprimeve juridike, në mënyrë të veçantë, pasojave të pavlefshmërisë absolute të shprehura kryesisht nga gjykata, si dhe fakti sa ka ndikuar precedenti unifikues i Gjykatës së Lartë në zbatimin e pasojave nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

Janë trajtuar në kuadrin e praktikës gjyqësore unifikuese mjetet proceduriale të mbrojtjes nga pavlefshmëria e veprimit juridik, legjitimiteti i palëve në ngritjen e padisë, parashkrimi i padisë për pavlefshmërinë e veprimit juridik. Në këtë kapitull, është trajtuar rregullimi i pasojave të nulitetit absolut, shqyrtuar si rast përjashtimor në praktikën gjyqësore, i cili ka tejkaluar doktrinën dhe parashikimin që i është bërë në legjislacion pavlefshmërisë absolute. Është trajtuar vlefshmëria e veprimit juridik të dhurimit midis bashkëshortëve dhe vlefshmëria e dhurimit të së drejtës së parablerjes, si dhe pasojat që ato efektojnë, analizuar në këndvështrimin e praktikës gjyqësore dhe risive unifikuese të saj. Është trajtuar gjithashtu, në kuadër të praktikës unifikuese të Gjykatës së Lartë, interpretimi i nenit 83 të Kodit Civil të 1994 dhe funksioni i publikimit deklarativ të transkriptimit të veprimeve juridike në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Në këtë kapitull, janë përdorur të dhëna statistikore dhe krahasuese, të marra nga një studim tjetër, në të cilin janë grupuar dhe klasifikuar 21 vendime të

Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për periudhën 2000-2011 dhe në lidhje me këto të dhëna, është paraqitur në formë grafike, raporti midis shkaqeve të ndryshme të pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike¹³.

Kapitulli VIII: “Konkluzione dhe rekomandime” përfshin një pasqyrë përmbledhëse të përfundimeve të arritura nga ky studim dhe të rekomandimeve të propozuara për përmirësimin e legjislacionit, si dhe të rolit që duhet të kenë gjykatat shqiptare, në lidhje me funksionin e tyre të interpretimit gjyqësor të ligjit, për zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë së veprimeve juridike.

¹³Semini. M, (2013) “Pavlefshmëria e Veprimeve Juridike nën Këndvështrimin e Kodit Civil, Doktrinës dhe Praktikës Gjyqësore”, Revista “Jeta Juridike”, nr. 4.

Kapitulli II: Metodologjia dhe Modeli Analitik

2.1 Literatura e përdorur

Për hartimin e këtij punimi, klasifikimin dhe llojet e pavlefshmërisë së veprimeve juridike e pasojave të tyre, si dhe vlerësimin e rolit të gjykatës në lidhje me zbatimin e këtyre pasojave, është përdorur literatura bazë, ligje dhe ndryshime ligjore, vendime gjyqësore si dhe burime interneti.

Në funksion të hipotezës dhe pyetjeve kërkimore, është analizuar doktrina bazë, artikuj dhe autorët kryesorë vendas, të cilët kanë trajtuar pavlefshmërinë e veprimeve juridike dhe kjo doktrinë është analizuar në të gjitha rastet e ndërvarura nga kuadrin normativ. Doktrina është analizuar në aspektin krahasues, në periudha të ndryshme, duke filluar nga trajtimi që i është bërë pavlefshmërisë së veprimeve juridike në të drejtën Kanunore, konkretisht në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe Kanunin e Labërisë, më tej në Kodin Civil të 1929, Kodin Civil të 1981 dhe Kodin Civil të 1994. Si pjesë e doktrinës vendase, në këtë punim janë shqyrtuar 52 artikuj dhe libra, të cilët kanë trajtuar pavlefshmërinë e veprimeve juridike.

Punimi ka trajtuar gjithashtu doktrinën e huaj dhe Kodet Civile të vendeve të ndryshme krahasuar me atë vendas, duke analizuar ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre. Pjesë e këtij punimi është kryesisht doktrina italiane, franceze dhe gjermane, duke qenë se Kodi ynë Civil është një miksim midis Kodit Civil gjerman dhe atij italo-francez, por është analizuar dhe trajtimi që i bëhet pavlefshmërisë së kontratave në doktrinën e vendeve lindore, si atë polake, bullgare e rumune. Gjithashtu, është analizuar doktrina e së drejtës së common law dhe së drejtës së krahasuar, në lidhje me trajtimin krahasues të pavlefshmërisë së veprimit juridik. Doktrina është trajtuar fillimisht në aspektin

përshkrues, analizues dhe krahasimor, midis vendeve që ndjekin traditën e common law dhe atyre të civil law dhe, më tej, është analizuar pavlefshmëria e veprimit juridik dhe kalimit të pronësisë në Gjermani dhe Zvicër, krahasuar me atë në Itali e Francë.

Si pjesë e doktrinës së huaj në këtë punim janë shqyrtuar 50 artikuj dhe libra, të cilët kanë trajtuar pavlefshmërinë e veprimeve juridike. Është studiuar parashikimi që i është bërë pavlefshmërisë së veprimit juridik dhe kontratave në Kodet Civile gjermane, italiane, franceze, zviceriane, polake, rumune, bullgare.

Në këtë punim është analizuar edhe praktika gjyqësore, duke grupuar, studiuar dhe krahasuar arsyetimin dhe disponimin gjyqësor unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjykatave të shkallëve të ndryshme të vendit tonë.

Konkretisht, janë përfshirë në këtë punim dhe janë cituar 38 vendime të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por janë marrë në studim rreth 50 vendime të tilla në periudhën kohore 2000-2016. Janë bërë pjesë e punimit dhe janë cituar pesë vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe 35 vendime të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykatave të ndryshme të Apelit dhe të Rretheve Gjyqësore.

Në këtë punim përfshihet një studim sasior dhe krahasues i kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën dhjetëvjeçare 2006-2016, ku janë marrë në studim 107441 vendime gjykate (padi civile themeli në total), sipas shpërndarjes grafike në dhjetë vjet. Nga këto rezultuan 2289 vendime gjykate me padi për pavlefshmëri.

Në bazë të analizës statistikore dhe klasifikuese, nga 2289 vendimet e gjykatës për pavlefshmëri, në formë grafike u studiua dhe u pasqyrua raporti midis padive civile të themelit në total, me ato të pavlefshmërisë në total, sipas viteve përkatëse, duke parë ecurinë e padive për pavlefshmëri në vite të ndryshme. U studiua dhe u pasqyrua në

formë grafike, raporti midis llojeve të ndryshme të padive për pavlefshmëri, konkretisht paditë për pavlefshmëri të veprimeve juridike sipas nenit 92 dhe 94 të Kodit Civil, paditë për pavlefshmëri kontrate, paditë për pavlefshmëri testamenti dhe paditë, ku në objektin e tyre kërkohet, njëkohësisht, pavlefshmëria e veprimit juridik dhe e kontratës specifike, me bazë ligjore nenin 92 dhe 94 të pjesës së përgjithshme të Kodit Civil për veprimet juridike dhe pjesës së posaçme të tij për kontratën specifike. U studiua dhe u pasqyrua, në formë grafike, raporti midis pavlefshmërisë së martesës si veprim juridik personal, me atë të zgjidhjes së martesës. U studiua dhe u pasqyrua, në formë grafike, trendi i gjykatës, për zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë, duke i klasifikuar në ato të kërkuara nga palët dhe të shprehura nga gjykata, të kërkuara nga palët dhe të pashprehura nga gjykata, të pakërkuara nga palët dhe të zgjidhura kryesisht nga gjykata. U studiua dhe u pasqyrua, në formë grafike, fati i gjykimit të padive, duke i klasifikuar në padi të gjykuara, padi të pranuar, padi të pushuara, padi të rrëzuara dhe padi për të cilat është vendosur kthim akti ose moskompetencë. Gjithashtu, u studiua dhe u pasqyrua në formë grafike, raporti midis pasojave në total, të cilat nuk janë kërkuar nga palët, por janë zgjidhur kryesisht nga gjykata, me ato për të cilat gjykata ka parashikuar kthim në të ardhurat e shtetit, sipas nenit 106 të Kodit Civil. U studiua trendi i gjykatës, në lidhje me llojet e pasojave të aplikuara për pavlefshmërinë absolute dhe atë relative, si dhe raporti midis konstatimit kryesisht të pavlefshmërisë absolute nga gjykata, me atë të kërimit nga palët. U studiua trendi i gjykatës, në lidhje me rregullimin e pasojave ndaj personave të tretë, pasuria e së cilëve, është përfituar nga një veprim juridik i pavlefshëm.

Në këtë punim, janë përdorur dhe të dhëna statistikore dhe krahasuese, të marra nga një studim tjetër, në të cilin janë grupuar dhe klasifikuar 21 vendime të Kolegjeve të

Bashkuara të Gjykatës së Lartë për periudhën 2000-2011 dhe është paraqitur në formë grafike raporti midis shkaqeve të ndryshme të pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike.

Në funksion të metodologjisë krahasimore, ngjashmërive dhe dallimeve me disponimet e gjykatave të vendeve të tjera, janë përfshirë në këtë punim, vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, vendime të Kasacionit Civil italian, francez dhe të Gjykatës së Lartë Federale gjermane, vendime të Seksioneve të Bashkuara të Kasacionit Civil italian dhe francez, vendime të Këshillit të Shtetit italian, si dhe vendime të gjykatave të shkallëve të ndryshme italiane dhe gjermane. Konkretisht, janë bërë pjesë e këtij punimi dhe janë cituar në të, katër vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, 24 vendime të Kasacionit Civil italian, frances dhe të Gjykatës së Lartë Federale gjermane, pesë vendime të Seksioneve të Bashkuara të Kasacionit Civil italian dhe francez, katër vendime të Këshillit të Shtetit Italian, gjashtë vendime të gjykatave të shkallëve të ndryshme italiane dhe gjermane.

2.2 Qëllimi i studimit

Objektivat dhe qëllimi i këtij punimi qëndrojnë pikërisht në studimin e rolit të legjislacionit, doktrinës dhe praktikës gjyqësore, në rregullimin që i bëhet pavlefshmërisë së veprimit juridik dhe veçanërisht zbatimit të pasojave të pavlefshmërisë së veprimit juridik, pasi qëllimi i palëve në proces është zgjidhja e pasojave. Ky studim synon të analizojë trendin e gjykatës, veprimtarinë dhe limitet e disponimit të gjyqësorit, në funksion të doktrinës dhe kornizës normative të Kodit Civil, për pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik, në mënyrë të veçantë, për pasojat e pavlefshmërisë absolute.

2.3 Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

Doktrina dhe kuadri ligjor në vite ka dhënë zgjidhje të pjesshme për pavlefshmërinë dhe pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik, në mënyrë të veçantë, për pasojat e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike, të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre të kryera në mashtim të ligjit.

Praktika gjyqësore, gjithashtu, disponon në mënyrë jo të unifikuar në lidhje me pasojat e pavlefshmërisë, kryesisht atyre të pavlefshmërisë absolute, duke vendosur në diskutim rolin pasiv të gjyqësorit, problem ky i krijuar nga neni 106 i Kodit Civil, pasi palët mund të mos kenë interes legjitim në kërkimin drejtuar gjykatës për pasojat.

Në bazë të studimit të doktrinë, ligjit dhe krahasimit të praktikës gjyqësore shtrihen pyetjet kërkimore:

- Cili është kufiri ndarës midis pavlefshmërisë absolute dhe pavlefshmërisë relative, nisur nga raporti midis të drejtës së kërkimit nga palët dhe gjykimit kryesisht të çështjes së themelit nga gjykata?
- Kush e disponon rolin aktiv kur konstatohet kryesisht pavlefshmëria e veprimit juridik dhe zgjidhen pasojat e tij?
- Cilat janë dallimet doktrimore dhe cili është trendi i gjykatës, lidhur me konstatimin e pavlefshmërisë së një veprimi juridik dhe kërkimit të pavlefshmërisë së veprimit juridik?
- Cilat janë dallimet midis pavlefshmërisë së veprimeve juridike të parashikuara në nenet 92-95 të Kodit Civil me pavlefshmërinë e parashikuar në nenet 663, 674, 677, 678 dhe 680 të Kodit Civil? Si do të ndërthuren raportet midis *jus comune* me *jus singularis* në këtë rast?

- Si ka ecur praktika gjyqësore në rastet e pavlefshmërisë absolute, kur si pasojë duhet të parashikohet kthimi në të ardhurat e shtetit, sipas nenit 106 të Kodit Civil?
- A është restitucioni karakteristikë për pavlefshmërinë absolute apo relative, parë në këndvështrimin e praktikës gjyqësore?
- A mundet që restitucioni i dyanshëm të jetë pasojë për të gjitha rastet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të parashikuara në nenin 92 dhe 94 të Kodit Civil? A mund të zbatohet analogjia e pasojës së veprimeve juridike të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre të kryera në mashtrim të ligjit?
- Kur gjykata konstaton kryesisht pavlefshmërinë, a mund të disponojë dhe për pasojat në të njëjtin vendim gjyqësor apo zgjidhjen e pasojave palët mund ta kërkojnë në një tjetër gjykim?
- Nëse gjykata do të kufizohet në konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik, pa u shprehur për pasojat, a nuk do t'i ngjante një vendimi gjyqësor për vërtetim fakti?

2.4 Metodologjia e punimit

Metodologjia e përdorur në këtë punim është në funksion të vërtetimit të hipotezës dhe pyetjeve kërkimore për arritjen e qëllimit. Në këtë punim, është aplikuar metodologjia e kombinuar, konkretisht analiza rishikuese dhe interpretuese e doktrinës dhe e ligjit, me atë statistikore, klasifikuese e krahasimore të vendimeve të ndryshme gjyqësore, pasi në lidhje me çështje të ngjashme, gjykatat shqiptare mbajnë qëndrime të ndryshme dhe pjesërisht të unifikuara, në mënyrë të veçantë për pasojat e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre të kryera në mashtrim të ligjit. Në disa raste, gjykatat konstatojnë kryesisht dhe shprehen edhe për zgjidhjen e pasojave të një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm, edhe pse një gjë e tillë nuk

kërkohej nga palët në proces dhe në disa raste thjesht konstatojnë pavlefshmërinë sipas kërkesës.

Në kapituj të ndryshëm të këtij punimi, janë përdorur metoda të ndryshme (të pasqyruara në strukturën e studimit), si ato përshkruese, interpretuese, analizuese, rishikuese, sasiore, statistikore, klasifikuese e krahasimore, në funksion të objektivave të punimit. Gjithashtu, brenda një kapitulli, është kombinuar metodologjia.

I është bërë një analizë interpretuese kuadrit ligjor dhe problematikës së zbatueshmërisë së tij në praktikën gjyqësore, nëpërmjet studimit të vendimeve të ndryshme gjyqësore me metodën sasiore të klasifikimit dhe krahasueshmërisë së tyre, për të nxjerrë në dukje përjasjen e gjyqësorit me doktrinën dhe kuadrin ligjor.

Analiza rishikuese e doktrinës është realizuar nëpërmjet mbledhjes dhe studimit të autorëve kryesorë vendas dhe të huaj, të cilët kanë trajtuar institutin e pavlefshmërisë së veprimeve juridike dhe pasojat e pavlefshmërisë në vite. Këta autorë dhe analiza përshkruese e rishikuese e doktrinës së tyre është trajtuar e ndërvarur me interpretimin e kuadrit ligjor, të klasifikuar sipas periudhave historike, të cilave u përkasin.

Gjithashtu, për trajtimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik dhe pasojave të tij, gjatë periudhave të ndryshme historike, është përdorur metoda e analizës historike, shoqëruar me analizën sistematike e krahasimore të doktrinës dhe kuadrit ligjor.

Në këtë punim, është përdorur metoda sasiore dhe analiza statistikore, duke kryer një studim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vitet 2006-2016, ku u morën në shqyrtim 107741 vendime gjykate civile në total dhe nga këto rezultuan 2289 vendime gjykate për pavlefshmëri. Në bazë të klasifikimit dhe krahasimit statistikor, pasqyruar në grafikë të ndryshëm, u studiua: a) ecuria e padive të pavlefshmërisë në vite, në raport me paditë civile të themelit në vite; b) raporti midis llojeve të ndryshme të padive për

pavlefshmëri; c) trendi i gjykatës në lidhje me zbatimin e pasojave të pavlefshmërisë; e) fati i gjykimit të padive për pavlefshmëri; f) raporti midis padive, pasojat e të cilave janë zgjidhur kryesisht nga gjykata pa u kërkuar nga palët, me ato për të cilat gjykata ka disponuar kryesisht me kthim në të ardhurat e shtetit.

Kapitulli III: Pavlefshmëria e veprimit juridik në aspektin historik dhe krahasues (E Drejta Kanunore, Kodi Civil i 1929, Kodi Civil i 1981)

Krijimi dhe forcimi i principatave feudale shqiptare të shekullit të XII deri XV tregon gjithashtu një shkallë zhvillimi në fushën e veprimeve juridike dhe në hartimin e akteve të ndryshme kontraktore, si kontrata porosie, dhurimi, huapërdorjeje, prokure, testament, njohje detyrimi, etj. Ky zhvillim i këtyre koncepteve juridike erdhi si rezultat i zhvillimit dhe pasurimit të jetës ekonomike, shoqërore, qarkullimit civil, zhvillimit të tregtisë e marrëdhënieve të ndryshme juridike midis qyteteve të ndryshme.

“Kontratë Dhurimi midis Gjon Kastriotit e djemve të tij dhe manastirit të Hilandarit, për fshatrat Radostushe dhe Trebisht, viti 1426:

... unë mëkatari dhe i pamerituari ...Gjon Kastrioti me bijtë e mij ... i dhuruam manastirit të shenjtë fshatin Radostushe me Kishën që është në atë fshat dhe fshatin Trebisht” (Luarasi.A, “Aktet Juridike”, 1999:87)

Në këtë kontratë, përshkruhen qartësisht të gjitha të drejtat e tjera, që manastiri mund të gëzojë nëpërmjet kësaj kontrate dhurimi, duke përjashtuar pagimin e haraçit karshi mbretit. Në fund të aktit, është përcaktuar nga vetë Gjon Kastrioti data dhe nënshkrimi i tij me vulën e principatës, element i rëndësishëm i një kontrate dhurimi edhe në kohët moderne.

“Kontratë dhurimi për një shtëpi që gjendet në Durrës, Dubrovnik, 6 Shtator 1400:

... Në Dubrovnik, në praninë e dëshmitarëve të ftuar dhe të lutur, veçanërisht për këtë çështje dhe në prani të të tjerëve, po aty zonja Maria, e veja e këpucarit Domeni nga Durrësi, me dijeninë e saktë të saj dhe me vullnetin e saj të mirë dhe të paitejes, në emër dhe me titull të dhurimit të pastër, të lirë dhe të thjeshtë... dhurim i cili për asnjë shkak mosmirënjohjeje apo fyerje nuk mund të revokohet, i dha, i lëshoi dhe i dhuroi zonjës Dome, bijës së të ndjerit mjeshtër Nikolla Sinagana ... një shtëpi dërrasash të mbuluara me tjegulla, me dyqan dhe me kopësht, të lidhura së bashku, që ishte pronë e ish-burrit të saj, Domenikut. Kjo shtëpi nga njëra anë ka për kufij shtëpinë e Gjergj

Gaverertës, nga ana tjetër shtëpinë e këpucarit Teodor dhe nga anët e tjera rrugët publike... në mënyrë që Domja tash e tutje ta ketë, ta mbajë dhe ta posedojë shtëpinë në fjalë, së bashku me kopshtin dhe të gjitha të drejtat e saj, ... por me angarinë e pagimit të tetë groshëve vjetorë, siç ka qenë zakon të paguhej për atë shtëpi. Për më tepër, me kusht që e thëna Dome për sa kohë që Maria të rrojë në këtë botë të mos e shesë, as të mos e falë, as të mos e tjetërsojë atë shtëpi". (Luarasi. A, "Aktet Juridike", 1999:122)

Në këtë kontratë, shihen elemente të një dhurimi me kusht, që nuk njihet në legjislacionin e sotëm shqiptar. Megjithatë, përshkrimi i hollësishëm që i është bërë pronës, kufizimet e saj, të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe përcaktimi i qartë i gjeneraliteteve të tyre, janë elemente kryesorë të një kontrate dhurimi edhe në legjislacionin e sotëm.

3.1 Kanuni i Lekë Dukagjinit

Kanuni, si korpusi ligjor më i rëndësishëm, ardhur nga shekujt e historisë së shqiptarëve të Malësisë, patjetër që përmban rregullime të veçanta dhe për marrëdhëniet kontraktore, krahas gjithë normave rregulluese të pashkruara, të transmetuara nga brezi në brez, për organizimin e jetës në Malësinë shqiptare. Marrëdhëniet kontraktore, si shkëmbimi e shitja, janë marrëdhënie që kanë ardhur nga lashtësia dhe kjo bën që ato të gjejnë një rregullim të veçantë në Kanunin e Lekë Dukagjinit:

“452. Kanuni i tregtis a blen e shet pa qyshkë, d.m.th. me të këputun, a edhe me qyshkë, faqe dishmitarve, a edhe me kapar.

453. Kapari asht njaj grosh (të hollash), qi epet para se të mirret në dorë gjaja qi blehet” (Kanuni i Lekë Dukagjini, 2013:51).

Pra, Kanuni bën një rregullim të veçantë të marrëdhënies kontraktore të shitjes, si një veprim juridik, madje ai ka të përcaktuar në mënyrë të hollësishme çmimet e produkteve

kryesore të Malësisë së asaj kohe¹⁴. Kanuni nuk e parashikon veprimin juridik në përgjithësi, por u referohet kontratave të veçanta dhe rregullave të vlefshmërisë së tyre. Edhe kapari, si një element i rëndësishëm i tregtisë dhe shitjes, ka një përcaktim të veçantë në Kanun. Nëse për një shitje paguhet një kapar, sipas Kanunit, malli bëhet i blerësit me kapar. Edhe nëse blerësi, pas pagesës së kaparit, tërhiqet nga kjo tregti dhe nuk paguan çmimin përfundimtar të sendit, ai e humbet kaparin, i cili nuk i kthehet më nga ana e shitësit:

“Po u pendue blesi edhe 100 grosh kapar me pasë i hupin” (Kanuni i Lekë Dukagjinit, 2013:52).

Shitja me kapar në Kanun ka elemente të kontratës së shitjes me kusht në ditët e sotme, ku përcaktohen sanksione për blerësin në lidhje me kaparin e paguar, nëse tërhiqet në mënyrë të njëanëshme nga kontrata e shitjes dhe pagesa e çmimit përfundimtar. Gjithashtu, Kanuni e përcakton si të jashtëligjshëm faktin nëse shitësi e shet diku tjetër sendin për të cilin është paguar kapar, edhe pse ai tjetri mund ta ketë paguar më tepër. Në këto raste, pleqtë e kanunit e detyrojnë shitësin që ta marrë përsëri sendin dhe t’ia japë atij, i cili ka paguar kapar:

“459. Me ba me u rrejt shitsi, tuj ia shitë tjetërkuejt gjanë e kaparueshme pse e dha ma tepër aj tjetri, tregu asht i paligjshëm. 460. Po hini puna nder pleq e pegje kanuni e ban shitsin qi ta stërmarrë gjanë e t’i a apë atij, qi e pat kaparue.” (Kanuni i Lekë Dukagjinit, 2013:52)

Pra, Kanuni ka përcaktuar shkaqet e paligjshmërisë dhe pavlefshmërisë së kontratës së shitjes dhe tregtisë midis palëve. Gjithashtu, nëpërmjet pleqve të Kanunit (si një gjykatë), zgjidhen dhe pasojat e këtyre veprimeve të paligjshme, nëpërmjet marrjes së

¹⁴ Kanuni i Lekë Dukagjinit, “nye i shtatëdhetenandë, çmime në kanu” 2013:53.

sendit nga personi i tretë, të cilit i është shitur ky send në mënyrë të paligjshme nga shitësi dhe kthimi i tij te pala që ka paguar kapar. Kanuni ka të përcaktuar dhe zgjidhjet e pasojave për sendet që pas shitjes dalin me të meta ose për sendet e vjedhura. Në këtë rast, shitësi detyrohet t'i kthejë blerësit çmimin e shitjes dhe sendi i vjedhur t'i kalojë pronarit të vërtetë të tij¹⁵.

Një element i rëndësishëm i hasur në Kanun është ajo që sot e quajmë e drejta e parablerjes për pasuritë e paluajtshme. Kanuni ka të përcaktuar detyrimin se, kur shitet një tokë, shitësi është i detyruar t'u drejtohet fillimisht kushërinjve, vëllazërisë e fisit, pastaj nëse këta nuk pranojnë ta blejnë tokën, u drejtohet kufitarëve dhe më tej është i lirë ta shesë te cilido në katund. Nëse ndodh që të mos e blejë asnjë nga katundi, atëherë shitësi është i lirë t'ia shesë kujtdo. Kjo ndodh, pasi qëllimi ishte që toka, mulliri apo çdo pasuri e paluajtshme, të mos dilte jashtë katundit. Nëse shitja do të bëhej pa zbatuar këtë procedurë, atëherë kontrata e shitjes do të konsiderohej e paligjshme dhe pleqtë e Kanunit mund ta detyronin blerësin që ta kthente këtë tokë. Pra, edhe ky shkak në Kanun përfshihej në shkaqet që e bënin një kontratë të paligjshme. Madje Kanuni, në këto lloj kontratash, ka të përcaktuar dhe i jep një rëndësi asaj që sot e quajmë mirëbesim të palës blerëse, pasi në këtë rast, sipas Kanunit, pala blerëse nuk mund të ketë pretendime, përsa kohë e ka ditur që bleu një pronë jashtë rregullave, por natyrisht Kanuni përcakton se atij do t'i kthehen të hollat e tij. Nëse blerësi nuk e ka ditur këtë gjë, pasi shitësi i ka thënë se e ka zbatuar këtë procedurë, atëherë shitësi, përveç prishjes së kontratës, edhe gjobitet¹⁶.

¹⁵ Kanuni i Lekë Dukagjinit, 2013:52.

¹⁶ Kanuni i Lekë Dukagjinit "Tregu i Tokës" 2013:52.

Kanuni ka të përcaktuar edhe kushtet për shitjen e pasurive të paluajtshme, armët, kuajt, bagëtitë dhe për vlefshmërinë e këtyre shitjeve duhet të zbatohen procedurat e përcaktuara në Kanun. Në librin e gjashtë të Kanunit janë të përcaktuara rregullat e zbatuara për “Të dhanunat”, ose huaja:

“499. Kanuja e malevet nuk njef uha me shtojca fitimesh (fajde). 500. Kanuja njef uha të fjeshtë: sa të dhaçë ke me më dhanë” (Kanuni i Lekë Dukagjinit, “Të dhanunat”, 2013:56).

E drejta zakonore shqiptare nuk e njeh si veprim të ligjshëm kontratën e huasë me interes ose atë që quhej fajde, pasi fajdeja në Kanun ishte një veprim i paligjshëm. Huaja e të drejtës zakonore shqiptare ngjan deri diku me huapërdorjen, sipas legjislacionit aktual, pasi me Kanun, palët duhet të kthenin po atë send ose shumë të hollash që merrnin të pashoqëruar me normën e fajdesë. Si garanci për kontratën e huasë dhe për të shmangur çdo pabesi, Kanuni njihte pengun, i cili jepej nga pala huamarrëse për të garantuar vlerën e huasë në rastin e pamundësisë së pagesës për shkaqe nga më të ndryshmet. Vlera e sendit të dhënë peng duhet të kishte një çmim sa vlera e huasë së marrë ose dhe më tepër në mënyrë që huadhënësi të ishte i garantuar në të drejtën e tij. Megjithëse huaja e njohur në të drejtën zakonore shqiptare ishte hua pa interes, Kanuni pranon se, me kalimin e shekujve, në Malësinë shqiptare është shfaqur dhe huaja për fitim, “ves ky i mbrapshtë dhe i vonë” për Kanunin.

Sendi i dhënë si peng për huanë e marrë konsiderohet si penghumbës, pasi nëse pala që ka marrë hua nuk e dorëzon shumën e huasë në ditën e caktuar, në perëndim të diellit të asaj dite, huadhënësi ka tagër për ta shitur pengun e për të nxjerrë huanë e vet¹⁷.

¹⁷ Kanuni i Lekë Dukagjinit 2013:56.

Pra, Kanuni, krahas përcaktimit të mjeteve të garantimit të detyrimeve të huadhënies, përcakton dhe mënyrën e përmbushjes së këtyre detyrimeve nëpërmjet shitjes së pengut, për llogari të shumës së dhënë peng. Nëse sendi i dhënë peng shitet më tepër se vlera e huasë, atëherë Kanuni përcakton se kjo vlerë i duhet kthyer të zotit të pengut. Si mjete të përmbushjes së detyrimit të huasë, Kanuni, krahas pengut, përcakton besën, burrërinë dhe dorëzaninë. Pra, si gjithë fryma që shoqëron Kanunin, besa zë një vend të veçantë edhe te mjetet e përmbushjes dhe garantimit të detyrimeve të huasë. E thënë më ndryshe, besa është çështje vullneti e besimi dhe deri diku, mund ta njësojmë me konsensusin dhe vullnetin e palëve në marrëdhëniet kontraktore aktuale. Në legjislacionin aktual, vullneti dhe besa e mirë luajnë një rol përcaktues për vijueshmërinë e marrëdhënies juridike, si dhe për fatin e pasojave të veprimeve juridike të pavlefshme.

Si mjet të përmbushjes së detyrimeve, Kanuni njeh dhe dorëzanësin, i cili përgjigjet ndaj një detyre, të cilën po nuk e përmbushi vetë detyruesi në kohën e caktuar, e përmbush dorëzanësi¹⁸. Dorëzanësi përgjigjet për gjithë detyrimin, sikur të ishte vetë huamarrësi. Edhe nëse vdes huamarrësi, detyrimi përmbushet nga dorëzanësi. Dorëzanësi nuk mund të tërhiqet nga dorëzania, pasi ai caktohet si i tillë. Detyruesi, nëse arrin t'i bëjë gati të hollat në kohën e caktuar, është i detyruar të njoftojë dorëzanësin për këtë fakt, njësoj siç është i detyruar ta njoftojë dhe nëse nuk arrin t'i bëjë gati të hollat, pra, njësoj si në legjislacionin aktual, dorëzanësi dhe detyruesi i huasë veprojnë duke njoftuar njëri-tjetrin, në funksion të shlyerjes së huasë së marrë.

Kanuni njeh si veprim dhe dhurimin (“të falmen”). Sipas tij, nëse i dhuron dikujt diçka dhe pastaj e kthen fjalën e dhënë, Kanuni nuk e quan këtë veprim si të paligjshëm,

¹⁸ Kanuni i Lekë Dukagjinit, 2013:70.

vetëm se të turpëron, pasi, sipas Kanunit, je i lirë ta mbash burrërinë, ashtu si je i lirë ta lësh atë¹⁹.

Në lidhje me tagrin e trashëgimit, Kanuni i Lekë Dukagjinit njeh si trashëgimtar vetëm djalin dhe jo vajzën e as nipërit nga vajza. Babai mund t'i falë vajzës kur është gjallë sende dhe të ardhura, por pas vdekjes së tij, vajza nuk mund të pretendojë tokë apo pasuri tjetër të paluajtshme. Edhe nëse nuk ka trashëgimtarë meshkuj, përsëri vajzat nuk kanë të drejtë të trashëgojnë dhe një veprim i tillë në Kanun është i paligjshëm. Gruaja, sipas Kanunit, nuk ka të drejtë të trashëgojë as nga babai dhe as nga burri. Vajzat që nuk kanë vëllezër, pas vdekjes së babait, kanë të drejtë vetëm të priten dhe të përcillen, sipas Kanunit, në shtëpi të babait nga kushërinjtë e tyre. Edhe vajzat beqare, të cilave u vdes babai, martohen nga kushërinjtë, por ato nuk kanë të drejta trashëgimie. Kushërinjtë, në këtë rast, luajnë disi rolin e kujdestarëve të pasurisë trashëgimore në legjislacionin aktual.

Kanuni i Lekës nuk e njeh as testamentin si një veprim të ligjshëm për pasurinë e tyre. Duke qenë se testamenti nuk njihet në Kanun, pasuria mund të lihet me dëshirë kur personi është gjallë, por gjithmonë jo vajzave të tij. Lënësi i pasurisë, në këtë rast, është i detyruar të mbledhë kushërinjtë dhe pleqtë e fisit për dëshmitarë, të cilët, bashkë me lënësin e pasurisë, do të vendosin shenjat e gishtit në letër për këtë dhurim (“të falme”). Çdo veprim që vjen në kundërshtim me Kanunin në lidhje me pasurinë trashëgimore është i paligjshëm. Edhe nëse nuk lë gjë me shkrim trashëgimtari, kushërinjtë e pleqtë e fisit kanë detyrim të kujdesen për pasurinë e tij dhe për pjesën që merr kisha. Gjithashtu, kushërinjtë kujdesen që me pasurinë trashëgimore, të shlyejnë huatë e trashëgimlënësit, nëse ka marrë hua dhe nuk ka arritur ta shlyejë atë. Pra, nëse dikush vdes papritur, nuk

¹⁹ Kanuni i Lekë Dukagjinit, 2013:58.

ka djem dhe nuk ka lënë asgjë nga pasuria e tij me shkrim, atëherë kushërinjtë kanë të gjitha tagrat në lidhje me pasurinë e tij²⁰.

3.2. Kanuni i Labërisë

Veprimi juridik është i përcaktuar në dispozitat e Kanunit të Labërisë. Konkretisht, në nenin 346 përcaktohet që: “Vetëm personi madhor me vullnetin e tij të lirë mund të kryejë veprimet juridike, të kryejë ose të shuajë të drejta e detyrime civile”. Konstatojmë se, për herë të parë, në ndryshim nga Kanuni i Lekës, këtu përcaktohet koncepti i veprimit juridik, si një koncept më i gjerë se kontrata. Duke qenë se Kanuni i Labërisë është një përmbledhje e dispozitave të vjetra të ardhura nga lashtësia, ashtu dhe e rregullave të reja të krijuara nga situatat e reja, në lidhje me marrëdhëniet shoqërore dhe civile në zonat e Labërisë, patjetër që do të bënte një rregullim të veçantë dhe për marrëdhëniet juridike. Ky koncept i veprimit juridik, përcaktuar në këtë Kanun si veprim i vullnetshëm i personave madhorë, që mund të kuptojnë rëndësinë e veprimit të kryer, është element i njëjtë me legjislacionin aktual. Sipas kësaj dispozite, që të kemi veprim juridik të vlefshëm, duhet të ekzistojë vullneti i palëve për të kryer veprimin juridik. Ky vullnet nuk duhet të jetë i vesuar dhe gjithashtu, palët e veprimit juridik duhet të gëzojnë zotësinë për të vepruar.

Kanuni i Labërisë, si gjithë e drejta zakonore shqiptare në përgjithësi, njeh si formë të veprimit juridik, kryesisht atë me gojë, bazuar në fjalën e dhënë, në fjalën e nderit, në besë. Në raste të veçanta, njihet dhe forma shkresore ose me shenja të tjera dhe me gjeste²¹. Në Kanunin e Labërisë, janë të përcaktuara edhe kushtet që duhet të plotësojë

²⁰ Kanuni i Lekë Dukagjinit 2013:28.

²¹ Kanuni i Labërisë, neni 347, 2006:136.

një person që të kryejë veprime juridike të vlefshme. Në radhë të parë, duhet të gëzojë zotësinë për të vepruar. Në Kanunin e Labërisë, zotësia për të vepruar lidhet me aftësinë për të mbajtur armë. Fëmijët që mbushin moshën 14-15 vjeç e lart, fitojnë disa të drejta dhe detyrime, por nuk mund të kryejnë veprime pa pëlqimin e prindit apo të kujdestarit, trajtim i njëjtë si në legjislacionin aktual. Fëmijët nën moshën 14-15 vjeç nuk kanë zotësi për të vepruar dhe gjithmonë, në vend të tyre, vepron prindi apo kujdestari²².

Kanuni i Labërisë nuk i trajton në mënyrë të barabartë meshkujt dhe femrat, përse i përket zotësisë për të vepruar, pasi femrat, edhe pasi martohen, nuk fitojnë zotësi të plotë për të vepruar në marrëdhëniet civile. Të drejtat e femrës janë të kufizuara, pasi në vend të saj vendos babai ose burri, sipas rastit²³. Gjithashtu, Kanuni i Labërisë ka përcaktuar që personat madhorë, të cilët vuajnë nga sëmundje mendore, janë tërësisht të pazotë për të vepruar dhe në vend të tyre vepron babai, vëllai, xhaxhai apo një tjetër nga vëllazëria²⁴. Pra, sipas kësaj dispozite, vërejmë se, Kanuni i Labërisë njeh konceptin e heqjes së zotësisë për të vepruar, si rezultat i sëmundjeve mendore, njësoj si legjislacioni aktual.

Sipas Kanunit të Labërisë, veprimi më formal është shitja e pasurisë së paluajtshme, pasi përcaktohet që ky veprim juridik kryhet në prani të dëshmitarëve, vëllazërisë, farefisit apo dhe personave të tjerë²⁵. Shtëpia dhe toka, sipas Kanunit, u shitet në radhë të parë vëllezërve, farefisit, gjitonit, sepse nuk lejohet hyrja e të huajve në vëllazëri e në farefis. Kur ndodh që nuk mund ta blejë askush prej tyre, atëherë mund t'i shitet secilit

²² Kanuni i Labërisë, neni 343, 2006:136.

²³ Kanuni i Labërisë, neni 344, 2006:136.

²⁴ Kanuni i Labërisë, neni 345, 2006:136.

²⁵ Kanuni i Labërisë, neni 348, 2006:136. Kjo ndodhte, pasi shitja e pasurisë së paluajtshme në zonat ku vepronte Kanuni i Labërisë, ishte një ngjarje e jashtëzakonshme. Pra, shitja e shtëpisë dhe e tokave nuk konsiderohet në Kanun si një veprim i përditshëm dhe i zakonshëm, pasi sipas tij, në zonën e Kurveleshit shitja e shtëpive kishte filluar 100-vjeçarën e fundit, ndërsa e tokave 90-vjeçarën e fundit.

bashkëfshatar ose edhe jashtë fshatit, por me kushtin që ky person të mos ketë pasur konflikt me fisin apo fshatin dhe të jetë i njohur për sjellje të mirë²⁶.

Kanuni përcakton rastet e pavlefshmërisë së veprimeve juridike, që janë²⁷:

- Veprimet juridike që vijnë në kundërshtim me zakonin.
- Veprimet juridike që kryhen nga të miturit që nuk kanë zotësi për të vepruar.
- Veprimet juridike që kryhen për të mashtruar ose janë fiktive.

Të gjitha veprimet që kryhen në këto mënyra konsiderohen si veprime juridike të pavlefshme dhe këto veprime pushojnë së ekzistuari, pasi nuk sjellin më pasoja. Pleqtë e zakonit, në këtë rast si një gjykatë, e zgjidhin mosmarrëveshjen duke i anuluar këto veprime juridike dhe duke rregulluar pasojat e ardhura nga këto veprime të pavlefshme.

3.3.Kodi Civil i Zogut, 1929

Kodi Civil i Zogut, i vitit 1929, solli shfuqizimin e ligjit turk që zbatohet në atë periudhë në Shqipëri, si dhe zbehjen e së drejtës kanunore. Ky kod, duke qenë se nuk ishte i ndarë në dy pjesë, e përgjithshme dhe e posaçme, nuk bënte një parashikim të institutit të veprimit juridik. Ishin kontratat e veçanta dhe rregullat e vlefshmërisë së tyre që parashikoheshin qartësisht në këtë kod. Veprimet juridike identifikoheshin në kontratat e ndryshme. Në nenin 1076, jepet përcaktimi i konceptit të kontratës: “Kontrata asht akordi i dy ose i ma shumë personave për me krijue, ndryshue ose me shue një lidhje raport juridike”. Kontrata konceptohet si një marrëveshje e vullnetshme për të krijuar një marrëdhënie juridike, element ky i veprimit juridik, sipas Kodit Civil aktual.

²⁶ Kanuni i Labërisë, neni 378, 2006:142.

²⁷ Kanuni i Labërisë, neni 350, 2006:136.

Kodi Civil i Zogut ka të përcaktuara dhe konditat e nevojshme për ekzistencën e kontratës, që janë: 1) Hiri i palëve; 2) Objekti që mund të formojë landë kontrate; 3) Shkaku i ligjshëm²⁸. Nga kjo dispozitë, vërehet se elementi formë nuk përfshihet në kushtet e vlefshmërisë së kontratës, megjithatë, doktrina e përfshin formën në elementet e pavlefshmërisë²⁹.

Kodi Civil i Zogut, në nenin 1086, përcakton rastet e anulueshmërisë së kontratave, të cilat janë:

- a. Për shkak se palët ose njëna prej tyre nuk ka pasë zotësinë ligjore.
- b. Për shkak se hiri ka qenë i vesuem.

Nëse i bëjmë një analizë, shikojmë se ky kod nuk bën një përcaktim të qartë dhe një ndarje midis pavlefshmërisë absolute dhe konstatimit të saj, si dhe pavlefshmërisë relative e shpalljes së saj. Kjo, pasi ky Kod është hartuar nën frymën e Kodit Civil italian, i cili nuk bën një ndarje midis pavlefshmërisë absolute dhe relative. Nga kjo dispozitë rezulton se, që kontrata të jetë e vlefshme dhe indirekt veprimet juridike në përgjithësi, duhet të ekzistojë zotësia e palës për të vepruar, pra të kuptojë rëndësinë dhe qëllimin e veprimit të kryer. Gjithashtu, nga pjesa e dytë e dispozitës rezulton se, jo vetëm që në një kontratë duhet pëlqimi dhe vullneti kontraktor (hiri i palëve), por duhet që ky vullnet i shprehur të përputhet me vullnetin e brendshëm “hiri ka qenë i vesuem”.

- Mungesa e zotësisë ligjore.

²⁸ Neni 1085 i Kodit Civil të vitit 1929. Pra, si në të gjitha legjislacionet, edhe ky kod përcakton kushtet për ekzistencën e vlefshmërisë së veprimeve juridike, pavarësisht se nuk përdor konceptin “veprim juridik”.

²⁹ Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:104. “Kontratat për të cilat ligji lyp formën shkresore janë nul, por ato vlejnë si kontrata preliminare, kontrata të premtimit për të ardhmen”.

Në nenin 1078, përcaktohet se: “Çdo person asht i zoti me kontraktue kur nuk asht deklarue i pazoti prej ligjit. Janë të pazotë me kontraktue në rastet e caktueme prej ligjit të mitunit, të ndaluemit, të paafteësuemit dhe gjithë ata të cilëve ligji nuk u njeh tagrin, me lidh disa kontrata të caktueme”. Kjo dispozitë bën një përcaktim të përgjithshëm të personave, të cilët nuk mund të kontraktojnë, pasi nuk gëzojnë zotësinë ligjore, pra zotësinë për të vepruar. Gjithë të tjerët janë të lirë të lidhin kontrata, për sa kohë nuk janë deklaruar të pazotë prej ligjit. Sipas kësaj dispozite, kuptohet se gjykata duhet të shprehet për heqjen ose mungesën e zotësisë për të vepruar³⁰. Sipas nenit 1030, kur një i mitur bën një veprim pa asistencën e kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor, në një kohë kur ligji ka të përcaktuar që ky veprim duhet të bëhet me asistencën e përfaqësuesit, është i atakueshëm vetëm kur përmban një lëndim për të miturin.

Si shkaqe që influencojnë zotësinë ligjore, si kusht për vlefshmërinë e kontratave, janë mosha, gjendja shëndetësore dhe dënimi penal³¹.

a) Mosha. Në nenin 296 të Kodit Civil të vitit 1929, përcakohet që zotësia për të vepruar fitohet me arritjen e moshës 20 vjeç. Pra, zotësia ligjore për të kryer veprime të ndryshme juridike të vlefshme dhe për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të kryera, lidhet me arritjen e një moshe të caktuar, që është më e madhe se mosha e përcaktuar në legjislacionin aktual. Megjithatë, ka edhe përjashtime në lidhje me këtë çështje dhe mund të fitohet zotësia ligjore edhe poshtë moshës 20 vjeç, p.sh., në rastin e martesës para kësaj moshe. Mosha 18 vjeç është e mjaftueshme gjithashtu për të bërë testament

³⁰ Zotësisë ligjore, sipas Kodit Civil të vitit 1929. Pra, pazotësia është një gjendje që nuk prezumohet, por duhet të provohet. Pazotësia e personit, që kontraktin sipas këtij legjislacioni është një ves i hirit, pasojat e të cilit janë të njëjta me ato të veseve të tjera të hirit. Padia e ngritur për anulim të veprimit juridik, është e njëjtë dhe sjell të njëjtat pasoja, qoftë kur bazohet në dhunë ose lajthim, qoftë kur bazohet në pazotësinë e personit që kontraktin.

³¹ Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:83

sipas nenit 367 të Kodit Civil³². Pazotësinë ligjore për të vepruar të të miturve, ligji e ka zgjidhur me anën e caktimit të përfaqësimit ligjor, që mund të jetë prindi ose tutori. Pra, veprimet juridike të kryera nga këta persona janë të vlefshme, kur kryhen me miratimin e përfaqësuesit ligjor. Veprimet e kryera nga përfaqësuesit ligjorë janë të paatakueshme, me përjashtim të rastit kur përmbajnë lëndim për të miturin³³.

E veçanta e këtij legjislacioni është se, ka të përcaktuar nevojën e caktimit të një kujdestari edhe me arritjen e një moshe të madhe, që e vendos personin në të njëjtat kushte analoge me miturinë: “Dobësia pleqnore e autorizon një person me kërkue që t’i vihet një kujdestar”³⁴.

b) Gjendja shëndetësore. Disa nga veprimet juridike të caktuara kanë nevojën e përdorimit të organeve ose shqisave të ndryshme, të cilat, nën efektin e sëmundjeve të ndryshme, e kanë humbur efektin e tyre ose janë dëmtuar. Sipas këtij legjislacioni, shurdhmemeci ose memeci nuk mund të bëjnë një testament publik, pasi për këtë formë testamenti, duhet një deklaram me gojë i disponimeve të vullnetit të testatorit. Ata mund të bëjnë vetëm një testament olograf ose testament të fshehtë. I verbri nuk mund të bëjë testament të fshehtë, pasi nuk di të shkruajë. Në këtë rast, verbëria dhe shurdhmemecia, me arritjen e moshës madhore, përsëri kanë nevojë për një kujdestar, për të plotësuar zotësinë e tyre ligjore dhe për të kryer veprime juridike të vlefshme:

³² Megjithatë edhe pse legjislacioni ka përcaktuar një moshë fikse për fitimin e zotësisë ligjore, fuqia mendore dhe çmuarja e saj ka një rëndësi të madhe, pasi fitimi i zotësisë ligjore poshtë 20 vjetëve bëhet në bazë të rrethanave përjashtimore, duke çmuar fuqinë mendore të të miturit.

³³ Neni 1030 i Kodit Civil të 1929. Edhe pse veprimi juridik i kryer nga të miturit është i anulueshëm, ai mund të krijojë pasoja juridike dhe të bëhet i paatakueshëm, kur kalojnë 5 vjet nga arritja e moshës madhore, pa u ngritur padia për anulim të këtij veprimi juridik.

³⁴ Neni 395 i Kodit Civil të 1929.

“... dobësia mendore, kur asht e vazhdueshme (e zakonshme), influencon krejtësisht zotësisë ligjore dhe e pengon atë qu vuen nga kejo dobësi në bamjen e akteve juridike.” (Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:85)

Pazotësia mendore mund të jetë e pjesshme ose e plotë, në bazë të rëndësisë së sëmundjes mendore. Dobësia mendore më e rëndë e bën personin që vuan nga kjo sëmundje, absolutisht të pazotin për të kryer veprime juridike, pra shkakton pavlefshmërinë absolute. Ky person, në bazë të nenit 380 vihet në gjendje *të ndalimit gjyqësor* dhe në bazë të nenit 385, *vihet nën tytori*, domethënë në të njëjtën pozitë me atë të të miturit. Kur dobësia mendore është më e lehtë, sjell vetëm paaftësimin, duke e deklaruar personin vetëm të paaftë për të kryer veprime juridike, që kapërcejnë një administrim të thjeshtë³⁵. Këto veprime, në këtë rast, duhet të kryhen me asistimin e një kujdestari³⁶. Në rastin kur dobësia mendore nuk është deklaruar nga gjykata, por ekziston realisht, ka mendime të ndryshme, nëse akti në këtë rast, është absolutisht i pavlefshëm nul apo është i anulueshëm.

c) Dënimi penal. Kur dënohet një person, zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar mund të pakësohet. Dënimi penal mund ta privojë personin e dënuar nga të drejtat publike, politike, civile dhe ndonjëherë kjo jepet nga gjykata si shtesë e dënimit. Dënimi me burgim të përjetshëm ose me burgim më të rëndë se pesë vjet, e privon të dënuarin nga pushteti atëror, autoriteti që ka burri mbi gruan dhe e vë nën tutori. Të ndaluarit ligjor për shkak dënimi, janë të privuar për të lidhur çfarëdo kontrate sipas këtij legjislacioni, përveçse atyre të së drejtës familjare³⁷.

- Pazotësia natyrale dhe pazotësia ligjore.

³⁵ Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:85

³⁶ Neni 385 i Kodit Civil të 1929.

³⁷ Neni 1087 i Kodit Civil të 1929.

Pazotësia e pjesshme ose pazotësia ligjore nuk i korrespondon në të gjitha herët pazotësisë natyrale të personit, që është gjendja mendore që pakëson ose zhduk fare vullnetin dhe gjykimin³⁸. Prandaj, ai që është deklaruar i pazoti ligjërisht, mund të mos jetë para pazotësinë natyrale. Disa herë, ndonjë person vuan nga një sëmundje nervore e rëndë, por kundër tij nuk ka dalë ndonjë vendim gjyqësor ndalimi apo paaftësimi³⁹. Gjithashtu, mund të ndodhë që një person i dehur ose nën një gjendje turbullimi të momentit, të kryejë veprime të ndryshme juridike, pa u përputhur me hirin e tij. Kodi Civil i 1929 nuk bën ndonjë rregullim të veçantë për pazotësinë natyrale, megjithatë ka përcaktuar se, testamenti dhe dhurimi janë të pavlefshëm, kur janë bërë nga një person që ka dobësi mendore, edhe pse kjo dobësi mendore nuk është konstatuar gjyqësisht me *“procedim ndalimi”*⁴⁰, mjafton që të provohet se sëmundja mendore ka ekzistuar në kohën e bërjes së testamenti ose nënshkrimit të kontratës së dhurimit. Gjithashtu, edhe veprimet e kryera para ndalimit gjyqësisht mund të anulohen, nëse vërtetohet se, në kohën e kryerjes së këtyre veprimeve ka ekzistuar shkak i anulimit, pra, personi ka qenë në dobësi mendore. Edhe në rastin kur personi me dobësi ose sëmundje mendore ka vdekur, personat e interesuar mund të kërkojnë që të anulohen veprimet e kryera nga ky person në gjallërinë e tij, kur kërkesa për ndalim gjyqësisht të jetë bërë para vdekjes së tij ose kur mund të provohet ekzistenca e dobësisë mendore⁴¹.

Në lidhje me pasojat e veprimeve juridike të kryera nga persona, që në kohën e kryerjes së këtyre veprimeve kanë qenë në kushtet e pazotësisë ligjore, Kodi Civil i 1929

³⁸ Neni 1485 i Kodit Civil të 1929. Gjithsesi, nuk bëhet një parashikim i qartë në këtë Kod, në lidhje me pazotësinë natyrale, në ndryshim nga rregullimi dhe përcaktimi që i bëhet pazotësisë ligjore.

³⁹ Pazotësia ligjore është një gjendje e vërtetuar me vendim gjyqësor, ajo që në legjislacionin aktual ka të bëjë me heqjen e zotësisë për të vepruar.

⁴⁰ Vendimi gjyqësor që vërteton pazotësinë për të vepruar.

⁴¹ Neni 392 i Kodit Civil të 1929.

mbështetet në disa parime bazë. Pazotësia ligjore, qoftë për shkak miturie, qoftë për shkak të sëmundjeve mendore, sjell si pasojë, anulueshmërinë e akteve juridike në të gjitha rastet⁴². Ndryshe nga pazotësia ligjore, pazotësia natyrale nuk merret parasysh, edhe sikur të provohet në mënyrën më të qartë. Kjo paaftësi merret parasysh vetëm përjashtimisht, kur shoqërohet nga kërkesa për ndalim ose paaftësim. Pra, në këtë rast nuk mjafton prova që personi në kohën e kryerjes së aktit juridik ka qenë në mangësi mendore, por që *“procedimi për ndalim ose paaftësim”* të ketë përfunduar dhe të jetë vendosur ndalimi ose paaftësimi dhe gjithashtu, të provohet se pala tjetër, që ka kontraktuar me të ndaluarin, të ketë qenë në keqbesim. Edhe kur i pazoti të ketë vdekur natyralisht, duhet që procedimi për ndalim të jetë kërkuar para vdekjes, edhe nëse nuk është kërkuar, duhet që vetë akti i bërë të përmbajë provën e sëmundjes mendore.

Sipas këtij legjislacioni, nuk mund të kërkohej anulueshmëria e aktit për shkak të gjendjes mendore të dobët që rezulton nga shkaqe të përkohshme, si dehja, somnambulizmi, turbullimi mendor për shkak pasional ose ai që shkaktohet nga ndonjë sëmundje mendore tjetër, kur kjo gjendje nuk është vërtetuar me procedimin e ndalimit ose të paaftësimit gjyqësisht. Megjithatë, çdo gjendje turbullimi e mendjes, kur është me rëndësi dhe provohet se ka ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, sjell pasojën e nulitetit të kontratës ose të çdo akti juridik tjetër, edhe pse pala mund të mos ketë qenë në pazotësi ligjore. Zotësia natyrale është një nga konditat kryesore të hirit dhe nuk mund të kemi një kontratë apo çdo akt juridik tjetër, kur personi që ka deklaruar vullnetin e tij, nuk ka pasur ndërgjegjen dhe nuk ka kuptuar pasojat e veprimit të kryer, pra hiri ka qenë i vesuar. Gjithsesi, kjo linjë arsyetimi do të sillte rrezikun e atakimeve të shpeshta të kontratave pa bazë ligjore, pasi do të qe tepër i vështirë provimi i hirit të

⁴² Neni 1088 i Kodit Civil të 1929.

vesuar nga pala që pretendonte një shkak të pazotësisë natyrale. Prandaj, pazotësia ligjore dhe pazotësia natyrale duhet të ecin njëkohësisht, për të mundësuar vlefshmërinë e akteve ligjore dhe të kontratave në përgjithësi.

Mungesa e zotësisë ligjore shkaton vetëm anulueshmërinë e kontratës. Anulimi mund të kërkohej vetëm nga personi i pazotë ligjërisht, ndërsa pala tjetër, nëse nuk ka qenë dhe ajo e pazonja, nuk mund të kërkojë pazotësinë ligjore të të miturit, të ndaluarit, të paaftësuarit me të cilin ajo ka kontraktuar⁴³. Në rastin e pazotësisë ligjore, përsa i përket provës, nuk duhet provuar që personi, në momentin e lidhjes së kontratës, ka qenë nën efektin e mangësive mendore, pasi mjafton dokumenti i miturisë, paraqitja e aktgjykimit të ndalimit apo paaftësimi, në rastin e pranimi të padisë për anulim. Kërkesë-padia për anulim të kontratës, në këtë rast, parashkruhet brenda pesë vjetëve⁴⁴.

Vlen të theksohet se, sipas nenit 1303 të Kodit Civil, ekziston një rast kur i mituri nuk mund të pretendojë anulueshmërinë e kontratës: “Obligimi nuk mund të atakohet prej të mitunit, i cili me dredhina ka fshehtë mituninë e vet”. Ky mashtrim i të miturit formon një faj, një vepër të paligjshme, të cilën i mituri detyrohet ta riparojë dhe për këtë faj, atij i refuzohet kërkesa për nulitet të kontratës. Pazotësia natyrale shkakton nulitetin absolut, mosekzistencën e aktit⁴⁵.

- Hiri i vesuar.

⁴³ Neni 1086 i Kodit Civil të 1929. Kjo pasi, e drejta për të kërkuar pazotësinë, i është dhënë vetëm të pazotët dhe është krijuar për të mbrojtur interesat e tij. Personi që ka zotësi ligjore duhet të tregohet i kujdesshëm, në lidhje me palët me të cilat do të kontraktojë. Nga ky rast, bën përjashtim vetëm ndalimi ligjor për shkak dënimi, në të cilin pazotësia mund të kundrejtohet prej kujt do që ka interes.

⁴⁴ Neni 1301 i Kodit Civil të 1929.

⁴⁵ Neni 1085 i Kodit Civil përcakton: “Veprimet e bame prej një të çmenduni në momentin e krizës prej një të dehuni, prej një personi që ndodhet në gjendje sonambulizmi, nuk janë vetëm të vesueme, por janë të paqena për mungesë absolute hiri, edhe pse këta persona nuk janë deklaruar të pazotë prej ligjit”. Ndërsa në pjesën e dytë të nenit 1088, përcaktohet se: “Pazotësia e të dënuemit që asht në ndalim ligjor, mund të kundrejtohet prej kujt do që ka interes”. Kjo tregon se, kushdo që ka interes për anulimin e kontratës, mund të parashtojë kërkesën e pazotësisë së personit që ka kontraktuar për mbrojtjen e interesave të tij ose të të miturit, të paaftit apo të ndaluarit.

Në nenin 1089 deri në 1097, janë përcaktuar veset e hirit, vullnetit, të cilat e bëjnë kontratën të pavlefshme: “Kontraktuesi që ka dhanë hirin, duke qenë në lajthim të ndjeshëm ose hiri i të cilit asht marrë me dhunë, ose tërheq me lehtësi mundet me kërkuar anulimin e kontratës”. Kur vullneti i palës kontraktore nuk ka qenë i vërtetë dhe pala nuk ka dëshiruar pikërisht ato pasoja, që kanë ardhur si rezultat se nuk e ka kuptuar drejt veprimin kontraktor, por ka qenë në lajthim, ai mund të kërkojë anulimin e këtij veprimi. Gjithashtu, në Kodin Civil të vitit 1929, janë përcaktuar rastet kur lajthimi e bën kontratën të anulueshme, që do të thotë se jo çdo lloj lajthimi e ka këtë rol⁴⁶. Në këtë analizë rezulton se, jo për çdo lloj lajthimi, palët mund të kërkojnë pavlefshmërinë e kontratës, pasi ligji e ka përcaktuar qartë kur lajthimi ka të bëjë me një cilësi esenciale të sendit objekt kontratë. Gjithashtu, nëse personi ka rënë në lajthim në lidhje me cilësitë e identitetit të personit, ai mund të kërkojë pavlefshmëri të kontratës.

Në doktrinën e kohës, ndeshim një klasifikim të lajthimit, në atë pengues, anulues dhe lajthim indiferent⁴⁷.

- Lajthimi pengues nuk është vetëm ai lajthim që e veson hirin, por është ai lajthim që e zhduk fare hirin e personit. Ky lloj lajthimi i referohet deklarimit të vullnetit dhe ka të bëjë me atë që, vullneti i vërtetë është i ndryshëm nga vullneti i deklaruar. Personi dëshiron të kryejë një veprim të caktuar, por deklaron një veprim tjetër, p.sh., kur një person nënshkruan një kontratë shitblerjeje, por në të vërtetë, dëshironte vetëm ta jepte me qera sendin.

⁴⁶ Neni 1090 i Kodit Civil të 1929. “Lajthimi në fakt e bën kontratën të anulueshme, kur qëllon në një cilësi të sendit ose në një rrethanë, që asht konsideruar prej palëve si esenciale, ose që duke u marrë parasysh mirëbesimi dhe konditat në të cilat asht lidh kontrata duhet të konsiderohet si e tillë. Gjithashtu, asht shkak anulueshmërie lajthimi në identitetin ose në cilësitë e personit me të cilin asht lidh kontrata, kur ky identitet, ose këto cilësi kanë qenë shkak i vetëm ose kryesor i kontratës”.

⁴⁷ Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:60.

- Lajthimi anulues është gabimi në shprehjen e vullnetit dhe nuk e përjashton hirin, pasi ekziston një vullnet për të kryer këtë veprim, veçse vullneti është nxitur nga një lajthim. Mosdija apo keqinterpretimi i një fakti apo i një dispozite ligjore mund të influencojë që shprehja e brendshme e vullnetit të mos përputhet me atë çka dëshironte realisht pala kontraktore të realizonte me këtë veprim, p.sh., në rastin kur i dhurohet një send i caktuar një personi, duke kujtuar se ky është personi që i shpëtoi jetën, por realisht nuk është ky personi.

- Lajthimi indiferent është lajthim i rastësishëm, aksidental dhe nuk ka ndonjë efekt, p.sh., lajthimi mbi vlerën e sendit, lajthimi mbi personin, lajthimi për arsyet e motivet që e kanë shtyrë një person për të kryer një veprim të caktuar. Edhe pas provimit të lajthimit, nuk është e sigurt se gjykata do ta anulojë kontratën, pasi për këtë, duhet që lajthimi të jetë i ndjeshëm, pra viktima e lajthimit nuk duhet të ketë faj. Po të jetë në faj, gjykata mundet ta kompesojë lajthimin me fajin dhe ta refuzojë kërkesën për anulimin e kontratës.

- Lajthimi mbi personin.

Sipas nenit 1090, kontrata e lidhur, duke qenë në lajthim mbi identitetin ose cilësitë e personit me të cilin është lidhur kontrata, mund të anulohet nga gjykata, vetëm kur ky identitet apo këto cilësi kanë qenë shkaku i vetëm ose kryesor i kontratës. Pra, lajthimi mbi personin e veson hirin e kontratës, vetëm kur personi ose cilësitë e tij kanë qenë shkaku kryesor i kontratës “intuitu personae”⁴⁸. Kontrata e lidhur në lajthim të personit mund të jetë ajo e lidhur me një arkitekt të caktuar, me një mjek të caktuar, me një

⁴⁸ Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:66. Në këtë diskutim nuk përfshihen veprimet që u përkasin të drejtave ekstrapatrimoniale, siç janë martesë, adoptim etj, pasi karakteri personal i këtyre veprimeve nuk mund të vihet në dyshim e natyrisht, lajthimi në person, në këto raste, sjell si pasojë anulueshmërinë.

avokat, një piktor, etj. Lajthimi mbi objektin e kontratës është më i rëndë, pasi si ves i vullnetit, shkakton mosekzistencën e aktit, ndërsa lajthimi mbi personin sjell si pasojë nulitetin relativ, anulueshmërinë e aktit.

Një ves tjetër i vullnetit, që e bën kontratën të pavlefshme në Kodin e 1929 në nenin 1092, është nënshkrimi i kontratës duke përdorur dhunën ndaj palës kontraktuese: “Dhuna e përdorun kundra atij që asht obligue, formon shkak anulueshmërie, jo vetëm kur asht përdorë prej atij në favor të të cilit asht lidh kontrata, por edhe prej një të treti”. Sipas kësaj dispozite, dhuna mund të ushtrohet dhe nga një person i tretë, i cili nuk është palë në kontratë, pra, jo vetëm nga pala në favor të së cilës është realizuar kontrata. Neni 1093 i këtij kodi shkon më tej, duke përcaktuar rastet kur dhuna do të konsiderohet shkak për anulueshmërinë e veprimit juridik: “Dhuna duhet të jetë e atillë sa ti baj përshtypje një personi me arsye dhe t’i shtij frikën se ka me ekspozue personin, nderin ose pasurinë e tij, në një të keqe të padrejtë dhe të randë. Në çmimin e këtyre cirkosdancave merret parasysh mosha, seksi dhe gjendja e personave”.

Këtu dallojmë tre elemente të veprimit të dhunshëm:⁴⁹ a) Të jetë e vërtetë, pra, të krijojë përshtypjen e një dëmi të vërtetë; b) Të jetë e padrejtë, pasi mund të ndodhë që dhuna të vijë si rezultat i zbatimit të një urdhëri të organeve kompetente gjatë një ndalimi arrestimi; c) Dhuna të jetë e rëndë, pra, të sjellë dëmtime të rënda në jetën dhe pasurinë e personit apo një të treti. Dëmi ose e keqja mund të bjerë në personin, nderin ose pasurinë e vet apo të personave të tjerë që janë të afërm me të kërcënuarin. Kjo lidhje afërsie mund të jetë gjinie, krushqie, miqësie ose interesi.

Në bazë të këtij Kodi, është përcaktuar se frikësimi që drejtohet kundër bashkëshortit, të paslindurve dhe të paralindurve tanë, konsiderohet si i bërë drejtpërdrejt kundër vetë

⁴⁹ Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:69.

personit⁵⁰. Sipas këtij Kodi, përcaktohet se, jo vetëm dhuna fizike, por dhe “frikësimi”, dhuna psikologjike e drejtuar kundër personit, bashkëshortit, të paralindurve dhe të paslindurve të tij, përbën shkak anulueshmërie të kontratës⁵¹. Megjithatë, Kodi, në nenin 1095, ka përcakuar se: “Frika reverenciale nuk asht shkak anulueshmërie, në qoftë se nuk asht e shoqërueme me dhunë”. Përsëri përforcohet koncepti se, kur frika ose kërcënimi është i tillë sa nuk mund të krijojë përshtypjen e një dëmtimi të rëndë dhe të padrejtë për personin, pasurinë e tij ose një person të tretë, ajo nuk përbën shkak për anulueshmëri. Gjithashtu, ndjenja e respektit ndaj një personi, sado e madhe që të jetë dhe ta shtyjë personin tjetër që të kryejë veprime, të cilat nuk do t’i kryente nëse nuk do të ishte nën këtë autoritet, nuk përbën shkak për anulueshmëri dhe nuk e bën vullnetin të vesuar, si rezultat i dhunës morale⁵².

Akti juridik i marrë me mjete të jashtëligjshme është i atakueshëm, edhe sikur autori i dhunës të ketë patur të drejtë për ta kërkuar nënshkrimin e këtij akti, pra, mjafton të provohet se ky akt është nënshkruar nën efektin e dhunës fizike ose morale. Kur kërcënimi që i bëhet palës tjetër përfshihet në një të drejtë të ligjshme, dhuna morale, në këtë rast, nuk është parimisht e paligjshme, p.sh., kur kreditori kërcënon debitorin se do ta padisë para organeve kompetente. Ashtu si lajthimi, edhe dhuna duhet të jetë determinuese, pra të jetë shkaku kryesor i lidhjes së kontratës, e cila kërkohet të atakohet. Përrjashtimisht, mund të ndodhë që personi që ushtron dhunë nuk ka patur

⁵⁰ Neni 1093 i Kodit Civil të 1929. Për çdo lidhje tjetër, ligji ia ka lënë në dorë gjyqtarit për të hetuar sipas kushteve të rastit, nëse justifikon apo jo vesimin e hirit të deklaruesit.

⁵¹ Neni 1094 i Kodit Civil të 1929. Mund të ndodhë që frikësimi ose kërcënimi të drejtohet edhe ndaj personave të tjerë, veç atyre të përcaktuar qartësisht në këtë dispozitë. Në këtë rast, çështja është lënë e hapur, pasi mund të ndodhë që gjykata ta anulojë ose jo veprimin juridik. Gjykata merr parasysh cirkonstancat, rrethanat e veprimit juridik dhe efektin që ka luajtur frikësimi në shfaqjen e vullnetit të palës.

⁵² Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:71.

asnjë lloj marrëveshjeje me personin në interes të të cilit është lidhur kontrata. Sipas nenit 1092, është parashikuar anulueshmëria e kontratës edhe në këtë rast.

Si shkak për anulueshmëri, sipas Kodit Civil të 1929, është dhe mashtrimi, i përcaktuar në nenin 1096: “Dheli asht shkak anulueshmërie e kontratës kur dredhitë e përdorura prej njenës nga palët ose prej një të treti, me dijeninë e asaj, kanë qenë të atilla sa po të mos ishin përdorë ana tjetër nuk kishte me kontraktue”. Sipas kësaj dispozite, mashtrimi mund të bëhet jo vetëm nga pala tjetër kontraktore, por dhe nga një i tretë që nuk është palë në kontratë, por gjithmonë me dijeninë e palës në interes të së cilës është lidhur kontrata. “Ledhi asht çdo sjellje qi asht në kundërshtim me ligjat e ndershmënisë dhe qi bahet me qëllim qi të gënjej të tjerët, asht një vullnet i keq qi vepron me dredhina për të shtye ose për të mbajtë tjetrin në lajthim dhe për të damtue të gënjyemin.” (Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:74)

Kontrata anulohet edhe kur lajthimi qëllon në elementë jothelbësorë të kontratës ose në motive të brendshme. Sipas nenit 1089, ledhi është një dredhi që përdoret për të tërhequr hirin e palës tjetër, prandaj është i vesuar. Që të shkaktohet anulueshmëria e kontratës dhe akteve juridike në përgjithësi, si rezultat i vesimit të hirit të palëve, duhet të plotësohen disa kondita⁵³:

1) Dredhitë duhet të jenë përdorur me qëllim, me dijeni dhe me ndërgjegjje të plotë, që ta shtyjnë viktimën në lajthim. Që dredhia të jetë e qëllimshme, duhet të konkurojnë tre kushte:

a) Autori i ledhit duhet ta dijë që arsyeja që provokon vullnetin e palës tjetër është e rreme ose nuk ekziston. Një pohim, qoftë dhe i remë, që bëhet si rezultat i pakujdesisë, nuk përbën shkak për anulueshmëri.

⁵³ Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:75.

b) Duhet që autori i ledhit të besojë se, pala tjetër do t'i konsiderojë të vërteta thëniet e rreme të tij dhe ndoshta do të shtyhet nga këto thënie për të kontraktuar.

c) Ledhi duhet të ketë pasur si qëllim që ta shtyjë palën tjetër për të lidhur kontratën e dëshirueshme nga autori i ledhit. Pohimet e rreme, të bëra me qëllim lavdërimi, nuk përbëjnë ledh, veçse kur autori i këtyre lavdërimeve e di se pala tjetër do të lidhë kontratë, si rezultat i këtyre thënieve.

2) Lajthimi i provokuar nga ledhi duhet t'u referohet fakteve, të cilat dihen me saktësi. Nuk mund të ketë ledh kur krijohen në vullnetin e palës tjetër ide dhe mendime, të cilat nuk janë të qarta, p.sh., mendimi se ka mundësi të rritet çmimi i një titulli në bursë.

3) Veprat ledhatare duhet të jenë moralisht të papëlqyera. Reklama dhe lavdërimi që i bën tregtari mallit të vet, edhe pse mund të mos respektojë aq shumë të vërtetën, nuk përbën veprim ledhatar, pasi kjo lejohet prej zakoneve të jetës së përditshme. Gjithsesi, caktimi i kufijve ku mbaron ledhi i mirë dhe ku fillon ledhi i keq, është natyrisht i pamundur në praktikë. Kriteri i këtij dallimi duhet të bëhet rast pas rasti prej gjykatës, e cila duhet të hetojë dhe të çmojë nëse ka ekzistuar ledhi, duke pasur parasysh natyrën e punës dhe zakonet e përgjithshme e ato të posaçme të vendit.

4) Ledhi duhet të jetë determinues kauzal, pra, duhet ta ketë shtyrë palën e mashtruar për të kontraktuar dhe të jetë pikërisht ky shkak që ka sjellë kontraktimin. Lidhja kauzale shkak-efekt mungon kur pala tjetër i ka ditur rrethanat e vërteta të veprimeve kontraktuale. Lidhja shkakësore mungon edhe kur pala tjetër e ka besuar mashtrimin, por për arsye të ndryshme do ta lidhte kontratën, edhe sikur të ishte në dijeni të këtij mashtrimi. Anulimi i marrëdhënies kontraktore të kryer nën efektin e ledhit ka për qëllim jo ndëshkimin e autorit të ledhit, por kthimin e lirisë së vullnetit palës, që i është mohuar kjo liri, si rezultat i ledhit.

5) Sipas këtij Kodi, kontrata e vesuar me ledh është e anulueshme, vetëm kur ledhi është përdorur prej njëres nga palët kontraktore, me qëllim vesimin e hirit të palës tjetër ose prej një të treti, por pala ka pasur dijeni për ledhin e përdorur prej të tredit⁵⁴.

Përsa u përket mjeteve të përdorura prej autorit të ledhit, ai mund të konsistojë në deklarime të rreme, si rezultat i përfitimit nga një lajthim dhe në heshtjen e palëve në lidhje me fakte esenciale, të cilat pala tjetër kontraktore duhet t'i dinte. Një heshtje e tillë është ledhatare vetëm në rastin kur, personi që i di këto fakte, është i detyruar t'i tregojë ato. Pra ledhi heshtësor ose negativ është i aftë për të vesuar hirin e palës, vetëm kur është moralisht i papëlqyer dhe është në kundërshtim me moralin juridik. Asnjëra nga palët nuk ka detyrimisht obligimin për të informuar palën tjetër për të gjitha cirkonstancat, që mund të kenë rëndësi kur pala tjetër nuk e pyet, pasi në marrëdhëniet tregtare, secila nga palët duhet t'i ruajë vetë interesat e saj.

Ledhi, në këtë legjislacion, sjell anulueshmërinë e kontratës. Në rastin e ledhit incidental, të kryer nga një person i tretë viktimë, që nuk ka të drejtë për të kërkuar anulimin e kontratës, ka të paktën të drejtë për të kërkuar shpërblimin e dëmeve prej autorit të dredhive. Në këtë rast, padia për dëmshpërblim zëvendëson padinë për nulitet, për të cilën nuk ekzistojnë të gjitha kushtet e duhura. Personi, i cili me ledh ka provokuar lidhjen e një kontrate, nuk mund të pretendojë nulitetin e saj, p.sh., obligimi

⁵⁴ Neni 1096 i Kodit Civil të 1929. Në analizë të kësaj dispozite, kur pala që ka përfituar nga ledhi nuk ka pasur dijeni dhe nuk ka pasur asnjë lidhje me dredhite e përdorura nga personi i tretë, pala e gënjyer nuk mund të kërkojë anulim për shkak të ledhit, por ajo mund të kërkojë anulim, për shkak se ka rënë në lajthim. Kur ledhi nuk është esencial, kontrata është e vlefshme dhe nuk anulohet nga gjykata. Pala e dëmtuar, në këtë rast, ka të drejtë që të kërkojë shpërblimin e dëmeve kundër autorit të ledhit. Sipas nenit 1096, i tretë quhet personi që nuk ka marrë pjesë në bisedime dhe në përfundimin e lidhjes së kontratës. Përfaqësuesit ligjorë, që kanë kontraktuar në emër të njëres palë, nuk mund të konsiderohen si persona të tretë, pasi dredhite e bëra nga këta persona, i atribuohen palës në interes të së cilës është bërë ledhi, njësoj sikur të ishte bërë vetë nga kjo palë.

nuk mund të atakohet prej të miturit, i cili me dredhira, me ledh, ka mbuluar miturinë e vet, duke paraqitur një certifikatë lindjeje të rreme⁵⁵.

Një rast tjetër i vesit të vullnetit, që sjell anulueshmërinë e kontratës, është kryerja e veprimit në kushtet e nevojës së madhe. Kjo është përcaktuar në nenin 1097 të Kodit Civil të 1929: “Në rast që prestimet ose obligimet e njënit nga kontraktuesit, në krahasim me dobitë që nxjerr prej kontratës ose me prestimin e anës tjetër, janë jashtë çdo proporcioni, në mënyrë që simbas cirkonstancave duhet të prezumohet se hiri i tij nuk ka qenë mjaftësisht i lirë, gjyqtari mbi kërkimin e anës së lëndueme mundet me anulue kontratën ose me i ul ato obligime. Padia për anulim duhet të ngrihet brenda 1 viti që prej lidhjes së kontratës. Kjo padi mund të prapset në rast që ana tjetër ofron me pague një plotësuese të cilën gjyqtari e gjen të mjaftme”. Sipas kësaj dispozite, ligji ka gjetur një mënyrë për t’i bërë këto kontrata me vlerë ligjore, në mënyrë që të rregullohet proporcioni i përfitimit nga kontrata dhe që gjykata të mos shprehet për anulueshmëri të veprimit kontraktor.

Koncepti i lëndimit mbështetet në dy kushte kryesore, njëra objektive dhe tjetra subjektive⁵⁶:

1) Në nenin 1097, është përcaktuar se, që të kemi lëndim, duhet që prestimi dhe kundërprestimi të jenë jashtë çdo proporcioni me njëri-tjetrin, pra, të mos ketë një ekuilibër midis obligimeve reciproke të palëve. Kjo lihet në çmim të gjykatës, pas gjykimit të elementeve të rastit konkret. Legjislatori nuk mundohet të realizojë një drejtësi absolute, pasi është i pamundur pretendimi për prestime reciproke të barabarta dhe ekuivalente të palëve kontraktore. Pra, ligji nuk ndalon çdo disproporcion midis

⁵⁵ Neni 1203 i Kodit Civil të 1929.

⁵⁶ Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:79.

“prestimeve”, por vetëm atë disproporcion që kalon kufijtë mesatarë dhe është evident e i dukshëm. Lëndimi, sipas nenit 1097 të këtij Kodi, mund të vesojë të gjitha kontratat, me përjashtim të atyre, për të cilat ligji ka disponuar shprehimisht se nuk cenohen nga lëndimi ose kur ka caktuar kritere të ndryshme për disa kontrata të posaçme. Kontrata lëndimtare janë p.sh., shitja e sendeve të paluajtshme me një çmim të tepërt ose shumë të vogël. Për efekt të lëndimit, gjykata, për zgjidhjen e pasojave, çmon nëse prestimet reciproke janë jashtë çdo proporcioni, duke pasur parasysh vlerën që kanë patur sendet në kohën e lidhjes së kontratës.

2) Elementi subjektiv i lëndimit. Mungesa e proporcionit midis prestimit dhe kundërprestimit nuk është e mjaftueshme, pasi për të cilësuar kontratën lëndimtare, duhet gjithashtu të vërtetohet edhe elementi subjektiv se hiri i palës së lënduar nuk ka qenë i lirë, pra ka qenë i vesuar. Mund të kemi lëndim kur një obligim i disfavorshëm është marrë prej një personi, i cili është në mënyrë të dukshme i pazoti për të mbrojtur interesat e tij, për shkak moshe ose dobësie mendore e shëndetësore, në rastin kur dobësia mendore e tyre është e tillë sa të konsiderohen prej ligjit të paaftë për të kontraktuar. Duhet që të dyja kushtet, si ajo objektive, edhe ajo subjektive, të konkurojnë me njëra-tjetrën, pasi njëra pa tjetrën nuk mjafton që të kemi lëndim.

Kodi Civil i 1929 e konsideron aktin e vesuar me lëndim të anulueshëm dhe jo nul. Afati i atakimit të kësaj kontrate ecën që nga dita e lindjes së saj dhe jo prej ditës së zbulimit të lëndimit⁵⁷. Gjyqtari mundet ta anulojë kontratën ose të zbresë shumën e obligimeve, në mënyrë që të rregullohet disproporcioni. Nëse gjykata nuk do të kishte tagrin për të rregulluar kushtet e disproporcionit, do të kishte vetëm anulim të kontratës, por kontraktuesi i lënduar do të kishte më shumë interes të mos e anulonte dhe të

⁵⁷ Neni 1097 i Kodit Civil të 1929.

rregullonte disproporcionin. Sipas nenit 1097, i lënduari nuk ka të drejtë të padisë lënduesin, kur ky ofron të paguajë një plotësuese të arsyeshme për të zhdukur lëndimin, pra, për të kompesuar dëmtimin. Kur gjykata e shqyrton të arsyeshme ofertën e lënduesit, refuzon padinë e të lënduarit.

Kur kontrata është anuluar, i lënduari mund të refuzojë prestimin⁵⁸ ose kur e ka bërë këtë prestim, mund të kërkojë kthimin, si me padinë e rivendikimit, ashtu dhe me atë të begatimit pa shkak. Gjithashtu, edhe lënduesi mund të kërkojë kthimin e prestimit që ka bërë në rastin e anulimit, pasi me këtë anulim zhduket shkaku i prestimit të bërë prej tij⁵⁹. Lëndimi, ashtu si dhuna dhe ledhi, janë veprime të bëra në kundërshtim me rregullat e mirëbesimit, prandaj i lënduari ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit. Neni 1097 aplikohet për të gjitha kontratat, në të cilat realizohet një fitim i tepërt në dëm të tjetrit.

- Objekti, shkaku dhe forma, si elemente të vlefshmërisë së kontratës.

Përveç hirit të palëve, element tjetër i vlefshmërisë së kontratës është objekti dhe shkaku i saj. “Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktuem ose i caktueshëm⁶⁰”. Sipas këtij Kodi, objekt kontratë mund të jenë edhe shumat e të hollave, si dhe sendet e ardhshme. Megjithatë, nga kjo bën përjashtim fakti se nuk mund të hiqet dorë nga një trashëgim i paçelur ende, edhe sikur personi trashëgimlënës të ketë dhënë pëlqimin. Kontrata nuk mund të jetë e vlefshme kur krijon obligime pa një objekt. Objekti i një obligimi mund të jetë pozitiv ose negativ: “Mund të kemi obligime me dhanë (dare) që kanë për objekt transferimin e zotnimit ose krijimin e një të drejte reale, obligime me ba (facere) tue perfshi në këtë grup edhe obligimet me dorëzue një send pa

⁵⁸ Ekzekutimin e kontratës.

⁵⁹ Neni 1102 i Kodit Civil të 1929.

⁶⁰ Neni 1098 i Kodit Civil të 1929.

ngja transferimi zotnimi dhe obligime mos me ba (non facere).” (Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:89). Nuk mund të mendohet një obligim pa objekt, megjithatë, Benussi pohon se mund të ketë dhe shembuj obligimesh pa objekt.

- Objekti i caktuar ose i caktueshëm. Objekti duhet të jetë i caktuar, si nga pikëpamja e llojit dhe gjinisë, ashtu dhe nga pikëpamja e sasisë. Obligimi që ka për objekt një send të individualizuar, zhduket kur sendi humbet pa faj të debitorit, ndërsa obligimi që ka për objekt një send të përcaktuar në gjini nuk humbet asnjëherë, pasi është një obligim që mund të realizohet lehtësisht. Përsa i përket sasisë, edhe ajo duhet të jetë e caktueshme. Objekti mund të caktohet në sasi edhe prej gjykatës, në bazë të vullnetit të palëve ose nga një person i tretë i ngarkuar nga palët për këtë aktim.

Objekti duhet të jetë i mundshëm. “Askush nuk mundet me u detyrue me ba me dhanë ose mos me ba një gjë që nuk asht e mundun të bahet.” (Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:91). Pamundësia e objektit mund të rrjedhë nga kushte materiale, siç mund të jetë dorëzimi i një sendi, i cili në kohën e lidhjes së kontratës nuk ekziston ose nga shkaqe juridike, si transferimi i pronësisë së një sendi, i cili është i ndaluar të tregtohet. Në objektet e pamundura, futen dhe ato për të cilat vlera e detyrimit është shumë e madhe, në krahasim me shpenzimet që duhen për ta ekzekutuar atë detyrim⁶¹. Kontrata është nul, nëse objekti ka qenë i pamundur që në momentin e lidhjes së saj dhe kjo kontratë ngelet nul, edhe nëse më vonë ndryshojnë kushtet e detyrimit të saj. “Çka asht nul nuk mund të shërohet me kalimin e kohës (quod nullum est non potest tractu temporis convalescere).” (Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”

⁶¹ Neni 1098 i Kodit Civil të 1929.

2012:89). Megjithatë, nëse kontrata, nga natyra e saj, duhet të ekzekutohet më vonë, kjo është e vlefshme nëse objekti i saj bëhet i mundshëm në kohën e ekzekutimit.

Objekti duhet të jetë i ligjshëm. “Asht i jashtëligjshëm çdo prestim i cili qoftë në vedvedi, qoftë për qëllimin që asht në kundërshtim me ligjen, me rendin publik, me moralin dhe me zakonet e mira.” (Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:93). Objekti i një kontrate është i jashtëligjshëm, kur detyrimi objekt kontratë ka të bëjë me një aktivitet të kundërligjshëm, prandaj është nul. Premtimi për të bërë një delikt, si dhe kundërpremtimi i një shume të hollash që personi tjetër të kryejë veprimin e kundërligjshëm, është nul. Veprimi i premtuar nuk është i kundërligjshëm, kur ky veprim nuk vjen në kundërshtim me ligjin, por me të drejtën kontraktuale të një personi të tretë, p.sh., kur dikush i shet një send një personi, të cilin ia detyron një personi të tretë. Shitja, në këtë rast, është e vlefshme vetëm nëse personi i tretë kërkon dëmshpërblimin e pamundësisë së ekzekutimit të këtij detyrimi nga personi i parë. Sipas këtij Kodi, janë të kundërligjshme kontratat që kanë për objekt trashëgimitë e ardhshme, trashëgimet e paçelura ende⁶². Janë të kundërligjshme marrëveshjet, me anën e të cilave një person i premtton një tjetri se do t’i lërë në trashëgim të gjithë pasurinë e tij ose një pjesë të saj. Sipas këtij legjislacioni, askush nuk mundet, qoftë dhe me kontratën martesore, të disponojë trashëgiminë kur trashëgimlënësi është gjallë, as të tjetërsojë të drejtat që mund të ketë në atë trashëgimi. Nuliteti në lidhje me kontratat, që kanë të bëjnë me trashëgimi të ardhshme të paçelura ende, është absolut, prandaj nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë akt të mëvonshëm konfirmimi ose miratimi të heshtur apo të shprehur⁶³.

⁶² Neni 1101 i Kodit Civil të 1929.

⁶³ Neni 1306 i Kodit Civil të 1929.

Fjala e drejtë përdoret për të treguar tërësinë e normave juridike, pra, për të treguar tërësinë e rregullave të miratuara nga organi përkatës, zbatimi i të cilave sigurohet në mënyrë të detyrueshme⁶⁴. Të gjitha ndalimet ligjore në objektin e kontratës, sipas këtij legjislacioni, janë vënë në interes të rendit publik ose në ruajtje të zakoneve të mira të moralit, megjithatë është i pamundur dhe i vështirë caktimi i një kufiri midis rendit publik dhe zakoneve të mira. Në disa raste, rendi publik dhe zakonet e mira identifikohen me njëra-tjetrën. Objekti i obligimit, ashtu si shkaku i obligimit, nuk mund të jetë i ligjshëm, kur i kundërshton zakonet e mira⁶⁵. Megjithatë, rregullat morale janë më të ndryshueshme se rregullat e tjera. Ajo që është morale në një periudhë kohore, nuk është në një periudhë tjetër dhe ajo që është morale për një komb nuk është për një komb tjetër. Vlerësimi nëse një vepër bazohet në zakonet e mira apo jo, bëhet në bazë të opinionit subjektiv të palëve ose të gjykatës. Në këtë legjislacion, konsiderohen imorale kontratat që i sjellin lirisë personale ose ekonomike një kufizim të papranueshëm. Një obligim kontraktor sjell gjithmonë një pakësim të lirisë, por ky pakësim nuk mund të shtrihet deri në atë shkallë që të kufizojë në mënyrë të tepërt e të pajustificuar lirinë personale të personit. Ligji me dispozita të ndryshme ruan kufijtë e lirisë kontraktuale, që të mos kapërcehen. Në mungesë të përcaktimit ligjor, palët, gjatë kontraktimit të tyre, udhëhiqen nga rregullat e moralit të mirë.

-Shkaku i veprimit juridik. “Obligimi pa shkak ose i mbështetur në një shkak të rremë ose të paligjshëm nuk ka asnjë efekt”⁶⁶. Ai që ka ekzekutuar një obligim në kundërshtim me zakonet e mira, nuk mundet të ushtrojë padinë për kthim të asaj që ka ekzekutuar. Kjo ngjan me atë që sot e quajmë kthim në të ardhurat e shtetit, në rastin e veprimeve

⁶⁴Tsitsos. N, “Parimet e Përgjithshme të së drejtës Civile”, 1931:12.

⁶⁵ Neni 1104 i Kodit Civil të 1929.

⁶⁶ Neni 1102 i Kodit Civil të 1929.

juridike të kundërligjshme ose në mashttrim të ligjit. Sipas këtij Kodi, në nenin 1103 përcaktohet se: “Kontrata asht e vlefshme, edhe sikur të mos tregohet shkak i saj. Qenia e shkakut prezumohet derisa nuk provohet e kundërta”. Pra, nuk kërkohet që shkak të jetë patjetër i dukshëm, mjafton që të mos provohet mosekzistenca e tij. Sipas nenit 1104 të Kodit Civil, shkak është i paligjshëm kur është në kundërshtim me ligjin, me rendin publik ose me zakonet e mira.

Neni 1102 nuk bën fjalë për kontratën pa shkak, por për obligimin pa shkak dhe shkak në këtë rast, është shpjegimi psikologjik i detyrimit, pasi, sipas këtij neni, nuk ka detyrim pa një shkak ligjor. Shkak është arsyeja që i shtyn palët në lidhjen e një kontrate të caktuar. Kontratat që mbështeten në një shkak të rremë ose në një shkak të paligjshëm, pra mungesa e shkakut, sipas nenit 1102 të Kodit Civil të vitit 1929, sjell si pasojë nulitetin absolut të kontratës: “Kjo don me thanë se nuliteti nuk mundet me u shërue n’asnji mënyrë” (Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:111). Në lidhje me pasojat e një kontrate të tillë, të mbështetur në një shkak të rremë ose të paligjshëm, secila palë mund t’i drejtohet gjykatës, për t’i deklaruar të zgjidhura këto pasoja juridike.

- Forma e kontratës. Kontratat, për të cilat ligji kërkon formën e tyre shkresore, janë nul dhe nuk sjellin asnjë pasojë juridike, nëse nuk bëhen me këtë formë, por ato vlejnë si kontrata preliminare⁶⁷. Është bërë ky parashikim në legjislacion, pasi në realitetin shqiptar të asaj kohe, vazhdonte të zbatohet e drejta zakonore, ku në katundet shqiptare pasuria e paluajtshme dhe toka shiteshin me anën e kontratave verbale: “Asht e vërtetë se mungesa e elementit formal pengon lidhjen e kontratës qi palët kanë dashtë me lidhë, por asht edhe e vërtetë se me kontratën verbale asht krijue midis palëve një vjegë

⁶⁷ Kontrata të premtimit e shitjes në të ardhmen.

juridike.” (Benussi. B, “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, 2012:104). Duke qenë se, për premtimet që kanë si objekt lidhjen e kontratave në të ardhmen, nuk nevojitet forma shkresore, atëherë edhe kontrata përfundimtare e lidhur verbalisht, sado që nuk ka vlerë si kontratë që sjell transferimin e pronësisë dhe të drejtën reale, duhet të ketë vlerë si kontratë preliminare, premtim reciprok shitjeje, që i jep secilës palë të drejtën për të kërkuar prej palës tjetër ekzekutimin e detyrimit të premtuar ose shpërblimin e dëmeve. Pala që ka dhënë hirin verbalisht, pas dhënies së këtij hiri, nevojitet që ta deklarojë vullnetin e vet edhe me shkresë, në këtë mënyrë, kontrata quhet definitive, pasi është plotësuar edhe kushti i formës.

3.4 Periudha socialiste dhe Kodi Civil i 1981

Në vitin 1944, sistemi i së drejtës në Shqipëri ndryshoi, duke kaluar në sistemin e së drejtës socialiste. Çdo fushë politike, ekonomike dhe kulturore e vendit drejtohej jo më nga normat e së drejtës perëndimore romaniste, por nga ideologia që karakterizonte familjen e së drejtës socialiste. Legjislacioni i mëparshëm u shfuqizua⁶⁸ dhe u krijua një vakum ligjor, pasi ligji i parë civil që rregullonte marrëdhëniet kontraktore, u miratua shumë vjet më vonë. Ishte ligji numër 2359, datë 15.11.1956 “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”, i cili ishte frymëzuar nga e drejta sovjetike dhe në të trajtohej gjerësisht veprimi juridik, në ndryshim nga Kodi Civil i 1929. E drejta sovjetike ishte frymëzuar nga e drejta gjermane. Sipas analizës së dispozitave të këtij ligji, pranohet pavlefshmëria e veprimeve juridike që vijnë në kundërshtim me ligjin, që janë haptazi në dëm të shtetit ose që bëhen në mashtrim të ligjit. Ligji i mësipërm sanksionon rritjen e rolit të

⁶⁸ Me ligjin 61, datë 17.05.1945 “Mbi abrogimin e dispozitave ligjore të promulgua gjatë okupacionit të huaj dhe mbi vleftën e dispozitave ligjore që ishin në fuqi para datës 7 prill 1939”.

veprimeve juridike midis personave, por praktikisht roli i tyre u kufizua, pasi marrëdhëniet kontraktore dhe ekonomia e lirë pothuajse u zhdukën plotësisht dhe çdo gjë u drejtua nga politika e kohës. Marrëdhëniet juridike civile, në këtë kohë, përcaktoheshin si marrëdhënie shoqërore midis personave, individëve ose organizatave, pjesëmarrësit e të cilave kanë të drejta dhe detyrime civile, që caktohen dhe mbrohen nga normat e së drejtës civile:

“Fjala marrëdhënie përdoret jo në kuptimin e saj kryesor të dhënies e marrjes midis dy personave, por në një kuptim më të gjerë, në atë të lidhjes të raporteve që ekzistojnë midis dy personave, palëve dhe detyrimeve të caktuara, të cilat garantojnë me anën e mbrojtjes shtetërore, si rezultat i rregullimit e sanksionimit të tyre nga normat e së drejtës, marrëdhëniet shoqërore marrin formën e marrëdhënies juridike”. (Nathanaili. A, “E Drejta Civile e R.P.Shqipërisë”, 1974:59).

Si rezultat i këtij arsytimi dhe doktrinës së kohës, pa njohjen dhe sanksionimin nga ligji, nuk mund të ekzistonte në atë periudhë një marrëdhënie juridike. Vullneti i palëve nuk mund të ishte vullneti i lirë, përse kohë nuk duhet të binte ndesh me vullnetin shtetëror. Pavarësisht se, në doktrinën e kohës flitet për marrëdhënie shoqërore të shumëllojta, vërejmë se marrëdhëniet juridike civile nuk janë të shumta, pasi edhe qarkullimi civil është i limituar dhe kontrollohet nga shteti:

“Nga marrëdhëniet shoqërore, ndër të cilat, në radhë të parë ato më të rëndësishmet, marrëdhëniet e pronësisë në lidhje me veglat dhe mjetet e prodhimit dhe që njëkohësisht paraqiten të dobishme për interesat e klasës sunduese, rregullohen nga normat e së drejtës në të cilat shprehet vullneti shtetëror, i cili përfaqëson vullnetin e klasës sunduese” (Nathanaili. A, “E Drejta Civile e R.P.Shqipërisë” 1974:59).

Si marrëdhëniet juridike civile më të rëndësishme në këtë kohë, përmendet shitja, furnizimi i mallrave midis organizatave socialiste, qiraja e banesës, sipërmarrja, transportimi, dhurimi dhe trashëgimia. Doktrina e asaj kohe e përcakton marrëdhënien

juridike si marrëdhënie shoqërore, e cila krijohet pasi njerëzit, për të plotësuar nevojat e tyre materiale e kulturore në veprimtarinë e përditshme, janë të detyruar të hyjnë në marrëdhënie të ndryshme me njëri-tjetrin. Vërejmë se, nuk ka një përcaktim të qartë në lidhje me veprimin juridik si marrëdhënie e mirëfilltë civile, ku palët pjesëmarrëse, me vullnet të lirë, të kryejnë veprime juridike, duke marrë përsipër të drejta dhe detyrime. Këto të drejta dhe detyrime sanksionohen nga ligji dhe nuk mund të dalin jashtë kornizës së tij⁶⁹. Marrëdhëniet juridike civile dallohen nga marrëdhëniet e tjera shoqërore, pasi ato janë marrëdhënie pasurore, që rregullohen nga normat e së drejtës civile, në bazë të pozitës së barabartë të palëve pjesëmarrëse, por përsëri, marrëdhëniet pasurore janë shumë të limituara për kohën.

Në marrëdhëniet juridike civile të kohës, sipas doktrinës, përfshihen edhe marrëdhëniet personale jopasurore:

“Duke i rregulluar këto marrëdhënie pasurore dhe jopasurore të cilat në vendin tonë janë marrëdhënie socialiste.” (Nathanaili. A, “E Drejta Civile e R.P.Shqipërisë”, 1974:60). Vërehet se, përveç legjislacionit, edhe doktrina udhëhiqej plotësisht nga ideologjia e kohës. Elementet përcaktues të këtyre marrëdhënieve juridike civile janë⁷⁰:

a) Karakteri vullnetar i tyre, por në ndryshim nga vullneti i parashikuar në Kodin Civil aktual dhe Kodin Civil të 1929, marrëdhëniet juridike civile në këtë kohë karakterizohen nga vullneti shtetëror, që përfaqëson dhe vullnetin e klasës sunduese. Pa vullnetin e shtetit, i cili fiksohet dhe pasyrohet në normat juridike, nuk mund të ketë marrëdhënie juridike civile. Në radhë të dytë, merret parasysh edhe vullneti i palëve pjesëmarrëse në një marrëdhënie juridike civile përkatëse.

⁶⁹ Neni 12 i Kodit Civil të 1981 parashikon që veprimet juridike, në pajtim me interesat e shtetit socialist, synojnë të krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.

⁷⁰ Nathanaili. A, “E Drejta Civile e R.P.Shqipërisë”, 1974:63-66.

b) Subjektet e marrëdhënies juridike civile janë personat mbajtës të të drejtave dhe detyrimeve juridike civile, që përfshihen në të. Të tillë janë si personat, ashtu dhe organizatat e kolektivat socialiste.

c) Përmbajtja e marrëdhënies juridike civile përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet që marrin përsipër palët pjesëmarrëse, me qëllim që të plotësojnë interesat e tyre të ligjshme, të përcaktuara në normat e së drejtës.

d) Objekti i marrëdhënies juridike civile është ai mbi të cilin drejtohet marrëdhënia juridike, ai në të cilin synojnë të drejtat subjektive dhe detyrimet juridike civile.

e) Qëllimi i marrëdhënies juridike civile është plotësimi i nevojave materiale dhe kulture të subjekteve, pra, të kënaqë interesat e tyre vetjake, ato interesa për të cilat është krijuar marrëdhënia juridike e rregulluar në ligj.

Sistemi i së drejtës socialiste u sanksionua përfundimisht në Kodin Civil 1981, i cili nuk i referohej të drejtës romaniste, që kishte e drejta shqiptare para Luftës së Dytë Botërore. Kodit Civil i 1981 ndahej në dy pjesë: e përgjithshme dhe e posaçme, duke e trajtuar në mënyrë të plotë veprimin juridik, te pjesa e parë si institut më vete. Karakteri ideologjik që karakterizon këtë kod, ndeshet në konceptin që i jepet marrëdhënies juridike civile dhe veprimeve juridike në veçanti⁷¹. Gjithë fryma e Kodit Civil të 1981 ka karakter ideologjik dhe mbron më tepër interesat shtetërore, se ato individuale.

⁷¹ Neni 11 i Kodit Civil të 1981. Sipas këtij neni marrëdhëniet juridike civile janë marrëdhënie shoqërore, me karakter politik e ideologjik, që përcaktohen nga marrëdhëniet socialiste në prodhim dhe rregullohen nga legjislacioni civil. Këto marrëdhënie, si marrëdhënie politike e ideologjike, kanë karakter klasor; ato shprehin vullnetin e klasës punëtore dhe të masave të tjera punonjëse. Ato janë marrëdhënie bashkëpunimi dhe ndihme e ndërsjellë ndërmjet njerëzve të lirë nga shfrytëzimi, që kanë për qëllim ndërtimin e shoqërisë socialiste.

Kuptimi i veprimit juridik në këtë Kod jepet në nenin 12 të tij⁷². Nga analiza e kësaj dispozite, vërejmë se kontratat janë pjesë e veprimeve juridike dhe përfshihen prej tyre. Në këtë dispozitë, duket qartë ideologjia që përshkon legjislacionin e kësaj kohe, në përputhje me interesat e partisë-shtet. Pra, veprimet juridike nuk janë thjesht individualiste personale, por kusht kryesor për vlefshmërinë e tyre është se, ato nuk duhet të vijnë në kundërshtim me interesat e shtetit socialist, interes i cili qëndron më lart se të gjitha interesat personale.

Si formë të veprimit juridik, ky Kod përcakton formën verbale dhe shkresore, që mund të jetë shkresë e thjeshtë, e vërtetuar ose e përpiluar tek noteri⁷³. Mungesa e formës së veprimit juridik të përcaktuar nga ligji, bëhet shkak për pavlefshmërinë e veprimit juridik, pasi veprimi juridik, që nuk është bërë me shkresë, është i pavlefshëm, kur një pasojë e tillë parashikohet shprehimisht në ligj. Në rastet e tjera, veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë. Kur një veprim juridik, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacion, duhet të bëhet me akt noterial, ai është i pavlefshëm nëse nuk bëhet në formë të tillë.

⁷²Pjesëmarrësit në marrëdhënie juridike civile kryejnë veprime juridike si kontratë shitjeje, furnizimi dhurimi qeraje, porositje etj. Veprimet juridike janë të njëanshme ose të dyanshme. Veprimet juridike që kryhen me vullnet të lirë synojnë që, në pajtim me interesat e shtetit socialist të krijojnë, të ndryshojnë ose të shuajnë një marrëdhënie juridike civile.

⁷³Në formë shkresore duhet të bëhen: a) veprimet juridike, për të cilat parashikohet në dispozitat ligjore forma shkresore; b) Kontratat që lidhin ndërmarrjet, institucionet, kooperativat bujqësore, organizatat shoqërore ndërmjet tyre, ose me shtetasit; c) Kontratat me vlerë më shumë se njëmijë e pesëqind lekë. Këto lloj kontratash, nëse bëhen jo në formë shkresore, konsiderohen të pavlefshme”.

Në këtë Kod përcaktohen veprimet juridike, të cilat mund të bëhen me gojë, pavarësisht nga forma që kërkohet në dispozita të veçanta për këto veprime juridike⁷⁴.

Përveç mungesës së formës së caktuar ligjore, veprimet juridike janë të pavlefshme kur⁷⁵: a) Janë haptazi në dëm të shtetit. b) Vijnë në kundërshtim me ligjin. c) Bëhen për të mashtruar ligjin. d) Janë kryer nga të miturit nën moshën 14 vjeç ose nga persona të cilëve, për shkak të sëmundjeve psikike a zhvillim mendor të metë, u është hequr krejt zotësia për të vepruar. e) Bëhet me marrëveshje të palëve, pa pasur për qëllim të sjellin pasoja juridike, domethënë bëhen për të mashtruar të tjerët ose për të fshehur një veprim juridik tjetër. Edhe në ligjin “Mbi veprimet juridike dhe detyrimet”, është parashikuar pavlefshmëria e veprimeve juridike, që vijnë në kundërshtim me ligjin⁷⁶.

Edhe në këtë dispozitë vërejmë karakterin ideologjik të Kodit Civil të 1981, në ndryshim nga Kodi Civil i vitit 1929 dhe Kodit Civil të 1994, pasi në shkaqet e pavlefshmërisë, ky Kod parashikon dhe veprimet juridike që janë haptazi në dëm të shtetit, ku përfshiheshin dhe ato që vinin në kundërshtim me urdhëresat e partisë. Doktrina e asaj periudhe sqaronte se, veprimet e paligjshme të njeriut, janë ato veprime që vijnë në kundërshtim me të drejtën në kuptimin objektiv dhe që shkelin një të drejtë subjektive të një personi tjetër⁷⁷.

Në këtë Kod nuk bëhet një ndarje e qartë midis pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative të veprimit juridik, por kjo ndarje kuptohet nga përmbajtja e Kodit Civil dhe

⁷⁴ Neni 16 i Kodit Civil të 1981 parashikon veprimet që nuk kërkojnë formë shkresore, të cilat janë: a) Shitjet me të holla në dorë, që bëhen aty për aty pavarësisht nga vlera, përveç kontratave, që ligji kërkon formën e tyre noteriale, p.sh., shitja e pasurive të paluajtshme. b) Depozitat, që bëhen në raste fatkeqësie si zjarr, përmytje dhe ngjarje të tjera të jashtëzakonshme.

Pra, përveç këtyre rasteve, që vetë ligji lejon kryerjen e tyre jo në formën noteriale, çdo rast tjetër, ku vetë natyra e veprimit të kryer dhe përcaktimi i bërë në legjislacion kërkon formën noteriale, konsiderohen të pavlefshme.

⁷⁵ Neni 17 i Kodit Civil të 1981.

⁷⁶ Neni 7 i Ligjit mbi “Veprimet Juridike dhe Detyrimet ” i vitit 1956.

⁷⁷ Nathanaili. A, “E Drejta Civile e R.P.Shqipërisë”, vol.1, 1974:87

dispozitave të tij. Neni 18 i këtij kodi ka përcaktuar rastet kur gjykata, me kërkesën e të interesuarve, deklaron të pavlefshme veprimet juridike, të cilat janë: a) Kur kryhen nga të miturit që kanë mbushur moshën 14 vjeç dhe e kryejnë veprimin pa pëlqimin e prindit apo kujdestarit. b) Kur kryhen nga persona të cilëve, për shkak sëmundjeje apo zhvillim mendor të metë, u është kufizuar zotësia për të vepruar dhe kur veprimin e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit. c) Personat të cilët, në kohën e kryerjes së veprimit, nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse në kohën e kryerjes së veprimit nuk u ishte hequr zotësia për të vepruar. Nga vetë përmbajtja e kësaj dispozite, ku përcaktohet se, gjykata deklaron të pavlefshme veprimet juridike, kuptohet që deklarimi, si një fazë më e lehtë e pavlefshmërisë, nënkupton pavlefshmërinë relative, ndërsa me veprimet juridike të pavlefshme, të përcaktuara në nenin 17 të ligjit, kuptohen veprimet juridike absolutisht të pavlefshme.

Gjithashtu, në bazë të nenit 19 të këtij Kodi, gjykata mund të investohet në deklarin të pavlefshëm të veprimit juridik dhe nga personi që ka kryer veprimin juridik, duke qenë i mashtruar, i kanosur ose në lajthim. Pra, mashtrimi, kanosja apo lajthimi përcaktohen si raste pavlefshmërie, duke qenë se sjellin vesim të vullnetit dhe mospërputhje të vullnetit të brendshëm me atë të shfaqur. Mashtrimi mund të shkaktojë pavlefshmërinë, vetëm kur gënjeshtria e përdorur nga njëra palë për të shtënë palën tjetër në lajthim, është e tillë që, pa atë, kjo palë nuk do të kishte kryer veprimin juridik⁷⁸.

Në bazë të nenit 21, kanosja mund të shkaktojë deklarin të pavlefshëm të veprimit juridik, kur është e tillë sa t'i shtjerë frikë një personi, se ai vetë, të afërmit e tij ose pasuria e tij janë në rrezik, që të pësojnë një dëm të padrejtë dhe të rëndë. Siç shihet nga

⁷⁸ Neni 20 i Kodit Civil të 1981. Mund të ndodhë që mashtrimi të kryhet dhe nga një person i tretë. Në këtë rast pala e mashtruar mund të kërkojë që veprimi të deklarohet i pavlefshëm vetëm në qoftë se, në kohën e kryerjes së tij, pala tjetër e ka ditur ose duhet ta dinte mashtrimin.

kjo dispozitë, në ndryshim nga Kodi Civil i 1929, nuk është përcaktuar rrethi i të afërmeve, kanosja e të cilëve do të sillte deklarimin e veprimit juridik të pavlefshëm. Kjo është lënë në çmim të gjykatës. Njësoj si përcaktimi i bërë në Kodin Civil të 1929, kanosja mund të bëhet dhe nga një person i tretë, i cili nuk është palë në veprimin juridik.

Si shkak pavlefshmërie në këtë legjislacion është përcaktuar dhe lajthimi, përfytyrimi i gabuar për objektin dhe personin e veprimit juridik⁷⁹. Në këtë rast, veprimi juridik do të deklarohet i pavlefshëm nga gjykata, në bazë të kërkesës së personit të interesuar, nëse lajthimi është i tillë sa, po t'i dinte rrethanat, personi nuk do ta kishte kryer veprimin juridik. Sipas këtij përcaktimi, vërejmë se, jo çdo lloj lajthimi në lidhje me veprimin juridik sjell deklarimin e tij të pavlefshëm. Kjo varet nga rrethanat konkrete që gjykohen nga gjykata dhe nga shkalla e lajthimit në të cilën ka rënë pala. Veprimi juridik, që deklarohet i pavlefshëm, quhet i tillë që nga çasti që është kryer. Ky është element i pavlefshmërisë absolute, megjithatë Kodi nuk bën një përcaktim dhe një ndarje të qartë midis dy llojeve të pavlefshmërisë⁸⁰. Në nenin 24 të Kodit Civil përcaktohet se, pjesët e pavlefshme të veprimit juridik nuk e bëjnë të pavlefshëm të gjithë veprimin juridik, nëse nga rrethanat, natyra ose përmbajtja e tij, del se palët do ta kryenin veprimin juridik edhe pa pjesët e pavlefshme të tij. Pra, Kodi përcakton një lloj rregullimi të pasojave të veprimit juridik, në rastin kur pjesët e tij të pavlefshme nuk mund të sjellin pavlefshmërinë e plotë të tij. Këtë parashikim e gjejmë dhe në Kodin Civil aktual.

Kodi Civil i 1981 ka përcaktuar dhe pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik, që janë të njëjta me ato të Kodit Civil të 1994.

⁷⁹ Neni 22 i Kodit Civil të 1981.

⁸⁰ Neni 23 i Kodit Civil të 1981.

- Kalimi në të ardhurat e shtetit.

Kur veprimi juridik është i pavlefshëm, çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës, merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit dhe kur nuk është e mundur të merret po ajo gjë, kërkohet vlera e saj⁸¹. Kjo përcaktohet nga gjykata, në rastin kur veprimi juridik vjen në kundërshtim me ligjin, është bërë për të mashtruar ligjin ose është haptazi në dëm të shtetit. Kjo e fundit është thelbësore, pasi është fryma ideologjike që përshkon të gjithë legjislacionin e asaj kohe. Në këto raste, gjykata vendos që çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës, nuk iu kthehet më atyre, por si një ndëshkim, kalon në të ardhurat e shtetit. Nëse veprimi juridik nuk dëmton interesat e shtetit dhe njëra nga palët ka vepruar në mirëbesim, gjykata mund të vendosë që çdo gjë që ka dhënë kjo palë t'i kthehet kësaj dhe kur kjo nuk është e mundur të paguhet vlera e saj. Pra, në këtë rast jemi para restitucionit të njëanshëm për palën që ka vepruar me mirëbesim, por përsëri duhet plotësuar kushti themelor që veprimi juridik nuk ka dëmtuar interesat e shtetit. Kjo pasi, edhe nëse pala është në mirëbesim, ky mirëbesim nuk gjen mbrojtje në Kodin Civil të 1981, nëse veprimi juridik dëmton interesat e shtetit.

- Restitucioni i njëanshëm.

Restitucioni i njëanshëm, pavarësisht se si term nuk përcaktohet në legjislacion, zbatohet nga gjykata edhe kur një veprim juridik është kryer me mashtrim ose kanosje⁸². Ky përcaktim ndryshon nga Kodi Civil aktual, pasi kjo dispozitë, si e gjithë fryma e Kodit Civil të 1981, kishte si qëllim ndëshkimin e palëve që nuk zbatonin

⁸¹ Neni 25 i Kodit Civil të 1981.

⁸² Neni 26 i Kodit Civil të 1981 “Palës së dëmtuar, pra asaj që ka pësuar mashtrimin ose kanosjen duhet t'i kthehet çdo gjë që ka marrë pala tjetër dhe kur kjo gjë nuk është e mundur, atëherë i kthehet vlera e saj. Ndërsa ajo që është dhënë nga pala, që ka bërë mashtrimin ose kanosjen, merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit dhe kur kjo gjë nuk është e mundur, merret vlera e saj”.

dispozitat ligjore. Sipas këtij arsytimi, ky parashimim në të drejtën civile ngjan me përgjegjësinë penale⁸³.

Ky Kod, njësoj si Kodi Civil aktual, në bazë të nenit 27 të tij, përcakton se, kur veprimi juridik është bërë jo me qëllim që të sjellë pasojat juridike të dukshme, por me qëllim që të mbulojë një veprim juridik tjetër, atëherë veprimi juridik i mbuluar do të jetë i vlefshëm, nëse i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara nga ligji, ndërsa veprimi juridik që nuk ka si qëllim të sjellë pasojat juridike është i pavlefshëm, pasi për të nuk shfaqet ndonjë vullnet për të krijuar, ndryshuar dhe shuar pasojat juridike të caktuara.

-Restitucioni i dyanshëm.

Kur veprimi juridik deklarohet i pavlefshëm, për arsye se njëra nga palët ka qenë në lajthim, atëherë secila palë detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj, edhe kur kjo gjë nuk është e mundur, t'i paguajë vlerën e saj. Kjo dispozitë shkon më tej duke përcaktuar se, pala që ka kërkuar që veprimi juridik të deklarohet i pavlefshëm, detyrohet të shpërblejë palën tjetër për dëmin e pësuar nga ky veprim juridik⁸⁴. I takon kësaj pale barra e provës për të provuar se nuk ka pasur faj ose se pala tjetër e dinte ose duhet ta dinte lajthimin. Në këtë rast, pala që ka kërkuar deklarimin të pavlefshëm të veprimit juridik nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar⁸⁵. Restitucioni i dyanshëm zbatohet dhe kur veprimi juridik është i pavlefshëm, pasi nuk është bërë sipas formës së caktuar nga ligji⁸⁶.

Sipas nenit 30 të këtij Kodi, restitucioni i dyanshëm zbatohet dhe kur veprimi juridik i pavlefshëm është kryer nga të mitur që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç ose nga të

⁸³ Në Kodin Civil aktual, në lidhje me këto raste, zbatohet restitucioni i dyanshëm, parashikuar në nenin 107 të tij.

⁸⁴ Neni 28 i Kodit Civil të 1981.

⁸⁵ Qëndrim i njëjtë me legjislacionin aktual, neni 110 i Kodit Civil të 1994.

⁸⁶ Neni 29 i Kodit Civil të 1981.

mitur që kanë mbushur moshën 14 vjeç, pa pëlqimin e prindit apo kujdestarit. Gjithashtu, pala që ka zotësi për të vepruar detyrohet që ta shpërblejë të miturin për dëmin që ky ka pësuar, ngaqë veprimi juridik është apo deklarohet i pavlefshëm⁸⁷. Neni 31 i Kodit Civil të 1981, përcakton më tej dhe tre raste të tjera, kur me deklarimin të pavlefshëm të veprimit juridik, gjykata vendos për restitucionin e dyanshëm, duke i detyruar palët që t'i kthejnë njëra-tjetrës çdo gjë që kanë marrë. Këto raste janë: a) Kur veprimi juridik është kryer nga një person, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar. b) Kur është kryer nga një person, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar. c) Kur është kryer nga një person, i cili në kohën e kryerjes së veprimit juridik, nuk ka qenë i ndërgjegjshëm për kryerjen e veprimit të tij. Pala që ka patur zotësi për të vepruar, detyrohet gjithashtu të shpërblejë palën tjetër për dëmin e shkaktuar dhe çlirohet nga ky detyrim vetëm kur arrin të provojë se nuk ka vepruar me faj dhe nuk e ka ditur shkakun e pavlefshmërisë⁸⁸. Gjykata, për të deklaruar të pavlefshëm veprimin juridik, investohet gjithmonë nga palët e interesuara nëpërmjet padisë, e cila duhet të ngrihet brenda një viti⁸⁹.

⁸⁷ Qëndrim i njëjtë me legjislacionin aktual, neni 108 i Kodit Civil të 1994.

⁸⁸ Qëndrim i njëjtë me legjislacionin aktual, neni 109 i Kodit Civil të 1994.

⁸⁹ Neni 32 i Kodit Civil të 1981 parashikon se, llogaritja e këtij afati për personat që nuk kanë patur zotësi për të vepruar ose kanë patur zotësi të kufizuar, fillon nga dita që bëhen madhorë ose nga dita që iu kthehet zotësia për të vepruar. Ndërsa për veprimet juridike të kryera në mashtrim, kanosje apo lajthim, afati fillon nga dita kur mashtrimi apo lajthimi janë zbuluar apo nga dita që kanosja ka pushuar, por në çdo rast, jo më vonë se tre vjet nga dita që është kryer veprimi juridik. Në rastet e tjera, të cilat legjislacioni nuk i parashikon dhe i lë në çmimin e gjykatës, afati i parashkrimit fillon që nga dita që është kryer veprimi juridik.

Kapitulli IV: Veprimet juridike të pavlefshme dhe pasojat e pavlefshmërisë në sisteme të ndryshme ligjore.

Veprimi juridik, si një nënkategori e veprimeve të ligjshme midis subjekteve, në një marrëdhënie juridike, është një koncept me të cilin sistemi kontinental është shumë i njohur, në ndryshim nga vendet që ndjekin traditën e common law. Tradita e case law është e dhënë pas zgjidhjes së rasteve konkrete dhe nuk priret ndaj përgjithësimit të zgjidhjes së rasteve. Zhvillimi i madh i marrëdhënieve ndërkombëtare tregtare ka sjellë dhe një ndërthurje dhe shkrirje të koncepteve mes dy sistemeve, atij kontinental dhe sistemit të common law. Pavarësisht se në sistemin common law nuk kemi një doktrinë për veprimet juridike, nga vetë mënyra e funksionimit të këtij sistemi, kjo nuk do të thotë që veprimet juridike janë një koncept që njihen vetëm në sistemin kontinental të së drejtës.

Teoria e kontratës është zhvilluar nga shkolla e Pandetistikës, e cila ka krijuar dhe ka zhvilluar konceptin e “marrëdhënies juridike”, “deklarimin e vullnetit”, “marrëdhënies së detyrimit” dhe “veprimit juridik”, koncepte të cilat u përhapën në Gjermani, Zvicër, Itali, Spanjë dhe Austri. Këto koncepte logjike dhe teorike nuk mundën të depërtonin në kulturën juridike të common law, pasi këtu koncepti kryesor i kontratës ngelet “premtimi”. Ndërkohë që, në disiplinën kontinentale u përshtatën teoritë e ndryshme, duke depërtuar në dispozitat e Kodeve dhe duke sjellë një mbizotërim të nocioneve me

përmbajtje normative⁹⁰. Koncepti kontraktual në sisteme të ndryshme mbështetet në vlerat e përbashkëta dhe në lirinë për të kontraktuar⁹¹.

Nga ana tjetër, edhe në të drejtën Italiane i kushtohet një rëndësi vlerave të personit⁹². Nuliteti tani nuk është më një zgjidhje drastike dhe ekstreme, duke e fshirë totalisht aktin për interesin e përgjithshëm, por shikohet si një zgjidhje më elastike e aktit, në mbrojtje të interesit të një pale, asaj më të dobët. Ky është versionin modern i së drejtës kontraktore, duke krijuar dhe zhvilluar kontratat standarde⁹³. Kontratat standarde u bënë mekanizmat mbrojtës të kontraktorit më të dobët.

Koncepti i veprimit juridik është shumë i vonë, për faktin se, e drejta romake nuk e ka pasur një koncept të tillë. Në të drejtën romake është përdorur termi veprimi obligator, dhe si palë të tij ishin kreditori dhe debitori, trajtim i adoptuar në të njëjtën mënyrë nga e drejta franceze⁹⁴. Veprimi obligator ishte e drejta e kreditorit që t'i kërkonte palës tjetër debitorit, të jepte (dare), të bënte (facere) ose të duronte (praestare). Pra, veprimi obligator kishte një kuptim më të gjerë se një veprim juridik⁹⁵. Vërejmë se, kushtet e

⁹⁰ Zimmermann, R, "The Law of Obligations, Roman Foundations of the Civilian Traditions", 1996:10.

⁹¹ Valcke, C, "Convergence and Divergence Between the English, French and German Conceptions of Contract", European Review of Private Law, vol 16, no 1, May 2008, pp 29-62. Në të drejtën Gjermane iu është dhënë rëndësi vlerave të personit në arritjen e një kontrate, madje ky është kusht për vlefshmërinë e kontratave.

⁹² Venosta, F, "Le Nullita Contrattuali nell Evoluzione del Sistema"- Nullita e Inesistenza del Contratto, vol I, 2004:198. Ka dy mendime në lidhje me autonominë private dhe lirinë për të kontraktuar. I pari i jep rëndësi autonomisë kontraktore të palëve, e pandikuar kjo autonomi nga ndërhyrjet e jashtme të ligjvënësit apo gjykatësit. Mendimi tjetër thekson se kontrata, edhe pse e realizuar nga palët, është një veprim i ekspozuar nga ndërhyrjet e jashtme të lejuara dhe orientuara nga rendi publik ose nga gjykatësi.

⁹³ Scalisi, V, "Invalidita e Inefficacia. Modalita Assiologiche della Negoziabilità", Rivista-Associazione Essper Periodici Italiani di Economia, Scienze Sociali e Storia, 2003:153.

⁹⁴ Malinvaud, P, Fenouillet, D, "Manuel Droit des Obligations", Edition 12, 2012:48-59

⁹⁵ Mandro, A, "E Drejta Romake", 1998:233: "Kushtet për vlefshmërinë e veprimit obligator ishin:

- a) Veprimi obligator duhet të ishte i mundshëm.
- b) Nuk duhet të ishte në kundërshtim me moralin ose zakonet e mira.
- c) Nuk duhet të ishte në kundërshtim me ligjin.
- d) Duhet të ishte i caktuar ose i caktueshëm.
- e) Duhet të ishte i vlerësuar në të holla."

vlefshmërisë së veprimeve obligatore në të drejtën romake, janë të ngjashme me ato të veprimeve juridike aktuale.

Kontratat përcaktoheshin si veprime juridike të dyanshme ose të shumëanshme, ku duhej pëlqimi i të paktën dy personave me zotësi juridike.⁹⁶

Si kontrata të pavlefshme në këtë kohë konsideroheshin ato për të cilat palët nuk kuptonin për çfarë bëhej fjalë ose ato që lidheshin me dhunë. Gjithashtu, në të drejtën romake, njiheshin si kontrata të pavlefshme edhe ato ku kishte mospërputhje të vullnetit⁹⁷. Element i rëndësishëm i vlefshmërisë së kontratës në të drejtën romake ishte hartimi i saj në formën e kërkuar ligjore, pasi forma është një element i rëndësishëm i kontratës.

⁹⁶ Mandro. A, “E Drejta Romake”, 1998:243: “Në elementet esenciale që duhet të kishte një kontratë, që të ishte e vlefshme, përfshiheshin:

a) Personat kontraktues të kishin zotësi juridike dhe zotësi për të vepruar.

b) Të ishte e shprehur marrëveshja e kontratës.

c) Të ekzistonte objekti i kontratës.

d) Shprehja e pëlqimit të subjekteve të bëhej në formën e caktuar juridike”.

Zotësia juridike dhe ajo për të vepruar e subjekteve lidhej me zotësinë pronësore, me zotësinë që kanë personat për të kryer veprime juridike në lidhje me të drejtat pronësore. Ndërsa objekti i kontratës ishin të gjitha sendet, që ishin objekt i marrëdhënies së detyrimit.

Përputhja e vullnetit të subjekteve të kontratave quhej konsensus (conventio) dhe pa përputhjen e vullnetit, një kontratë nuk ekzistonte. Marrëveshja për të lidhur kontratë bëhej nëpërmjet deklarimit të palëve ose me anën e veprimeve të tyre, pasi shprehja e pëlqimit mund të bëhej me çfarëdo shenje ose në mënyrë heshtësore.

⁹⁷ Mandro. A, “E Drejta Romake”, 1998:244-245. “a) Kur palët deklarojnë se dëshirojnë diçka, por në të vërtetë dëshironin diçka tjetër, të cilën e mbanin të fshehtë (reservatio mentalis).

b) Kur palët merreshin vesh të deklaronin diçka, që nuk e donin për arritjen e një qëllimi juridik (stimulatio).

c) Gabimi ose lajthitja, pasqyrimi i gabuar në kontratë i fakteve të rëndësishme të saj. Në këtë rast bëhej fjalë për vullnet të gabuar, që sillte pavlefshmërinë e veprimit juridik.

d) Mashtrimi, që ishte veprim i qëllimshëm i njëres palë, për të krijuar tek pala tjetër një përfytyrim të rremë në lidhje me elementët dhe të kuptuarit të kontratës, me synim për ta shtyrë palën të lidhte kontratë.

e) Lidhja e kontratës nën ndikimin e përdorimit të forcës dhe frikësimit. Forca kishte të bënte me përdorimin e dhunës për lidhjen e kontratës, ndërsa frika kishte të bënte me një kërcënim antiligjor, që e kishte shtyrë palën të lidhte kontratë”.

Format e parashikuara për lidhjen e kontratës ishin të shumëllojshme, me gjeste simbolike, me kryerjen e veprimeve soleme, me dëshmitarë⁹⁸.

- Pavlefshmëria e kontratave njihej dhe në të drejtën Romake.

Në të drejtën romake, një kontratë që nuk i plotësonte të gjitha kushtet dhe elementet, ishte e pavlefshme. Këto kontrata të pavlefshme klasifikoheshin në kontrata joekzistuese, absolutisht nul dhe relativisht nul⁹⁹.

4.1 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën angleze

Sipas të drejtës angleze, kontrata përcaktohet si marrëveshje për të dhënë sende ose për të kryer veprime, ku njëra palë ka bërë një ofertë, e cila pranohet nga pala tjetër dhe ku të dyja palët kanë si qëllim të hyjnë në një marrëdhënie kontraktore. Nëse bëjmë një vështrim në disiplinat shkencore, dallojmë disa veçanti midis dy sistemeve: atij common law, ku përfshihet dhe Anglia dhe sistemit kontinental. Sistemi common law është më afër me përkufizimet romake, ku figura kryesore e veprimeve juridike këtu ngelet premtimi (promise), duke mos pasur një përkufizim dhe trajtim të veprimit juridik. Duke qenë se sistemi common law nuk është një disiplinë e kodifikuar, ku duhet të

⁹⁸Mandro. A, "E Drejta Romake", 1998:247. Ky formalizëm i madh në lidhjen e kontratave në Romën e lashtë solli vështirësi në zhvillimin e tregtisë dhe jetës ekonomike të vendit, për këtë arsye u shfaqën kontratat verbale, ku pyetjes së kreditorit për lidhjen e kontratës, debitori i përgjigjej pozitivisht. Më vonë, u shfaq kontrata reale, që konsistonte thjesht në dorëzimin e sendit dhe ky moment konsiderohej momenti i lidhjes së kontratës. Gjithashtu, njihej dhe kontrata literale, që kishte të bënte me përpilimin e një shkrese ose dokumenti që vërtetonte lidhjen e kontratës dhe së fundi kontrata konsensuale.

⁹⁹Mandro. A, "E Drejta Romake", 1998:251

a) Kontrata joekzistuese, që ishin kontratat të cilat nuk respektonin formën. Këto kontrata nuk sillnin asnjë efekt juridik dhe nëse ishin zbatuar e kishin sjellë pasoja, u jepnin të drejtë palëve që të kërkonin restitucionin e asaj që kishin ekzekutuar.

b) Kontrata absolutisht nul, që ishin kontratat e lidhura nga personat e paaftë, ishin lidhur në mënyrë të paligjshme ose kishin si objekt një send të palejuar. Kjo pavlefshmëri trajtohej dhe gjykohej nga gjykata dhe kur vërtetohej pavlefshmëria e kontratës, nuk sillte asnjë efekt ligjor.

c) Kontratat relativisht nul konsideroheshin ato që ishin lidhur në lajthitje, në mashtrim, në kushtet e frikës dhe nga persona të mitur. Këto kontrata sillnin efekte juridike, deri në momentin që shpalleheshin të pavlefshme me vendim gjykate në bazë të kërkesave të palëve, të cilat i drejtoheshin me padi gjykatës për restituimin e veprimit dhe pasojave.

mbështetet dhe rregullimi që iu bëhet kontratave, natyrshëm mendohet se në të drejtën angleze flitet për të drejtën e kontratës specifike, e rregulluar rast pas rasti¹⁰⁰.

Disiplina kontinentale mbështetet në rregullat e pasqyruara në kodifikimet e ndryshme, duke sjellë mbizotërimin e nocioneve normative, ku gjen pasqyrim dhe veprimi juridik. Disiplina e veprimit juridik dhe e kontratës në veçanti, në sisteme të ndryshme, mbështetet në vlerat e përbashkëta, duke i dhënë përparësi konsensusit, lirisë për të kontraktuar dhe autonomisë së vullnetit. Diferenca midis trajtimit që i bëhet marrëdhënies kontaktore në Gjermani, si pjesë e traditës së civil law dhe në Angli, mund të gjendet në krahasimin midis nocionit të lirisë së vullnetit kontraktor dhe përcaktimit ligjor të cenimit të vullnetit. Kjo diferencë pasqyrohet e ndarë nga ana objektive dhe subjektive¹⁰¹.

Procesi i harmonizimit dhe unifikimit të konceptit të veprimit juridik, në sisteme të ndryshme ligjore, ka lindur për arsye të qëllimeve praktike dhe ekonomike. Rezultatet e arritura nga unifikimi konceptual i kontratës dhe veprimit juridik, në përgjithësi, kanë vlerë funksionale dhe jo historike apo kulturore¹⁰². Në të drejtën angleze, gjykatat e common law, në fillim nuk e dënonin mosmbajtjen e një premimi kontrate, ndërsa më vonë, kjo u quajt delikt. Në ditët e sotme, në Angli, shkelja e një kontrate nuk trajtohet si delikt, por shqyrtohet me kërkesën e palës së dëmtuar, kur kjo palë e kërkon atë. Në të

¹⁰⁰ Mc Kendrick. E, “Contract Law”, Fifth Edition, 2012:147. Megjithatë parimet themelore të së drejtës kontraktore të krijuara në shekuj gjatë zhvillimit të common law, mbeten elementi unifikues i llojeve të ndryshme të kontratave.

¹⁰¹ Hadjiani. A, Article “Duress and Undue Influence in English and German Contract Law: Comparative Study on Vitiating Factors in Common and Civil Law”, Oxford U Comparative L. Forum, 2002. “Anglia bën një trajtim objektiv, ku liria kontraktore është thelbësore, nëse pala që pretendon invaliditetin e kontratës ia ka bërë të ditur palës tjetër, faktin se kontrata ishte defekte. Në kontrast me këtë trajtim objektiv, ligji gjerman i jep më shumë rëndësi karakterit subjektiv të cenimit të vullnetit, në sensin që, nëse një deklaram apo premtim nuk është bërë lirisht, nuk mund të krijohet kurrë kontratë”

¹⁰² Valcke. C, “Convergence and Divergence Between the English French and German Concepts”, European Review of Private Law, vol 16, no 1, May 2008, Legal Studies Research Series. “Zhvillimi i marrëdhënieve ekonomike dhe atyre të tregtisë është qëllimi dhe arsyeja e harmonizimit të koncepteve kontraktuale, për arritjen e një terminologjie të përbashkët normative”.

drejtën angleze, i jepet një rëndësi konsensusit në lidhjen e një kontrate. Kontratat, në të drejtën angleze, klasifikohen në kontrata të vulosura dhe kontrata të thjeshta¹⁰³. Nëse gjykata konstaton se vullneti është i vesuar, pasoja do të jetë zgjidhja e kontratës. Konsensusi është i vesuar, kur ai nuk përputhet me konsensusin e vërtetë kontraktor të palëve¹⁰⁴. Në të drejtën angleze, si kontrata të pavlefshme, përcaktohen dhe ato, të cilat janë të ndaluara nga ligji dhe ato që vijnë në kundërshtim me moralin dhe rendin publik. Si kontrata, të cilat janë në kundërshtim me rendin publik, mund të përmendim kontratat që kufizojnë lirinë e industrisë dhe të tregtisë dhe veçanërisht konkurrencën e lirë.

- Pasojat e pavlefshmërisë së kontratës.

Pala e dëmtuar ka të drejtë të zgjedhë¹⁰⁵:

a) Të mos pranojë vazhdimin e kontratës dhe të kërkojë kthimin e shpenzimeve të saj, pra prishjen e njëanshme të kontratës.

b) Të kërkojë gjyqësisht dëmshpërblim dhe interesa. E bazuar në common law, dhënia e tyre është e detyrueshme, edhe pse mund të mos ketë asnjë dëm. Në këtë rast, si pagesë

¹⁰³ Fromont. M, “Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës”, 2009:105. a) Kontrata të vulosura janë kontratat e bëra me shkrim, të nënshkruara dhe të vulosura. Kjo formë është e mjaftueshme për kontrata, që nuk mund të jenë të thjeshta, si në rastin e kalimit të të drejtave reale mbi pasuri të paluajtshme.

b) Kontrata e thjeshtë është një kontratë pa një formë të caktuar, përveç rastit kur ligji e kërkon kontratën me shkrim, por që parashikon një kompesim të asaj për çka është angazhuar pala, gjë që përjashton të gjitha veprimet e bëra pa arsye. Ky kompesim është premtimi i palës tjetër për të bërë diçka, për të cilën nuk ishte e detyruar ta bënte më parë.

¹⁰⁴ Fromont. M, “Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës”, 2009:106. “Konsensusi është i vesuar kur është: a) Në lajthim, pra, keqkuptim në lidhje me atë që secili kishte dashur të thoshte në aktin e kontratës. Lajthimi mund të jetë shkaktuar tek të dyja palët ose tek njëra prej tyre duke efektuar të kuptuarit gabim të cilësive thelbësore të objektit të kontratës dhe identitetit të personit.

b) Pohimet e pasakta dhe të paqarta në kontratë. Nëse këto pohime janë bërë në mashtrim, pala mund të përfitojë dëmshpërblim, sepse është para një delikti, si dhe anulimin e kontratës, duke qenë se kontrata është e cenuar në këtë rast. Nëse pohimet janë bërë me mirëbesim, pra nuk ekziston mashtrimi, por si rezultat i pakujdesisë së njëres palë janë kuptuar gabim, viktimat në këtë rast mund të zgjedhë mes prishjes së kontratës ose dëmshpërblimit. Në këtë rast, pakujdesia prezumohet dhe i duhet autorit të pohimeve të pasakta, që të provojë se nuk ka pasur pakujdesi.

c) Detyrimi dhe abuzimi me influencën janë dy nocione të së drejtës angleze që sjellin pavlefshmëri të kontratës, p.sh., abuzimi me influencën, haset kryesisht në marrëdhëniet me mirëbesim, siç janë marrëdhëniet mes bashkëshortëve, mes bankierit dhe klientit etj”.

¹⁰⁵ Fromont. M, “Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës”, 2009:107.

dëmi do të jenë interesat simbolike, por shuma e dëmshpërblimit mund të ulet, nëse viktima nuk ka marrë masa për të kufizuar dëmet.

c) T'i kërkojë gjykatës që të urdhërojë palën tjetër të zbatojë materialisht në natyrë angazhimet e saj për gjëra që duhet të bënte ose të jepte, ose ta detyrojë të heqë dorë nga disa angazhime të saj. Zbatimi i vendimit të gjykatës lihet në dorë të palëve dhe kërkesa të tilla zakonisht hidhen poshtë, kur kontrolli i zbatimit të tyre është i vështirë ose kur shkelin liritë e njeriut.

4.2 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën amerikane

Në të drejtën Amerikane, kontrata përcaktohet si tërësi e të drejtave dhe detyrimeve ligjore, të cilat vijnë si rezultat i marrëveshjeve të palëve, konsensusit në zbatim të Kodit Unik Tregtar dhe akteve të ndryshme nënligjore. Kontrata trajtohet si një kompensim, që bëhet me anën e negociatës, midis palës premtuese ose ofertuese dhe sakrificës së palës tjetër, që i është drejtuar premtimi¹⁰⁶. Sipas Kodit të Njësuar të Tregtisë, kontrata quhet e lidhur, kur oferta e bërë nga njëra palë pranohet nga pala së cilës i drejtohet. Oferta nuk është e detyrueshme për personin që e ka bërë, pasi ofertuesi mund të tërhiqet në çdo kohë, derisa nuk është pranuar akoma nga pala tjetër.

Në të drejtën amerikane, kontratat konsiderohen të pavlefshme kur:

¹⁰⁶ Fromont, M, “Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës”, 2009:132-133. Kjo palë, gjatë negociatave midis ofertuesit dhe premtuesit, pranon të pësojë një dëm kompesues, ndërkohë që nuk është aspak e detyruar, por e ka bërë me qëllim, që të marrë shërbimin e kërkuar. Që kontrata të jetë e vlefshme, kompesimi duhet të jetë real, pra të ketë të bëjë me diçka, që jepet realisht ose një angazhim real nga ana e përfituesit të premtimit. Nuk është e nevojshme për një kontratë të vlefshme të ketë barazi absolute mes kompesimit dhe asaj që premtohet të bëhet nga pala tjetër.

a) Palë në një kontratë është një person i paaftë juridikisht, që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç ose një person i paaftë mendërisht. Në këtë rast, kontrata trajtohet nga gjykata si relativisht e pavlefshme.

b) Kontrata në të cilën vetëm njëra palë ka qenë në lajthim, pasi nëse rezulton se, të dyja palët kanë qenë në lajthim, në parim, kontrata nuk konsiderohet si e pavlefshme.

c) Kontrata, e cila është nënshkruar me detyrim, cilido qoftë shkaku i detyrimit. Kjo kontratë është relativisht e pavlefshme.

d) Kontrata, e cila është nënshkruar nën ndikimin abuziv që mund të ketë një palë karshi kontraktuesit ose me deklaratë të pavërteta e mashtruese. Në këtë rast, kontrata anulohet me kërkesë të palës që ka qenë viktimë e ndikimit abuziv dhe gjithashtu, kjo palë ka të drejtën e dëmshpërblimit. Sipas gjykatave amerikane, edhe fshehja e informacionit konsiderohet mashtrim.

e) Kontrata, e cila ka në përmbajtje të saj një klauzolë, që bie në kundërshtim me rendin publik ose një klauzolë abuzive që bie në kundërshtim me ndërgjegjen (moralin e mirë). Në të dyja rastet, palët kanë të drejtë të mos i zbatojnë këto kontrata.

Një element i rëndësishëm për vlefshmërinë e disa kontratave në të drejtën amerikane, është respektimi i formës së tyre shkresore. Sipas Kodit të Njësuar të Tregtisë, forma shkresore është e detyrueshme, për shitjen e mallrave mbi 500 dollarë, për shitjen e aksioneve dhe obligacioneve, për shitje që tejkalojnë vlerën 5000 dollarë. Në këtë rast, nëse mungon forma shkresore, debitori mund të pretendojë moszbatimin e kësaj kontrate, gjë që nuk ndodh nëse pala tjetër ka bërë shpenzime në lidhje me zbatimin e ardhshëm të kontratës.

4.3 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën gjermane

Në lidhje me problemin e kalimit të pronësisë së një sendi nga shitësi te blerësi, sistemet e ndryshme ligjore, japin përgjigje të ndryshme. Në shumicën e vendeve të sistemit roman dhe në vendet e common law, blerësi e fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin në momentin kur nënshkruhet kontrata e vlefshme e shitblerjes. Në vendet e familjes ligjore gjermanike, përveç aktit të kalimit të pronësisë, duhet të ketë një marrëveshje kontraktuale të veçantë ndërmjet palëve, për kalimin e pronësisë nga shitësi te blerësi. Kjo quhet kontratë reale ose marrëveshje reale dhe dallohet qartë nga marrëveshja që shprehin palët në kontratën e shitjes. Në kontratën e shitjes, shitësi shpreh vetëm konsensusin për të transferuar të drejtën e pronësisë, ndërsa në kontratën reale, ai bie dakord me blerësin, që ky i fundit të bëhet më pas pronar¹⁰⁷. Pra, akti juridik real është i ndryshëm nga akti që parashikon detyrimet kontraktuale midis palëve.

Në të drejtën gjermane, akti real i kalimit të pronësisë përbëhet nga dy elemente: elementi konsensual ose marrëveshja e dy palëve për kalimin e pronësisë dhe elementi real, që konsiston në dorëzimin e sendit te blerësi¹⁰⁸. Në të drejtën gjermane, kalimi i pronësisë së një sendi kalon në tre faza¹⁰⁹: 1) palët përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në marrëdhënien kontraktore; 2) palët hartojnë marrëveshjen konsensuale për kalimin e pronësisë nga shitësi te blerësi; 3) dorëzohet sendi te pala blerëse. Në të drejtën gjermane, në rastin e kontratës së shitjes me rezervë, dorëzimi i sendit nuk sjell

¹⁰⁷ Zweigert dhe H.Kotz “Njohuri për të Drejtën e Krahasuar”, 1994:243.

¹⁰⁸ Neni 929 i Kodit Civil Gjerman.

¹⁰⁹ Zweigert dhe H.Kotz “Njohuri për të Drejtën e Krahasuar”, 1994:246.

trasferimin e pronës¹¹⁰, pasi në këtë rast mungon qëllimi, por transferohet vetëm posedimi, duke e ruajtur sendin deri në momentin e plotësimit të rezervës¹¹¹.

Akti i kalimit të pronësisë përbëhet nga qëllimi i shprehur në marrëveshjen konsensuale midis palëve dhe nga elementi real. Marrëveshja konsensuale përbëhet nga deklaratat e palëve, që bëhen para noterit ose në zyrën e regjistrimit të kadastrës. Në elementin real të aktit të kalimit të pronësisë përfshihet dhe regjistrimi i pronës në regjistrin e kadastrës, duke bërë të njohur për të tretët pronarin e kësaj pasurie. Pra, në ndryshim nga e drejta shqiptare, kontrata reale abstrakte parashikon si element real të kalimit të pronësisë, regjistrimin e pronës në regjistrat publikë¹¹². Në të drejtën gjermane, regjistrimi i pasurisë në regjistrat e kadastrës është prova e pronësisë së një pronari¹¹³. Sistemi gjermanik ka krijuar doktrinën e kontratës reale abstrakte dhe marrëveshja reale në këtë rast është dhe abstrakte, sepse duke patur parasysh dorëzimin, ajo bën kalimin e pronësisë, edhe nëse nuk është bërë me një kontratë të vlefshme shitjeje ose nëse kontrata e shitjes në fillim ishte e vlefshme dhe më pas preket nga ndonjë shkak pavlefshmërie. Kjo teori njihet në sistemin e familjes gjermane, jo vetëm kur sendi shitet, por dhe kur dhurohet, këmbëhet apo kalohet te një kreditor si hipotekë. Në të gjitha këto raste, duhet të bëhet dallimi midis veprimit juridik bazë ose veprimi juridik kauzal, domethënë kontratës së shitjes dhe veprimit juridik plotësues, pra, kalimit të pronësisë. Sipas teorisë së kontratës reale abstrakte, veprimi juridik i plotësuar nuk preket nga ndonjë shkak pavlefshmërie i veprimit juridik bazë. Personi mund të bëhet

¹¹⁰ Neni 455 i Kodit Civil Gjerman.

¹¹¹ Fromont. M, “Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës”, 2009:39.

¹¹² Në të drejtën tonë, pronësia kalon në momentin e nënshkrimit të kontratës, që është momenti i fitimit të pronësisë për një palë dhe i humbjes së pronësisë për palën tjetër. Regjistrimi në regjistrat publikë nuk efekton vlefshmërinë e veprimit juridik, pasi pronësia kalon edhe nëse akti i kalimit të pronësisë nuk regjistrohet në favor të pronarit të ri. Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr.1 datë 06.01.2009.

¹¹³ Neni 891 i Kodit Civil Gjerman.

pronar i së drejtës, edhe nëse veprimi juridik bazë do të shpallet i pavlefshëm. Vlefshmëria dhe pasojat ligjore të kontratës reale duhet të dallohen nga ato të veprimit juridik. Megjithatë, mund të ndodhë që gjykata të mos e marrë parasysh teorinë e kontratës reale abstrakte, kur të dyja veprimet juridike, ai kauzal dhe veprimi juridik real, të jenë pjesë e të njëjtit akt, p.sh., kur veprimi juridik bazë është i pavlefshëm, për arsye se është në kundërshtim me moralin e mirë, në këtë rast, edhe veprimi juridik i plotësimit është gjithashtu i pavlefshëm¹¹⁴.

Sipas Kodit Civil Gjerman, kontrata krijohet si rezultat i përputhjes së vullneteve të palëve. Pavlefshmëritë, që vijnë si rezultat i vesimit të vullnetit, janë:

a) Lajthimi, ka të bëjë me mospërputhjen midis vullnetit të brendshëm dhe shfaqjes së tij, lidhur me të kuptuarit gabim të natyrës së kontratës, cilësive të sendit, llogaritjeve të gabuara apo cilësive të personit, kur këto konsiderohen si thelbësore në marrëdhëniet e biznesit¹¹⁵.

b) Mashtrimi dhe kanosja, kanë të bëjnë me cenimin e vullnetit të palëve, si rezultat i cenimit të parimit të respektimit të moralit të mirë¹¹⁶. Në këto raste, pala, pëlqimi i së cilës është i vesuar, ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të kontratës. Personi që ka shkaktuar gabimin duhet të ndreqë dëmin që i ka shkaktuar palës tjetër¹¹⁷.

¹¹⁴ Kjo zbatohet nga gjykata, në rastin kur veprimi juridik është bërë në kushte të nevojës së madhe të njëres palë, kur është shfrytëzuar mungesa e përvojës së një personi, të metat mendore të tij, etj. Edhe në raste të tjera, gjykata i shpall të pavlefshme kontratën reale dhe veprimin juridik kauzal, kur është e mendimit se e meta u takon të dyjave. Kontrata reale, në thelb, nuk preket nga pavlefshmëria e veprimit juridik bazë. Ajo zbatohet në ato raste kur pavlefshmëria vjen nga gabimi, mashtrimi, nga mungesa e marrëveshjes dhe e formës.

¹¹⁵ Neni 119 i Kodit Civil Gjerman.

¹¹⁶ Neni 123 dhe 142 i Kodit Civil Gjerman përcaktojnë se palët mund të anulojnë kontratën me efekt retroaktiv, kur veprimin juridik e kanë kryer nën efektin e mashtimit dhe kanosjes.

¹¹⁷ Neni 122 i Kodit Civil Gjerman.

Gjithashtu, viktima e mashtrimit apo e dhunës, ka të drejtë t'i kërkojë palës tjetër dëmshpërblim, në bazë të rregullave të përgjegjësisë kontraktore¹¹⁸.

Kodi Civil Gjerman i kushton një rëndësi të madhe vullnetit të palëve. Edhe nëse vërehet mospërputhje midis vullnetit të brendshëm dhe vullnetit të shprehur, gjykata e shpall kontratën të pavlefshme. Në këtë rast, pasojë e kësaj pavlefshmërie, që ka ardhur si rezultat i vesimit të vullnetit, do të jetë zgjidhja njëpalëshe e kontratës. Zgjidhja e kontratës mund të bëhet brenda një viti nga zbulimi i mashtrimit, gabimit apo ndalimit të dhunës¹¹⁹.

Në të drejtën gjermane, një kontratë konsiderohet e pavlefshme edhe në rastet kur:

- a) Akti është hartuar në kundërshtim me ligjin¹²⁰.
- b) Akti është në kundërshtim me moralin e mirë¹²¹.

Një e veçantë e Kodit Civil Gjerman është se, ai ka të përcaktuara dy lista të gjata mbi klauzolat e ndaluara gjatë hartimit të kontratave, si klauzolat që autorizojnë një nga palët për të prishur kontratën pa një arsye të caktuar, klauzolat që parashikojnë rritjen e çmimit pas katër mujave nga data e nënshkrimit të kontratës dhe klauzola të shumta për përjashtimin ose kufizimin e përgjegjësisë¹²². Në këtë rast, gjykata, me kërkesën e palës së pafavorizuar, mund t'i deklarojë të paefektshme klauzolat e ndaluara dhe pjesa tjetër e kontratës të mbetet e vlefshme, nëse zbatimi i rregullave plotësuese lejon ekzekutimin e rregullt të kontratës¹²³.

¹¹⁸ Neni 311 i Kodit Civil Gjerman.

¹¹⁹ Hadjiani. A, Article "Duress and Undue Influence in English and German Contract Law: Comparative Study on Vitiating Factors in Common and Civil Law", Oxford U Comparative L. Forum, 2002.

¹²⁰ Neni 134 i Kodit Civil Gjerman.

¹²¹ Neni 38/1 i Kodit Civil Gjerman. Sipas kësaj pike, janë të ndaluara kontratat, me anën e të cilave, pala më e fortë ekonomikisht, shfrytëzon pozicionin e saj, për të imponuar klauzola shumë të rrepta.

¹²² Neni 308 dhe 309 i Kodit Civil Gjerman.

¹²³ Fromont. M, "Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës", 2009:40. Pra, në këtë rast, zbatohet parimi i ndreqjes ose rregullimit të kontratës me qëllim që ajo të mos shpallet e gjitha e pavlefshme.

Reforma në legjislacion dhe në Kodin Civil Gjerman e përafron atë me legjislacionin privat European, duke adoptuar elementët e direktivave Europiane: “consumer sales directive”. Këto ndryshime dhe direktiva kanë përfshirë në legjislacionin gjerman obligime të reja në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit kontraktor më të dobët në një marrëveshje. Obligimet, në këtë rast, janë bërë objekt kontrolli për nulitetin e veprimeve juridike¹²⁴.

4.4 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën zviceriane

E drejta zviceriane, sipas Kodit Civil Zvicerian, në ndryshim nga e drejta gjermane, nuk përmban një pjesë të përgjithshme, ku të trajtohet veprimi juridik si deklaram i vullnetit të lirë mbi aktin juridik. Kodi Civil Zvicerian e trajton veprimin juridik te pjesa e kontratave¹²⁵. Edhe Zvicra, duke qenë pjesë e familjes ligjore gjermanike, e trajton parimin e kontratës reale abstrakte. Në të drejtën zviceriane, transferimi i pasurisë së paluajtshme, përcakton si kusht vlefshmërie regjistrimin e tjetërsuesit si pronar në regjistrin publik. Në këtë rast, personi, i cili në mirëbesim e ka fituar pasurinë, si rezultat i tjetërsimit nga një person që gabimisht është regjistruar si pronar i kësaj pasurie, gëzon një mbrojtje, si rezultat i mirëbesimit. Ndërsa një person, i cili është në keqbesim, nuk e siguron këtë mbrojtje¹²⁶. Nëse kalimi i një të drejte reale bëhet pa një shkak ligjor ose në bazë të një veprimi juridik të pavlefshëm, pala e tretë nuk mund ta përfitojë këtë pasuri, nëse kjo palë ishte në dijeni të pavlefshmërisë së veprimit juridik

¹²⁴ Micklits. H. W, “The New German Sales Law: Changing Patterns in The Regulation of Product Quality”, 2002:379-385.

¹²⁵ Nenet 1-10 të Kodit Civil Zvicerian. Kontrata rezulton nga përputhja e vullnetit midis ofertës së njëres palë dhe pranimit të palës tjetër. Kontrata quhet e lidhur kur ofertuesi merr pranimin e palës pranuese.

¹²⁶ Neni 974 i Kodit Civil Zvicerian.

bazë. Nëse veprimi juridik bazë është i pavlefshëm, edhe kalimi i pronësisë është gjithashtu i pavlefshëm.

Kodi Civil Zvicerian konsideron si kontrata të pavlefshme:

a) Kur objekti i kontratës vjen në kundërshtim me moralin, rendin publik dhe të drejtat e personit¹²⁷.

b) Kur objekti i kontratës është i parealizueshëm¹²⁸.

c) Kur kontrata është në disproporcion të theksuar mes ofertuesit dhe asaj që zotohet të bëjë në këmbim pranuesi. Pala e dëmtuar, në këtë rast, ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën¹²⁹.

d) Kur pëlqimi i palëve është dhënë në mangësi, pra është dhënë në faj (mashttrim), lajthim dhe kanosje¹³⁰.

e) Kur veprimet kryhen nga persona, të cilët nuk kanë fuqi për të vepruar ose kanë fuqi të pamjaftueshme për të vepruar. Kontrata quhet e pavlefshme në këtë rast, nëse kryhet pa përfaqësuesin ligjor. Nëse përfaqësuesi e jep këtë miratim më pas, atëherë ky ves i kontratës tejkalohet dhe kontrata bëhet e vlefshme¹³¹.

4.5 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën franceze

E drejta franceze nuk e ka rregulluar në mënyrë të shprehur konceptin e veprimit juridik, por Kodi Civil i Napoleonit bën përkufizimin e kontratës si një marrëveshje, në bazë të së cilës, një apo më shumë persona, detyrohen kundrejt një apo më shumë

¹²⁷ Neni 19 i Kodit Civil Zvicerian.

¹²⁸ Neni 20 i Kodit Civil Zvicerian.

¹²⁹ Neni 21 i Kodit Civil Zvicerian.

¹³⁰ Neni 23 i Kodit Civil Zvicerian. Faji, në këtë rast, duhet të jetë thelbësor, si në deklarin e vullnetit mbi natyrën e kontratës, mbi sendin objekt kontratë apo personin e palës tjetër. Gjithashtu, faji ka të bëjë dhe me fakte e elemente të nevojshme të kontratës, që duheshin bërë të ditura nga pala tjetër, e cila ka heshtur në lidhje me to.

¹³¹ Neni 32 i Kodit Civil Zvicerian.

personave të tjerë, të japin, të bëjnë apo të mos bëjnë diçka¹³². Pra, kontrata përcaktohet si marrëveshje e vullnetshme, që ka për qëllim të krijojë detyrime ose të transferojë të drejta nga një person te një tjetër.

Doktrina dhe ligji francez, përsa u përket pasojave të pavlefshmërisë, ka adoptuar një sistem që nuk bën një klasifikim të qartë midis nulitetit dhe anulueshmërisë¹³³. Qëllimi i ligjit është që të rikuperojë një ves kontrate, kur kjo është e mundur në marrëveshjet invalide të palëve¹³⁴. Akordi dhe qëllimi i palëve për ruajtjen e kontratës arsyetohet dhe me rëndësinë që i jepet konsensusit dhe vullnetit të palëve, për të rikontraktuar një kontratë preliminare, që nuk është bërë në formën e kërkuar ligjore. Në këtë rast, theksohet se palët kanë shfaqur vullnet, i cili përbën elementin thelbësor të kontratës, por ky vullnet ka qenë i heshtur¹³⁵.

Kodi Civil i Napoleonit, në ndryshim nga Kodi Gjerman, dallohet për thjeshtësinë e gjuhës së përdorur, megjithatë, klasifikimi i kontratës si një marrëveshje është e përgjithshme, pasi kontrata është një nënkategori e marrëveshjes. Si gjithë familja romane, Kodi Civil Francez nuk e parashikon veprimin juridik, por e identifikon atë me marrëdhënien kontraktore dhe obligacionin. Kontrata klasifikohet në kategorinë veprimeve juridike për faktin se, pasojat e krijuara vijnë nga vullneti i pavesuar i palëve, ashtu si dhe marrëdhënia e obligacionit¹³⁶.

Në të drejtën kontraktore franceze, luan një rol të rëndësishëm autonomia e vullnetit të palëve, e sanksionuar kjo autonomi dhe në dispozitat e Kodit Civil¹³⁷. Megjithatë, me

¹³² Neni 1101 i Kodit Civil Francez

¹³³ Chabas. J. F, "Aatreintes-Generalites", 2005:257.

¹³⁴ Neni 1304 i Kodit Civil Francez.

¹³⁵ Planiol. M, "Traite Pratique de Droit Civil Français", 1954:435.

¹³⁶ Malinvaud. P – Fenouillet. D "Manuel Droit des Obligations", Edition 12, 2012:48-59.

¹³⁷ Zweigert dhe H.Kotz "Njohuri Për të Drejtën e Krahastuar", 1994:129.

zhvillimin e së drejtës dhe marrëdhënieve kontraktore, kjo autonomi dhe liri u kufizua në kuptimin që të mos cenojë lirinë e palës tjetër. Sipas së drejtës Franceze, kontrata që të jetë e vlefshme, duhet të plotësojë dy kushtë¹³⁸:

a) Deklarimi i vullnetit të palëve kontraktore për të krijuar marrëdhënien, detyrimin me liri të plotë dhe për të realizuar qëllimin e kërkuar. Gjithsesi, deklarimi i vullnetit nuk nënkupton abuzimin e njërës palë kundrejt tjetrës. Pëlqimi dhe vullneti është element kryesor i kontratës dhe nëpërmjet tij, prodhohen pasojat juridike.

b) Deklarimi i vullnetit nuk është i mjaftueshëm, por duhet që ky vullneti të sjellë efektet juridike, pasi marrëveshjet morale nuk janë juridikisht detyruese dhe ndaj tyre nuk mund të ngrihet padi.

Duke marrë parasysh që në traditën juridike franceze edhe dhurimet trajtohen si kontrata, thuhet se, edhe pse vullneti i dhuruesit është kryesor, një pëlqim paraprak i përfituesit është i detyrueshëm, pasi përfituesi mund të mos e pranojë dhurimin. Doktrina franceze, e cila i kushton një rëndësi thelbësore mbrojtjes së vullnetit kontraktor të palëve, ashtu si dhe legjislacioni francez, qëndrojnë të ndarë dhe hezitojnë karshi legjislacionit Europian të kontratave, që i trajton kontratat unilaterale si kontrata të plota, pavarësisht se në to është shprehur vetëm vullneti i njërës palë¹³⁹.

Nëse ky vullnet rezulton i vesuar, pasojë do të jetë anulimi i kontratës nga gjykata, në bazë të kërkesës së palës së cenuar. Inkapaciteti total apo kufizimi i kapacitetit, sipas ligjit dhe doktrinës franceze, sjell paaftësinë e palëve për të konceptuar veprimet kontraktore që konkludojnë, duke dëmtuar interesat e tyre pasurore ose jopasurore. Në

¹³⁸ Ghestin, J, "La Notion de Contract", 1990:10.

¹³⁹ Saço. R, "Le Contrat Sans Volonte, Exemple Italien in: le Role de la Volonte Dans les Actes Juridiques", 2000:721.

Ky qëndrim është mbajtur nga Seksionet e Bashkuara të Kasacioni Civil Francez, vendimi nr. 2963, datë 06.09.2002 dhe Kasacioni Civil Francez, Seksioni II, vendimi nr. 1185, datë 11.02.1998.

këtë rast, palët e dëmtuara kanë të drejtë të pretendojnë anulimin e këtyre veprimeve¹⁴⁰.

Në të drejtën franceze, gjyqtarët luajnë një rol të rëndësishëm në analizën e Kodit Civil dhe pasurimin e zhvillimin e së drejtës, duke e përshtatur Kodin me zhvillimet aktuale.

4.6 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën rumune

Në të drejtën rumune, veprimi juridik identifikohet me kontratat e ndryshme, të lidhura në bazë të vullnetit të shprehur të palëve, me qëllim që të krijojnë, ndryshojnë apo shuajnë pasojat juridike të caktuara, të mbështetura në një shkak të ligjshëm. Sipas të drejtës rumune, kushtet e vlefshmërisë së kontratës janë:

a) Shkaku i ligjshëm. Që kontrata të jetë e vlefshme, duhet të mbështetet në një shkak të ligjshëm, pasi mungesa e shkakut ose një shkak i rremë dhe joreal, sjell pavlefshmërinë relative të kontratës¹⁴¹. Shkaku duhet të jetë gjithashtu në mbështetje të rregullave morale e shoqërore, pasi në të kundërt, kontrata është e pavlefshme.

b) Forma e kontratës. Kontrata është konsensuale dhe mjafton të vërtetohet deklarimi i vullnetit të palëve, me përjashtim të shitjes së pasurive të paluajtshme, që duhet të vishet në formë autentike. Në këtë rast, mungesa e formës sjell pavlefshmërinë absolute të kontratës¹⁴². Transkriptimi i pronës, në këtë rast dhe regjistrimi i saj në regjistrin e tokës, sipas nenit 888 të Kodit Civil, bëhet në bazë të dokumentit autentik të noterizuar. Pra kontrata e shitjes së pasurive të paluajtshme është kontratë formale.

c) Qëllimi është i ndryshueshëm nga një kontratë në tjetrën. Qëllimi i drejtpërdrejtë në një kontratë shitjeje për shitësin është marrja e çmimit, ndërsa për blerësin është blerja e

¹⁴⁰Flour. J – Aubert. L. J – Savaux. E, “Droit Civil, Les Obligations, Le Acte Juridique”, Edition 15, 2013:217-224.

¹⁴¹ Neni 1236 i Kodit Civil të Rumanisë.

¹⁴² Neni 1244 i Kodit Civil të Rumanisë.

sendit, ndërsa qëllimi indirekt është arsyeja që shkaktoi manifestimin e vullnetit të palëve. Mungesa e qëllimit apo një qëllim jo i ligjshëm, në të drejtën rumune, e bën kontratën absolutisht të pavlefshme.

d) Aftësia e palëve kontraktore. “Çdo person mund të bëjë dhe të marrë bamirësi në mbështetje të rregullave të kapacitetit”¹⁴³. Palët, gjatë kryerjes së veprimeve juridike, duhet të kenë zotësi për të vepruar (kapacitet). Sipas nenit 988 të Kodit Civil, pala që ka kapacitet të dobët ose kapacitet të kufizuar, nuk mund të tjetërsojë pasuritë e saj, përveçse siç parashikohet nga ligji. Mungesa e kapacitetit (zotësisë) sjell pavlefshmërinë e kontratës.

e) Lënda e kontratës (objekti). Objekti duhet të jetë i lirë për qarkullimin civil, duhet të jetë i përcaktuar ose i përcaktueshëm, të jetë i mundshëm, të ekzistojë në momentin që lidhet kontrata apo të ketë mundësinë e ekzistencës për të ardhmen.

4.7 Pavlefshmëria e veprimit juridik në të drejtën Italiane

Sipas legjislacionit italian, kontrata trajtohet si veprim juridik, pasi Kodi nuk bën një përcaktim të veprimit juridik¹⁴⁴. Sipas Kodit Civil Italian, kontrata është akordi midis dy ose më shumë palëve, për të krijuar, rregulluar ose shuar midis tyre një raport juridik pasuror¹⁴⁵.

Kontrata në këtë rast ka dy funksione¹⁴⁶:

1) Është një nga mënyrat e fitimit të pronësisë¹⁴⁷.

¹⁴³ Neni 987 i Kodit Civil të Rumanisë.

¹⁴⁴ Titulli i dytë i librit të katërt të Kodit Civil Italian bën një rregullim të së drejtës kontraktore, konkretisht nga neni 1321 deri në nenin 1469.

¹⁴⁵ Neni 1321 i Kodit Civil Italian.

¹⁴⁶ Galgano. F, “E Drejta Private”, 1999:227.

¹⁴⁷ Neni 922 i Kodit Civil Italian.

2) Është një nga burimet e detyrimeve¹⁴⁸.

Kodi Civil Italian, siç parashikon kontratën, ka parashikuar dhe elementët kryesorë të vlefshmërisë së saj¹⁴⁹.

- Pavlefshmëria e kontratës, llojet e saj

Kodi Civil Italian nuk ka një përcaktim të qartë në lidhje me invaliditetin, nulitetin dhe pasojat e pavlefshmërisë së veprimeve juridike, ashtu siç nuk ka një përcaktim të qartë për veprimin juridik në përgjithësi, pasi vetë legjislacioni është indiferent në lidhje me këto pasoja, në kuptimin që pasojat e nulitetit nuk ekzistojnë. Koncepti i invaliditetit, mund të përkufizohet si parregullshmëri e kontratës, që sjell si pasojë anulimin e saj. Në këtë konkluzion, ka arritur pjesa më e madhe e doktrinës italiane, që edhe pse ndan pjesërisht qëndrime të ndryshme, ka një mendim i përbashkët. Kur kontratat shpallen invalide ose nul, ato sjellin si pasojë prishjen dhe zgjidhjen e kontratës ose anulueshmërinë e saj¹⁵⁰. Pra, nuk bëhet një përcaktim dhe një ndarje e qartë midis pasojave të nulitetit dhe invaliditetit. Pa dyshim që legjislacioni ka përcaktuar pasojat shkallë pas shkalle, nga më e rënda, që është nuliteti, te faza më e lehtë, që është anulueshmëria dhe zgjidhja e kontratës. Në këtë mënyrë, legjislatori, nëpërmjet

¹⁴⁸ Neni 1173 i Kodit Civil Italian.

¹⁴⁹ Neni 1325 i Kodit Civil Italian. "Elementet e vlefshmërisë së kontratës:

a) Marrëveshja, që në këtë rast nënkupton bashkimin e dy ose më shumë vullnete.

b) Palët, pasi kontrata dallon nga veprimet e njëanshme.

c) Shkaku, në bazë të nenit 1325/2 të Kodit Civil Italian, është funksioni ekonomik-social i aktit të vullnetit, që ka të bëjë me krijimin, ndryshimin apo shuarjen e marrëdhënies juridike të caktuar, pra me atë që synojnë të realizojnë palët me anën e kontratës.

d) Objekti, kontrata, ka si objekt një marrëdhënie juridike me përmbajtje pasurore dhe kjo e dallon kontratën nga kategoria e marrëveshjeve. Sipas legjislacionit Italian, kjo do të thotë se, palët nuk mund të lidhin kontratë që nuk ka natyrë pasurore. Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i përcaktuar ose që mund të përcaktohet.

e) Forma, parimi i përgjithshëm i sistemit modern është ai i lirisë së formave. Pra, si parim mund të pranohen deklaratimet e shprehura ose të heshtura, gojore ose të shkruara pasi, që kontrata të jetë e vlefshme është e mjaftueshme, që të manifestohet vullneti i palëve, cilado qoftë mënyra ose forma e kësaj shfaqjeje".

¹⁵⁰ Ruscica. S, "Nullita del Contratto: Breve Analisi della Recente Casistica Giurisprudenziale", Rivista Altalex, Articolo dt. 08.09.2008.

rregullimit ligjor, iu garanton në mënyrë të barabartë palëve një siguri juridike ndaj rrezikut, që mund të vijë nga pasojat e pavlefshmërisë së kontratave.

Sipas nenit 1418/1 të Kodit Civil Italian, kontrata është absolutisht e pavlefshme kur është në kundërshtim me një normë detyruese, veç kur ligji parashikon ndryshe. Megjithatë nuk ka një përcaktim të qartë midis pavlefshmërisë absolute dhe relative të kontratës, pasi kontrata, që vjen në kundërshtim me një normë detyruese, mund të jetë absolutisht e pavlefshme apo relativisht e pavlefshme¹⁵¹. Gjithashtu, kontrata është konsideruar absolutisht e pavlefshme, për pavlefshmëri të shkakut, të objektit, të motiveve, që kanë shtyrë palët në deklarin e vullnetit¹⁵². Objekti, shkak dhe motivet janë të paligjshme, kur janë në kundërshtim me normat detyruese, me rendin publik apo zakonet e mira¹⁵³. “Akti i autonomisë kontraktore që cenon këto vlera është i paligjshëm dhe për këtë arsye është absolutisht i pavlefshëm”. (Galgano. F, “E drejta private”, 1999:267)

Në lidhje me kontratat e pavlefshme, Kodi Civil Italian parashikon anulimin e kontratës në rastet:

a) Kur palët kontraktore nuk kanë zotësi për të vepruar. Një kontratë e lidhur nga një person që është ligjërisht i pazoti për të vepruar, është e anulueshme¹⁵⁴.

¹⁵¹ Galgano. F, “E Drejta Private”, 1999:261. Që kontrata të jetë absolutisht e pavlefshme nuk është e nevojshme që kjo lloj pavlefshmërie të jetë parashikuar në legjislacion, mjafton të jetë shkelur një normë detyruese e ligjit. Pavlefshmëria relative ndodh kur është parashikuar në ligj një pavlefshmëri e tillë, si rezultat i shkeljes së një norme detyruese.

¹⁵² Neni 1418/2 i Kodit Civil Italian.

¹⁵³ Neni 1343 i Kodit Civil Italian.

¹⁵⁴ Neni 1425 i Kodit Civil Italian. Janë të pazotë për të kontraktuar ata të cilët nuk e kanë fituar zotësinë ligjore për të vepruar dhe ata që, pasi e kanë fituar, e kanë humbur. Këtu futen të miturit nën 18 vjeç, të paaftët mendërisht, vërtetuar me vendim gjykate dhe të dënuarit me burgim të përjetshëm.

b) Kur vullneti i palëve ka qenë i vesuar¹⁵⁵. Në këtë rast, kontrata është e anulueshme, kur vullneti i palëve është deklaruar si pasojë e gabimit, mashtrimit, lajthimit dhe dhunës së përdorur.

Kërkesën për deklarimin e një kontrate si absolutisht të pavlefshme, mund ta bëjë kushdo, edhe një i tretë, i cili provon se ka interes¹⁵⁶. Për deklarimin e kontratës relativisht të pavlefshme, pra anulimin e saj, legjitimohet vetëm pala në favor të së cilës është parashikuar anulimi i kontratës¹⁵⁷, pra, pala që nuk ka zotësi për të vepruar, pala e mashtruar, ajo ndaj së cilës është ushtruar dhunë dhe pala që ka qenë në lajthim¹⁵⁸. Pavlefshmëria absolute mund të deklarohet kryesisht edhe nga gjykata. Gjykata mund të deklarojë të pavlefshme një kontratë që ndodhet nën shqyrtimin e saj, edhe pa një kërkesë të veçantë apo prapësim nga i interesuari, ndërkohë që anulimi nuk mund të deklarohet nga gjykata pa një kërkesë apo prapësim të palës së legjitimuar¹⁵⁹.

Padia për deklarimin të pavlefshëm të kontratës nuk parashkruhet¹⁶⁰, ndërsa padia për anulimin e kontratës i nënshtrohet afatit të parashkrimit pesëvjeçar¹⁶¹. Deklarimi i pavlefshmërinë absolute të një kontrate sjell efekte prapavepruese, qoftë ndërmjet palëve, qoftë ndaj të tretëve¹⁶². Vendimi gjyqësor që anulon kontratën i shtrin efektet dhe ka fuqi prapavepruese vetëm midis palëve dhe personave të tretë, të cilët nuk kanë qenë në mirëbesim¹⁶³. Kontrata relativisht e pavlefshme mund të bëhet e vlefshme. Kjo ndodh kur pala së cilës i takon padia e anulimit, deklaron në mënyrë të shprehur se e

¹⁵⁵ Neni 1427 i Kodit Civil Italian.

¹⁵⁶ Neni 1421 i Kodit Civil Italian.

¹⁵⁷ Neni 1441/1 i Kodit Civil Italian.

¹⁵⁸ Galgano. F, "E Drejta Private", 1999:286.

¹⁵⁹ Seksionet e Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit Italian, vendimi nr. 26242 dhe 26243, datë 12.12.2014.

¹⁶⁰ Neni 1422 i Kodit Civil Italian.

¹⁶¹ Neni 1442/1 i Kodit Civil Italian.

¹⁶² Galgano. F, "E Drejta Private", 1999:287.

¹⁶³ Neni 1445 i Kodit Civil Italian.

njej këtë kontratë, si dhe kur, në mënyrë të heshtur, e ekzekuton vullnetarisht kontratën¹⁶⁴. Kontrata absolutisht e pavlefshme nuk mund të bëhet e vlefshme me asnjë veprim të mëvonshëm¹⁶⁵. Kontrata absolutisht e pavlefshme mund të konvertohet, gjë që nënkupton se, ligji tenton t'i japë vlerë deklarimit të vullnetit, duke zbatuar parimin e përgjithshëm, atë të ruajtjes së kontratës¹⁶⁶.

- Pavlefshmëria dhe paefektshmëria e kontratës

Një kontratë e vlefshme, në një moment të caktuar, mund të jetë joefektive, të mos prodhojë pasojat e dëshiruara. Një kontratë mund të jetë vetëm përkohësisht e paefektshme, si në rastin e kontratës me afat apo në rastin e kontratës me kusht, por mund të jetë përfundimisht e paefektshme, si në rastin e kontratës së simuluar¹⁶⁷. Kontrata është e simuluar, kur kontraktuesit, me anë të deklarimeve të tyre, krijojnë vetëm anët e jashtme të një kontratë, për të cilën nuk duan të ketë efekte (simulimi absolut) ose krijojnë anët e jashtme të një kontrate të ndryshme nga ajo që ata dëshirojnë (simulimi relativ)¹⁶⁸.

- Pasojat e invaliditetit dhe nulitetit të kontratës

Me zhvillimin e legjislacionit në funksion të gamës së madhe të kontratave në mbrojtje të kontraktorit konsumator, kapaciteti krijues i legjislacionit dhe doktrinës ka

¹⁶⁴ Neni 1444 i Kodit Civil Italian.

¹⁶⁵ Neni 1423 i Kodit Civil Italian.

¹⁶⁶ Galgano. F, "E Drejta Private", 1999:290. Sipas nenit 1419 të Kodit Civil, kjo ndodh nëse shkaqet e pavlefshmërisë absolute prekin klauzola të veçanta të kontratës, por jo kontratën në tërësinë e saj dhe këto klauzola nuk janë thelbësore, në kuptimin që, palët do ta kryenin veprimin juridik dhe në mungesë të tyre, si dhe nëse këto klauzola janë juridikisht të zëvendësueshme nga normat juridike. Zbatimin e parimit të ruajtjes së kontratës e ndeshim edhe në rastin e kontratave shumëpalëshe, ku pavlefshmëria absolute apo relative, ka të bëjë me njëren palë pjesëmarrëse dhe kontrata do t'i vazhdojë efektet me palët e tjera që ngelen.

¹⁶⁷ Galgano. F, "E Drejta Private", 1999:293.

¹⁶⁸ Neni 1414 i Kodit Civil Italian.

parashikuar kategori të reja të nulitetit, si nuliteti i mbrojtjes dhe nuliteti virtual¹⁶⁹. Në disa raste, e drejta italiane, përsa u përket pasojave të pavlefshmërisë, e njëson anulimin e kontratës me zgjidhjen dhe rënien e kontratës, por edhe pse burimet juridike të rënies dhe zgjidhjes së kontratës janë të njëjta me atë të anulimit, pasi kanë një vlefshmëri të përkohshme dhe sjellin pasoja të përkohshme deri në momentin që anulohen me kërkesë të njëanshme të njëres prej palëve të cenuara nga kjo kontratë, përsëri nuk mund të mohohet diferenca e thellë midis këtyre dy llojeve të pavlefshmërive.

Anulimi, si formë invaliditeti, presupozon një ves vullneti dhe si pasojë, në bazë të vendimit gjyqësor, ky ves vullneti zgjidhet me anulimin e kontratës¹⁷⁰. Zgjidhja e kontratës rrjedh nga një mangësi e konstatuar në fazën fillestare të lidhjes së kontratës dhe jo në atë të elementëve bazë dhe përcaktimeve ligjore të kontratës. Kjo mangësi e konstatuar në fazën e lidhjes së kontratës nuk mund të futet në teorinë e veseve të vullnetit, por tek kontratat e lidhura në kundështrim me ligjin.

Anulimi dhe rënia duken sikur kanë të njëjtin fushë zbatimi, mirëpo rënia karakterizohet nga fakti që ky akt është nënshkruar në kushte e rrethana nevojë dhe rreziku të njëres palë, duke i ofruar palës tjetër mundësinë që të nxjerrë përfitime të jashtëligjshme, që kanë sjellë një dispropocion në përfitimet e palëve. Tek kontrata e anulueshme, cenimi është i determinuar nga një ves vullneti, mundësisht i shkaktuar nga një veprim ose faj i një personi tjetër¹⁷¹, ndërsa tek rënia, vullneti i palëve është shprehur tashmë dhe cenimi i interesit rrjedh nga dispropocioni i përfitimit të palëve. Si konkluzion, anulimi dhe

¹⁶⁹ Gentili. A, (2003) "Nullita Annulabilita, Inefficacia (Nella Prospettiva del Diritto Europeo), i Contratti", Rivista Associazione Essper Periodici Italiani di Economia, Scienze, Sociali e Storia, Anno: 2003, Fascicolo: 2, Pagina 200-205.

¹⁷⁰ Tommasini. R, "Invalidita" (Diritto Privato), in Enciclopedia del Diritto, vol 22 Milano 1972:576

¹⁷¹ Bianca. M. C, "Diritto Civile 3, Il Contratto", 2015:612.

rënia janë dy koncepte të përcaktuara në legjislacion, të pangatërrueshme me njëra-tjetrën, si nga pikëpamja e strukturës, ashtu dhe nga përcaktimi ligjor i tyre¹⁷².

Invaliditeti rrjedh nga një inefikasitet ose efikasitet i përkohshëm i kontratës, pasi jo çdo inefikasitet do të sjellë invaliditet. Doktrina ka arritur në përfundimin se, invaliditeti mund të jetë një përmbledhje e formave të veseve të kontratës, që sjell anulimin e saj¹⁷³.

Gjykimi në termat validitet dhe invaliditet tregon klasifikimin e aktit me qëllimin që t'i jepet ose t'i mohohet atij fuqia ligjore. Në lidhje me pasojat ligjore, invaliditeti nuk është një fenomen diametralisht i kundërt me validitetin, duke pranuar që ekzistojnë akte të vlefshme, por që nuk prodhojnë efekte ligjore. Ndërsa përsa i përket raportit midis invaliditetit dhe kundërligjshmërisë, nga doktrina del se, që të dyja shkojnë në të njëjtin drejtim, mjafton të analizosh hipotezën që hedh neni 1338 i Kodit Civil, i cili klasifikon te pavlefshmëria edhe kundraligjshmërinë me pasojë dëmshpërblimin ose dënimin¹⁷⁴. Doktrina flet për invaliditet total ose të pjesshëm, që sjell inefikasitetin e të gjithë aktit apo të një pjese të tij, për invaliditet absolut dhe relativ të aktit, i cili konsiderohet inefikas kundrejt të gjithë aktit ose një pjese të tij dhe gjithashtu flet për invaliditetin aktual dhe potencial ku pavlefshmëria del nga thelbi i aktit ose nxirret nga gjykimi i gjyqtarit¹⁷⁵. Anulimi nëpërmjet organeve gjyqësore, kur këto ndërhyjnë në një fazë të mëvonshme gjatë zbatimit të kontratës, sjell pavlefshmërinë e kontratës¹⁷⁶.

¹⁷² Cariota. F. L, "Il Negozio Giuridico nel Diritto Privato Italiano", 2011:134.

¹⁷³ Di Marzio. F, "La Nullita del Contratto", Enciclopedia, 2008:104.

¹⁷⁴ Falzea. A, "Efficacia Giuridica", Capacita. Efficacia Giuridica. Fato Giuridico. Manifestazione, 1999:475.

¹⁷⁵ Caringela. F, "Il Contratto", Manuale di Diritto Civile, vol I, 2007:778.

¹⁷⁶ Këshilli i Shtetit Italian, Seksioni i V, dt. 12/02/2008 vendimi nr. 490: "Pavlefshmëria e mëpasshme ndërhyr atëherë kur akti në origjinë ishte i vlefshëm, por vlefshmëria e tij rrëzohet, kur del një shkak ose arsye pavlefshmërie e mëpasshme. Kjo kuptohet si një e metë funksionale që ka akti, i cili ndesh në interesa juridike të rangut ose rëndësisë madhore si interesi i lartë publik". Gjyqësori, në këtë rast, nuk nxjerr në pah pavlefshmërinë, por inefikasitetin, që sjell ai akt (akti është i vlefshëm, por për një interes të lartë publik, gjykata e lë ato joefikas).

Risite normative e doktrinare kanë sjellë një rishikim të analizës së disa kategorive tradicionale në studimet e nulitetit dhe kanë drejtuar jurisprudencën në nxjerrjen e akteve të reja normative, duke përsosur dhe zhvilluar akte të mëparshme, që nuk përdoreshin ose përdoreshin shumë pak. Nga ana tjetër, ato kanë sjellë një zvogëlim të interesit për zgjidhjen e problemit nëpërmjet konstatimit të pavlefshmërisë së plotë¹⁷⁷. Gjithë kjo procedurë erdhi në mbështetje të standardeve europiane dhe kontratave standarde për mbrojtjen e kontraktorit më të dobët. Legjislacioni aktual në mbrojtje të kontraktorit konsumator, zhvillon kapacitetin krijues të tij dhe si pasojë, nuliteti kalon nga një instrument i njohjes së thjeshtë të parregullsisë ligjore, në një instrument, nëpërmjet të cilit dallohen veprimet që bien në kundërshtim me rregullat e së drejtës kontraktore europiane, e themeluar mbi vlerat e përbashkëta dhe teknikat e reja të kodifikimit, efektive efikase dhe demokratikisht të ligjëruara¹⁷⁸.

Nuliteti tani nuk është më një zgjidhje drastike dhe ekstreme, duke e fshirë totalisht aktin për interesin e përgjithshëm, por ai tani shikohet si një rregullim më elastik i aktit në mbrojtje të interesit të një pale kundrejt tjetrës dhe kundër interesit të përgjithshëm¹⁷⁹. Praktika gjyqësore sqaron se, përse u përket kushteve të përgjithshme të kontratës, është e domosdoshme që kushtet sanksionuese të kenë një kundërfirmim të

¹⁷⁷ De Cristofaro.G (2005) "Il Codice del Consumo" Un Ocasione Perduta? Rivista Studium Iuris, Anno 2005, Volume: 10, Pagina 1137-1149.

¹⁷⁸ Rodota. S, (2005) "I Saggi, il Codice Civile e il Processo Costituente europeo", Rivista-Associazione Essper Periodici Italiani Di Economia, Scienze, Sociali e Storia, Anno: 2005, Volume: 23, Fascicolo: 1, Pagina 21-33.

¹⁷⁹ Scalisi. V, (2003) "Invalidita e inefficacia. Modalita Assiologiche Della Negoziallita", Rivista-Associazione Essper Periodici Italiani di Economia, Scienze Sociali e Storia, Anno 2003, Volume: 49, Fascicolo: 2, Pagina 201-217.

veçantë, të ndarë dhe të kuptueshëm, kundrejt të gjithë kushteve të tjera të kontratës¹⁸⁰.

Nuliteti tani konceptohet si një instrument ligjor i kontrollit dhe dinamikës kontraktuese dhe gjithashtu një instrument promovues i mirëbesimit në përfundimin e kontratave. Nëpërmjet rolit të nulitetit, jurisprudenca tani duhet që të marrë një rol më aktiv në zhvillimin e dinamikës kontraktuese¹⁸¹.

Këto nulitete të reja janë më të lehta se tradicionalet, më të kontrolluara dhe më pak dëmtuese se invaliditeti i të drejtës së përbashkët. Zgjidhja e nulitetit tani merr një formë të re dhe bëhet një instrument i mbrojtjes së interesave të veçanta ose më ndryshe të kategorive, që në treg njihen si kontraktorët e dobët. Këndvështrimi modern i interesit të përgjithshëm është tani jo më ai i interesave të palëve pjesëmarrëse, por bëhet pjesë e njërës prej tyre, asaj që identifikohet si kontraktori i dobët ose ajo, që ka nevojë për një mbrojtje më specifike¹⁸².

Në praktikën gjyqësore italiane, është ngritur për diskutim problemi i trajtimit të kontratave të nënshkruara para hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore, por që janë në fazë ekzekutimi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij legjislacioni¹⁸³. Gjithsesi, përsa u përket normave të reja urdhëruese, duhet bërë dallimi midis momentit të nënshkrimit të kontratës dhe momentit të krijimit të efekteve të saj, pasi gjykata i trajton të ndara këto

¹⁸⁰ Kasacioni Civil Italian vendimi nr.1868 datë. 05.12.2003: “Duhet të firmosen në mënyrë të veçantë kushtet sanksionuese të kontratës. Nuk është e vlefshme në prezencë të këtyre kushteve një firmë e përgjithshme e të gjitha kushteve të kontratës ose dy firma të palës, ku me firmën e dytë, sipas neneve 1341 dhe 1342 të Kodit Civil, pala kontraktuese pranon gjithë kushtet e kontratës veçanërisht ato sanksionuese. Aprovimi i kushteve sanksionuese duhet të jetë specifikuar, veçanërisht në mënyrë që të tërheqë vëmendjen e palës dhe të kuptohet prej saj.

¹⁸¹ Scalisi. V, (2003) “Invalidita e Inefficacia. Modalita Assiologiche Della Negoziabilità”, Rivista-Associazione Essper Periodici Italiani di Economia, Scienze Sociali e Storia, Anno 2003, Volume: 49, Fascicolo: 2, Pagina 201-217.

¹⁸² Caringella. F, “Il Contratto” Manuale Di Diritto Civile, vol I, 2007:780.

¹⁸³ Gjykata e Romës, vendimi nr. 430, dt. 21/01/2000: “Praktika gjyqësore arsyeton se, normat e reja urdhëruese në objektin e kushteve abuzive të kontratës, aplikohen edhe për kontratat e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtyre normave”.

dy momente¹⁸⁴. Përsa i përket një kontrate afatgjatë, ndërhyrja në të, gjatë kohës që ajo sjell efektet ligjore duke shtuar një dispozitë të re që synon futjen e një norme të re detyruese, e cila kërkon të kushtëzojë autonominë kontraktuale të palëve, mund të bëhet¹⁸⁵.

¹⁸⁴ Gjykata e Romës, vendimi nr. 2275, dt. 06/06/2005: “Nuk mund të urdhërohet nga gjykata nuliteti i kushteve të kontratës së huasë së shtëpisë, që ka të bëjë me normat e interesit e nënshkruar në vitin 1989, duke patur parasysh se, kjo nuk është nënshkruar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 108, të vitit 1996. Gjithashtu, nuk vërehet asnjë shkelje e principeve të përgjithshme të korrektesës dhe besimit të mirë nga ana e bankës kredidhënëse, kur ajo mohon kërkesën e huamarrësve, që të rikonstraktojnë kushtet e kredisë sipas ligjit të ri, pasi efektet e kësaj kontrate kanë filluar, janë bërë aktive dhe kanë sjellë pasojat e tyre para hyrjes në fuqi të ligjit të ri”

¹⁸⁵ Kasacioni Civil Italian, Seksioni nr. III, vendimi nr. 1689, datë. 26/01/2006: “Nëse krijohet një normë detyruese, që parashikon ndryshimin e disiplinës juridike të mëparshme, që nuk e përmbante këtë normë detyruese të re, atëherë lind kontradita e kësaj të fundit me përmbajtjen e kontratës, pasi nuk i lejon kushtet e kontratës të veprojnë në të ardhmen, domethënë të justifikojnë veprime të tjera, përveç atyre që janë bërë më parë. Kjo kontratë rregullohet tashmë duke patur parasysh, që neni 1339 i Kodit Civil thotë se, efikasiteti juridik i kontratës pas normës detyruese, duhet konsideruar vetëm si efikasitet i lindur nga kushti, që përmban kjo normë e re, e cila e zëvendëson ose e integron për të ardhmen (për jetën aktive të mbetur të kontratës, pra, kjo normë detyruese e re do të ketë vlerë për të ardhmen). Kushti i vendosur do të ketë fuqi ligjore vetëm për vazhdimësinë e saj, përse u përket efekteve të reja, që kontrata duhet të prodhojë”.

Kapitulli V: Pavlefshmëria e veprimeve juridike dhe llojet e pavlefshmërisë (doktrina, ligji dhe praktika gjyqësore)

Burimi i të drejtave subjektive pasurore ose jo, është e drejta objektive, por kjo e drejtë vihet në jetë nëpërmjet veprimeve juridike¹⁸⁶. Megjithëse shprehja e vullnetit të veprimeve juridike njihet dhe mbrohet nga rendi juridik, ajo nuk është e plotfuqishme, sepse është pikërisht rendi juridik, ai që përcakton dhe kufijtë e kësaj shprehjeje vullneti, duke përcaktuar rregullat që duhen ndjekur.

Legjislacioni shqiptar i klasifikon veprimet juridike të pavlefshme në dy lloje:

1. Ato të cilat janë të pavlefshme (absolutisht të pavlefshme).
2. Ato të cilat shpallen të pavlefshme (relativisht të pavlefshme).

Në legjislacionin dhe doktrinën italiane, nuk ka një ndarje të qartë midis pavlefshmërisë absolute dhe relative. Kur bëhet fjalë për klasifikimin e pavlefshmërisë, përplasen dy mendime të ndryshme¹⁸⁷. Nga njëra anë, cenimi dhe mangësitë e kontratës përfshihen në grupin e anulueshmërisë dhe nga ana tjetër, pretendohet për nulitetin e kushtit negociues. Mungesa e elementit konsensual në kontratë, afirmon invaliditetin radikal dhe absolut të kontratës, duke sjellë rënien e saj¹⁸⁸.

Në ndryshim nga doktrina dhe ligji italian, doktrina dhe praktika gjyqësore gjermane, bën një klasifikim dhe një dallim midis nulitetit dhe anulueshmërisë, në kuptimin që, vetëm kjo e fundit vendos në lëvizje gjykatën, nëpërmjet një kërkesë për eliminimin e pasojave të mëtejshme të kontratës. Praktika gjyqësore gjermane sqaron se, në lidhje me

¹⁸⁶ Tartari. A, (2015) “Kushti në Veprimet Juridike Civile”, Revista-Avokatia, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë Shqiptare, nr.13, dt. 15.01.2015, f. 115-131.

¹⁸⁷ Fox. V, “Annullamento Degli Atti di Gara ed Invalidita del Contratto d appalto”, Rivista-Altalex, datë 17.02.2003.

¹⁸⁸ Kasacioni Civil Italian, Seksioni I, vendimi nr. 1490, datë 17.11.2000.


nulitetin, nuk është as e mundur dhe as e nevojshme, të anulohet diçka që nuk ekziston, pra çfarë është nul nuk anulohet¹⁸⁹. Nga kjo analizë vërehet se, praktika gjyqësore gjermane, dallimin midis pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative të veprimeve juridike, e trajton në të njëjtën mënyrë me të drejtën tonë.

Në bazë të studimit sasior dhe klasifikues, të kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, rezultuan 107 741 vendime gjykate për padi civile në total dhe nga këto, rezultuan 2289 vendime gjykate për pavlefshmëri në total.

Raporti midis vendimeve gjyqësore të padive civile në total dhe atyre të padive për pavlefshmëri në total, sipas viteve përkatëse, në mënyrë tabelare dhe grafike, paraqitet si më poshtë:

Viti	Nr. i padive civile në total	Nr. i padive për pavlefshmëri në total
2006	7646	145
2007	9524	209
2008	11151	199
2009	11020	202
2010	10243	194
2011	10073	188
2012	12944	157
2013	13201	215
2014	12487	209
2015	9452	571

¹⁸⁹ Vendimi nr. 1265, datë 14.12.20065, i Gjykatës së Apelit Hamm, Gjermani.




Nga analiza statistikore dhe krahasuese e kryer, si dhe verifikimi i paraqitjes grafike rezulton se, viti 2015 ka një rritje të numrit të padive për pavlefshmëri në total, ndërkohë që duket sikur numri i padive civile të total është ulur¹⁹⁰. Në të vërtetë, nuk është ulur numri i padive civile në total, por nuk janë përfshirë në këtë numër, paditë civile administrative, të cilat i kanë kaluar gjykatës administrative dhe për këtë arsye paraqitet ky rezultat. Nga studimi i viteve të tjera rezulton se, numri i padive për pavlefshmëri qëndron thuhet në të njëjtat shkallë, me përjashtim të vitit 2013, në të cilin vërehet një rritje e vogël e numrit të tyre, por kjo rritje ndikohet nga rritja e pasqyruar dhe te paditë civile, në total të këtij viti.

Në vijim të kësaj analize, 2289 vendimet gjyqësore për pavlefshmëri në total, janë klasifikuar në katër grupe, sipas llojeve të ndryshme të padive për pavlefshmëri. Konkretisht, për periudhën 10-vjeçare, rezultuan 178 vendime me padi për pavlefshmëri testamenti, 1564 vendime me padi për pavlefshmëri të kontratave, 166 vendime me padi

¹⁹⁰ Rritja e numrit të pavlefshmërive në këtë vit, vërehet më tepër në paditë për pavlefshmëri të kontratave, kryesisht atyre tregtare, të shoqërive tregtare.

për pavlefshmëri të veprimeve juridike dhe 381 vendime, ku në objektin e padisë kërkohej pavlefshmëri e veprimit juridik dhe pavlefshmëri e kontratës specifike apo testamentit, pra, paditë ku ka konkurruar pavlefshmëria e veprimit juridik me atë të kontratës (dispozitat e përgjithshme me ato të posaçme të Kodit Civil).

Raporti midis llojeve të ndryshme të padive për pavlefshmëri, në formë grafike për periudhën 2006-2016, paraqitet si më poshtë:



Nga kjo paraqitje grafike vërehet se, numri më i madh i padive për pavlefshmëri në periudhën 2006-2016, janë pavlefshmëritë e kontratave, pasi janë veprimet juridike më të shpeshta në veprimtarinë e përditshme midis subjekteve. Gjithashtu, përbëjnë një numër të konsiderueshëm dhe vendimet e gjykatës me objekt pavlefshmëri të veprimeve juridike dhe të kontratave apo testamenteve, pra, paditë ku konkurojnë dispozitat e përgjithshme, me ato të posaçme të Kodit Civil.

Duke qenë se, veprimi juridik e përfshin kontratën, marrëdhënien juridike dhe detyrimin, elementet, kushtet dhe rregullat ligjore të përcaktuara në pjesën e

përgjithshme për pavlefshmërinë e veprimit juridik, janë të zbatueshme edhe për pjesën e posaçme. Përderisa veprimi juridik ka përparësi ndaj këtyre koncepteve, ai i shtrin efektet dhe te konceptet që kanë si bazë veprimin juridik, konkretisht, kontratat dhe testamenti, të parashikuara në pjesën e posaçme.

5.1 Veprimet juridike absolutisht të pavlefshme

Pavlefshmëria absolute është forma e pavlefshmërisë së një veprimi juridik, që nuk efektton asnjë pasojë juridike. Edhe nëse një veprim juridik mund të ekzistojë faktikisht, pra, të plotësohen elementet për përbërjen e tij faktike, ai nuk është i aftë të prodhojë ato pasoja juridike të dëshiruara nga palët¹⁹¹.

Sipas dispozitave ligjore, veprimi juridik është nul, kur mungon zotësia për të vepruar e palës, kur vullneti për kryerjen e veprimit juridik është inekzistent ose kur veprimi juridik është në kundërshtim e mashtrim me normat urdhëruese të ligjit¹⁹².

Doktrina flet për veprime absolutisht të pavlefshme, edhe në rastet kur janë plotësuar elementet themelore për kryerjen e veprimit juridik, por ato nuk sjellin pasoja juridike, për shkak se cenojnë interesat publike. Në këtë rast, veprimet juridike janë të ndaluara me dispozita urdhëruese të ligjit¹⁹³.

Veprimi nul është sikur të mos kishte ekzistuar fare dhe palët ose të tretët, mund të sillen sikur veprimi juridik të mos ishte kryer¹⁹⁴. Veprimi juridik është nul, që në momentin e konkludimit të tij dhe gjykatës nuk i duhet të shprehet për rregullimin e

¹⁹¹ Semini. M, (2013), “Pavlefshmëria e Veprimeve Juridike nën Këndvështrimin e Kodit Civil, Doktrinës dhe Praktikës Gjyqësore”, Revista “Jeta Juridike”, nr. 4: “Kjo paaftësi mund të jetë e përhershme e pakorrigjueshme dhe, në këtë rast, veprimi juridik është absolutisht i pavlefshëm ose paaftësia mund të jetë potencialisht e mundshme për t’u korrigjuar, atëherë veprimi juridik është relativisht i pavlefshëm”.

¹⁹² Neni 92 i Kodit Civil të 1994.

¹⁹³ Gjata. R, “E Drejta Civile”, 2010:160.

¹⁹⁴ Nuni. A, “Veprimet Juridike”, 2001:97.

pasojave, që ky veprim juridik mund të ketë shkaktuar tek të tretët. Megjithatë, gjykata, disa herë, investohet nga palët edhe për zgjidhjen e pasojave dhe në këtë rast, duke qenë se gjykata shprehet për aq sa palët kërkojnë në gjykim, është e detyruar të zgjidhë dhe pasojat e një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm.

Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm është i paaftë të sjellë pasojat e dëshiruara nga palët, por mund të sjellë pasoja të tjera jashtë synimeve të palëve, pasoja që vijnë për shkak të ligjit. Nuk kërkohet prej palës të shpenzojë asnjë lloj energjie për të vënë në lëvizje gjykatën. Veprimi juridik është në vetvete i pavlefshëm¹⁹⁵.

Pavarësisht se veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm është nul dhe nuk sjell pasojat e dëshiruara nga palët, ai realisht ka sjellë pasoja të ndryshme nga ato që kanë synuar palët, për këtë arsye, për të garantuar siguri në qarkullimin civil, pala e interesuar duhet të kërkojë, krahas konstatimit të pavlefshmërisë së veprimit juridik, edhe zgjidhjen e pasojave, që realisht mund të kenë ardhur në këtë rast.

Në lidhje me këtë arsyetim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se, për të konstatuar një veprim juridik si absolutisht të pavlefshëm, nuk është e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë në gjykatë, qoftë kjo padi apo kundërpadi, pasi kjo lloj pavlefshmërie konstatohet, pavarësisht nga paraqitja në gjykatë e kërkesës¹⁹⁶.

Pavlefshmëria absolute mund të parashtrohet nga çdo palë ndërgjyqëse që ka interes. Forma e parashtrimit mund të jetë edhe prapësimi, pasi veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm. Pavlefshmëria absolute mund të pretendohet nga cilido që ka interes kundrejt palëve që

¹⁹⁵ Semini. M, (2013), "Pavlefshmëria e Veprimeve Juridike nën Këndvështrimin e Kodit Civil, Doktrinës dhe Praktikës Gjyqësore", Revista "Jeta Juridike", nr. 4.

¹⁹⁶ Vendimi nr. 13, datë 09.03.2006, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

kanë kryer veprimin juridik, si dhe kundër çdo personi të tretë që pretendon të drejta nga veprimi juridik.

Edhe në praktikën gjyqësore italiane është analizuar çështja e fuqisë së gjykatësit, në lidhje me rastin e konstatimit të nulitetit të kontratës kryesisht dhe rregullimin e pasojave të zgjidhjes së kontratës. Sipas Seksioneve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit italian, nuliteti mund të vërtetohet edhe kryesisht nga gjykata¹⁹⁷.

Në këtë analizë, në doktrinën italiane, anulimi dhe zgjidhja e kontratës janë ekuivalente me invaliditetin e kontratës, bazuar në një ves gjenetik. Në këtë rast, përfundimi i kontratës operon me eliminimin e pasojave që kontrata ka prodhuar për palët, duke sjellë një rezultat të njëjtë me atë që do të kishte prodhuar një deklaram vullneti, kryesisht nga gjykata. Nuliteti mund të konstatohet kryesisht nga gjykata, edhe pse nuk është kërkuar nga palët anulimi i kontratës, por është kërkuar përmbushja e kësaj kontrate. Në fushën e së drejtës private Europiane dhe tregut European, gjykata ka detyrimin e zgjidhjes, kryesisht të nulitetit, në funksion të parimit të mbrojtjes nga nuliteti, të palës së dobët kontraktore dhe interesit të natyrës mbi individual të palëve¹⁹⁸.

Doktrina dhe legjislacioni gjerman, në lidhje me konceptin dhe konsekuencat e një transaksioni nul, parashikon se, kontratat nul nuk mund të ekzekutojnë të drejta dhe detyrime dhe një transaksion i tillë, duhet të merret sikur nuk ka ekzistuar “null ab initio”¹⁹⁹. Nuliteti i një transaksioni në ligjin gjerman del nga analiza e dispozitave ligjore të Kodit Civil.²⁰⁰ Vërehet se, trajtimi i nulitetit në ligjin gjerman është i ngjashëm me ligjin tonë. Në rrethana specifike, transaksioni nul në të drejtën gjermane

¹⁹⁷ Seksionet e Bashkuara të Kasacionit Civil Italian, vendimi nr. 26242 dhe 26243, datë 12.12.2014.

¹⁹⁸ Rizzo. N. (2015) “Accertamento Della Nullità e Azioni di Impugnazione del Contratto”, Rivista-Diritto Civile Contemporaneo, Anno II, No. 1, Gennaio-Marzo, dt. 15.03.2015.

¹⁹⁹ Foster. N – Sule. S, “German Legal System and Laws”, Fourth Edition, 2010:446.

²⁰⁰ Nenët 105, 171, 125, 134, 138 të Kodit Civil Gjerman.

mund të bëhet i vlefshëm, nëse është konstatuar gabim forme²⁰¹. Edhe pse kontrata mund të jetë nul, legjislacioni lejon që një nulitet parcial të tejkalohet, nëse palët bien dakord ta konkludojnë kontratën pa pjesët e pavlefshme dhe nëse ekziston mundësia reale e ndarjes së këtyre pjesëve, trajtim të cilin e hasim dhe në ligjin tonë²⁰². Një përjashtim tjetër, që lejon tejkalimin e nulitetit është kur palët, edhe pse janë përballur me nulitetin, do ta kishin konkluduar kontratën²⁰³. Një deklaram vullneti nul mund të konfirmohet si i vlefshëm dhe të barazohet me një deklaram vullneti të ri²⁰⁴.

Disa nga format e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik në legjislacionin tonë janë:

Veprimet juridike që kryhen duke shkelur formën e caktuar

Respektimi i formës së kërkuar nga ligji, gjatë hartimit të një veprimi juridik, është një element i vlefshmërinë së tij. Kjo është e domosdoshme kur forma shkresore përcaktohet në një dispozitë urdhëruese e ligjit, për efekt ligjshmërie. Në këtë rast, ky veprim juridik është absolutisht i pavlefshëm. Mungesa e formës së kërkuar nga ligji, si shkak i pavlefshmërisë absolute, nuk është e përcaktuar qartësisht në nenet 92 dhe 94 të

²⁰¹ Neni 311 i Kodit Civil Gjerman parashikon formën e transaksionit të pasurive të paluajtshme dhe neni 510 parashikon vlefshmërinë e kontratës së dhurimit.

²⁰² Neni 139 i Kodit Civil Gjerman dhe neni 111 i Kodit tonë Civil.

²⁰³ Neni 140 i Kodit Civil Gjerman.

²⁰⁴ Neni 141 i Kodit Civil Gjerman.

Kodit Civil, por del në dispozitat e tjera ligjore²⁰⁵. Në legjislacionin shqiptar, njihen dy forma të veprimit juridik, me gojë dhe me shkresë. Veprimi juridik, i cili nuk është kryer në formë shkresore, është absolutisht i pavlefshëm, vetëm në rastin kur kjo pavlefshmëri është e përcaktuar në ligj. Në këto raste, forma është kusht themelor për vlefshmërinë e veprimit juridik dhe forma e veprimit juridik duhet për solemnitet “ad solemnitatem-ad substantiam”²⁰⁶. Në të gjitha rastet e tjera, kur ligji nuk kërkon që veprimi juridik të bëhet me shkresë, veprimi juridik nuk është i pavlefshëm, por ky veprim juridik nuk mund të provohet me dëshmitarë “ad probationem”²⁰⁷.

Mosrespektimi i formës së caktuar ligjore është element që shkakton pavlefshmërinë e veprimeve kontraktore dhe në legjislacionin italian. Sipas nenit 2702 të Kodit Civil Italian, nënshkrimi me gjeneralitete të plota është kusht për t'i dhënë eficiencë kontratës. Gjithsesi, Gjykata e Kasacionit Civil ka arsyetuar se, nuk konsiderohet nul kontrata e nënshkruar pa firma të dallueshme dhe pa gjeneralitete të plota të palëve, nëse gjeneralitetet e tyre dalin nga konteksti i kontratës. Sipas gjykatës, vetëm ai që ka nënshkruar, mund të pretendojë pavlefshmërinë e firmës dhe jo pala tjetër²⁰⁸. Nuk ka dyshim se shkrimi dhe personi që nënshkruan, janë elementë që e bëjnë kontratën të

²⁰⁵ Neni 83 i Kodit Civil të 1994: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt notarial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik, që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji”.

Neni 107 i Kodit Civil të 1994: “Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm, për arsye se është bërë me mashttrim, kanosje, nga nevoja e madhe ose sepse mungon forma e kërkuar nga ligji, secila nga palët duhet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj”.

Semini. M, (2013) “Pavlefshmëria e Veprimeve Juridike nën Këndvështrimin e Kodit Civil, Doktrinës dhe Praktikës Gjyqësore”, Revista “Jeta Juridike”, nr. 4. “Dispozita të tjera, që parashikojnë pavlefshmërinë e veprimeve juridike, kontatave, nëse nuk respektohet forma e caktuar ligjore, janë 81, 82, 193/1, 195, 235/1, 393, 397, 547/1, 562, 750, 764/1, 786, 963/1, 1114”.

²⁰⁶ Kondili. V, “E Drejta Civile”, Pjesa e Përgjithshme, 2008:243.

²⁰⁷ Kondili. V, “E Drejta Civile”, Pjesa e Përgjithshme, 2008:244.

²⁰⁸ Kasacioni Civil Italian, Seksioni II, vendimi nr. 23669, datë 19.11.2015.

vlefshme, por do të ishte e pavend që të pretendohet për pavlefshmëri të firmës nga pala tjetër dhe jo nga pala që ka firmosur²⁰⁹.

Përsa i përket formës, në të drejtën italiane, kur kontrata përbëhet nga disa klauzola detyruese për palët, këto klauzola duhet të bëhen të qarta. Kusht për vlefshmërinë e kontratës dhe e marrëveshjeve në përgjithësi, është përcaktimi dhe nënshkrimi i të gjitha klauzolave detyruese të kontratës, edhe në kontratat standarde²¹⁰. Përveç mungesës së formës, në të drejtën italiane, ashtu si dhe në legjislacionin tone, parashikohet nuliteti i kontratës dhe për mungesë ose mospërcaktim të objektit²¹¹. Në këtë rast, kërkesa drejtuar gjykatës bëhet nga palët²¹².

Përsa i përket formës, në të drejtën gjermane, kur ligji nuk parashikon ndryshe, kontratat verbale janë të vlefshme dhe mund të provohen me çfarëdo forme. Megjithatë, një pjesë e kontratave duhet bërë me shkrim, p.sh., pranimi i një huaje²¹³.

Doktrina dhe ligji gjerman parashikon nulitetin e veprimit juridik dhe në rastin e pamundësisë “imposibilitetit” të objektit të detyrimit²¹⁴. Debitori mund të refuzojë të përmbushë një detyrim, kur kushtet e tij të detyrimit janë shumë të mëdha dhe të pamundura nga pikëpamja ekonomike, në krahasim me përfitimet e kreditorit, p.sh., detyrimi i gjetjes së një unaze në një shishe në fund të oqeanit. Ky detyrim mund të realizohet, por kërkon shpenzime të mëdha. Nëse debitori, me vullnet do ta realizojë

²⁰⁹ Valeria. T, “Contatti-Cassazione Civile: Il Contratto Può Essere Firmato Con Una Sigla Illeggibile” Rivista-Filodirit, Articolo dt. 26.01.2016.

²¹⁰ Giuseppe Cammalleri “Contratto di Intermediazione Finanziaria: Nullo in Assenza di Forma Scritta e Sottoscrizione”, Rivista-Filodirit, Articolo dt. 04.06.2014.

²¹¹ Neni 663 i Kodit Civil Italian.

²¹² Kasacioni Civil Italian, Seksioni II, vendimi nr. 22161, datë 20.10.2014.

²¹³ Pieck. M, (2010) “A Study of the Significant Aspects of German Contract Law”, Annual Survey of International & Comparative Law, vol 3, iss 1, article 7.

²¹⁴ Neni 275 dhe 311 i Kodit Civil Gjerman.

këtë detyrim, ai është i lirë ta bëjë²¹⁵. Imposibiliteti i veprimit juridik në ligjin gjerman, përfshin dhe pamundësinë “de juro”, p.sh., një pronë e vjedhur nuk mund të transferohet²¹⁶.

Veprimet juridike, të cilat duhet të bëhen me akt noterial, janë absolutisht të pavlefshme, edhe nëse pavlefshmëria e tyre nuk është parashikuar në një dispozitë ligjore. Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm më vonë. “Ajo që është e vesuar që në fillim nuk mund të ndreqet me kalimin e kohës (Quod ab initio vitiosum est, tractu temporis convalescere non potest)” (Kondili. V, “E Drejta Civile”, 2008:244)

Pra, pavlefshmëria absolute e veprimit juridik, e shkaktuar si rezultat i shkeljes së formës së tij, të përcaktuar me ligj, nuk mund të bëhet e vlefshme me asnjë veprim të mëvonshëm ose shprehje të mëvonshme të vullnetit të palëve, për t'i dhënë jetë këtij veprimi nul. I vetmi rast që tejkalon këtë lloj pavlefshmërie është parashkrimi fitues, si mënyrë e fitimit të pronësisë, kur plotësohet elementi kohë, i përcaktuar në ligj dhe posedimi i pandërprerë i sendit si pronar. Ky është një rast përjashtimor, ku tejkalohet pavlefshmëria absolute.

Pra, veprimet juridike, për të cilat ligji ka të përcaktuar qartë formën shkresore si element vlefshmërie të shfaqjes së vullnetit të palëve, janë absolutisht të pavlefshëm, nëse mungon kjo formë.

²¹⁵ Reimann. M, – Zekoll, J. “Introduction to German Law”, Second Edition, 2005:223.

²¹⁶ Neni 935 i Kodit Civil Gjerman.

Praktika gjyqësore njeh raste të tilla²¹⁷.

Paditësat kanë pretenduar pavlefshmëri absolute të kontratës së shitblerjes së vitit 1994, pasi nuk ka formën e kërkuar nga ligji, nuk është bërë me akt noterial dhe është shitur vetëm nga njëri prej bashkëshortëve, në një kohë kur, sipas ligjit, ajo ishte pasuri bashkëshortore. Si rrjedhojë e kësaj pavlefshmërie, edhe kontratat e tjera janë të pavlefshme. Gjykata ka gjetur dhe një shkak tjetër pavlefshmërie. Në kontratën e dytë të shitjes, shtetasja U.K., duke qenë se nuk dinte shkrim dhe lexim, ka nënshkruar në kontratë me shenjën e gishtit, në një kohë kur ligji “Për noterinë”, parashikonte nënshkrimin nga një i autorizuar prej palës dhe i identifikuar nga gjykata konform kërkesave ligjore. Sipas arsyetimit të gjykatës, edhe kontrata e tretë është absolutisht e pavlefshme, pasi është shitur vetëm nga shtetasja U.K., pa pëlqimin e bashkëshortit të saj. Të tre kontratat, duke qenë të pavlefshme, nuk sjellin asnjë pasojë, janë nul, sikur të mos kenë ekzistuar dhe banesa ngelet në pronësi të të dy bashkëshortëve U.K dhe Rr.K. Pretendimi i ngritur nga i padituri, se kontrata e fundit nuk është e pavlefshme pavarësisht nga dy të parat, pasi paditësja U.K. e ka shprehur vullnetin e saj si bashkëpronare e shtëpisë nuk qëndron, pasi në këtë kontratë të tretë mungon vullneti i bashkëshortit të saj²¹⁸.

²¹⁷ Vendimi nr. 30, datë 19.02.2009, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mori në shqyrtim çështjen me palë paditëse U.K., etj, të paditur F. K., me objekt: “Pavlefshmëri e veprimit juridik, kontratës së shitjes të vitit 1994, të kontratës së shitjes nr. 189, datë 16.02.2000 dhe të kontratës së shitjes nr. 429, datë 09.06.2000, si dhe të çdo lloj kontrate që ka të bëjë me këtë pasuri. Çregjistrimin e këtyre kontratave nga regjistrat hipotekorë. Detyrimi i të paditurit të njohë pronarë paditësat”.

Kolegji Civil vëren se, nga materialet e administruara në dosje, Rr. K., bashkëshorti i U. K., i ka shitur djalit të tij A. K., babait të F. K., në datën 15.04.1994, një shtëpi banimi dhe kjo kontratë është regjistruar në emrin e tij në regjistrat hipotekorë. Kjo kontratë nuk është hartuar para noterit, por është përpiluar nga një avokat dhe është vërtetuar nga noteri. Në datën 16.02.2000, me kontratën e shitjes 55 rep, shtetasi A. K., ia ka shitur këtë shtëpi nënës së tij U. K. dhe kjo e fundit, pas 4 muajsh, ia ka shitur përsëri djalit të saj A. K. Përfundimisht, në ZVRPP, shtëpia figuron e regjistruar në emër të A. K. Dhe, duke qenë se ai ka vdekur me trashëgimi, i ka kaluar djalit të tij F. K.

²¹⁸ Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Vendimi nr. 1226, datë 30.10.2007, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Qëndrimi dhe arsyetimi i bërë në këtë rast është i drejtë, pasi veprimi juridik nuk mund të efektojë pasojat e një veprimi juridik i vlefshëm. Veprimi juridik është hartuar duke mos respektuar formën e caktuar ligjore dhe në kundërshtim me ligjin, pasi bashkëshortja, në cilësinë e bashkëpronares nuk ka shprehur pëlqimin e saj për këtë kalim. Paditësit edhe pse nuk kanë qenë palë në kontratën e shitjes, legjitimohen në kërkesën e tyre, sipas nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, pasi interesi legjitim që ata kërkojnë të realizojnë nga kjo kërkesë padi, është njohja e pronësisë së tyre në këtë pasuri. Ky interes realizohet nëpërmjet konstatimit të pavlefshmërisë së këtij veprimi juridik dhe zgjidhjes së pasojave, fshirjen nga regjistri hipotekor. Gjithsesi, edhe nëse nga palët do të kërkohej vetëm njohja e pronësisë në zbatim të interesit legjitim në ngritjen e padisë, konstatimi i pavlefshmërisë dhe zgjidhja e pasojave mund të bëhej kryesisht nga gjykata.

Në lidhje me respektimin e formës së caktuar ligjore, si element i vlefshmërisë së veprimit juridik, lind pyetja nëse, edhe regjistrimi në regjistrat publikë përbën element të vlefshmërisë së tij?²¹⁹ Kushtet që duhet të plotësojë një veprim juridik, që të jetë i vlefshëm dhe të efektojë pasoja, janë: pëlqimi i palëve, shkaku i ligjshëm, objekti i kontratës dhe forma e kërkuar ligjore.²²⁰ Në analizë të kësaj dispozite, regjistrimi nuk është kusht për vlefshmërinë e veprimit juridik. Regjistrimi ka vetëm funksionin e publikimit dhe deklarimit, duke bërë të njohur për të tretët, personin që disponon titullin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme. Forma e caktuar ligjore, si element vlefshmërie

²¹⁹ Kjo pasi, neni 83 i Kodit Civil përcakton se, veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm.

²²⁰ Neni 663 i Kodit Civil të 1994.

nuk duhet ngatërruar me formalitetin e regjistrimit, i cili disponon vetëm funksionin deklarativ²²¹.

Gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme dhe të paunifikuara në lidhje me efektin e regjistrimit të veprimeve juridike në regjistrat publikë. Në disa raste, e kanë lidhur regjistrimin me vlefshmërinë e veprimit juridik dhe i kanë dhënë vlerë një veprimi juridik, i cili, edhe pse është hartuar i dyti në kohë, është regjistruar i pari²²². Praktika gjyqësore, në këtë rast, arsyeton se regjistrimi i veprimit juridik në regjistrat publikë është kusht për vlefshmërinë e tij, pasi sipas përparësisë në regjistrim²²³, është pikërisht ky veprim që arrin të krijojë pasojat e ligjshme të transferimit të pronësisë, duke qenë se kjo është paraqitur e para për regjistrim.

Ky është një qëndrim i gabuar i gjykatës dhe i interpretimit të përparësisë në regjistrim, pasi kjo ka të bëjë vetëm me faktin e radhës së paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim te Regjistruesi dhe duke u nisur nga kjo radhë, refuzohet regjistrimi i akteve që aplikohen më vonë në kohë në sportelin e Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme²²⁴. Gjithashtu, duke iu referuar “Pasojave të regjistrimit”, regjistrimi i një pasurie të paluajtshme i jep personit të drejtën për ta transkriptuar këtë pasuri të paluajtshme, në përputhje me ligjin.²²⁵ Përparësia në regjistrim është një veprimtari

²²¹ Këtë qëndrim kanë mbajtuar dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1, datë 06.01.2009.

²²² Vendimi nr. 6837, datë 15.10.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²²³ Neni 37/1 i ligjit nr. 33 datë 21.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” parashikon përparësinë në regjistrim: “Përparësia e regjistrimit përcaktohet në varësi nga radha e paraqitjes në mënyrë të përshtatshme të dokumentave të tyre te regjistruesi, pavarësisht nga data e përpilimit të tyre dhe pavarësisht se shënimi në kartelë mund të vonohet”.

²²⁴ Neni 37/2 i ligjit nr. 33, datë 21.04.2012, Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme: “Regjistruesi nuk mund të pranojë asnjë regjistrim të ri të një pasurie të paluajtshme nëse për këtë pasuri ka një regjistrim të mëparshëm të një titulli, sipas neneve 44 dhe 45 të këtij ligji”. Formulari i aplikimit për regjistrimin e një titulli pronësie ka të pasqyruar datën dhe orën e depozitimit të aktit në ZVRPP.

²²⁵ Neni 36 i ligjit nr. 33, datë 21.04.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

administrative e Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe nuk efektton vlefshmërinë e akteve dhe veprimeve juridike.

Veprimet juridike që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit

Veprimet juridike janë të pavlefshme, kur vijnë në kundërshtim me një normë urdhëruese ose ndaluese të ligjit. Në këto veprime nuk përfshihen vetëm ato që vijnë në kundërshtim me ligjin si akt normativ, por dhe ato që vijnë në kundërshtim me çdo akt normativ e nënligjor tjetër. Marrëdhëniet juridike civile janë tepër komplekse dhe jo çdo element në lidhje me to, mund të përcaktohet në aktet normative të përgjithshme. Ligjet përcaktojnë rregullat e përgjithshme për marrëdhëniet juridike të caktuara, ndërsa elementet specifike, sipas llojeve të veprimeve, përcaktohen në aktet normative të dala në zbatim të ligjit. Veprimet juridike të kryera në kundërshtim me dispozitat e akteve nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit, janë veprime të kryera në kundërshtim me ligjin.

Shfaqja e vullnetit të palëve pjesëmarrëse, jo vetëm që duhet të jetë e ligjshme, por duhet të gjejë shprehje në botën e jashtme, pasi në të kundërt, nuk sjell pasoja juridike. Nëse heqja dorë nga trashëgimia bëhet tej afatit tremujor, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, atëherë kjo heqje dorë është absolutisht e pavlefshme dhe nuk sjell pasoja juridike. Vullneti i palëve, në këtë rast, nuk është bërë i njohur në botën e jashtme brenda afateve të përcaktuara në ligj dhe në formën e kërkuar ligjore, me anën e deklaratës së shkruar dhe të regjistruar në gjykatën ku është çelur trashëgimia ose në procesverbalin gjyqësor²²⁶.

²²⁶ Revista - Avokatia, "Veprimi Juridik. Probleme të Teorisë dhe Praktikës Gjyqësore", Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë Shqiptare, shkruar nga Av/Artan Hajdari, dt. 06.05.2014.

Këto veprime ndahen në ato që vijnë në kundërshtim me ligjin dhe në ato të cilat realizohen për të mashtruar ligjin. Nuk është e nevojshme të veprimet që vijnë në kundërshtim me ligjin, të vërtetohet dijenia e palëve se veprimet e tyre ndaloheshin nga një dispozitë e ligjit²²⁷. Padijenja e tyre ose mirëbesimi ka rëndësi vetëm në rastin e zgjidhjes së pasojave²²⁸. Veprimet juridike të kryera në kundërshtim me ligjin apo në mashtrim të ligjit, nuk duhet të ngatërrohen me veprimet e paligjshme. Veprimet e paligjshme janë veprime juridike që sjellin përgjegjësi civile, si rezultat i shkakimit të dëmit ose përgjegjësi penale.

I njëjti trajtim bëhet dhe në legjislacionin italian, në lidhje me nulitetin e kontratës, të konkluduar në kundërshtim me një normë imperative të ligjit. Praktika gjyqësore në këtë rast ka sqaruar se, vetëm shkelja e normave imperative të përcaktuara në ligj dhe kur nuk thuhet ndryshe nga ligji, sjell nulitetin e kontratës dhe jo paligjshmërinë e veprimit si rezultat i shkeljes së ligjit, që shkakton përgjegjësi civile apo penale²²⁹.

Megjithatë, mund të ketë raste, kur veprimi juridik i pavlefshëm të jetë dhe veprim juridik i paligjshëm civil apo penal, i cili do të shkaktojë përgjegjësi civile, në lidhje me shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i veprimit të paligjshëm.

E drejta italiane konsideron nul dhe kontratat që vijnë në kundërshtim me normat imperative të së drejtës publike, në rastin kur shkelen interesa publike. Sipas këtij arsyetimi, rënia e kontratës është konsekuencë e nulitetit dhe jo e anulueshmërisë, në rastin kur janë shkelur rregullat gjatë zgjedhies së kontraktorit, në kontratat e lidhura për

²²⁷ Nuni. A, "Veprimet Juridike", 2001:106.

²²⁸ Neni 106 i Kodit Civil të 1994.

²²⁹ Kasacioni Civil Italian, Seksioni I, vendimi nr. 8642, datë 10.04.2015.

interes publik, që udhëhiqen nga normat e së drejtës publike, pra, normat imperative²³⁰.

Sipas doktrinës gjermane, kontratat e lidhura në kundërshtim me ligjin janë nul, nëse ky nulitet për kontratën specifike, është parashikuar në dispozitat ndaluese të ligjit²³¹. Një kontratë është nul, nëse nuk ka në përmbajtjen e saj kushtet e përcaktuara nga ligji²³². Gjykata e Lartë Federale Gjermane ka arsyetuar se, një kontratë qeraje e një pasurie të paluajtshme, e cila pas një periudhe kohe, me marrëveshje të palëve, kthehet në një kontratë shitjeje, atëherë vlera e qerasë së paguar përfshihet në çmimin e kontratës. Kjo kontratë konsiderohet e pavlefshme, nëse nuk plotëson të gjitha kushtet formale të përcaktuara nga ligji, për kontratën e shitjes²³³. Gjithashtu, në ligjin gjerman, janë nul dhe kontratat e konkluduara në kundërshtim me moralin e mirë²³⁴.

Praktika gjyqësore gjermane i konsideron nul kontratat e konkluduara në kundërshtim me moralin e mirë. Gjykata e Lartë Gjermane arsyeton se, palët e një veprimi juridik, duhet të sillen me korrektesë karshi njëri-tjetrit dhe sipas rregullave të mirëbesimit. Janë të ndaluara rregullat që kufizojnë lirinë kontraktore të palës. Gjatë një marrëdhënieje kontraktore, dorëzanësit i lind detyrimi për të përmbushur obligimin e debitorit jopërmbushës, që në momentin që lind obligimi parësor. Çdo marrëveshje e bërë në keqbesim, në kundërshtim me këto përcaktime dhe moralin e mirë, është e pavlefshme²³⁵.

²³⁰ Qëndrime të mbajtura nga Këshilli i Shtetit Italian, vendimi nr. 1328, datë 28.03.2008 dhe vendimi nr. 1218, datë 05.03.2003.

²³¹ Pieck. M, "A Study of the Significant Aspects of German Contract Law", Annual Survey of International & Comparative Law, vol 3, iss 1, article 7 datë. 25.08.2010.

²³² Neni 125 i Kodit Civil Gjerman.

²³³ Gjykata e Lartë Federale Gjermane, Oberlandesgericht Stuttgart, vendimi nr. 5 U 40/14, datë 28.07.2014.

²³⁴ Neni 138/1 i Kodit Civil Gjerman. Kontratat që kufizojnë tregtinë dhe ato që cenojnë lirinë kontraktore dhe autonominë e personit janë nul, duke qenë në kundërshtim me moralin e mirë.

²³⁵ Gjykata e Lartë Federale Gjermane, Bundesgerichtshof, vendimi nr. 2008/487, datë 29.01.2008.

Edhe në praktikën gjyqësore franceze konsiderohen nul kontratat e konkluduara në kundërshtim me përcaktimet ligjore, pasi cdo veprim i vullnetshëm midis palëve duhet të ndjekë qëllimin e ligjit²³⁶.

Nga ana tjetër, edhe në doktrinën e legjislacionin polak, i kushtohet rëndësi faktit që kontrata duhet të përbëhet nga të gjitha karakteristikat e përcaktuara për aktet juridike, në dispozitat ligjore²³⁷. Lidhja e kontratës i detyron palët, që përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve subjektive, t'i referohet ligjit civil polak, duke parashikuar konceptin e efektit të dyfishtë, që nënkupton se, një kontratë duhet të ketë në përbërjen e saj, konceptin e të drejtave dhe detyrimeve si dhe të shuarjes së kontratës²³⁸. Në ligjin polak, kanë vlerë ligjore marrëveshjet paraprake, ku palët konkludojnë me njëra-tjetrën për një kontratë përfundimtare në të ardhmen²³⁹. Vlefshmëria e kontratës paraprake varet nga përmbajtja e saj, e cila duhet të ketë parashikimet thelbësore për kontratën e së ardhmes. Marrëveshja paraprake, që të jetë e vlefshme, duhet të përmbajë një datë, brenda së cilës kontrata përfundimtare duhet të konkludohet. Gjithsesi, nëse kontrata përfundimtare nuk konkludohet brenda afatit, secila palë ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit ose zëvendësimin e palëve, me të cilat do të lidhet kontrata përfundimtare²⁴⁰.

Praktika e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka shqyrtuar pavlefshmërinë

²³⁶ Kasacioni Civil Frances, vendimi nr. 12-28013 dhe 12-28654 co 00466 datë 13.05.2014.

²³⁷ Machnikowski. P – Balcarczyk. J – Drela. M, “Contract Law in Poland”, 2011:31.

²³⁸ Neni 155/1, 510/1 dhe 1052/1 i Kodit Civil Polak.

²³⁹ Neni 389 dhe 390 i Kodit Civil Polak.

²⁴⁰ Machnikowski P – Balcarczyk. J – Drela. M, “Contract Law in Poland”, 2011:34.

absolute të veprimit juridik, të lidhur në kundërshtim me një ligj të veçantë²⁴¹.

Në Kolegjet e Bashkuara, është shtruar për diskutim pyetja nëse do të konsiderohet se, veprimi juridik vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit dhe nëse ky fakt do të konstatohet vetëm me prapësimet e palës së paditur apo me kundërpadi? Kolegjet e Bashkuara kanë arsyetuar se, shitja e objektit është bërë me ankand dhe fitues i ankandit është shpallur Ministria e Pushtetit Lokal, për këtë arsye kontrata e shitjes është e ligjshme. Çdo shitblerje tjetër, pa u zhvilluar një ankand i ri në lidhje me këtë objekt, është në kundërshtim me ligjin dhe konsiderohet si një veprim absolutisht i pavlefshëm. Personi i tretë V.L., nuk e ka fituar ankandin, por është renditur i dyti në radhën e pjesëmarrësve dhe nuk mund të shpallej fituese oferta e dytë, edhe sikur fituesi i ankandit të mos plotësonte kushtet e përcaktuara nga aktet ligjore²⁴². Mosplotësimi i kushteve dhe kriterëve ligjore nga fituesi i parë i ankandit nuk legjitimon automatikisht të dytin në radhë, pasi mosplotësimi i detyrimeve ligjore çon në përsëritjen e ankandit. Kontrata e shitjes, në këtë rast, është absolutisht e pavlefshme, pasi është lidhur në

²⁴¹ Me vendimin nr. 13, datë 09.03.2006, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë marrë në shqyrtim rastin, me paditës V. L. dhe A.P., të paditur Ministria e Pushtetit Lokal, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, administratorët e shoqërive huamarrëse, person i tretë V. L me objekt: “Detyrimin e të paditurve të na njohin si të vetmit pronar mbi objektin, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute juridike të kontratës së shitblerjes, e lidhur ndërmjet të paditurve, me datë 14.12.1999, me nr. 1987 rep dhe 353 kol. Sigurimin e objektit të padisë”.

Sipas kësaj çështjeje, vërehet se objekti “Bar Restorant Drini”, ka qenë pasuri e shoqërisë huamarrëse, dhe pas ngjarjeve të vitit 1997, ka kaluar në administrim të administratorëve të kësaj shoqërie. Ky objekt do të shitej përmes ankandit. Fitues i ankandit është shpallur Ministria e Pushtetit Lokal dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Në vendimin e administratorëve të shoqërisë thuhet se, nëse blerësi nuk paguan brenda një muaji shumën e ankandit, atëherë do të shpallet fitues oferta pasardhëse. Në këtë mënyrë, administratorët e përbashkët shpallin si fitues të ankandit të dytin në listë V. L. dhe, pasi lidhet kontrata me të, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme. Tre ditë më vonë, ky shtetas ia shet këtë pasuri vëllait të tij dhe një shtetasi grek, duke u regjistruar dhe kjo kontratë në Zyrën e Regjistrimit. Gjithashtu, nga ana tjetër, Grupi i Mbikqyrjes i është drejtuar qendrës së ankandëve për të ndërprerë çdo lloj veprimi që binte ndesh me praktikën ligjore, që kishte shpallur fitues të ankandit Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe është lidhur kontrata e shitjes me këtë Ministri dhe është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit.

²⁴² Në zbatim të ligjit nr. 8386, datë 30.07.1998, "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridike jobankare që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

kundërshtim me ligjin²⁴³. Në këto rrethana bien dhe pasojat që ka sjellë kjo kontratë shitjeje, siç janë veprimet procedurale të regjistrimit të saj në regjistrat publike.

Gjithashtu, edhe kontrata e shitjes në favor të personit të tretë V.L., është absolutisht e pavlefshme, duke qenë se ka si origjinë një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm. Me anën e kësaj kontrate, palës së tretë i është transmetuar një e drejtë që pala shitëse nuk e kishte: “askush nuk mund t’i transmetojë tjetrit të drejtë më të madhe nga ajo që ka vetë (nemo plus juris ad alium transferre potest, quam ipse habet)” (Kondili. V, “E Drejta Civile”, 2008:246)

Qëndrimi dhe arsyetimi i gjykatës është i drejtë, përse i përket konstatimit të pavlefshmërisë së veprimit juridik, por vërehet se, edhe pse veprimi juridik vjen në kundërshtim me ligjin, nuk është shqyrtuar fakti nëse palët kanë qenë në keqbesim dhe nuk është zbatuar kalimi i të ardhurave në favor të shtetit²⁴⁴. Gjithashtu, gjykata është kufizuar thjesht në konstatimin e pavlefshmërinë absolute dhe të kontratës, në favor të personit të tretë, duke e lënë atë pa efekte ligjore, por nuk ka shqyrtuar faktin nëse pala e tretë ka qenë në mirëbesim, duke i garantuar një mbrojtje mirëbesimit të saj. Gjithsesi, kjo nuk e pengon këtë palë që t’i drejtohet gjykatës në një tjetër proces, në lidhje me zgjidhjen e pasojave.

Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë shqyrtuar kërkesën për pavlefshmëri absolute të tjetërsimit të pasurisë martesore, pa pëlqimin e njërit prej

²⁴³ Pra, shkak i kësaj pavlefshmërie është kundërligjshmëria dhe kjo kundërligjshmëri qëndron në faktin se objekti i është shitur një personi, që nuk është shpallur fitues nga qendra e vlerësimit të ofertave të ankandit. Për shkak të shkeljes së ligjit, kjo kontratë nuk ka fuqi juridike dhe është absolutisht e pavlefshme, që nga nënshkrimi i saj.

²⁴⁴ Neni 106 i Kodit Civil të 1994: “Kur veprimi juridik është i pavlefshëm, për arsye se vjen në kundërshtim me ligjin ose është bërë me qëllim mashtrimi të ligjit, çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës, merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit dhe kur nuk është e mundur, të merret po ajo gjë merret vlefte e saj”.

bashkëshortëve²⁴⁵. Kolegjet e Bashkuara kanë unifikuar praktikën me arsyetimin se, vendimet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk janë mënyrë e re e fitimit të pronësisë, por korrigjim i padrejtësisë së bërë dhe për këtë qëllim, shfuqizojnë “ipso lege” të gjitha aktet e mëparshme, me të cilat u ishte marrë prona pronarëve padrejtësisht. Këto vendime nuk krijojnë një situatë të re dhe nuk kanë efekt konstituiiv, por kanë si qëllim kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme²⁴⁶. Kthimi i pronës në këto raste, trajtohet si padi e rivendikimit, pasi pronari joposedues nuk e ka humbur për asnjë moment titullin e pronësisë, por vetëm posedimin e sendit²⁴⁷.

Në këtë mënyrë dhe sipas këtij përcaktimi ligjor, pasuria e fituar nga e paditura me trashëgim, nuk konsiderohet si pasuri bashkëshortore, por si pasuri vetjake e saj dhe për këtë arsye, kjo shtetase ka të drejtë që ta disponojë lirisht këtë pasuri. Në këtë mënyrë, edhe kontrata e dhurimit që ajo ka disponuar, është në mbështetje të ligjit dhe është një veprim juridik i vlefshëm, për këtë arsye, nuk mund të shfuqizohet me vendim gjyqësor.

²⁴⁵ Me vendimin nr. 24, datë 13.03.2002 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar çështjen me paditës të kundërpaditur R. Ll., e paditura kundërpaditëse V. Ll., me objekt: “Deklarimin e pavlefshëm të veprimit juridik kontratës së dhurimit”.

Palët ndërgjyqëse kanë qenë të martuar, që nga viti 1966 deri në vitin 1997. Paditësi ka ngritur padi për pavlefshmërinë e kontratave të dhurimit. Ai ka pretenduar se, këto kontrata kanë disponuar në kundërshtim me ligjin, pasi nuk është marrë pëlqimi i tij, duke qenë se këto pasuri janë fituar nga shtetësja V. Ll., gjatë martesës dhe, si të tilla, ato janë pasuri martesore. Këto pasuri rezultojnë të jenë përfituar nga shtetasja V. Ll., me anën e vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në vitet 1993 dhe 1994, si trashëgimtare e ish-pronarëve, për të cilët kanë disponuar vendimet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

²⁴⁶ Nëpërmjet këtyre akteve normative, ligji u njeh ish-pronarëve dhe trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara.

²⁴⁷ Për këtë arsye, ligji, nëpërmjet këtyre akteve, i kthen palët në situatën e mëparshme. E paditura e ka fituar pasurinë me titull të prejardhur nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë, e çelur në kohën e vdekjes së trashëgimtarëve dhe sipas ligjit të kohës së vdekjes së tyre. Pra, pasuria kësaj shtetaseje i ka kaluar në momentin e vdekjes së trashëgimtarëve, konkretisht vitet 1971, 1979 dhe 1981, pavarësisht se kjo pasuri ka qenë e konfiskuar dhe vetëm në vitin 1993 dhe 1994 iu është kthyer trashëgimtarëve të ish-pronarëve. Të paditurës i është kthyer posedimi mbi këtë pasuri, pas daljes së Kodit Civil të 1981, i cili e konsideron këtë pasuri si pasuri të fituar gjatë martesës, pra, në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve. Në të vërtetë, kjo pasuri është përfituar nga kjo shtetase, në momentin e çeljes së trashëgimisë, moment në të cilin nuk kishte hyrë në fuqi Kodi Civil i vitit 1981. Në nenin 96 të Dekretit “Mbi Trashëgiminë”, përcaktohet se, në pasuritë e përbashkëta të bashkëshortëve, nuk përfshihen sendet që secili prej tyre ka fituar gjatë martesës me dhurim apo me trashëgim.

Këto kontrata janë nënshkruar para noterit, sipas formës së kërkuar nga ligji për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme.

Duke qenë se vendimet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (V.K.K.K.P) janë trajtuar nga vendimi unifikues, jo si mënyrë e re e fitimit të pronësisë, kjo i bën të vlefshme veprimet juridike dhe disponimet që kanë bërë ish-pronarët dhe trashëgimtarët e tyre në lidhje me këto pasuri, të fituara në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe jo në momentin që ka dalë vendimi i K.K.K.P.-së. Kjo është një nga situatat përjashtimore, ku nëpërmjet unifikimit, i është dhënë vlerë ligjore një veprimi juridik, i cili, në interpretimin e ngushtë të ligjit, rezultonte absolutisht i pavlefshëm, pasi ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore, përsa kohë nuk kishte shprehur pëlqimin bashkëshorti bashkëpronar. Kjo pavlefshmëri është tejkaluar me anën e interpretimit të zgjeruar të dispozitave ligjore dhe arsyetimit unifikues të Gjykatës së Lartë, pasi situata e krijuar në lidhje me pronat e ish-pronarëve kërkonte një rregullim.

Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në mbështetje të nenit 1 të Konventës, i siguron një garanci mbrojtjeje të drejtës së pronësisë, të fituar me vendim të K.K.K.P.²⁴⁸. Nga rrethanat e çështjes rezulton se, Ambasada Italiane në Shqipëri, në vitin 1991, ka blerë dy ndërtesa në Tiranë, në kufi të pronës që i ishte konfiskuar gjyshit të ankuesit. Në bazë të vendimit të K.K.K.P.-së, ankuesit iu kthye nga Komisioni një sipërfaqe trualli i lirë, i ndodhur brenda mjediseve të zëna nga Ambasada Italiane dhe e regjistroi këtë titull pronësie në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Në lidhje me këtë çështje, gjykatat shqiptare e deklaruan të pavlefshëm vendimin e K.K.K.P.-së dhe vendosën që ankuesi të kompesohej për sipërfaqen e tokës së zënë nga Ambasada

²⁴⁸ Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg 29.09.2009, Çështja “Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë”, Ankimi nr. 35720/04 dhe 42832/06.

Italiane, në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji. Gjykatat arsyetuan se, përderisa prona ishte pjesë e Ambasadës Italiane, ajo nuk mund të konsiderohej si tokë e lirë dhe t'i kthehej pronarit.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut arsyetoi se, autoritetet nuk i ofruan ankuesit marrjen e kompensimit të duhur, në cenim të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut²⁴⁹. Ankuesi ishte cenuar në të drejtën e tij të pronësisë, me konstatimin të pavlefshëm të aktit të fitimit të pronësisë, duke qenë se, kjo pasuri ishte transkriptuar në favor të Ambasadës Italiane, me një akt juridik që u konsiderua i vlefshëm nga gjykata.

Veprimet juridike që kryhen për të mashtruar ligjin

Në grupin e veprimeve juridike të kryera në kundërshtim me ligjin, futen dhe veprimet juridike, të cilat kryhen për të mashtruar ligjin. Këto veprime në formë dhe në dukje paraqiten si veprime të ligjshme, por në përmbajtje të tyre, kanë elemente paligjshmërie²⁵⁰.

Vullneti i shprehur në këto veprime juridike nuk korrespondon me vullnetin e brendshëm të personit, si një nga elementet kryesore të një veprimi juridik të

²⁴⁹ Qëndrim i ngjashëm është mbajtur dhe në Vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg 22.08.2006, Çështja “Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, Ankimi nr. 7352/03, Vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg 13.11.2007, Çështja “Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, Ankimi nr. 38222/02, dhe Vendimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg 20.07.2010, Çështja “Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, Ankimi nr. 609/07.

²⁵⁰ Neni 709 i Kodit Civil.

vlefshëm²⁵¹. Ky ves vullneti godet drejtpërdrejt ligjin, prandaj është absolutisht i pavlefshëm.

Edhe ligji “Mbi Veprimet Juridike dhe Detyrimet” e trajtonte veprimin juridik të pavlefshëm, të kryer në mashtrim të ligjit²⁵². Personi që kryen veprimin juridik në mashtrim të ligjit, ka dijeni për pavlefshmërinë e veprimit, pasi vepron me ndërgjegje dhe dëshiron ardhjen e pasojave, që janë në interes të tij, në ndryshim nga veprimet juridike të kryera në kundërshtim me ligjin, ku palët mund të mos kenë dijeni për ndalimin ligjor të veprimit juridik. Palët dëshirojnë ta kryejnë këtë veprim juridik por pasojat e tij janë të kundërligjshme, duke qenë se vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit. Normat ligjore, edhe në këtë rast, përfshijnë dhe aktet e posaçme nënligjore²⁵³.

Veprimet juridike të cilat bëhen me marrëveshje të palëve, pa pasur si qëllim të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar)

Veprime juridike fiktive janë ato veprime që kryhen nga palët vetëm formalisht “për sy e faqe²⁵⁴”, pa pasur si qëllim të sjellin pasoja juridike, pra, pa pasur si qëllim të krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë marrëdhënie juridike. Në këto veprime juridike, mungon qëllimi

²⁵¹ Vendimi nr. 5499, datë 17.05.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: “Edhe në rastin hipotetik të vlefshmërisë së veprimit juridik, të kontestuar nga aktet shkresore, rezulton e provuar se në kohën e redaktimit të kësaj kontrate (tjetërsimi të sendit), shitësit nuk gëzonin tagrin e pronarit mbi sendin e paluajtshëm, pasi, nëpërmjet një veprimi juridik tjetër e kishin transferuar atë më parë dhe si e tillë, askush nuk mund të transferojë të drejta që nuk i disponon (nemo plus juris transferre potest quam ipse habet)”.

²⁵² Neni 168 i ligjit “Mbi Veprimet Juridike dhe Detyrimet”, viti 1956.

²⁵³ Kondili. V, “E Drejta Civile”, Pjesa e Përgjithshme, 2008:247.

²⁵⁴ Latifi. J, “E Drejta Civile”, Pjesa e Përgjithshme, 2000:185.

dhe vullneti i palës, prandaj klasifikohen në rastet e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të tyre²⁵⁵.

Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim juridik tjetër të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët nuk kanë dashur ta kryejnë hapur dhe që vërtetohet prej kundërdeklarimit të palëve. Në rastin e veprimeve juridike të simuluara, midis palëve, lidhet ajo që quhet kundërdeklarim ose marrëveshja e veçantë e simulimit, ku palët shprehin vullnetin e tyre për të kryer veprimin juridik të simuluar. Kjo është marrëveshja e fshehtë, ku palët shprehen se, në vend të kontratës së simuluar, dëshirojnë një kontratë tjetër të ndryshme nga ajo që kanë nënshkruar. Këto veprime janë të pavlefshme dhe kur përmbajtja e tyre nuk është e kundërligjshme.

Edhe legjislacioni dhe praktika gjyqësore gjermane bën të njëjtin trajtim në lidhje me pavlefshmërinë e kontratës, si rezultat i fiktivitetit. Një kontratë është e pavlefshme për shkak të cenimit të elementeve përbërës të saj, të përcaktuara në dispozitat ligjore. Sipas praktikës gjyqësore gjermane, që një kontratë të konsiderohet fiktive, është e nevojshme që të dyja palët të kenë rënë dakord për një marrëveshje të tillë, pra, për kryerjen e veprimit juridik fiktiv. Nëse një nga palët nuk e di që përfaqësuesi i tij ka rënë dakort gjatë lidhjes së kontratës, që të konkludojë një kontratë fiktive, ajo nuk konsiderohet fiktive. Elementi subjektiv i vullnetit, për të realizuar një kontratë fiktive, është kushti kryesor i pavlefshmërisë së kësaj kontrate, njësoj si në ligjin tonë²⁵⁶.

Veprimet juridike të simuluara janë ato veprime absolutisht të pavlefshme, të cilat kryhen për të mbuluar një veprim tjetër, të cilin palët nuk dëshirojnë ta realizojnë hapur.

²⁵⁵ Vendimi nr. 6914, datë 13.09.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: “Veprimi juridik nuk ka pasur asnjëherë si qëllim të sjellë pasoja midis palëve, por është bërë fiktivisht. Shtëpia vazhdon të përdoret nga paditësit dhe asnjëherë nuk u ka kaluar në posedim të paditurve. Edhe likuidimi i shumës së parave nga blerësit është fiktiv, pasi në realitet nuk është dhënë asnjë shumë parash”.

²⁵⁶ Gjykata Federale Gjermane, vendimi nr. V ZR 399/99, datë 25.05.2000.

Veprimi i vërtetë, në këtë rast, maskohet nga veprimi i simuluar, i cili nuk synon të sjellë asnjë pasojë përveç fshehjes së qëllimit të vërtetë të palëve. Duke qenë se mungon qëllimi për këtë veprim, ai është i pavlefshëm, ndërsa veprimi i maskuar, nëse përputhet me kërkesat e ligjit dhe nuk preket nga ndonjë shkak tjetër pavlefshmërie, është i vlefshëm dhe do të sjellë të gjitha pasojat juridike ²⁵⁷.

Veprimet juridike të simuluar, zakonisht bëhen ose për të mashtruar ligjin, ose për të mbuluar ndonjë veprim juridik të ndaluar²⁵⁸. Meqë veprimet juridike fiktive dhe të simuluar bëhen sa për dukje, pa pasur qëllim për të krijuar ndryshuar ose shuar pasoja juridike, ato janë nul. Në këtë situatë, ndeshemi me dy lloj veprimesh juridike, veprimi juridik i simuluar, pasojat e të cilit palët nuk i dëshirojnë dhe ai i mbuluar pasojat e të cilit palët i dëshirojnë. Zakonisht, veprimet juridike fiktive dhe të simuluar synojnë të mbulojnë veprimet juridike të kundërligjshme. Në këtë rast, në doktrinë ekziston mendimi se, këto veprime duhet të konsiderohen si veprime juridike të kundërligjshme²⁵⁹.

Veprimet juridike fiktive apo të simuluar, ndryshojnë nga veprimet juridike që kryhen për të mashtruar ligjin. Në veprimet juridike fiktive, palët nuk shprehin vullnet për kryerjen e veprimit juridik ose dëshirojnë të kryejnë një veprim juridik tjetër nga ai që realizojnë. Ndërsa në rastin e veprimeve juridike që kryhen në mashtrim të ligjit, palët shprehin vullnetin për veprimin juridik, pasojat e të cilit janë të kundërligjshme. Ky lloj

²⁵⁷ Neni 93 i Kodit Civil të 1994: "Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm nëqoftëse përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij". Pra, kur veprimi i simuluar mbulon një veprim tjetër dhe gjykata konstaton se veprimi juridik i vërtetë nuk preket nga ndonjë shkak pavlefshmërie, ajo e merr parasysh këtë veprim që palët kanë dashur të kryejnë.

²⁵⁸ Latifi, J, "E Drejtës Civile", Pjesa e Përgjithshme, 2000:187.

²⁵⁹ Kondili, V, "E Drejta Civile", Pjesa e Përgjithshme, 2008:250.

dallimi në praktikë ka rëndësi, për shkak të pasojave të ndryshme që efektojnë këto lloj veprimesh juridike.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë morën në shqyrtim çështjen gjyqësore me palë: paditës S.K., i paditur A.R., me objekt deklarimin të pavlefshëm të kontratës së huasë, me numër 1757 rep dhe 599 kol, datë 14.10. 1996²⁶⁰. Kolegjet e Bashkuara konkluduan se, është rasti të unifikohet praktika gjyqësore lidhur me këto çështje.

1. Kur veprimi juridik mund të konsiderohet i simuluar dhe cilët janë elementët që e bëjnë atë?

2. Si duhet kuptuar parashikimi i bërë në nenin 686/2 të Kodit Civil²⁶¹, lidhur me humbjen apo dëmtimin e palëve në një kontratë?

Në rastin e fiktivitetit dhe simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e dëshirojnë vetë palët dhe veprimi quhet i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë në të vërtetë.

²⁶⁰ Me vendimin Unifikues, nr. 932, datë 22.06.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga rrethanat e çështjes, vërejnë se, palët S. K. dhe A. R. kanë lidhur një kontratë huaje për një shumë prej 12.500.000 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë) dhrahmi greke për një vit dhe në fund të kësaj periudhe, pala huamarrëse detyrohet të kthejë, së bashku me shumën, edhe interesat, gjithsej 22.500.000 (njëzetë e dy milionë e pesëqind mijë) dhrahmi dhe si garanci është vendosur një magazinë. Po në këtë datë, është lidhur një kontratë me firmën "Kamberi" për të njëjtën shumë, ku si palë huadhënëse ka nënshkruar S. K., por duke përfshirë si kreditor A. R.

Nëpërmjet padisë së tij, shtetasi S. K. ka pretenduar se, kontrata e huasë me kamatë, e lidhur midis tij dhe A. R. është një veprim i simuluar, pasi ekziston një mospërputhje midis vullnetit të vërtetë të palëve dhe shfaqjes së tij të jashtme, të materializuar në formën e kontratës së huasë të lidhur para noterit. Sipas paditësit, vullneti i vërtetë ka qenë depozitimi i të hollave në firmën rentjere "Kamberi", me ndërmjetësinë e paditësit me qëllim që, pas një viti, i padituri të përfitonte, krahas shumës së depozituar dhe një kamatë të barabartë me atë të kontratës së simuluar të huasë lidhur midis tyre. Këto pretendime janë të pambështetura në ligj dhe prova dhe, gjithashtu, i padituri A. R. ka mohuar faktin e ekzistencës së vullnetit dhe qëllimit për t'i depozituar paratë në firmën "Kamberi". Në këtë rast, mungon kundërdeklarimi, që është marrëveshja e veçantë e simulimit, ku shprehet vullneti i palëve për të lidhur një kontratë të simuluar.

²⁶¹ Shpërblimi i dëmit, në rastin e mosekzekutimit të detyrimit.

Në këtë çështje rezulton e provuar se, qëllimi i paditësit ka qenë që shumën e marrë hua, ta depozitojë në firmën "Kamberi", duke synuar që, me plotësimin e afatit, të ketë mundësi të shlyejë shumën e marrë hua nga i padituri. Kontrata e lidhur me firmën "Kamberi" nuk mund të konsiderohet as si kontratë në dobi të një personi të tretë për shkak se, është shënuar në të edhe emri i të paditurit, pasi në një kontratë të tillë, personi i tretë mund të jetë vetëm përfitues pa kundërshtpërblim dhe si i tillë, ai nuk merr mbi vete asnjë rrezik. Një kontratë nuk mund të bëjë kreditor apo debitor asnjë person pa pëlqimin e tij.

Huadhënësi në një kontratë nuk ka të drejtë të ndërhyjë në mënyrën sesi huamarrësi i administron paratë, por ai ka të drejtë vetëm të kërkojë kthimin e tyre, si dhe kamatat nëse huamarrësi e ka marrë përsipër një detyrim të tillë, me plotësimin e afatit të kontratës. Rreziqet që rrjedhin nga administrimi i shumës së marrë hua dhe nga investimi i tyre apo kryerja e veprimeve të tjera juridike, me qëllim rritjen e fitimeve, rëndojnë kurdoherë mbi huamarrësin dhe jo mbi huadhënësin. Në rastin konkret, i padituri nuk është i detyruar të vuajë pasojat e një veprimi juridik ku nuk është palë, pra, humbjen e shumës së parave në firmën rentjere "Kamberi".

Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë se, si Gjykata e Sarandës, ashtu dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë kanë gabuar, kur e kanë konsideruar të vlefshme kontratën e huasë lidhur midis palëve për pjesën e kamatave të tilla, jashtë çdo logjike ekonomike. Çdo veprimtari bankare apo tregtare e ligjshme, sado e suksesshme të jetë, nuk mund të krijojë një normë fitimi aq të lartë, që të lejojë të paguhen interesa të tilla. Gjithsesi, Kodi ynë Civil nuk ka të përcaktuar ndonjë kufi maksimal të kamatave të lejuara, siç kanë të përcaktuar disa legjislacione në botë. Ai ka pranuar parimin e lirisë

së plotë të kontraktimit dhe të konkurrencës, sipas rregullave të tregut²⁶².

Duke qenë se, në dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nuk është i përcaktuar kufiri maksimal i kamatave të lejuara, atëherë referimi bëhet te dispozitat e përgjithshme. Kreditori dhe debitori duhet të sillen me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes²⁶³. Janë të pavlefshme kushtet e përgjithshme që sjellin dëmtim të shpërpjestuar të interesave të palëve kontraktuese, sidomos kur ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga parimet e barazisë e paanësisë së marrëdhënieve kontraktuale²⁶⁴. Në rastin konkret, kontrata e huasë me kamatë është në vetvete një veprim i ligjshëm dhe i vlefshëm. Pavlefshmëria, sipas nenit 686/2 të Kodit Civil, është vetëm pjesa e kamatave në kapërcim të kufijve të përcaktuar, sipas logjikës ekonomike. Megjithatë, pjesët e pavlefshme nuk e bëjnë detyruesisht të pavlefshëm veprimin juridik, pasi, kur shkak i pavlefshmërisë prek vetëm një pjesë të veprimit juridik, ky mbetet i vlefshëm në pjesët e tjera të tij, përveç kur, sipas përmbajtjes së veprimit juridik, këto pjesë paraqesin marrëdhënie të pandashme me pjesën e pavlefshme të veprimit juridik²⁶⁵.

Në kundërshtim me pretendimet e paditësit, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, vënia si garanci e magazinës përforcon faktin se, qëllimi i palëve ka qenë lidhja e kontratës së huasë midis tyre, pasi pretendimi i të paditurit, huadhënësit, për të garantuar shumën e

²⁶² Ky është një qëndrim i drejtë në një treg të lirë të mallrave dhe të kapitaleve, por në një treg të deformuar e të pushtuar nga ndërhyrjet e kundërligjshme, nuk mund të bëhet fjalë për liri të kontraktimit dhe për këtë arsye gjykata duhet të ndërhyjë për të rregulluar dhe përcaktuar si në rastin konkret kufirin maksimal të kamatës së lejuar. Kufiri maksimal i kamatave të lejuara në legjislacion shërben si barrierë, për të shmangur lidhjen e kontratave në kushte të tilla që të çojnë në humbjen apo dëmtimin e shpërpjestuar të interesave të palëve.

²⁶³ Neni 422 i Kodit Civil të 1994. Përcaktimi i bërë në këtë dispozitë nënkupton se liria e kontraktimit nuk është absolute e pakufizuar, por ajo mund të kufizohet nga faktorët ekonomikë dhe moralë e që duhet t'i ketë parasysh gjykata në zgjidhjen e çdo çështjeje, pasi dëmtimi i shpërpjestuar i interesave të palëve, nënkupton se vullneti i palës nuk ka qenë krejtësisht i lirë.

²⁶⁴ Neni 686/2 i Kodit Civil të 1994.

²⁶⁵ Neni 111 i Kodit Civil të 1994.

dhënë hua dhe shlyerjen e detyrimit të marrë përsipër nga paditësi, është provë e plotë dhe e pakontestueshme e vlefshmërisë së kontratës së huasë. Në përfundim, Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë se, kontrata e huasë do të konsiderohet e pavlefshme, vetëm për pjesën e kamatave që duhet të ktheheshin në fund të vitit.

Veprime juridike që kryhen nga të miturit nën moshën 14 vjeç

Të miturit nën 14 vjeç nuk gëzojnë zotësi për të vepruar. Për këtë arsye, veprimet juridike të kryera prej tyre, konsiderohen absolutisht të pavlefshme. Sipas legjislacionit tonë, kusht për vlefshmërinë e veprimeve juridike është zotësia për të vepruar, pra, subjekti të jetë në gjendje të kuptojë rëndësinë e veprimit që kryen dhe të mos ketë gjasa për t'u bërë subjekt i mashtrimit, si rezultat i moskuptimit të pasojave të veprimeve të tij. Duke qenë se veprimi juridik është akt i vullnetshëm i palëve, përsa kohë që legjislacioni e lidh shprehjen e vullnetit me zotësinë për të vepruar, mungesa e saj do të sjellë pavlefshmëri absolute të veprimit. Në këtë rast, legjislatori e ka zgjidhur që këto veprime kryhen nga kujdestari i personit, të cilit i mungon zotësia për të vepruar dhe në disa raste siç është, p.sh., tjetërsimi i pasurisë, ku duhet pëlqimi i këshillit të kujdestarisë. Në rastin e tjetërsimit të pasurisë së tyre, është gjykata që lëshon autorizimin për tjetërsim²⁶⁶.

I mituri që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, është i pazot për të vepruar dhe për të kryer veprime juridike të vlefshme²⁶⁷. Ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty, si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa

²⁶⁶ Vendimi nr. 940, datë 15.02.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili arsyeton se tjetërsimi i pasurisë, në këtë rast, është në interes të të miturit. Në këto rrethana, gjykata çmon se, kërkesa për lëshimin e autorizimit është e drejtë dhe e bazuar në ligj dhe, si e tillë, duhet pranuar.

²⁶⁷ Neni 8 i Kodit Civil të 1994.

kundërshpërblim. Një element të tillë e ndeshim dhe në të drejtën gjermane dhe austriake, ku një i mitur poshtë 7 vjeç nuk mund të kryejë asnjë veprim juridik pa pëlqimin e kujdestarit. Pas kësaj moshe, veprimi është përkohësisht i pavlefshëm, derisa të jepet pëlqimi nga përfaqësuesi ligjor. Megjithatë, ai mund të kryejë veprime që i përshtaten moshës së tij për të përmbushur interesat e tij, pa kundërshpërblim. Kjo ka të bëjë me ato që quhen para të konsumit të përditshëm të fëmijës, për përmbushjen e nevojave të tij, por përsëri, këtu nuk kemi zotësi të plotë për të vepruar të të miturit, por një lloj ratifikimi nga përfaqësuesi ligjor. Në ndryshim nga legjislacioni i vendeve të common law, veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi i tij ligjor.

Në sistemin common law, nuk ndeshet një koncept i qartë për përfaqësimin e të miturit. Për këtë arsye, nuk ka as ndonjë koncept të përgjithshëm për pazotësinë për të vepruar të të miturit. E drejta angleze, për t'i dhënë vlefshmëri kontratës së të miturit, nisët nga teoria e nevojshmërisë, domosdoshmërisë, që do të thotë se, nëse kontrata nuk lidhet për sendet e nevojshme, atëherë ajo është absolutisht e pavlefshme. Një kontratë e tillë nuk kërkohet të shpallet si e pavlefshme nga gjykata, por mjafton t'i njoftohet palës tjetër mituria dhe kjo përbën mbrojtje ndaj çdo pretendimi. Pra, kontrata e të miturit konsiderohet e pavlefshme për mbrojtje të interesave të të miturit, nëse ajo nuk u përshtatet nevojave dhe domosdoshmërisë së fëmijës.

Në të drejtën e vendit tonë, është përcaktuar qartë nga legjislatori, privueshmëria e të miturit nën 14 vjeç, për të qenë palë në një kontratë²⁶⁸. Sipas këtij arsyetimi, i mituri nuk mund të jetë palë në marrëdhënie të ndryshme kontraktore. Ky qëndrim i Kodit Civil aktual është i njëjtë me qëndrimin e Kodit Civil të 1981.²⁶⁹

²⁶⁸ Neni 7 dhe 8 i Kodit Civil të 1994.

²⁶⁹ Neni 17 i Kodit Civil të 1981.

Edhe në ligjin dhe praktikën gjyqësore italiane, kontrata e lidhur me një minoren konsiderohet e anulueshme²⁷⁰. Madje, në të drejtën italiane, nuliteti civil i së drejtës kontraktore me një minoren, konkurren me të drejtën penale, pasi konsiderohet krim veprimi kontraktor me një minorin ose një person me deficiencë psikike, i kryer duke abuzuar me mungesën e eksperiencës së tyre, nga pala tjetër, duke i sjellë vetes apo një të treti një përfitim të pamërituar²⁷¹. Në këtë rast, praktika gjyqësore analizon pamundësinë kontraktuale natyrore ose ligjore të subjektit pasiv, viktimë e sjelljes së palës tjetër, për përfitim të padrejtë, duke efektuar një shkak anulueshmërie²⁷².

Veprimet juridike që kryhen nga persona të cilëve, për shkak të sëmundjeve psikike ose zhvillim mendor të metë, u është hequr zotësia për të vepruar

Ky rast nuk përfshihet në veprimet juridike absolutisht të pavlefshme të parashikuara në nenin 92 të Kodit Civil, por del nga analiza e dispozitave ligjore²⁷³ dhe praktika gjyqësore. Legjislacioni i mëparshëm e përfshinte këtë rast në veprimet juridike absolutisht të pavlefshme²⁷⁴. Veprimet juridike janë absolutisht të pavlefshme, kur kryhen pa pëlqimin e kujdestarit ose këshillit të kujdestarisë, njësoj si ato të kryera nga persona nën 14 vjeç, të cilët nuk gëzojnë zotësi për të qenë subjekt i të drejtave dhe detyrimeve në një veprim juridik ose kontratë. Vullneti dhe shprehja e lirë e tij është element i vlefshmërisë së veprimit juridik. Këta persona, në momentin e kryerjes së

²⁷⁰ Nenet 428 dhe 1425 të Kodit Civil Italian.

²⁷¹ Neni 643 i Kodit Penal Italian.

²⁷² Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 13566, datë 26.05.2008, Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 27412, datë 23.04.2008.

²⁷³ Neni 10 i Kodit Civil të 1994: "Personi madhor që, për shkak të sëmundjeve psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i zoti, mund t'i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës".

²⁷⁴ Neni 17/ç i Kodit Civil të 1981: "Janë të pavlefshme veprimet juridike që janë kryer nga të miturit nën moshën 14 vjeç ose nga persona të cilëve, për shkak të sëmundjeve psikike, zhvillimi mendor të metë u është hequr krejt zotësia për të vepruar".

veprimit, nuk e kuptojnë rëndësinë e veprimit dhe nuk shprehin vullnet për këtë veprim. Vullneti i tyre nuk është i vesuar, por është inekzistent, për këtë arsye veprimet e tyre janë absolutisht të pavlefshme. Mungesa e zotësisë për të vepruar, tek këta persona, vërtetohet me anën e vendimit gjyqësor, i cili disponon me heqjen e zotësisë për të vepruar dhe caktimin e kujdestarit ligjor²⁷⁵.

Mungesa e aftësisë ligjore, edhe sipas legjislacionit dhe praktikës gjyqësore italiane, sjell nulitetin e kontratës. Kasacioni Civil italian ka arsyetuar se, gjykatat, gjatë verifikimit të pretendimeve të palëve, duhet të shqyrtojnë pavlefshmërinë e veprimeve kontraktore të kryera nga palët pa aftësi ligjore²⁷⁶. Veprimet juridike, të kryera nga persona të cilët nuk kanë zotësi për të vepruar, në legjislacion tonë, përfshihen te veprimet juridike relativisht të pavlefshme²⁷⁷, por një veprim juridik i kryer nga një person, vullneti i të cilit është inekzistent, nuk mund të shpallet i pavlefshëm, pasi ai është absolutisht i pavlefshëm.

Në të drejtën italiane, mungesa totale e konsensusit, sjell nulitet të kontratës dhe jo anulueshmëri²⁷⁸. Është e kuptueshme se, vesi radikal i konsensusit, në kuptimin e defektit të tij parësor, sjell nulitetin e kontratës dhe jo anulueshmërinë e saj²⁷⁹. Kufiri ndarës midis pavlefshmërisë absolute dhe relative të këtyre veprimeve, varet nga niveli i zotësisë që zotërojnë palët. Kur palët nuk kanë zotësi për të vepruar, veprimet e tyre janë absolutisht të pavlefshme. Kur palët kanë zotësi të kufizuar për të vepruar dhe

²⁷⁵ Vendimi nr. 624, datë 03.02.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, arsyeton: “Në thëniet e saj para gjykatës, mjekja u shpreh se ajo ka që nga viti 2001 që e ndjek në aspektin shëndetësor pacienten e cila vuan nga sindroma “Daun” ose Trizoma 21. Kjo sëmundje shoqërohet me një prapambetje mendore të mesme ose të rëndë, por në këtë rast, pacientja është e paaftë të kujdeset për veten e saj dhe ka nevojë për mbikqyrjen e personave të tjerë”.

²⁷⁶ Kasacioni Civil Italian, Seksioni II, vendimi nr. 2860, datë 07.02.2008.

²⁷⁷ Neni 94 i Kodit Civil të 1994.

²⁷⁸ Neni 1418/2 i Kodit Civil Italian.

²⁷⁹ Këshilli i Shtetit Italian, Seksioni V, vendimi nr. 6281, datë 13.11.2002.

veprimet juridike kryhen pa pëlqimin e kujdestarit, ato janë relativisht të pavlefshme. Në praktikën gjyqësore, janë konstatuar raste të kryerjes së veprimeve juridike, me pasurinë e personave pa zotësi për të vepruar dhe pa pëlqimin e kujdestarit²⁸⁰. Formalisht, kontrata e dhurimit në emër të paditësit Xh. A., në cilësinë e dhuruesit, rezulton të jetë nënshkruar prej të ashtuquajturit kujdestar të tij A. A., në prani të dëshmitarëve R. A. dhe F. B. Kjo kontratë dhurimi rezulton të jetë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në emër të pranuesit të dhurimit. Në gjykim nuk u paraqit ndonjë provë që shtetasi A. A. të ketë patur kujdestarinë ndaj shtetasit Xh. A., të cilit i ishte hequr zotësia për të vepruar. Aktualisht, shtetasit Xh. A. i është kthyer zotësia për të vepruar²⁸¹. Gjithashtu, arsyetohet se, edhe nëse shtetasi A. A. do të ishte caktuar kujdestar i përkohshëm i shtetasit Xh. A., në bazë të nenit 309 dhe 293 të Kodit të Familjes, kujdestari vetëm e administron pasurinë e personit nën kujdestari dhe nuk mund ta tjetërsojë atë. Për këto arsye, në bazë të nenit 92 të Kodit Civil, kontrata e dhurimit është një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, që nuk sjell asnjë efekt juridik, që në momentin e lidhjes së saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë vendosi: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit nr.397 rep dhe 250 kol datë 20.03.1996, të lidhur midis palëve Xh. A., përfaqësuar nga kujdestari i tij A. A. dhe K. A., në cilësinë e pranuesit të dhurimit.

²⁸⁰ Me vendimin nr. 1424, datë 16.10.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, u shqyrtua çështja me palë paditëse Xh. A., të paditur K. A., dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Sarandë, me objekt: “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit nr. 397 rep dhe 250 kol, datë 20.03.1996 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke fshirë regjistrimin e kryer në favor të të paditurit K. A. dhe kthimin e këtij regjistrimi në emrin e pronarit Xh. A.”. Nga rrethanat e çështjes rezulton se, me kontratën e dhurimit nr. 397 rep dhe 250 kol, datë 20.03.1996, paditësi Xh. A., në cilësinë e dhuruesit i ka dhuruar K. A., një shtëpi banimi ndodhur në qytetin e Delvinës dhe djali i tij K. A., e ka pranuar atë. Në kohën e nënshkrimit të kontratës së dhurimit, shtetasi Xh. A., nuk ka patur zotësi për të vepruar, pasi kjo zotësi atij i ishte hequr gjyqësisht me vendimin civil nr. 36, datë 19.01.2001 të Gjykatës Sarandë, duke i caktuar si kujdestar të përkohshëm djalin e tij, V. A.

²⁸¹ Me vendimin civil nr. 1346, datë 03.09.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Sarandë të fshijë këtë kontratë dhurimi nga regjistrat hipotekor”. Ky vendim u la në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Gjirokastër²⁸².

Vërehet se, gjykata, përveç konstatimit të pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit është shprehur dhe për rregullimin e pasojave sipas kërkesës së palëve, por nuk ka disponuar për shpërblimin e dëmit të shkaktuar palës që nuk kishte zotësi për të vepruar nga pala tjetër²⁸³. Një gjë e tillë nuk është kërkuar dhe gjykata ka disponuar sipas kërkesë padisë. Gjithashtu, vërehet se kontrata është konstatuar si absolutisht e pavlefshme, duke iu referuar nenit 92 të Kodit Civil, ndërkohë që përfshihet në veprimet që shpallen të pavlefshme, sipas nenit 94 të Kodit Civil. Gjithsesi, ky është një qëndrim i drejtë i gjykatës, pasi një veprim i kryer nga një person të cilit i është hequr krejt zotësia për të vepruar, pra, vullneti i tij është inekzistent dhe jo i vesuar, nuk mund të shpallet i pavlefshëm.

5.2 Veprimet juridike relativisht të pavlefshme, anulueshmëria

Veprimet juridike, të cilat shpallen të pavlefshme, janë specifikuar në nenin 94²⁸⁴ të Kodit Civil. Për defekte dhe mangësi të ndryshme, këto lloj veprimesh shpallen të pavlefshme nga gjykata. Ky akt, në ndryshim nga pavlefshmëria absolute, ekziston dhe sjell pasojë deri në momentin që njëra nga palët kërkon dhe realizon nga organet e drejtësisë anulueshmërinë e tij. Kjo lloj pavlefshmërie e lë aktin pezull derisa të plotësohet afati i parashkrimit, nëse nuk është kërkuar anulueshmëria e aktit nga pala e interesuar. Nëse plotësohet afati i parashkrimit, akti konsiderohet i vlefshëm dhe do të

²⁸² Me vendimin gjyqësor, nr. 476, datë 08.12.2009, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

²⁸³ Neni 109 i Kodit Civil të 1994.

²⁸⁴ Klasifikimi i veprimeve juridike që shpallen të pavlefshme.

sjellë pasoja për të ardhmen, njësoj si të gjitha aktet e vlefshme. Akti i vërtetë është i anulueshëm, por kjo anulueshmëri evitohet nëse plotësohet afati i parashkrimit dhe palët nuk e kërkojnë anulueshmërinë e aktit. Në këtë rast, presupozohet se palët kanë shprehur vullnet për të krijuar, ndryshuar dhe shuar pasoja juridike në bazë të këtij akti të anulueshëm dhe, në një farë mënyre, i kanë dhënë jetë aktit relativisht të pavlefshëm. Gjithashtu, veprimet juridike bëhen të vlefshme nëse palët, prindërit apo kujdestarët shprehin pëlqimin për këtë veprim juridik, të kryer nga personat me zotësi të kufizuar për të vepruar.

Nëse gjendja e pezullit përfundon me anulim, veprimi juridik konsiderohet nul dhe nuk mund të sjellë pasoja juridike për të ardhmen. Veprimi juridik që shpallet i pavlefshëm, quhet i tillë që nga çasti që është anuluar dhe për rrjedhojë, pasojat e efektuara prej tij shuhet. Në këtë rast, barazohet veprimi absolutisht i pavlefshëm me atë relativisht të pavlefshëm. Anulimi i kthen palët në gjendjen e mëparshme në atë që quhet "restitutio in integum".²⁸⁵

Anulueshmëria dhe rastet e saj janë të përcaktuara qartë në ligj. Anulueshmëria zbatohet kur mungesa e ndonjë elementi nuk konsiderohet e mjaftueshme për të sjellë pavlefshmërinë absolute të aktit. Veprime juridike "relativisht të pavlefshme" nuk pasqyrohet si term në legjislacion. Kjo del nga interpretimi i dispozitave ligjore, pasi në Kodin Civil përdoret termi "shpallen të pavlefshme" dhe doktrina i identifikon këto me veprimet e anulueshme, pra, relativisht të pavlefshme²⁸⁶.

²⁸⁵ Kondili. V, "E Drejta Civile", Pjesa e Përgjithshme, 2008:251.

²⁸⁶ Kondili. V, "E Drejta Civile", Pjesa e Përgjithshme, 2008:250.

Të drejtën për të kërkuar pavlefshmërinë relative të veprimit juridik e disponojnë palët kontraktore, trashëgimtarët dhe përfaqësuesit e tyre²⁸⁷. Personat e tjerë nuk mund t'i drejtohen gjykatës për shpalljen të pavlefshmërisë relative të veprimeve juridike dhe gjykata nuk mund të vihet në lëvizje me iniciativën e saj (ex officio).

Veprime të kryera nga të miturit mbi 14 vjeç, kur veprimin e kanë kryer pa pëlqimin e prindit ose kujdestarit

I mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç, mund të kryejë veprime juridike vetëm me pëlqimin e mëparshëm të përfaqësuesve të tyre ligjor, të cilët, përgjithësisht janë prindërit e tyre ose kujdestarët e emëruar. Të miturit që kanë mbushur moshën 14 vjeç, mund të kryejnë veprime juridike të vlefshme, që kanë të bëjnë me disponimin lirisht të fitimeve të nxjerra nga puna e tyre, për të depozituar kursimet e tyre dhe administruar vetë këto kursime²⁸⁸. Gjithsesi, të miturit 14 deri në 18 vjeç nuk mund të jenë subjekt i të drejtave dhe detyrimeve juridiko-civile, pa ndihmën e prindit ose të kujdestarit të tyre. Edhe nëse veprimi juridik është kryer nga i mituri në formën e kërkuar nga ligji, ky veprim, me kërkesën e prindit apo kujdestarit, mund të shpallet i pavlefshëm nga gjykata, përveç rastit kur ky veprim miratohet nga prindi ose kujdestari i të miturit²⁸⁹. Gjithashtu, në bazë të nenit 6 të Kodit Civil²⁹⁰: “Gruaja që ka mbushur moshën 16 vjeç e fiton zotësinë e plotë për të vepruar me anë të martesës dhe nuk e humbet këtë zotësi edhe nëse martesa zgjidhet para mbushjes së moshës 18 vjeç”.

²⁸⁷ Neni 94 i Kodit Civil të 1994: “Të anulueshme quhen veprimet juridike të cilat janë të vlefshme, gjersa gjykata, me kërkesën e të interesuarit, i shpall të pavlefshme... Anulimi i këtyre veprimeve mund të kërkohej edhe pas vdekjes së personit përkatës, por vetëm kur para vdekjes është kërkuar heqja e zotësisë së tij për të vepruar”.

²⁸⁸ Neni 7 i Kodit Civil të 1994.

²⁸⁹ Latifi, J, “E drejta Civile”, Pjesa e Përgjithshme, 2000:188.

²⁹⁰ Rast përjashtimor i fitimit të zotësisë për të vepruar para moshës 18 vjeç.

*Veprimet juridike të kryera nga personat, të cilëve, për shkak të sëmundjeve psikike ose zhvillimit të metë mendor, u është kufizuar zotësia për të vepruar*²⁹¹

Zotësia për të vepruar iu hiqet tërësisht ose iu kufizohet nga gjykata personave madhorë, që, për shkak të sëmundjeve psikike ose zhvillimit të metë mendor janë të pazotë të kujdesen për punët e tyre²⁹². Këta persona nuk mund të kryejnë veprime juridike dhe nuk mund të jenë subjekt i të drejtave dhe detyrimeve, që rrjedhin nga një marrëdhënie juridike. Kodi Civil aktual nuk bën ndonjë dallim midis veprimeve juridike të kryera nga persona të cilëve iu është kufizuar zotësia për të vepruar dhe ato të kryera nga persona të cilëve iu është hequr zotësia për të vepruar, duke i përfshirë të dyja rastet në veprimet juridike të anulueshme²⁹³. Kodi Civil i 1981 i trajtonte veprimet juridike të kryera nga personat me zotësi të kufizuar për të vepruar si veprime relativisht të pavlefshme²⁹⁴.

Në rastin kur personave iu është kufizuar zotësia për të vepruar me vendim gjykate nuk është e nevojshme, që ata të provojnë se, në momentin e kryerjes së veprimit, nuk e kanë pasur ndërgjegjen dhe vullnetin për pasojat e këtij veprimi. Në këtë rast, për t'u anuluar, mjafton vendimi i gjykatës që ka kufizuar zotësinë për të vepruar. Këto veprime janë të pavlefshme edhe sikur, në momentin që janë kryer, personi ka qenë në gjendje të mirë mendore dhe e ka kuptuar rëndësinë e veprimit të kryer. Në qoftë se

²⁹¹ Sipas parashikimit të bërë në nenin 94/b të Kodit Civil të 1994, në këtë grup futen dhe personat të cilëve iu është hequr zotësia për të vepruar.

²⁹² Neni 10 i Kodit Civil të 1994.

²⁹³ Neni 94/b i Kodit Civil të 1994: "...Personat të cilët, për shkak të sëmundjeve psikike ose zhvillimit të metë mendor, u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit".

²⁹⁴ Neni 18/b i Kodit Civil të 1981: "Gjykata, me kërkesën e të interesuarve, deklaron të pavlefshme veprimet juridike të kryera nga personat të cilët, për shkak të sëmundjeve psikike ose zhvillimit mendor të metë, u është kufizuar zotësia për të vepruar, kur veprimin e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit".

veprimi juridik është kryer nga persona me zotësi të kufizuar për të vepruar pa pëlqimin paraprak të prindit ose kujdestarit, ky veprim do të jetë relativisht i pavlefshëm dhe do të anulohet nga gjykata. Nëse veprimi është kryer nga subjekte pa zotësi për të vepruar, praktika gjyqësore disponon nulitetin, pra, ai konsiderohet veprim juridik absolutisht i pavlefshëm²⁹⁵. Në bazë të volumit të zotësisë për të vepruar, vijnë dhe pasojat, nuliteti ose anulueshmëria e veprimit. Këtu mund të thuhet se afrohet kufiri ndarës midis pavlefshmërisë absolute dhe relative, përse u përket pasojave, parë nën këndvështrimin e praktikës gjyqësore. Pra, për personat që, për shkak të sëmundjeve psikike apo zhvillimit mendor të metë, iu është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar dhe kryejnë veprime pa pëlqimin e prindit dhe kujdestarit, këto veprime do të shpallen të pavlefshme, mbi bazën e kërkesës së prindit apo të kujdestarit të tij.

Një person, të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar me vendim gjykate, duhet t'i drejtohet vetë ose me anën e përfaqësuesit të tij ligjor gjykatës për kthimin e zotësisë për të vepruar, në mënyrë që të realizojë veprime juridike të vlefshme. Heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar parashikohet dhe në legjislacionet e tjera. E drejta e common law bën një dallim midis kontratave të lidhura nga lunatikët dhe të paaftët²⁹⁶. Sipas të drejtës angleze, një kontratë e lidhur nga një person i paaftë që nuk ka zotësi për të vepruar, është absolutisht e pavlefshme, ndërsa për një kontratë të lidhur nga një lunatik, mund të kërkohej anulimi i kontratës mbi bazë të provës se, në kohën e lidhjes së saj, ai nuk mund të kuptonte veprimin. Në ShBA, një person i sëmurë, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar, mund të kërkojë anulimin, vetëm nëse është në gjendje që të kthejë atë që ka përfituar nga kjo kontratë, e cila do të anulohet. Në sistemin

²⁹⁵ Pavarësisht se parashikohet në nenin 94 të Kodit Civil të 1994 te veprimet juridike të anulueshme.

²⁹⁶ Dallimi midis pavlefshmërisë relative dhe asaj absolute.

gjerman, një person, të cilit i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, nuk mund të kryejë veprime juridike pa pëlqimin e kujdestarit të tij. Mungesa ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, ka të bëjë vetëm me personat që vuajnë nga një sëmundje psikike ose kanë zhvillim mendor të metë dhe jo për ato raste kur personi, për shkak të gjendjes së tij fizike ose dëmtimeve fizike nuk mund të realizojë direkt të drejtat e tij. Këta persona e shfaqin vetë vullnetin e tyre gjatë veprimeve juridike, veçse kanë nevojë për ndihmë teknike të personave të tjerë, kryesisht të kujdestarëve²⁹⁷.

Veprimet juridike të kryera nga personat të cilët, në kohën e kryerjes së veprimit juridik, nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse nuk u ishte hequr zotësia për të vepruar

Nën rezultatin e një gjendjeje të rënduar mendore ose një traume të pësuar, mund të ndodhë që personi, edhe pse ka zotësi të plotë për të vepruar, të mos kuptojë rëndësinë e veprimeve që kryen. Këta persona nuk janë të sëmurë mendorë, por në momentin e kryerjes së veprimit juridik dhe shprehjes së vullnetit, kanë qenë në një gjendje të rënduar psikike. Vullneti i shprehur nga këta persona nuk identifikohet me vullnetin e vërtetë, por është i vesuar. Këta persona nuk ndodhen para faktit që iu është kufizuar zotësia për të vepruar, për këtë arsye, vërtetimi i gjendjes së rënduar mendore bëhet nga gjykata rast pas rasti, mbështetur në vlerësimin mjekësor.

Pavlefshmëria e këtyre veprimeve juridike kërkohet nga i interesuari, kur personi është gjallë, megjithatë mund të kërkohet dhe pas vdekjes, p.sh., kur ndodhemi para pavlefshmërie testamentare, kontratave të dhurimit etj, por gjithmonë nëse para vdekjes

²⁹⁷ Latifi. J, “E drejta Civile”, Pjesa e Përgjithshme, 2000:192.

është kërkuar nga organet gjyqësore heqja e zotësisë për të vepruar²⁹⁸. Këta persona duhet të provojnë para organeve të drejtësisë se nuk e kanë pasur vullnetin dhe ndërgjegjen e plotë, në momentin e kryerjes së veprimit juridik.

Edhe legjislacioni gjerman, parashikon nulitetin e një kontrate, nëse njëra nga palët nuk ka aftësi juridike suficiente, pra, i mungon zotësia për të vepruar²⁹⁹. Gjykata Federale gjermane, gjatë verifikimit të pretendimit të palëve, ka arsyetuar se, kontrata është nul, nëse njëra nga palët ishte e dehur gjatë konkludimit të kontratës dhe nuk ishte në gjendje të kuptonte rëndësinë e veprimit. Në këtë rast, kontrata konsiderohet nul, kur intoksikimi nga dehua, është në një shkallë të tillë, që sjell çrregullim psikik.³⁰⁰

*Veprime juridike që kryhen nën ndikimin e veseve të vullnetit*³⁰¹

Është e ditur tashmë se, vullneti është një element esencial i veprimit juridik. Mospërputhja e vullnetit të shprehur me vullnetin e brendshëm do të sjellë vesim të vullnetit dhe pavlefshmëri të veprimit juridik. Veset e vullnetit, që e bëjnë veprimin juridik të anulueshëm janë mashtrimi, lajthimi dhe kanosja. Në dallim nga fiktiviteti dhe simulimi, që kanë të bëjnë gjithashtu me vullnetin e veprimit juridik, veset e vullnetit nuk sjellin nulitet por anulueshmëri, pasi vullneti në këtë rast ekziston, por ai nuk është i plotë.

- Veprime juridike të kryera në mashtrim konsiderohen ato veprime juridike të kryera, kur pala shtyhet në gabim, me anën e gënjeshtres nga pala tjetër. Nëse këto fakte të pavërteta do t'i bëheshin të ditura kësaj pale, kjo e fundit nuk do ta kryente veprimin

²⁹⁸ Neni 94 paragrafi i fundit i Kodit Civil të 1994.

²⁹⁹ Neni 105 i Kodit Civil Gjerman.

³⁰⁰ Gjykata Federale Gjermane, vendimi nr. V ZR 56/65, datë 15.03.1967.

³⁰¹ Neni 95, 96, 97 i Kodit Civil.

juridik³⁰². Edhe nëse njëra palë shtyhet në gabim nga të tretët, por pala tjetër ka dijeni për këtë rrethanë jo të vërtetë, veprimi juridik do të shpallet i pavlefshëm, si rezultat i mashtrimit. Mashtrimi realizohet edhe duke heshtur me qëllim mbi rrethanat ose të metat e konstatuara. Nëse këto fakte do të diheshin nga pala tjetër, ajo nuk do ta kryente veprimi juridik³⁰³. Palët, gjatë veprimeve kontraktore duhet të sillen me korrektesë dhe në bazë të parimit të mirëbesimit, t'i bëjnë të ditura njëra-tjetrës të gjitha rrethanat që janë thelbësore në lidhje me veprimin juridik dhe pasojat që ai efekton, pasi në të kundërt, detyrohen të shpërblejnë dëmin e shkaktuar³⁰⁴. Që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, duhet që faktet e mashtrimit të kenë rëndësi thelbësore dhe të ketë ndikuar në mënyrë direkte në kryerjen e tij. Mashtrimi është një veprim i paramenduar që, me qëllim, e çon palën, nëpërmjet gënjeshtërisë, në gabimin e të kuptuarit të asaj çka kërkon të realizojë me anën e këtij veprimi juridik. Me palë kuptohet edhe personi në interes të të cilit është kryer veprimi juridik p.sh., trashëgimtari testamentar. Mashtrimi në të drejtën civile është një veprim i paligjshëm, prandaj dhe gjykata, në disa raste, vendos shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i paligjshmërisë së veprimit³⁰⁵.

Edhe e drejta italiane e vendos mashtrimin në të njëjtin rang me veprimet e paligjshme, dhe i jep mundësinë palës të dëmshpërblehet. Kontrata e konkluduar me efekt mashtrimi të njëres palë nga pala tjetër nuk është nul, por është e anulueshme, sipas nenit 1439 të Kodit Civil Italian. Praktika Gjyqësore ka arsyetuar se, në fakt, thelbi i vjedhjes me anën e kontratës, si vepër e parashikuar në nenin 640 të Kodit Penal, nuk ndryshon nga

³⁰² Neni 95 i Kodit Civil të 1994.

³⁰³ Latifi, J, "E drejta Civile", Pjesa e Përgjithshme, 2000:195.

³⁰⁴ Neni 674 i Kodit Civil të 1994: "Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës. Pala që ka ditur ose që duhej të dinte shkakun e pavlefshmërisë së kontratës dhe nuk ia ka bërë të ditur atë palës tjetër detyrohet të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar, për shkak se besoi, pa fajin e vet, në vlefshmërinë e kontratës".

³⁰⁵ Neni 608 i Kodit Civil: "Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar".

ai mashtrimit që veson negociatën e një kontrate, sepse të dyja kanë për qëllim ta çojnë në gabim palën, t'i vjedhin konsensusin në konkludimin e kontratës³⁰⁶.

Sipas doktrinës italiane, marrëdhënia kontraktore kryhet me mashtrim, kur pala me artifica apo gënjeshtër tërheq palën tjetër në gabim, duke i sjellë vetes apo të tjerëve një përfitim të pamërituar në dëm të palës tjetër. Në këtë rast, anulueshmëria civile e kontratës konkurren me krimin e mashtrimit³⁰⁷.

- Veprimet juridike të kryera në lajthitje. Këto veprime kryhen kur njëra palë krijon një përfytyrim të gabuar dhe jo të saktë për cilësitë e sendit, për identitetin apo cilësitë e personit tjetër kontraktor, që e kanë shtyrë për të kryer veprimin juridik. Lajthimi është kuptimi jo i qartë i elementeve dhe rrethanave të veprimit juridik³⁰⁸. Në veprimet juridike të kryera në lajthitje, vullneti i shprehur nuk përputhet me vullnetin e brendshëm, pasi pala synon një qëllim të ndryshëm nga ai që realizon me anën e veprimit juridik të vesuar. Që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, duhet që ndryshimi i cilësive të objektit, personit apo rrethanave të veprimit juridik, të jetë thelbësor dhe të mos i shërbejë qëllimit që kishin palët. Veprimi juridik nuk shpallet i pavlefshëm nga gjykata, kur gabimi konstatohet në llogaritje, përveçse kur sasia ka qenë element esencial dhe përcaktues për veprimin juridik. Në këtë rast, Kodi Civil ka parashikuar korigjimin e gabimit të bërë në llogaritje, duke i dhënë vlerë ligjore këtij veprimi³⁰⁹.

³⁰⁶ Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 13566, datë 26.05.2008 dhe Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 29003, datë 16.04.2012.

³⁰⁷ Di Marzio, Fabrizio. (2014) "Illiceita Penale ed Invalidita Contrattuale", Rivista-Enciclopedia Treccani, Libro Dell Ano del Diritto.

³⁰⁸ Neni 97 i Kodit Civil të 1994.

³⁰⁹ Neni 98 i Kodit Civil të 1994.

Lajthimi është një veprim, i cili mund të bëhet pa qëllimin e keq, për ta shtënë palën në gabim, në ndryshim nga mashtrimi, pasi nëse pala shtyhet në gabim me qëllim nga pala tjetër, kemi të bëjmë me mashtrim. Lajthimi mund të ndodhë edhe nga veprimet e një personi të tretë, i cili nuk ka lidhje me palët kontraktore apo me veprimin juridik, pasi nëse personi i tretë vepron me qëllim, i shtyrë nga pala tjetër kontraktore, atëherë jemi para mashtrimit³¹⁰. Në Kodin Civil nuk jepet një përkufizim për lajthimin³¹¹, ndërsa Kodi Civil i 1981 e përkufizon lajthimin, duke e konsideruar si përfytyrim të gabuar për veprimin juridik³¹². Pavlefshmëria e veprimit juridik nuk mund ta shkaktojë çdo lajthim, por ai që është thelbësor dhe bazohet në rrethana, pa të cilat personi nuk do të kishte kryer veprimin juridik. Lajthimi i referohet shkakut, subjektit apo objektit të veprimit juridik. Shkaku i veprimit juridik është ajo çka synojnë të arrijnë palët kontraktore nëpërmjet kryerjes së veprimit juridik. Veprimi juridik kryhet në lajthim me llojin e subjektit, kur njëra palë lidh kontratë me një person të ndryshëm nga ai që pretendonte ta lidhte. Në këtë rast, kontrata lidhet për cilësitë e personit kontraktues, pra, kjo lloj kontrate është personale (intuitu personae)³¹³.

Lajthimi në lidhje me llojin dhe cilësitë e sendit, është në rastin kur krijohet një përfytyrim i gabuar në lidhje me objektin dhe ndryshimi në këto cilësi të jetë aq i madh, sa objekti nuk mund t'i shërbejë më qëllimit, për të cilin është lidhur kontrata.

³¹⁰ Neni 95, paragrafi i dytë i Kodit Civil të 1994: “Kur mashtrimi është bërë nga një person i tretë, pala e mashtruar mund të kërkojë shpalljen e pavlefshmërisë së veprimit juridik, vetëm kur, në kohën e kryerjes së tij, pala tjetër ka ditur ose duhej të dinte mashtrimin”.

³¹¹ Neni 97 i Kodit Civil të 1994 parashikon vetëm pasojën që mund të shkaktojë lajthimi, pra, pavlefshmërinë e veprimit juridik.

³¹² Neni 22 i Kodit Civil të 1981: “Lajthimi, domethënë përfytyrimi i gabuar për veprimin juridik, mund të shkaktojë që ky të deklarohet i pavlefshëm, kur ai është i tillë që, po ta dinte këtë rrethanë personi, nuk do ta kishte kryer veprimin juridik”.

³¹³ Kondili. V, “E Drejta Civile”, Pjesa e Përgjithshme, 2008:257.

- Veprimet juridike të kryera me kanosje. Kanosja është një ndikim dhe vesim mbi vullnetin e personit, që e detyron atë të kryejë një veprim juridik të caktuar nga frika e një dëmi fizik ose material, të padrejtë dhe të rëndë, që i drejtohet personit, bashkëshortit, pasardhësit apo paraardhësit të tij³¹⁴. Jo çdo lloj kanosje mund të sjellë pavlefshmërinë e veprimit juridik, kjo në varësi të shqyrtimit rast pas rasti nga gjykata të mospërputhjes së vullnetit të shprehur me vullnetin e brendshëm. Është gjykata ajo që vlerëson dëmin e shkaktuar dhe faktin nëse kemi të bëjmë me kanosje.

Kanosja duhet të ketë ardhur si rezultat i shkeljes së një dispozitë ligjore, pra, të jetë e kundërligjshme. Kanosja duhet të jetë e rëndë dhe dëmi pasuror ose jopasuror, që do t'i shkaktohet palës ose familjarëve të tij, duhet të jetë me pasoja të rënda dhe të rrezikshme për jetën, si kërcënimi për vrasje ose plagosje të rëndë. Që të quhet kanosje, ajo iu drejtohet personave të afërt të palës që merr pjesë në veprimin juridik, cenimi i shëndetit të të cilëve ndikon në vullnetin e kësaj pale. Kanosja duhet t'i krijojë idenë palës se, cenimi i jetës dhe i shëndetit, është i mundshëm për t'u realizuar. Në këtë rast, pala vepron nën efektin e frikës se, nëse nuk e kryen veprimin juridik, do të shkaktohen dëmtime të rënda fizike apo materiale për të dhe familjarët e tij të afërt.

Kanosja realizohet edhe nga personat e tretë, që nuk marrin pjesë në veprimin juridik³¹⁵. Tek elementi kanosje, që sjell si rezultat pavlefshmërinë e veprimit juridik, futet dhe dhuna ose shkaktimi i vuajtjeve fizike të palës ose të afërmeve të saj, që e detyrojnë të kryejë veprimin juridik të pavlefshëm. Megjithatë, doktrina mban qëndrime të ndryshme në lidhje me këtë fakt³¹⁶. Kanosja duhet të dallohet nga dhuna fizike, sepse kanosja

³¹⁴ Neni 96 i Kodit Civil të 1994.

³¹⁵ Neni 96, paragrafi i dytë i Kodit Civil të 1994.

³¹⁶ Kondili. V, "E Drejta Civile", Pjesa e Përgjithshme, 2008:256.
Latifi. J, "E Drejta Civile", Pjesa e Përgjithshme, 2001:200.

trajtohet si dhunë psikologjike dhe pasojat e saj nuk kanë ardhur, por i bëhet një kërcënim personit për të ardhmen. Kjo arsyetohet me faktin që dhuna fizike sjell si rezultat mungesë totale të vullnetit të palës që dhunohet dhe jo vesim të vullnetit të saj, si rrjedhojë e këtij arsytimi, dhuna shkakton pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik dhe jo pavlefshmëri relative, siç shkakton kanosja. Gjithsesi, ekziston dhe mendimi tjetër se dhuna është pjesë e kanosjes dhe sjell vesim të vullnetit të palës.

Kodi Civil i vitit 1981 e kishte më të zgjeruar parashikimin në lidhje me subjektet, që iu drejtohej kanosja, në mënyrë që veprimi juridik të shpallej i pavlefshëm. Veprimi juridik deklarohet i pavlefshëm, kur kanosja ishte e tillë sa t'i shtinte frikën një personi se ai vetë ose të afërmit, si dhe pasuria e tij ishin në rrezik, që të pësonin një dëm të padrejtë dhe të rëndë³¹⁷.

Edhe në legjislacionin italian pranohet kërcënimi, si një ves i konsensusit, që shkakton anulimin e kontratës. Praktika gjyqësore italiane ka shqyrtuar kërkesën e palës dhe ka sqaruar se konkludimi i kontratës, kur është realizuar nën efektin e kërcënimit, sjell pavlefshmëri të saj³¹⁸. Një nga palët pëson një kërcënim nga pala tjetër apo një i tretë dhe në këtë mënyrë finalizohet marrja e pëlqimit për konkludimin e kontratës. Kërcënimi e bën subjektin pasiv, duke ndikuar në konsensusin e dhënë, pasi në mungesë të saj, pala nuk do ta kishte finalizuar kontratën. Kasacionin Civil, në këtë rast, analizon dhe sqaron karakteristikat që duhet të ketë kërcënimi, në mënyrë që të sjellë anulimin e kontratës. Kërcënimi duhet të marrë trajtat e dhunës morale, të cenojë konsensusin e kontratës dhe ky cenim duhet të jetë kushti determinues për lidhjen e kontratës.

³¹⁷ Neni 21 i Kodit Civil të 1981. Ndërsa, në bazë të nenit 96 të Kodit Civil të 1994, rrethi i personave përfshin, bashkëshortin, paraardhësit dhe pasardhësit e tij. Pra, neni 96 i Kodit Civil bën kufizime në lidhje me subjektet që mund të dëmtohen si rrjedhojë e kanosjes.

³¹⁸ Kasacioni Civil Italian, Seksioni I, vendimi nr. 20305, datë 09.10.2015.

Doktrina dhe ligji gjerman, gjithashtu, parashikon se, një kontratë e bërë me kërcënim, është e anulueshme, në sensin që, personi i kërcënuar mund ta anulojë kontratën me efekt retroaktiv³¹⁹. Pala, liria e vullnetit të së cilës, është cenuar, mund të kërkojë rrëzimin e kontratës. Nëse rrëzon kontratën, pala kthehet në gjendjen fillestare në statusin “quo ante”³²⁰. E drejta e anulimit të kontratës së bërë me kërcënim, parashkruhet pas një viti nga kërcënimi, por jo më shumë se tre vjet nga nënshkrimi i kontratës³²¹.

- Veprimet juridike të kryera nga nevoja e madhe³²². Me nevojë të madhe, kuptohet rrethana në të cilën personi ose njëra palë merr përsipër detyrime, për shkak të një gjendjeje nevoje, të cilat janë krejtësisht të papërfillshme me përfitimet e palës tjetër. Duke qenë se, element kryesor i veprimeve juridike është shprehja e vullnetit të palës, është e domosdoshme që ky vullnet të jetë i pavesuar, të përputhet me vullnetin e brendshëm dhe të plotësojë interesat e palëve pjesëmarrëse në këtë veprim juridik. Nëse njëra nga palët ndodhet në kushtet e nevojës së madhe, për arsye nga më të ndryshmet, dhe kjo gjendje shfrytëzohet nga pala tjetër, duke kryer veprime juridike në kushte jashtëzakonisht të disfavorshme, këto veprime juridike deklarohen të pavlefshme.

Në këtë rast, që veprimet të deklarohen të pavlefshme, duhet të ekzistojnë tre kushte:

- a) Detyrimet e veprimit juridik të jenë shumë të rënda, në krahasim me përfitimet e nxjerra prej tij.
- b) Veprimi juridik të jetë realizuar në kohën kur njëra palë të jetë në nevojë të madhe.
- c) Veprimi juridik të jetë kryer, si rezultat i kësaj nevoje.

³¹⁹ Neni 123 dhe 142 i Kodit Civil Gjerman.

³²⁰ Hadjiani. A, (2002) “Duress and Undue Influence in English and German Contract Law: Comparative Study on Vitiating Factors in Common and Civil Law”.

³²¹ Neni 124 i Kodit Civil Gjerman.

³²² Neni 99 i Kodit Civil të 1994.

Këto tre elemente duhet të ekzistojnë së bashku që veprimi të deklarohet i pavlefshëm. Nevoja e madhe përcaktohet rast pas rasti nga gjykata, në bazë të rrethanave konkrete të veprimit juridik, pasi nuk ka një përcaktim në legjislacion në lidhje me elementet që shkaktojnë kryerjen e veprimit juridik në nevojë të madhe. Çdo rrethanë e vështirë në një moment të caktuar, që vërtetohet se e çon palën në lidhjen e një kontrate të tillë, e bën veprimin juridik të pavlefshëm, pasi vullneti ka qenë i vesuar, për shkak të nevojës së madhe.

Rregullat e korrektesës dhe lidhja e kontratave, në kushte të disfavorshme për palët, duke cenuar lirinë kontraktore, edhe pse nuk përcaktohet saktë në normat ligjore, është një sjellje që sjell nulitetin e kontratës dhe në të drejtën italiane. Kjo për shkak të varësisë dominante ekonomike të njërës palë³²³. Gjykata e Kasacionit ka sqaruar se, nuk përbën shkak për invaliditet dhe cenim të parimit të mirëbesimit, edhe pse është cilësuar jokorrekte sjellja e kreditorit që kërkon pagimin e penaliteteve të tepërta. Gjykata quan të vlefshme klauzolën, me anën e së cilës përcaktohet mënyra e matjes së këtij penalteti, nëse është vërtetë aq sa kërkon kreditori³²⁴.

Kryerja e veprimit juridik në kushtet e nevojës së madhe, është një veprim i paligjshëm, për këtë arsye pala e dëmtuar, mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar si rezultat i këtyre veprimeve. Shpërblimi i dëmit, në këtë rast, nuk është i parashikuar në nenin 107 të Kodit Civil, i cili rregullon pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik të kryer në kushtet e nevojës së madhe, por ky shpërblim dëmi mund të kërkojë rast pas rasti nga palët në gjykatë, në zbatim të dispozitave të tjera ligjore³²⁵.

³²³ Albanese. A, "Contratto Mercato Responsabilita", 2008:538.

³²⁴ Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 18128, datë 13.09.2005.

³²⁵ Neni 608-609 i Kodit Civil të 1994.

Edhe në doktrinën dhe ligjin gjerman mungesa ose cenimi i vullnetit të palëve ose njëres prej tyre, kur kontrata është lidhur, i jep të drejtë palës ta deklarojë kontratën nul³²⁶. Një arsye për këtë nulitet mund të jetë një gabim në kohën e nënshkrimit të kontratës dhe ky gabim mund të vijë nga deklarimet e palëve, nga një gabim në shprehje ose një gabim i karakterit të rëndësishëm të subjektit. Gjithashtu, kontrata quhet nul, edhe nëse është nënshkruar për shkak të një kërcënimi³²⁷. Në të drejtën gjermane, njësoj si në të drejtën tonë parashikohet që, nëse bëhet nul kontrata, kjo duhet të trajtohet si nul, që nga fillesa e saj “ex tunc”³²⁸.

5.3 Pavlefshmëria e veprimt juridik të kryer nga përfaqësuesi

Në zhvillimet aktuale të marrëdhënieve kontraktore dhe të biznesit, një pjesë e konsiderueshme e veprimeve juridike kryhen nëpërmjet përfaqësimit. Përfaqësuesi, në bazë të tagrave të përfaqësimit që i janë dhënë nga i përfaqësuari, ushtron vullnetin e tij për kryerjen e veprimeve të ndryshme juridike. Gjatë kryerjes së këtyre veprimeve juridike, mund të ndodhë që ky vullnet i shfaqur nga përfaqësuesi, të jetë i vesuar. Në këtë rast, i përfaqësuari, i cili cenohet dhe dëmtohet nga ky veprim juridik i vesuar, mund t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për shpalljen të pavlefshëm të tij, me arsyetimin se vullneti i të përfaqësuarit ka qenë i vesuar³²⁹. Por nëse rezulton se, ky vullnet i vesuar ka ardhur si rezultat i elementeve dhe kushteve të përcaktuara nga i përfaqësuari në aktin e përfaqësimit, veprimi juridik nuk mund të shpallet i pavlefshëm. Vetëm kur i përfaqësuari provon para organeve gjyqësore se, vullneti i tij i shprehur në aktin e

³²⁶ Polten, P, Erik. (2011) “A Survey of Canadian and German Contract Law”, Polten & Associates, February 2011.

³²⁷ Neni 119 i Kodit Civil Gjerman.

³²⁸ Neni 142/1 i Kodit Civil Gjerman.

³²⁹ Neni 101 i Kodit Civil të 1994.

përfaqësimit ka qenë i vesuar, ai mund të kërkojë shpalljen të pavlefshëm të këtij veprimi juridik. Në këtë rast, duhet provuar në procesin civil mirëbesimi apo keqbesimi i të përfaqësuarit. I përfaqësuari, që është në keqbesim, nuk mund të pëfitojë nga mosdijenja apo mirëbesimi i përfaqësuesit³³⁰. Nëse përfaqësuesi, në marrëveshje me keqbesim me një palë të tretë, mund të kryejë veprime juridike që dëmtojnë të përfaqësuarin, atëherë këto veprime juridike, me kërkesën e të përfaqësuarit, shpallen të pavlefshme, pasi përfaqësuesi duhet të veprojë në interes të të përfaqësuarit dhe të transferojë vullnetin e të përfaqësuarit³³¹. Të përfaqësuarit, në këtë rast, i garantohet një mbrojtje karshi përfaqësuesit, deri në momentin që vërtetohet keqbesimi i tij.

5.4 Pavlefshmëria e pjesshme e veprimit juridik

Sipas nenit 111 të Kodit Civil, shkaku i pavlefshmërisë së veprimit juridik mund të prekë vetëm një pjesë të tij, ndërsa në pjesët e tjera, veprimi juridik ngelet i vlefshëm. Nga kjo bën përjashtim rasti kur, sipas përmbajtjes së veprimit juridik, këto pjesë paraqesin marrëdhënie të pandashme me pjesët e pavlefshme të veprimit juridik, pra, pjesët e pavlefshme janë esenciale dhe ky veprim juridik nuk mund të qëndrojë pa këto pjesë. Nëse shkaku i pavlefshmërisë së veprimit juridik prek vetëm një pjesë të tij, duke mos cenuar veprimin juridik në tërësi, praktika gjyqësore konsideron të pavlefshme vetëm këto pjesë, duke rregulluar pasojat e tyre dhe veprimi juridik, në tërësinë e tij, ngelet i vlefshëm. Sipas arsyetimit unifikues të Gjykatës së Lartë, pjesët e pavlefshme nuk e bëjnë detyrues të pavlefshëm të gjithë veprimin juridik³³². Edhe legjislati i mëparshëm ka parashikuar që pjesët e pavlefshme të veprimit juridik nuk e bëjnë

³³⁰ Neni 101 paragrafi i fundit i Kodit Civil të 1994.

³³¹ Neni 102 i Kodit Civil të 1994.

³³² Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 932, datë 22.06.2000.

detyrimisht të pavlefshëm të gjithë veprimin, nëse nga rrethanat, natyra ose përmbajtja e tij, del se palët do ta kishin kryer veprimin juridik, edhe pa pjesët e pavlefshme të tij³³³.

Pavlefshmërinë e pjesshme të veprimit kontraktor, që nuk sjell nulitetin e plotë të kontratës, e vërejmë dhe në legjislacionin italian. Pavlefshmëria e pjesshme e një kontrate ose pavlefshmëria e klauzolave të veçanta të saj, sjell pavlefshmërinë e të gjithë kontratës nëse rezulton që palët kontraktuese nuk do ta kishin përfunduar atë, pa atë pjesë të përmbajtjes së saj, e cila është goditur nga pavlefshmëria. Pavlefshmëria e klauzolave të veçanta nuk sjell pavlefshmërinë e kontratës, kur klauzolat e pavlefshme janë zëvendësuar nga normat urdhëruese³³⁴. Në këto raste, praktika gjyqësore italiane disponon me ndreqje të efekteve negative, që kanë shkaktuar këto kontrata. Gjykata e Kasacionit ka qartësuar se sjellja jokorrekte e bankës, që ndryshon ose kapitalizon çdo tre muaj interesat e përcaktuar në kontratë, nuk sjell invaliditetin e kontratës, por sjell pasojë vetëm në aspektin e rimbursimit dhe rregullimit të interesave të kontratës, duke riparuar pjesët që e cenojnë kontratën³³⁵.

5.5 Pavlefshmëria e testamentit, parashikuar në pjesën e posaçme të Kodit Civil dhe raporti me dispozitat e përgjithshme.

Testamenti është veprim juridik i njëanshëm, i kryer nga trashëgimlënësi, me anën e të cilit, ky disponon pasurinë e tij pas vdekjes. Duke qenë se testamenti është një nënkategori e veprimit juridik, kuptohet që ai është shfaqje e ligjshme e vullnetit të testatorit. Nëse iu bëhet një analizë dispozitave të tjera të Kodit Civil, në lidhje me testamentin, vërehet se vullneti i testatorit nuk është plotësisht i lirë, por ai kufizohet

³³³ Neni 24 i Kodit Civil të 1981.

³³⁴ Neni 1419 i Kodit Civil Italian.

³³⁵ Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 13477, datë 03.06.2010.

nga këto dispozita, në kundërshtim me nenin 79 të Kodit Civil³³⁶. Sipas këtyre dispozitave, është i pavlefshëm testamenti i cili disponon në favor të personave që janë të pazotë për të trashëguar me ligj, pra, jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë. Gjithashtu, trashëgimlënësi mund të disponojë me testament pasurinë e tij, në favor të çdo personi tjetër, vetëm kur nuk lë të paslindur apo të paralindur, si dhe vëllezër e motra. Vullneti i testatorit është i limituar dhe ai mund të disponojë vetëm brenda rrethit të trashëgimtarëve ligjorë.

Pra, parashikimi i bërë në dispozitat e posaçme të Kodit Civil, në lidhje me shkaqet që efektojnë pavlefshmërinë e testamentit, cenonë autonominë e vullnetit dhe bien në kundërshtim me parashikimet e përgjithshme të veprimit juridik.

³³⁶ Nenet 374, 375, 376, 377, 405 dhe 406 të Kodit Civil të 1994.


Kapitulli VI: Klasifikimi i pasojave të pavlefshmërisë së veprimeve juridike sipas ligjit dhe praktika gjyqësore

Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton asnjë pasojë juridike dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore. Ai është nul dhe nuk është e nevojshme të anulohet me vendim gjykate, ndërsa veprimi juridik relativisht i pavlefshëm shkakton pasoja juridike dhe ka vlerë ligjore, deri në momentin që konsiderohet i pavlefshëm me vendim gjykate. Gjykata nuk vihet në lëvizje nëse njëra nga palët nuk e investon atë dhe si rezultat, veprimi juridik relativisht i pavlefshëm do të vazhdojë të sjellë pasoja juridike.

Nëse ndodhemi para faktit që veprimi juridik i pavlefshëm nuk është përmbushur, pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik midis palëve nuk kanë ndonjë rëndësi. Por nëse nga veprimi absolutisht apo relativisht i pavlefshëm, palët kanë përfituar të drejta dhe kanë marrë përsipër detyrime midis tyre, pra, veprimi juridik ka efektuar pasojat përkatëse, duhet të rregullohen këto pasoja. Gjykata, në këtë rast, duhet të përcaktojë rregullimin e detyrimeve që kanë përmbushur palët kundrejt njëra-tjetrës, në lidhje me një veprim juridik të pavlefshëm.


Nga studimi i kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, sipas analizës statistikore dhe krahasuese, në lidhje me fatin e gjykimit të padive për pavlefshmëri, rezultoi se, nga 2289 paditë për pavlefshmëri në total, 1317 padi janë gjykuar nga gjykata dhe nga këto 797 padi janë pranuar, ndërsa 520 padi janë rrëzuar. Gjithashtu, gjykata ka pushuar 789 padi dhe është shprehur për moskompetencë ose kthim akti për 183 padi.

Raporti në lidhje me fatin e gjyimit të padive për pavlefshmëri, disponuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, në mënyrë grafike, paraqitet si më poshtë:



Nëse bëhet një analizë statistikore dhe krahasuese në lidhje me disponimin e gjykatës për pasojat e pavlefshmërisë, gjatë periudhës 2006-2016, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vërehet se, nga 2289 vendimet gjyqësore për pavlefshmëri në total, janë pranuar nga gjykata 797 padi. Përsa i përket rregullimit të pasojave, nga 797 paditë e pranuar, në 769 raste rregullimi i pasojave është kërkuar nga pala dhe është shprehur nga gjykata sipas kërkesës, në 15 raste, pasojat janë kërkuar nga pala, por nuk janë shprehur nga gjykata, ndërsa në 13 raste, pasojat nuk janë kërkuar nga pala, por janë zgjidhur kryesisht nga gjykata.

Raporti në lidhje me pasojat të pavlefshmërisë, të shprehura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nisur nga kërkitimi ose jo i palës, për periudhën 2006-2016, në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë:



Nga analiza dhe krahasimi i të dhënave statistike, në lidhje me disponimin e gjykatës, për pasojat e pavlefshmërisë në periudhën 2006-2016, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vërehet se në pjesën më të madhe të rasteve, gjykata shprehet sipas kërkesës dhe i zgjidh pasojat sipas asaj çka kanë kërkuar palët. Vetëm në 15 vendime, gjykata nuk është shprehur për pasojat e kërkuara nga palët, por është kufizuar vetëm në konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike, duke mos u dhënë rëndësi pasojave të efektuara nga një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm. Sipas kësaj analize dhe interpretimit gjyqësor, në këto raste veprimet juridike absolutisht të pavlefshme konsiderohen se, nuk janë në gjendje të efektojnë asnjë pasojë juridike dhe për këtë arsye, gjykata nuk është shprehur në lidhje me to, edhe pse veprimet juridike kanë efektuar pasoja të ndryshme nga ato të synuara nga palët. Në 13 vendime, gjykata është shprehur kryesisht në lidhje me rregullimin e pasojave, të cilat nuk janë kërkuar nga palët. Në këto raste, gjykata ka tejkaluar kërkesën e palës për konstatimin e pavlefshmërisë dhe është shprehur kryesisht pa kërkesë, edhe për rregullimin e pasojave të shkaktuara nga këto veprime juridike të pavlefshme.

Nga kjo analizë vërehet se, praktika gjyqësore nuk ka një qëndrim të unifikuar, përse i përket rregullimit të pasojave të pavlefshmërisë, në mënyrë të veçantë asaj absolute, të veprimeve juridike të kryera në kundërshtim me ligjin dhe në mashtrim të ligjit, edhe pse në pjesën më të madhe, ajo shprehet sipas asaj çka kanë kërkuar palët dhe brenda kufijve të kërkesës së tyre.

Nëse bëjmë një krahasim me Kodin Civil Italian, vërejmë se, në të nuk ka një përcaktim dhe një ndarje të qartë midis pasojave të invaliditetit dhe nulitetit të veprimeve kontraktore, pasi legjislatori nuk tregon interes në lidhje me pasojat e nulitetit, në kuptimin që këto pasoja nuk ekzistojnë. Doktrina e përcakton konceptin e invaliditetit si parregullshmëri të kontratës, që sjell si pasojë anulimin e saj³³⁷. Kur kontrata shpallet invalide ose nul, sjell si pasojë prishjen e zgjidhjen e kontratës, ose anulueshmërinë e saj. Pasojat janë nuliteti, anulueshmëria dhe zgjidhja e kontratës³³⁸. Padyshim që legjislacioni ka përcaktuar shkallë pas shkallë pasojat, nga ajo më e rënda e pavlefshmërisë së kontratës që është nuliteti, te fazat më të lehta, që janë anulueshmëria dhe zgjidhja e kontratës. Në këtë mënyrë, nëpërmjet rregullimit ligjor garantohet siguria juridike ndaj rrezikut që vjen nga pavlefshmëria e kontratave. Kjo ka krijuar kategori të reja të nulitetit si nuliteti i mbrojtjes dhe nuliteti virtual³³⁹. Është një fakt i pakontestueshëm që doktrina italiane është e paqartë dhe e ndarë, jo vetëm në lidhje me përcaktimin dogmatik të konceptit të nulitetit, por dhe përse i përket kategorisë në të cilën përfshihen pasojat, si nuliteti, anulimi dhe prishja e kontratës³⁴⁰.

³³⁷ Putti. Maria. P, “La Nullita Parziale”, Diritto Interno e Comunitario, 2002:231.

³³⁸ Ruscica. S, “Il contratto: invalidita e nullita”, Rivista - Altalex, Articolo dt. 26.05.2008.

³³⁹ Rodota. S, (2005) “I Saggi, il Codice Civile e il Processo Costituente Europeo”, Rivista - Associazione Essper Periodici Italiani di Economia, Scienze, Sociali e Storia, Anno: 2005, Volume: 23, Fascicolo: 1, Pagina 21-33.

³⁴⁰ Diana. G. A, “La Nullita Parziale del Contratto”, Il Diritto Privatto Ogi, 2004:579.

Në lidhje me pasojat e kontratave të pavlefshme, ligji dhe doktrina franceze bën një trajtim të ngjashëm me atë italian. Diferenca midis nulitetit dhe zgjidhjes së kontratës në të drejtën franceze, bazohet në faktin që nuliteti përbën një parregullsi në formimin e kontratës në gjenezën e saj, ndërsa zgjidhja e kontratës ka të bëjë me lindjen e një shkaku posterior të mëpasshëm, i cili invalidon kontratën³⁴¹.

6.1 Kalimi i ekzekutimit në të ardhurat e shtetit

Kalimi i ekzekutimit në të ardhurat e shtetit përcaktohet në nenin 106 të Kodit Civil: “Çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit dhe kur nuk është e mundur të merret e njëjta gjë, kërkohet vlefja e saj”, pra, sipas kësaj dispozite, nuk mund të zbatohet restitucioni dhe asnjëra nga palët nuk mund të kërkojë nga pala tjetër atë që ka ekzekutuar. Si rregull, kalimi në të ardhurat e shtetit zbatohet kur veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm ka ndodhur si rezultat i kryerjes së tij në kundërshtim me ligjin ose në mashtim me ligjin, pra, kur veprimi juridik është absolutisht i pavlefshëm. Nga ky rregull bën përjashtim rasti kur veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm është kryer nga një i mitur, që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç³⁴². Në të ardhurat e shtetit, sipas nenit 106 të Kodit Civil kalon ajo që palët aktualisht kanë dhënë dhe jo ajo që duhet të jepnin. Në këtë rast, ajo me të cilën është begatuar pa shkak pala, shkon në favor të shtetit, pra, ajo që është marrë pa shkak nuk i kthehet palës në dëm të së cilës është bërë begatimi, por shkon në favor të shtetit.

³⁴¹ Picod. Y, “Nullite”, 2004:432.

³⁴² Neni 108 i Kodit Civil të 1994. Në këtë rast, nëse veprimi është kryer nga i mituri pa pëlqimin e prindit apo të kujdestarit, gjykata vendos që palët duhet t'i kthejnë njëra-tjetrës çdo gjë që ka ekzekutuar midis tyre dhe, kur nuk është e mundur kjo gjë, t'i paguajnë vlerën. Gjykata, gjithashtu, në këtë rast, vendos që, pala që ka pasur zotësinë për të vepruar, t'i shpërblejë palës tjetër edhe dëmin e shkaktuar. Përjashtohet nga shpërblimi i dëmit vetëm nëse kjo palë vërteton se nuk e ka ditur shkakun e pavlefshmërisë (miturinë e palës tjetër).

Sipas Kodit Civil 1981, nëse kemi mirëbesim të dyanshëm, pra, asnjëra nga palët nuk e ka ditur se veprimi juridik ishte në kundërshtim me ligjin ose në mashtrim me ligjin, dhe nuk dëmtoheshin interesat e shtetit, zbatohet restitucioni i dyanshëm.

Megjithatë, në praktikën gjyqësore bëhet një trajtim i ndryshëm dhe jo i unifikuar në lidhje me pasojat e pavlefshmërisë së veprimeve juridike, të kryera në kundërshtim të ligjit apo në mashtrim të ligjit. Nga gjykata, kryesisht në këto raste, zbatohet restitucioni i dyanshëm dhe e ashtuquajtura kthimi i palëve në gjendjen fillestare, në kundërshtim me nenin 106 të Kodit Civil, edhe pse është e qartë, që palët kanë qenë në keqbesim. Ky koncept dhe neni 106 i Kodit Civil është trashëguar nga legjislacioni i mëparshëm, ku për zbatimin e kthimit në të ardhurat e shtetit, duhet të konkurronte keqbesimi i palëve, me dëmtimin e interesave të shtetit.

Kthimi në të ardhurat e shtetit të asaj çka është përfituar pa të drejtë, në dëmtim të interesave shtetërore, mund të thuhet se vërehet në vendimet penale, (p.sh., falsifikimi i dokumentave). Në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është shqyrtuar çështja “për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumentacionit”³⁴³.

Në lidhje me këtë çështje është disponuar nga gjykata dënimi me gjobë, duke përcaktuar dhe vlerat përkatëse, të cilat kalojnë në favor të shtetit, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumentacionit, i cili ka sjellë dëmtimin e pronës shtetërore dhe përfitim pa të drejtë të kësaj prone nga persona të tretë nëpërmjet një akti juridik absolutisht të pavlefshëm të kryer në kundërshtim me ligjin.


³⁴³ Vendimi nr. 5, datë 15.09.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në bazë të studimit të bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një periudhë prej 10 vjetësh konkretisht 2006-2016, rezultuan vetëm dy vendime ku gjykata ka disponuar kryesisht me kthim në të ardhurat e shtetit për kontratat e lidhura në kundërshtim me ligjin³⁴⁴. Fakti që në periudhën dhjetë vjeçare të studimit, u konstatuan vetëm 2 vendime që kanë disponuar sipas nenit 106 të Kodit Civil për pasojat, tregon se praktika gjyqësore ka devijuar nga parashikimet ligjore, duke krijuar një precedent të ndryshëm. Sipas kësaj analize statistikore dhe krahasuese, për periudhën 2006-2016, nga 797 paditë për pavlefshmëri të pranura nga gjykata, rezultuan vetëm 13 vendime, pasojat e të cilëve nuk janë kërkuar nga palët, por janë shprehur kryesisht nga gjykata, dhe nga këto vetëm në dy vendimet e mësipërme, gjykata ka disponuar kryesisht me kthim në të ardhurat e shtetit.

Në mënyrë grafike, ky raport midis vendimeve të gjykatës, pasojat e të cilëve janë zgjidhur kryesisht nga gjykata pa kërkesë të palës dhe atyre, për të cilët gjykata ka disponuar me kthim në të ardhurat e shtetit, paraqiten si më poshtë:

³⁴⁴ Vendimi nr. 1000, datë 06.02.2013 “Ndërmarrja e Komunale Banesave nuk e gëzonte më të drejtën e pronarit, për rrjedhim nuk mund të transferonte të drejta që nuk i dispononte (nemo plus juris transferre potest quam ipse habet). Në kuptim të nenit 92/a të Kodit Civil, rezulton se kontrata e shitjes të jetë në kundërshtim me nenin 750 e vijues të Kodit Civil. Në vijim të zgjidhjes së pasojave juridike, parashikuar në nenin 106 të Kodit Civil, gjykata konkludon se, të ardhurat e nxjerra nga shitja e dytë e kësaj pasurie, duhet të kalojnë në favor të shtetit, pasi të dy palët kanë qenë në dijeni të ekzistencës së transaksionit të mëparshëm të kalimit të pronësisë (që do të thotë, kanë qenë në keqbesim), për rrjedhim, të ardhurat e përfituara duhet të kalojnë për llogari të shtetit.

Vendimi nr. 6505, datë 22.06.2012: “Është detyrë e gjykatës që, gjatë shqyrtimit të një kërkit të tillë, kur nga ana e saj konstatohet se veprimi juridik është i pavlefshëm, për arsye se vjen në kundërshtim me ligjin, të rregullojë pasojat, në përputhje me nenin 106 të Kodit Civil. Prandaj, gjykata vlerëson se të paditurit duhet të kthehen në gjendjen e mëparshme dhe pagesa për privatizimin e banesës, që është e pavlefshme, duhet të kalojë në të ardhurat e shtetit, pasi i padituri ka qenë në keqbesim.



Në praktikën gjyqësore, për veprimet juridike absolutisht të pavlefshme, që janë kryer në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, gjykata përgjithësisht disponon me restitucion të dyanshëm ose me kthimin e palëve në gjendjen fillestare ³⁴⁵.

Kolegji Civil, në këtë rast, arsyeton se padia e palës paditëse N.Q., është e bazuar në ligj, në zbatim të nenit 83 dhe 750 të Kodit Civil³⁴⁶. Gjatë gjykimit, është provuar se

³⁴⁵ Vendimi nr. 1226, datë 30.10.2007. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen me objekt: “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së privatizimit, datë 27.09.2001, lidhur midis të paditurve, si e lidhur në kundërshtim me ligjin dhe fshirjen e saj nga regjistri hipotekor”, me objekt të kundërpadisë: “Pavlefshmëri e kontratës së shitjes nr. 2198/1096, datë 09.09.1996, të lidhur mes H. D. dhe Entit Kombëtar të Banesave dhe kontratës së shitblerjes, me nr. 1144/802, datë 18.06.1998 lidhur mes H. D. dhe N. Q. Fshirjen e tyre nga regjistrat hipotekorë”.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vëren se paditësi N. Q., me kontratën e shitblerjes nr. 1144/802, datë 18.06.1998, ka blerë nga H. D. një banesë ndodhur në qytetin e Sarandës dhe ky i fundit e ka blerë nga N. K. Banesave, me kontratën nr. 2198/1096, datë 09.09.1996, pronë kjo, e cila figuron e regjistruar në ZVRPP Sarandë në emër të paditësit N. Q. Gjithashtu, rezulton se dhe shtetasi A. H. të ketë blerë të njëjtën banesë nga Bashkia Sarandë, me kontratën e shitjes nr. 28/12, datë 27.09.2001. Nga gjykimi ka rezultuar se, me vendimin nr. 4, datë 23.07.1996, Këshilli Bashkiak Sarandë ka autorizuar të paditurin H. D. të privatizojë zyrën e qendrës së arsimit dhe, në vijim, është lidhur kontrata e shitblerjes me Entin Kombëtar të Banesave, të cilën e ka regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Me tej, këtë banesë ia ka shitur N. Q., i cili, përsëri, ka bërë regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Paditësi A. H. ka lidhur kontratën e shitjes, nr. 28/12, datë 27.09.2001, për të njëjtin objekt të cilin me parë e kishte privatizuar H. D., por kjo kontratë shitjeje është me emërtimin “Vërtetim”, lidhur pranë Noterit, ku nuk kanë nënshkruar as pala shitëse, Bashkia Sarandë dhe as pala blerëse, A. H.

veprimet juridike për kalimin e pronësisë, datë 09.09.1996, lidhur midis H. D. dhe Ndërmarrjes së Komunale-Banesave dhe datë 18.06.1998, lidhur midis H. D. dhe N.Q., janë në formë, në përputhje dhe në përmbajtje me kërkesat e dispozitave të sipërcituara të këtij Kodi, pasi janë bërë me akt noterial, janë regjistruar në regjistrat hipotekorë dhe gjithashtu, nuk konstatohen se vijnë në kundërshtim me ndonjë dispozitë urdhëruese të ligjit, që e bëjnë të pavlefshëm veprimin juridik. Ndërsa kontrata e shitjes datë 27.09.2001, e lidhur mes Bashkisë Sarandë dhe paditësit A. H., vjen në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi nuk është bërë në formën e kërkuar ligjore, palët nuk kanë nënshkruar para noterit. Bashkia Sarandë është paraqitur me cilësinë e shitësit në këtë kontratë, në një kohë kur nuk ka qenë më pronare dhe nuk mund ta dispononte këtë pasuri, pasi në vitin 1996, me vendim të Këshillit Bashkiak, ka autorizuar shitjen e kësaj pasurie H. D., pra, pronësia i ka kaluar këtij të fundit dhe Bashkia Sarandë nuk mund ta dispononte përsëri këtë pasuri në vitin 2001.

Për këto arsye, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë: “Pranimin e kërkesë padisë së paditësit N. Q., konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes nr. 28/12 datë 27.09.2001, lidhur mes Bashkisë Sarandë dhe A. H., fshirjen nga regjistri hipotekor. Rrëzimin e padisë së A. H., me objekt pavlefshmërinë e kontratave të shitjes, datë 09.09.1996, lidhur mes H. D. dhe Entit Kombëtar të Banesave dhe kontratës, datë 18.06.1998, lidhur mes H. D. dhe N. Q.”.

³⁴⁶ Neni 83 i Kodit Civil të 1994: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji”.
Neni 750 i Kodit Civil të 1994: “Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrës së parashikuar në nenin 83 të këtij kodi, përndryshe është e pavlefshme”.

Në këtë rast, ky veprim juridik është absolutisht i pavlefshëm, pasi vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, duke qenë se është shkelur forma e kërkuar nga ligji dhe kontrata nuk është nënshkruar nga palët kontraktuese para noterit nëpërmjet aktit noterial. Gjithashtu, Bashkia Sarandë, në cilësinë e palës shitëse, në këtë kontratë, nuk rezulton të ketë qenë pronare mbi këtë pasuri dhe asnjë palë nuk mund t'i transmetojë tjetrit një të drejtë që nuk e ka.

Duke qenë se gjykata ka disponuar për pavlefshmëri absolute të kontratës së shitjes dhe fshirjen nga regjistri hipotekor, ka zgjidhur dhe pasojat, ndërsa shuma e kësaj kontrate ka ngelur në favor të shtetit. Shtetasi A. H., për përfitimin e kësaj pasurie, ka paguar në llogari të Bashkisë Sarandë (Shtetit), çmimin e blerjes, shumë e cila nuk i është kthyer më dhe ka ngelur në favor të shtetit. Nga gjykata nuk është shqyrtuar fakti nëse shtetasi A. H. ka qenë në mirëbesim, në mënyrë që të zbatohet restitucioni dhe t'i kthehej shuma e pagesës. Duke qenë se ky veprim është konstatuar absolutisht i pavlefshëm, i lidhur në kundërshtim me ligjin, është prezumuar kalimi në të ardhurat e shtetit³⁴⁷, ndërkohë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, kishte disponuar me restitucion të dyanshëm, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme dhe detyruar Bashkinë Sarandë t'i kthejë shtetasit A.H. çmimin e blerjes, ndërsa shtetasi A.H. të kthejë objektin. Ndoshta nga gjykata duhet të ishte verifikuar, nëse kjo kontratë ishte lidhur në mashtrim të ligjit, në mënyrë që vlera e blerjes të ngelej në favor të shtetit.

6.2 Restitucioni i dyanshëm

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm, zbatohet restitucioni i dyanshëm, pra, secila palë detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe kur nuk është e

³⁴⁷ Neni 106 i Kodit Civil të 1994.

mundur t'i kthejë po atë gjë detyrohet t'i paguajë vlerën. Gjithashtu, pala që ka zotësinë për të vepruar ose pala që ka kërkuar shpalljen të pavlefshëm të veprimit juridik, duhet t'i shpërblejë palës tjetër dëmin e shkaktuar, përveç kur provon se ka qenë në mirëbesim dhe nuk ka qenë në dijeni të lajthimit të palës tjetër apo mungesës së zotësisë për të vepruar dhe mungesës së ndërgjegjes për të kuptuar rëndësinë e veprimit të kryer nga pala tjetër³⁴⁸.

Praktika mund të ketë dhe raste që pala e dëmtuar të jetë pala që gëzon zotësinë për të vepruar. Në këtë rast, lind pyetja nëse kjo palë ka të drejtën e kërimit të dëmit të shkaktuar nga ky veprim juridik i pavlefshëm. Parashikimi i bërë në nenet 108 dhe 109 të Kodit Civil e ka përjashtuar personin që gëzon zotësinë për të vepruar nga e drejta e kërimit të dëmshpërblimit, për faktin se, ai duhet të jetë i kujdesshëm në zgjedhjen e personave me të cilët kontrakton.

Restitucioni i dyanshëm ndodh kur: a) Veprimi juridik kryhet nga një i mitur, që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç. b) Kryhet nga një i mitur, që ka mbushur moshën 14 vjeç, por e kryen veprimin pa pëlqimin e prindit apo të kujdestarit. c) Veprimi juridik kryhet nga një person, të cilit i është hequr krejt zotësia për të vepruar. d) Kryhet nga një person, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar, pa pasur pëlqimin e kujdestarit të tij. e) Veprimi juridik kryhet nga një person, i cili në kohën e kryerjes së veprimit, nuk ka pasur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimit të kryer.

³⁴⁸ Neni 108-110 i Kodit Civil të 1994. Siç shihet, ky detyrim për shpërblim dëmi nuk është absolut, pasi është i lidhur me faktin se, pala që ka zotësi për të vepruar, ka qenë në dijeni ose ka pasur mundësi për të qenë në dijeni të faktit që pala tjetër ka qenë e privuar nga zotësia për të vepruar ose që s'ka pasur ndërgjegjen për rëndësinë e veprimeve të saj të kryera. Vërtetimi i këtij fakti është problem i të provuarit në procesin civil.

Restitucioni i dyanshëm zbatohet dhe kur pavlefshmëria e veprimit juridik është shkaktuar nga lajthimi i njërës prej palëve. Kur pala e cila ka iniciuar gjykatën për shpalljen e veprimit juridik të pavlefshëm, provon se nuk ka faj që pala tjetër ka rënë në lajthim ose pala tjetër ka ditur ose duhet ta dinte lajthimin, detyrimi për shpërblim dëmi nuk rëndon mbi këtë palë.

Kodi Civil përcakton zbatimin e restitucionit të dyanshëm dhe në rastin kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm, për arsye se është bërë me mashtrim, kanosje, nga nevoja e madhe ose duke mos respektuar formën e kërkuar ligjore³⁴⁹. Në këtë rast, secila palë duhet t'i kthejë palës tjetër atë që ka marrë, por nuk e dëmshpërblen personin i cili ka qenë në mashtrim, kanosje dhe në kushtet e nevojës së madhe. Gjykata, në këtë rast, nuk është e detyruar të shprehet për shpërblim dëmi ndaj këtij personi.

Në legjislacionin e mëparshëm, për veprimet juridike të bëra me mashtrim, kanosje, palës së dëmtuar duhet t'i kthehej nga pala tjetër çdo gjë që ajo kishte marrë dhe kur nuk ishte e mundur kjo gjë t'i paguhej vlefë, ndërsa të ardhurat e përfituara nga pala, që kishte bërë mashtrimin, kanosjen, kalonin në favor të shtetit³⁵⁰.

³⁴⁹ Neni 107 i Kodit Civil të 1994.

³⁵⁰ Neni 21 i ligjit “Mbi Veprimet Juridike dhe Detyrimet” i vitit 1956 dhe neni 26 i Kodit Civil të 1981, të cilët nuk parashikojnë vetëm rastin kryerjes së veprimit juridik në kushtet e nevojës së madhe. Për vetë frymën ndëshkuese që kishte ky legjislacion, nuk i trajton të dyja palët në mënyrë të barabartë, por ka parashikuar të kthejë në gjendjen e mëparshme vetëm palën e dëmtuar. Pala që bëri mashtrimin, kanosjen ndëshkohet, pasi ka vepruar me faj dhe çdo gjë që ajo ka dhënë, kalon në të ardhurat e shtetit.

Në praktikën gjyqësore, vërehen raste kur gjykata ka disponuar me restitucion të dyanshëm, edhe pse veprimi juridik është konstatuar absolutisht i pavlefshëm³⁵¹.

Në këtë rast, gjykata krijon bindje se kjo kontratë shitjeje, lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse, është absolutisht e pavlefshme nul, pasi është bërë në kundërshtim të hapur me ligjin dhe bie ndesh me nenin 92 të Kodit Civil, pasi nuk është marrë pëlqimi i paditëses F. Th., për pasurinë bashkëshortore të përfituar gjatë martesës në regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore. Gjithashtu, gjatë arsyetimit del se, dhe vullneti i palës shitëse I. Th. është i vesuar, pasi është marrë me kanosje. Në bazë të nenit 92 të Kodit Civil, përcaktohet se, veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike.

Gjykata, në lidhje me vlefshmërinë e veprimit juridik dhe të pasojave që ai efektton, i është referuar qëndrimit unifikues të Gjykatës së Lartë³⁵². Edhe në lidhje me

³⁵¹ Vendimi nr. 68, datë 20.01.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është shqyrtuar çështja me palë: F. Th., të paditur R. H. dhe I. Th., me objekt: “Pavlefshmëri absolute e kontratës së shitjes me nr. 692 rep dhe 213 kol, datë 09.03.1997, të lidhur midis palëve I. Th. dhe R. H., dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme”. Nga analiza gjyqësore rezulton se, konform ligjeve dhe rregullave të kohës, kryefamiljarit I.Th., i është dhënë në pronësi private një shesh ndërtimi, bazuar në vendimin e Komitetit Ekzekutiv Pluralist Sarandë dhe më datë 27.10.1992 ky shtetas ka lidhur kontratën e shitblerjes numër 1714 rep dhe 1705 kol. Mbi bazën e titullit të pronësisë, pala e paditur ka kryer dhe regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Sarandë. Paditësja F. Th. është në marrëdhënie martesore me shtetasin I. Th., që në datën 13.07.1979 dhe duke qenë se kjo është pasuri bashkëshortore, është në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve. Shtetasi I. Th., në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe pa marrë pëlqimin e bashkëshortes, e ka shitur këtë pasuri. Shtetasja F. Th. është vënë në dijeni të kësaj kontrate në vitin 2011, kur punimet e kryera mbi këtë truall u janë pezulluar me vendim gjyqësor nga shtetasi R. H. Paditësja F. Th. pretendon pavlefshmërinë absolute të kësaj kontrate shitjeje, pasi, në bazë të nenit 87 të Kodit Civil të vitit 1981, tjetërsimi i pasurive të përbashkëta të paluajtshme duhet të bëhet me pëlqimin e dy bashkëshortëve. Gjithashtu, neni 208 i Kodit Civil aktual përcakton se, tjetërsimi i sendit të përbashkët duhet të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve. Në këtë proces gjyqësor është ngritur nga pala e paditur I. Th. dhe pretendimi se kjo kontratë shitjeje është lidhur me shtetasin R. H., nën presion dhe kërcënim gjatë trazirave të vitit 1997, për këtë arsye është lidhur pa pëlqimin e bashkëshortes së tij. Pra, sipas këtij arsyetimi, vullneti i shprehur i palës shitëse ka qenë i vesuar.

³⁵² Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 13, datë 09.03.2006: “Veprimi juridik, që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët, për pasojë, ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm. Pavlefshmëria absolute mund të merret parasysh nga gjykata edhe, kryesisht, pa u kërkuar nga palët e interesuara ose kundër dëshirës së saj. Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike. Vetëm për veprimet juridike relativisht të pavlefshme është e domosdoshme iniciativa e palëve, e cila shoqërohet me ngritjen e një padie në gjykatë”.

pretendimin tjetër të palës së paditur R. H., se kjo padi është parashkruar, gjykata, duke u ndodhur para një veprimi absolutisht të pavlefshëm, arsyeton se nuk parashkruhet kërkesa për pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik. Në lidhje me këtë çështje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arsyetuar se: “Nëse kërkohet pavlefshmëri absolute e akteve, kërkimi nuk është i ndërvarur nga ndonjë afat parashkrimi”³⁵³.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë vendosi: “Pranimin e kërkesë padisë. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, kontratës së shitjes nr. 692 rep dhe 213 kol, datë 09.03.1997, të lidhur midis palëve të paditura I. Th. dhe R. H. dhe zgjidhjen e pasojave të kësaj kontrate, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke detyruar palën e paditur R. H. t’i kthejë të paditurit I. Th. sipërfaqen e truallit dhe duke detyruar të paditurin I. Th. t’i kthejë R. H. shumën e shitjes së truallit”. Ky vendim është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë³⁵⁴.

Vërejmë se, përveç konstatimit të pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik si të lidhur në kundërshtim me ligjin, gjykata, me anën e këtij vendimi, është shprehur dhe për zgjidhjen e pasojave, me anën e restitucionit të dyanshëm, duke i kthyer palët njëra-tjetrës çdo gjë që kanë përfituar nga ky veprim juridik absolutisht i pavlefshëm. Sipas nenit 106 të Kodit Civil, duke qenë se, ky veprim juridik është konstatuar absolutisht i pavlefshëm, në këtë rast, duhet të zbatohet nga gjykata kalimi i të ardhurave në favor të shtetit, gjë që nuk ka ndodhur dhe është zbatuar restiticioni i dyanshëm, pavarësisht se palët kanë kryer një veprim juridik në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu, nga gjykata nuk është marrë në shqyrtim fakti, nëse njëra prej palëve ka qenë në mirëbesim, në

³⁵³ Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 3, datë 27.03.2008.

³⁵⁴ Me vendimin nr. 168, datë 29.03.2011, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

mënyrë që të zbatohet restitucioni i njëanshëm. Në lidhje me zbatimin e pasojave për këto raste, praktikat gjyqësore shqiptare mbajnë qëndrime të ndryshme dhe të paunifikuara, qëndrime të cilat vijnë në kundërshtim me nenin 106 të Kodit Civil.

Sipas studimit dhe analizës statistikore e krahasuese, të bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, rezultoi se, gjykata ka disponuar në mënyrë të njëjtë për të dyja llojet e pavlefshmërisë, duke u shprehur për pasojat me kthim të palëve në gjendjen fillestare dhe restitucion të dyanshëm. Vetëm në dy raste, gjykata është shprehur për pasojat me kthim në të ardhurat e shtetit, sipas nenit 106 të Kodit Civil.

Edhe në doktrinën gjermane, ushtimi i së drejtës për zgjidhjen e kontratës, obligon detyrimin për restituim. Çdo palë obligohet të kthejë palën tjetër në gjendjen që ishte para se të lidhte kontratën³⁵⁵. Përveç kësaj, ligji gjerman parashikon se, e drejta e zgjidhjes së kontratës është një e drejtë që i takon palës së pafajshme³⁵⁶.

6.3 Restitucioni i njëanshëm

Ky lloj restitucioni është i përcaktuar në nenin 106 të Kodit Civil dhe ka si element për zbatimin e tij, mirëbesimin e palës në kryerjen e veprimit juridik. Restitucioni i njëanshëm zbatohet në rastin kur vërtetohet mirëbesimi i njërës palë, në veprimet juridike absolutisht të pavlefshme të kryera në kundërshtim me ligjin dhe në mashtrim të ligjit. Pala që është në mirëbesim, në këtë rast, ka të drejtë t'i kërkojë palës tjetër, t'i kthejë çdo gjë që i ka dhënë asaj, në përmbushje të veprimit juridik absolutisht të

³⁵⁵ Pieck. M, "A Study of the Significant Aspects of German Contract Law", Annual Survey of International & Comparative Law, vol 3, iss 1, article 7, dt. 25.08.2010.

³⁵⁶ Nenet 346 dhe 361 të Kodit Civil Gjerman, edhe pse parashikojnë se e drejta për të zgjidhur kontratën duhet të jetë në kontratë, analogjikisht mund të zbatohet e drejta për zgjidhje edhe nga një shkak i mëvonshëm në interes të palës së cenuar.

pavlefshëm, ndërsa pala fajtoje nuk ka të drejtë të kërkojë një gjë të tillë, pasi çdo gjë që ajo ka dhënë merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit. Legjislatori i jep një rëndësi elementit faj dhe mirëbesim në këtë rast, pasi neni 106 i referohet zgjidhjes së pasojave me kalim në të ardhurat e shtetit³⁵⁷ dhe restitucioni i njëanshëm është një përjashtim.

Në këtë rast, elementi vullnet për kryerjen e veprimit juridik në kundërshtim me ligjin ose në mashttrim të ligjit për palën në mirëbesim, nuk ka ekzistuar, prandaj dhe legjislatori bën një përjashtim për të, duke e dëmshpërblyer. Palës, me vendim gjykatë, i kthehet çdo gjë që ajo ka dhënë dhe kur nuk është e mundur një gjë e tillë, i paguhet vlera përkatëse.

6.4 Pasojat e pavlefshmërisë së veprimeve juridike në lidhje me personat e tretë

Veprimet juridike dhe transaksionet, në kushtet e zhvillimit të madh të tregtisë dhe ekonomisë, janë bërë një element i përditshëm në marrëdhëniet e tregut. Mund të ndodhë që një person t'i kalojë një të treti një të drejtë, të cilën ai e ka fituar në bazë të një veprimi juridik të pavlefshëm. Lind pyetja nëse veprimi i dytë, i cili e ka origjinën te veprimi juridik i pavlefshëm, do të ketë vlerë ligjore apo jo. Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm konsiderohet nul dhe për rrjedhojë nuk mund të sjellë pasoja juridike, por gjithashtu, dhe veprimi juridik relativisht i pavlefshëm, kur deklarohet i tillë nga gjykata, nuk sjell më pasoja juridike dhe barazohet me veprimin juridik absolutisht të pavlefshëm.

Në këtë moment, lind problemi si do të zgjidhen pasojat në lidhje me veprimin juridik që mund të ketë kryer njëra nga palët me një person të tretë, kur origjina është një veprim juridik i pavlefshëm. Nuk mund t'i tanskriptohet një tjetri një e drejtë, që ai vetë

³⁵⁷ Për veprimet juridike në kundërshtim ose në mashttrim të ligjit.

nuk e gëzon, për këtë arsye, dhe veprimi i dytë, i cili është përfituar në bazë të një veprimi juridik të pavlefshëm, nuk mund të efektojë asnjë pasojë juridike:

“po të zhduket e drejta e dhënësit zhduket dhe e drejta e marrësit (resoluto jure dantis, reslvtur et jus accipientis)”. (Kondili. V, “E Drejta Civile”, 2008:263)

Nëse bëjmë një shqyrtim të praktikës gjyqësore, me objekt pavlefshmëri të veprimeve juridike, do të shohim që gjykata nuk shprehet fare për fatin e transaksioneve, që janë kryer tek të tretët, në bazë të një veprim juridik të pavlefshëm, pra, nuk iu jep asnjë vlerë juridike atyre përsa kohë rrjedhin nga një veprim juridik i pavlefshëm. Bëhet përjashtim kur pavlefshmëria e veprimit të parë ka ardhur si rezultat i fiktivitetit apo simulimit. Personat e tretë ruajnë të drejtat e tyre, nëse i kanë fitur me mirëbesim, në bazë të një veprimi juridik fiktiv apo të simuluar. Në këtë rast, luan rol elementi mirëbesim në zbatimin e pasojave të veprimit juridik.

Sipas analizës dhe studimit të bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, përsa i përket rregullimit të pasojave të pavlefshmërisë, nuk rezulton që gjykata të jetë shprehur në lidhje me pasojat e transaksioneve në favor të personave të tretë edhe kur këta persona kanë qenë palë e tretë në gjykim.

Edhe në Kodin Civil të 1981, është parashikuar që personat e tretë, të cilët kanë fituar me mirëbesim të drejta në bazë të veprimeve juridike të pavlefshme, nuk dëmtohen³⁵⁸.

Mirëbesimi do të thotë mbrojtje e besës së mirë dhe është një element i rëndësishëm për të drejtën në ditët e sotme. Vullneti dhe përputhja e deklarimit të vullnetit të shprehur me vullnetin e brendshëm është element thelbësor i veprimeve juridike, pasi, në të kundërt, do të kemi “një trup pa shpirt” (Nuni. A, “Veprimet Juridike”, 2001:119).

³⁵⁸ Neni 27 i Kodit Civil të 1981.

Kush vepron në mirëbesim në lidhje me vullnetin e shprehur, duhet të mbrohet, pasi pala në mirëbesim shpreh vullnetin për të krijuar, ndryshuar dhe shuar një pasojë juridike dhe nuk është në dijeni të keqbesimit nga pala, e cila mund të mos ketë asnjë vullnet për të kryer veprim juridik ose e kryen këtë veprim në kundërshtim apo mashtrim të ligjit. Mirëbesimi nuk mund të efektojë mbrojtje në çdo rast për personin, i cili, nëse do të qe treguar më i kujdesshëm në kryerjen e veprimit juridik, do ta kishte kuptuar mospërputhjen e vullnetit të shprehur me atë të brendshëm të palës tjetër: “Mirëbesim nuk do të thotë vlerë absolute e aparençës, por mbrojtje e besës së mirë” (Nuni. A, “Veprimet Juridike”, 2001:119).

Pra, ligji mbron vetëm të tretin që ka qenë i kujdesshëm dhe që, nga rrethana që nuk vareshin prej tij, ai nuk ka mundur të konstatojë se ndodhej para një veprimi juridik të pavlefshëm, megjithëse ka kryer të gjitha veprimet për këtë konstatim.

Duke iu referuar mirëbesimit të njëres palë, shihet një qëndrim i ligjit për të shkuar më tej, drejt përgjegjësisë së palës që ka shkaktuar vesimin e vullnetit të tjetrit, pasi kjo palë nuk ka të drejtë të kërkojë, që t'i kthehet ajo që ka dhënë në një veprim juridik të pavlefshëm, të shkaktuar prej saj, si dhe detyrohet t'i shpërblejë dëmin palës tjetër³⁵⁹.

Në një marrëdhënie juridike private, gjatë shprehjes së vullnetit, nuk pranohet gjuha abstrakte dhe jo e qartë, pasi secila palë duhet të kuptojë atë për të cilën po bëhet palë e një veprimi juridik. Mbrojtja e mirëbesimit të palës është një nocion, të cilin e ndeshim dhe në shitblerjen e sendeve të luajtshme³⁶⁰. Nëse sendi i luajtshëm është përfituar në bazë të një veprimi juridik të anulueshëm, blerja e tij nga të tretët me mirëbesim, ngelet një veprim i vlefshëm. Kjo dispozitë nuk zbatohet për sendet e vjedhura dhe për sendet

³⁵⁹ Neni 608 i Kodit Civil të 1994.

³⁶⁰ Neni 166 i Kodit Civil të 1994.

e regjistruara në regjistrat publike si pronë publike. Në këtë rast, tjetërsuesi nuk bëhet pronar i sendit edhe sikur ky të jetë fituar me mirëbesim.

Në doktrinën bullgare parashikohet një kufizim për personin, prona e të cilit është transferuar te një palë e tretë, edhe pse origjina e këtij transferimi është një kontratë e pavlefshme. Personi i tretë, të cilit i është transferuar prona dhe është në mirëbesim, gëzon një mbrojtje karshi palëve, në kuptimin që nuk cenohet në të drejtën e tij të pronësisë. Përsa u përket pasojave, ky veprim duhet të konsiderohet i vlefshëm mes palëve dhe nuk ka efekte ligjore, në lidhje me përvetësimin e të drejtave nga pala e tretë në mirëbesim. Sipas kësaj analize, midis dy transferimeve përfiton ai i cili ka qenë në mirëbesim, jo ai që transferon i pari. Kjo aplikohet në rastin kur, në të njëjtën kohë, dy personave iu shitet i njëjti send. Detyrimi kontraktual i pavlefshëm duhet të trajtohet me kujdes dhe pala e cenuar nga kontrata e pavlefshme mund të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar³⁶¹.

Pra, mirëbesimi është një element i rëndësishëm, që merret parasysh në zgjidhjen e pasojave të veprimeve juridike të pavlefshme, në lidhje me personat e tretë. Personat e tretë, të cilët janë bërë pronar nëpërmjet një veprimi juridik të pavlefshëm, duhet të jenë gjithmonë palë në proceset gjyqësore me objekt pavlefshmërinë e veprimeve juridike.

³⁶¹ Wolfgang. Faber – Lurger. B, “National Reports on the Transfer of Movables in Europe”, Volume 4: France, Belgium, Bulgaria, Poland, Portugal, 2011:385.

Praktika gjyqësore e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka arsyetuar parimin e mirëbesimit, gjatë tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme.³⁶²:

Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë se, pretendimet e ngritura nga paditësja janë të drejta, pasi të drejtën e kompensimit nuk e ka fituar vetëm i padituri, por të gjithë trashëgimtarët dhe paditësja ka kërkuar dorëzimin e pasurisë që rrjedh nga trashëgimia, pasi ajo gëzon 1/5 pjesë të pasurisë trashëgimore. Më konkretisht, paditësja ka kërkuar pjesën e saj në të drejtën e kompensimit për truallin e zënë. Meqënëse kompensimi, në këtë rast, i është bërë njërit prej trashëgimtarëve, atëherë secili trashëgimtar mund t'i kërkojë atij pjesën e pasurisë trashëgimore nëpërmjet padisë, pasi të paditurit, të drejtat pasurore mbi truallin i burojnë nga trashëgimlënësi, në mënyrë të prejardhur dhe jo nga shteti. Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë se, sipërfaqja prej 1200 m² është pasuri trashëgimore dhe u takon të gjithë trashëgimtarëve.

Ngelen për t'u shqyrtuar pasojat në lidhje me personin e tretë shoqërinë “Al-Gi”, e cila e ka marrë me kontratë sipërmarrjeje këtë sipërfaqe trualli për ndërtimin e dy pallateve nga shtetasi P. D., të cilit ia ka dhuruar pala e paditur. Personi i tretë është thirrur si palë në këtë proces, në kërkesën drejtuar gjykatës³⁶³. Është kërkuar nga paditësja, nëpërmjet

³⁶² Me vendimin numër 6, datë 24.01.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është shqyrtuar çështja me palë Q. D., të paditur F. M., P. D., person i tretë Shoqëria “Al-Gi” Tiranë, me objekt: “Dorëzim pasurie që rrjedh nga trashëgimia. Pavlefshmëri e kontratës së dhurimit, datë 13.11.1997”.

Në bazë të analizës së këtij vendimi gjyqësor, rezulton se paditësja dhe i padituri janë motër e vëlla dhe trashëgimtarë të ish-pronarit M. M., të cilit i është njohur prona me anën e një vendimi të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e cila do t'i kompesohej në një nga mënyrat e njohura nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish-pronarëve”. Në zbatim të së drejtës së kompensimit, që kishte fituar babai i tij, shtetasi F. M. i ridrejtohet Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe me vendim i është kompensuar sipërfaqja prej 1200 m². Këtë sipërfaqe trualli, shtetasi F. M. ia ka dhuruar, më datë 13.11.1997, të paditurit tjetër P. D. dhe ky shtetas, nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes, ka kontraktuar me shoqërinë “Al-Gi” për ndërtimin e dy pallateve. Paditësja në këtë proces gjyqësor ka kërkuar dorëzimin e pasurisë trashëgimore që është përfituar nga i padituri në mënyrë të paligjshme, si dhe pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit si kontratë absolutisht e pavlefshme, pasi dhuruesi i saj nuk ishte pronar i vetëm i kësaj pasurie dhe kjo kontratë vjen në kundërshtim me nenin 92 dhe 349 të Kodit Civil.

³⁶³ Pasi legjitimimi pasiv i tij është i përcaktuar në nenin 350 të Kodit të Procedurës Civile.

padisë, kërkimi i pasurisë trashëgimore nga i padituri dhe personi i tretë, i cili e ka përfituar këtë pasuri nëpërmjet një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm, siç është kontrata e dhurimit. Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm, duke qenë nul, nuk sjell asnjë pasojë dhe nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim juridik të mëvonshëm. Të gjitha veprimet juridike që rrjedhin prej tij, siç është, në rastin konkret, kontrata e sipërmarrjes, janë nul dhe nuk sjellin asnjë pasojë për palët pjesmarrëse. Për këtë arsye, është kërkuar nga paditësja, krahas dorëzimit të pasurisë trashëgimore, edhe pavlefshmëria absolute e veprimit juridik, kontratës së dhurimit, me anën e së cilës është tjetërsuar pasuria trashëgimore te personi i tretë, shoqëria “Al-Gi”.

Në lidhje me këtë kërkim të paditëses, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik dhe zgjidhjes së pasojave juridike të ardhura, ngelet për t'u shqyrtuar nga gjykata, nëse personi i tretë e ka përfituar këtë pasuri me mirëbesim dhe kundërshpërblim, pra, ndaj tij kanë ardhur pasojat e dëmshme nga ky veprim juridik absolutisht i pavlefshëm. Barra e provës, në këtë rast, për zgjidhjen e pasojave dhe vërtetimi i mirëbesimit, i takon personit të tretë, në mënyrë që t'i sigurohet një mbrojtje për mirëbesimin.

Mirëbesimi është një çështje shumë e debatuar edhe në të drejtën italiane, pasi lind pyetja nëse shkelja e rregullave të korrektesës sjell invaliditetin e kontratës. Përplasja, gjithmonë e më shumë, midis rregullave të korrektesës dhe rregullave të pavlefshmërisë, sjell një diferencë, në bazë të së cilës realizohet kontrolli i gjykatës mbi veprimin

konkret, në mbrojtje të autonomisë kontraktuale³⁶⁴. Me ndryshimet e fundit, zhvillimi i ndërhyrjes publike në ekonomi, garanton funksionimin korrekt dhe eficient të mirëbesimit në raportin negociues, duke ndaluar ose zëvendësuar disa klauzola, në funksion të kontraktimit të lirë³⁶⁵. Legjislacioni italian nuk ndalon, në mënyrë kategorike, një marrëveshje kontraktuale, por nuk miraton atë pakt, që në rastin konkret cënon konsensurin kontraktual³⁶⁶. Palët përcaktojnë me vullnet të lirë rregullat e kontraktimit, por janë të ndaluara sjelljet jokorrekte, me anën e së cilës, njëra palë i imponon tjetrës një klauzolë abuzive. Është detyrë e gjykatës që të shqyrtojë nëse njëra palë imponon një abuzim, për shkak të fuqisë ekonomike³⁶⁷.

Edhe doktrina franceze e ka trajtuar mirëbesimin e palëve në një marrëveshje kontraktore, si detyrimin për ta mbrojtur këtë palë, e cila ka ushtruar vullnet të lirë dhe mirëbesim kundrejt kontratës, duke dashur që kjo kontratë të krijojë pasoja ligjore³⁶⁸.

Parimi i mirëbesimit dhe rregullat e korrektesës në marrëdhëniet kontraktore, gjejnë pasqyrim dhe në praktikën gjyqësore gjermane. Sjellja e mirë e palës kontraktore, gjatë vazhdimësisë së kontratës dhe mirëbesimi i kësaj pale, në lidhje me garancitë e lëshuara prej saj, për përmbushjen e detyrimit, lejon të paguhet garanci të vogla, kur të ardhurat e palës janë të ulëta dhe sjellja e saj ka qenë korrekte³⁶⁹.

³⁶⁴ Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 26724 e 26725, datë 19.12.2007 ka sqaruar se, në bazë të ndryshimeve midis rregullave të korrektesës dhe atyre të pavlefshmërisë në fushën e ndërmjetësimit financiar, është përjashtuar që shkelja e detyrës së informimit dhe ekzekutimi korrekt i kontratës nga ana e ndërmjetësuesit financiar, nuk sjell invaliditet për shkak të shkeljes së rregullave imperative, kur kjo shkelje nuk është parashikuar në dispozitat ligjore, por verifikohet mirëbesimi i tij nga gjykata. Ky vendim ka përforcuar arsyetimin e vendimit të Kasacionit Civil Italian, nr. 19024, datë 29.09.2005.

³⁶⁵ Albanese. A, "Violazione di norme imperative e nullita del contratto", 2003:253.

³⁶⁶ Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 25047, datë 27.11.2009, ka përjashtuar invaliditetin e paktit që lidhte kontratën preliminare të një terreni, në mungesë të aprovimit të një plani ndarjeje dhe përfitimi të këtij terreni nga pala. Në këtë rast, lind detyrimi i kthimit të çmimit të paguar më parë dhe interesave pasi, këtë rast, gjykata nuk e quan invaliditet.

³⁶⁷ Albanese. A, "Contratto mercato responsabilita", 2008:547.

³⁶⁸ Viney. G, "Les Obligations la Responsabilite Conditions", 1982:579.

³⁶⁹ Vendimi nr. 2006/99, datë 24.08.2005, i Gjykatës së Apelit Oberlandesgericht Gjermani.

6.5 Pavlefshmëria e martesës si veprim juridik personal dhe pasojat e saj

krahasuar me pavlefshmërinë civile

Pavlefshmëria e martesës ka të bëjë me mosrespektimin e kushteve thelbësore dhe formale të lidhjes së një martese si akt ose të vesimit të vullnetit të bashkëshortëve. Ndërsa, zgjidhja e martesës përfshihet në një nga rastet e mbarimit të martesës, pasi martesa mbaron me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort ose me zgjidhjen e martesës³⁷⁰. Pra, me anën e zgjidhjes së martesës, mbaron një marrëdhënie juridike personale, që ka sjellë efekte ligjore deri në momentin e disponimit të gjykatës për zgjidhjen e saj. Me zgjidhjen e martesës, gjykata zgjidh dhe pasojat ligjore që ka efektuar kjo martesë.

Ndryshimi ndërmjet pavlefshmërisë së martesës dhe zgjidhjes së martesës, qëndron që në konceptimin e martesës si akt dhe martesës si raport ndërmjet çiftit³⁷¹. Në rastin kur cenohet martesa, si akt juridik, kemi të bëjmë me pavlefshmëri të martesës, ndërsa kur vërehen vese dhe të meta të krijuara pas lindjes së martesës, të cilat godasin martesën si raport, kemi të bëjmë me zgjidhjen e martesës. Në rastin e pavlefshmërisë së martesës, marrëdhënia martesore si raport konsiderohet se nuk është krijuar, ndërsa në rastin e zgjidhjes së martesës, kjo marrëdhënie martesore si raport, është krijuar dhe ka sjellë pasoja juridike, por në një moment të caktuar ka mbaruar, si rezultat i tronditjes së marrëdhënies martesore.

Nëse i referohemi praktikës gjyqësore vërejmë se, rastet e disponimit të gjykatës për pavlefshmëri të martesës janë shumë të rralla, në krahasim me kërkesat për zgjidhje të

³⁷⁰ Neni 123 i Kodit të Familjes të 2003.

³⁷¹ Mandro, Arta - Mecaj, V.- Zaka, T - Fullani, A. “E Drejta Familjare”, 2006:153.

marteseve. Në bazë të studimit dhe analizës sasiore e krahasuese, të bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016 rezultoi se, janë shqyrtuar 9968 çështje me objekt zgjidhje martese, ndërsa çështje me objekt pavlefshmëri martese janë vetëm 16 raste. Nga këto, 11 çështje janë pushuar për mosparaqitje të palës paditëse³⁷², një çështje është rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe në prova³⁷³ dhe katër çështje janë pranuar³⁷⁴. Nga analiza e çështjeve të pranuar rezultoi se, në dy raste, martesa është shpallur e pavlefshme, për arsye se është lidhur gjatë vazhdimin të një martese të mëparshme të njërit prej bashkëshortëve³⁷⁵. Në një rast, martesa është shpallur e pavlefshme, pasi njëri prej bashkëshortëve vuante nga një sëmundje e rëndë psikike, vërtetuar me raporte mjekësore³⁷⁶. Në rastin e fundit, martesa është shpallur e pavlefshme për arsye se, ka qenë e simuluar, bashkëshortët nuk kanë pasur qëllim për jetë të përbashkët³⁷⁷.

Fakti që numri i kërkesave për pavlefshmëri martese është shumë i vogël, në krahasim me kërkesat për zgjidhje martese, ndoshta vjen si rrjedhojë se, rastet e tilla nuk bëhen të njohura nga palët, edhe pse numri i martesave të pavlefshme mund të jetë shumë më tepër se kaq. Gjithashtu, nga analiza e kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 2006-2016 rezultoi se, kërkesat për pavlefshmëri martese janë bërë kryesisht pas vitit 2009.

³⁷² P.sh., vendimet nr. 169, datë 20.01.2015, nr. 5079, datë 08.05.2013, nr. 4504, datë 30.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁷³ Vendimi nr. 9394, datë 23.09.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.


³⁷⁴ Vendimet nr. 12340, datë 10.12.2013, nr. 10625, datë 25.10.2013, nr. 8762, datë 28.09.2012, nr. 1835, datë 25.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁷⁵ Neni 41 i Kodit të Familjes të 2003.

³⁷⁶ Neni 35 i Kodit të Familjes 2003.

³⁷⁷ Neni 36 i Kodit të Familjes 2003.

Raporti midis padive për zgjidhje të martesës dhe padive për pavlefshmëri të martesës, për periudhën 2006-2016, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mënyrë grafike, paraqitet si më poshtë:



Pasojat e pavlefshmërisë së martesës janë të ndryshme nga pasojat e zgjidhjes së martesës. Një martesë e pavlefshme, njësoj si veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, është nul që nga lindja e saj, njësoj sikur të mos ketë ekzistuar ndonjëherë, me përjashtim të rastit të pasojave në lidhje me fëmijët e lindur nga kjo martesë e pavlefshme. Fëmijët e lindur nga një martesë që shpallet e pavlefshme quhen si të lindur nga martesa dhe marrëdhëniet midis tyre dhe prindërve rregullohen si në rastet kur zgjidhet martesa³⁷⁸. Ndërsa midis ish-bashkëshortëve, në rastin e pavlefshmërisë së martesës, nuk ka asnjë pasojë, pasi martesa nuk ka ekzistuar ndonjëherë. Në rastin e zgjidhjes së martesës midis ish-bashkëshortëve, ekzistojnë disa të drejta dhe detyrime, edhe pas zgjidhjes së martesës, si përdorimi i mbiemrit të ish-

³⁷⁸ Neni 49 i Kodit të Familjes 2003.

bashkëshortit, kontributi kompesues, e drejta e përdorimit të banesës, pasoja të cilat nuk ekzistojnë në rastin e një martese të pavlefshme³⁷⁹.

Një e veçantë e martesës së pavlefshme, në ndryshim nga veprimet e tjera juridike të pavlefshme, është se një marrëdhënie martesore, që ka lindur si rrjedhojë e një akti të vesuar ose të metë, mund të transferohet, në disa raste, në një marrëdhënie juridike të vlefshme³⁸⁰. Pra, vetë vullneti i palëve në marrëdhënien martesore, mund t'i japë jetë dhe ta ndreqë të metën, vesin ose difektin e martesës së pavlefshme. Në këtë rast, martesa e pavlefshme kthehet në një martesë të vlefshme, element të cilin nuk e ndeshim tek marrëdhëniet e tjera juridike të pavlefshme. Një marrëdhënie juridike absolutisht e pavlefshme nuk sjell asnjë pasojë juridike dhe kjo marrëdhënie e pavlefshme nuk mund të bëhet e vlefshme dhe të riparohet me asnjë akt vullneti të mëpasshëm.

Për një martese të pavlefshme, tashmë të ndrequr, nuk mund të kërkohet përsëri pavlefshmëria e saj, por bashkëshortët, në çdo kohë, mund të kërkojnë zgjidhjen e saj. Pra, pavlefshmëria e martesës dhe zgjidhja e martesës janë dy koncepte të ndryshme të dallueshme nga njëra-tjetra.

- Pavlefshmëria absolute dhe relative e martesës

Klasifikimi i pavlefshmërisë së martesës në pavlefshmëri absolute dhe relative bëhet nga doktrina në bazë të interesit të cenuar, palëve të cilat mund të reagojnë, kufijtë e reagimit dhe pasojat e njërës apo tjetrës pavlefshmëri³⁸¹.

³⁷⁹ Nenet 146, 147 dhe 153 të Kodit të Familjes.

³⁸⁰ Mandro, Arta - Mecaj, V.- Zaka, T - Fullani, A. "E Drejta Familjare", 2006:155-156. Pra, martesa si raport me vullnetin e palëve, mund të rregullojë ato të meta të martesës si akt, të cilat shkaktonin pavlefshmëri të aktit. Në këtë rast, ligji e lejon një tejkallim të pavlefshmërisë së martesës dhe rregullimit të aktit, pasi, në kushte të caktuara, është raporti ai që ka rëndësi në marrëdhënien martesore.

³⁸¹ Mandro, A, "E drejta Familjare". 2006:160.

Martesa është absolutisht e pavlefshme kur, nga veprimet e kryera prej palëve ose institucionit shtetëror të ngarkuar me lidhjen e martesës, janë shkelur normat juridike, duke cenuar një interes jo vetëm të privatëve, por një interes më të gjerë publik³⁸². Ndërsa, në rastin e një martese relativisht të pavlefshme, cenohen interesat e individëve, të cilët kanë lidhur këtë martesë dhe, nëse ekziston dëshira dhe vullneti i tyre, kjo martesë bëhet e vlefshme. Një martesë absolutisht e pavlefshme, vetëm në raste përjashtimore, mund të kthehet në një martesë të vlefshme për shkaqe me rëndësi³⁸³.

Ndryshimi midis tyre qëndron dhe në ushtrimin e së drejtës së padisë. Në rastin e pavlefshmërisë absolute, e drejta e padisë nuk parashkruhet dhe mund të ngrihet e pretendohet nga palët edhe pas zgjidhjes së martesës³⁸⁴.

Një martesë absolutisht e pavlefshme është joekzistuese, sepse nuk ka ekzistuar kurrë dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë, megjithatë, deklarimi prej gjykatës për një pavlefshmëri të tillë është e rëndësishme. Një martesë relativisht e pavlefshme i prodhon efektet e saj, derisa subjekti i interesuar, i cili është prekur nga akti i martesës, i drejtohet gjykatës për pavlefshmëri relative të martesës.

Megjithatë, Kodi i Familjes nuk bën një klasifikim, përse u përket pasojave midis martesës relativisht të pavlefshme dhe absolutisht të pavlefshme, në ndryshim nga pasojat e parashikuara për pavlefshmërinë civile. Martesa relativisht e pavlefshme mund të bëhet e vlefshme, në bazë të vullnetit të palëve, por gjithashtu, edhe martesa absolutisht e pavlefshme në disa situata të veçanta të lejuara nga vetë ligji, mund të

³⁸² Nenet 36, 39, 40 dhe 41 të Kodit të Familjes.

³⁸³ Neni 40, paragrafi i dytë i Kodit të Familjes: “Gjykata nuk shpall të pavlefshme martesën e lidhur midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave, kur çmon se ka shkaqe me rëndësi”.

³⁸⁴ Neni 45 i Kodit të Familjes: “Të drejtën e padisë për pavlefshmërinë e martesës, për shkaqet e parashikuara në nenet 36, 39, 40 dhe 41 të këtij Kodi e kanë secili nga bashkëshortët, prokurori dhe kushdo tjetër që ka një interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm. Kjo padi mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës. E drejta e padisë për pavlefshmërinë e martesës nuk parashkruhet përveç rasteve të parashikuara në nenet 44 dhe 46 të këtij Kodi”.

bëhet e vlefshme. Kështu, gjykata për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën midis fëmijëve të mortave dhe të vëllezërve, e cila është një martesë absolutisht e pavlefshme, për shkak të lidhjeve të gjakut³⁸⁵. Me anën e një vendimi gjyqësor, kjo martesë bëhet e vlefshme. Edhe martesa nën moshën 18 vjeç, e cila është një martesë absolutisht e pavlefshme, për shkaqe me rëndësi, të çmuara nga gjykata, kthehet në një martesë të vlefshme³⁸⁶. Doktrina nuk përcakton një kufi ndarjeje të plotë dhe të qartë midis pavlefshmërisë absolute dhe relative të martesës, pasi, në disa raste, midis këtyre dy llojeve të pavlefshmërisë ka një përzierje të elementëve të tyre³⁸⁷.

6.6 Pavlefshmëria administrative dhe pasojat e saj krahasuar me pavlefshmërinë civile

Akti administrativ është shprehja e vullnetit të institucioneve administrative shtetërore, të ngarkuara nga ligji për të krijuar ndryshuar dhe shuar pasoja të caktuara juridike, gjatë veprimtarisë administrative³⁸⁸. Akti administrativ nxirret në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe ka karakter nënligjor. Nëse procedura e ndjekur nga organet administrative gjatë nxjerrjes së aktit apo përmbajtja e tij është në kundërshtim me dispozitat ligjore, në bazë të të cilit është nxjerrë, atëherë akti nuk krijon pasoja juridike, pasi ai është i pavlefshëm. Pra, në ndryshim nga pavlefshmëria juridike, ku përcaktohen një sërë elementesh që sjellin pavlefshmërinë e veprimit juridik, në rastin e aktit administrativ,

³⁸⁵ Neni 10/2 i Kodit të Familjes të 2003: “Nuk mund të lidhin martesë midis tyre të paralindurit dhe të paslindurit, vëllai dhe motra, ungji dhe mbesa, emta dhe nipi, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave. Gjkata, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën midis fëmijëve të vëllezërve dhe motrave”.

³⁸⁶ Neni 7/2 i Kodit të Familjes të 2003: “...Gjkata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe para kësaj moshe”. Vendimi nr. 1169, datë 22.02.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë: “Kërkuesja e mbështet këtë kërkesë edhe në faktin se pret të lindë një fëmijë... Gjykata krijoi bindjen se, pavarësisht se kërkuesja është e mitur, ajo është e ndërgjegjshme për rëndësinë e veprimit që do të kryejë dhe gjykata vlerësoi pozitivisht zhvillimin e saj psikik”.

³⁸⁷ Mandro, Arta - Mecaj, V. - Zaka, T. - Fullani, A. “E Drejta Familjare”, 2006:168-169.

³⁸⁸ Neni 105 i Kodit të Procedurës Administrative.

një rol të madh për vlefshmërinë e tij luan fakti që ky akt duhet të hartohet nën frymën e ligjit.

Akti administrativ konsiderohet i pavlefshëm, pasi deklarimi i vullnetit të organit administrativ mund të ketë dalë në shkelje të ligjit, të ketë të meta në formë dhe përmbajtje, të mos jetë respektuar procedura ligjore gjatë nxjerrjes së tij ose vullneti shtetëror të jetë i vesuar. Në këto raste, akti administrativ nuk ka fuqi juridike. Edhe nëse krijon fuqi juridike, një akt i tillë revokohet apo anulohet nga organet kompetente³⁸⁹.

Shqyrtimi i vlefshmërisë së këtyre akteve dhe i faktit nëse ato janë hartuar brenda kompetencave të organeve të ngarkuara nga ligji për nxjerrjen e tyre, bëhet nga organi më i lartë administrativ ose nga gjykata³⁹⁰. Pavlefshmëria e aktit administrativ shkaktohet si rezultat i tejkalimit të kompetencave të organit administrativ, i ndonjë mangësie në përmbajtjen e aktit apo me mosrespektim të formës dhe procedurës së nxjerrjes së tij.

Në bazë të ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative, janë objekt shqyrtimi i gjykatave administrative. Megjithatë, në lidhje me këtë çështje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë mbajtur qëndrimin që, kur në një kërkesë padi përfshihen objekte gjykimi të ndryshme, si të natyrës civile,

³⁸⁹ Sadushi, S, “Teoria e Aktit Administrativ”, 2000:146.

³⁹⁰ Neni 123 dhe 124 i Kodit të Procedurës Administrative. Gjykata, në këtë rast, vihet në lëvizje në bazë të kërkesë padisë së ngritur nga palët e prekura nga ky akt administrativ. Pavlefshmëria e aktit administrativ lidhet me kundërligjshmërinë dhe me cenimin e kushteve që përcaktojnë vlefshmërinë dhe rregullshmërinë e aktit administrativ, të nxjerrë në zbatim të ligjit dhe brenda kompetencave e kufijve të caktuar me ligj, për organet administrative përkatëse.

ashtu dhe administrative, gjykata fillimisht duhet të vlerësojë lidhjen mes objekteve dhe faktin nëse mund të shqyrtohen në një gjykim të vetëm³⁹¹.

Kolegjet e Bashkuara, gjithashtu, arsyetojnë se, gjykimet me objekt kundërshtimin e vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk janë gjykime, që përfshihen në fushën administrative, por janë mosmarrëveshje të fushës civile, pasi subjekti pretendues kërkon të drejtën e pronës mbi një send të paluajtshëm, duke paraqitur provat përkatëse për këtë pretendim.

Për kontestimin e një akti administrativ, palët e interesuara, para se t'i drejtohen juridiksionit gjyqësor, sipas Kodit të Procedurës Administrative, duhet të ezaurojnë procedurën e ankimit administrativ³⁹². Pra, janë pikërisht organet hierarkike më të larta dhe gjykata, që kanë kompetencë për shqyrtimin e ligjshmërisë dhe vlefshmërisë së aktit administrativ, iniciuar nga kërkesat e palëve të interesuara³⁹³. Asnjë institucion tjetër, që në ushtrim të veprimtarisë së tij njihet me këto akte, nuk legjitimohet të shprehet për vlefshmërinë e tyre.

³⁹¹ Vendimi numër 4, datë 10.12.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: “Kur në objektin e gjykimit ka disa kërime të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërime konstatohen nga gjykata se janë një bashkim i ndërruar mes tyre, atëherë nëse një ndër objektet është kundërshtim i aktit administrativ dhe nga akti prodhohen pasoja civile, kompetente është gjykata administrative. Nëse një ndër objektet është një kërkim me natyrë civile, por i lidhur ngushtë me aktin administrativ dhe pasojat e këtij akti kanë ardhur nga vullneti shtetëror, atëherë kompetente është gjykata administrative. Kur mosmarrëveshja objekt gjykimi rezulton të jetë e natyrës civile, por nga zgjidhja e pasojave mund të urdhërohen disa veprime me natyrë administrative, atëherë shqyrtimi i kësaj çështjeje do të jetë në kompetencë të gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen civile”.

³⁹² Neni 137/3 i Kodit të Procedurës Administrative: “...Në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës, vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ”.

³⁹³ Neni 139 dhe 141 i Kodit të Procedurës Administrative.

Megjithatë, gjatë auditimeve të ndryshme të ushtruara në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, kryesisht nga Kontrolli i Lartë i Shtetit³⁹⁴, këto zyra nuk trajtohen si institucione të cilat administrojnë dokumentacionin ligjor, që vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme, si dhe përgatitjen, mbajtjen e administrimit e regjistrave të pasurive e hartave kadastrale, pra administrojnë sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme³⁹⁵.

ZVRPP nuk ka përgjegjësi për mënyrën e nxjerrjes së këtyre akteve, konkretisht vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të cilët kanë marrë formë të prerë dhe janë bërë titull pronësie të detyrueshëm për regjistrim në momentin, që përcillen në ZVRPP. Regjistrimi i vendimeve të mësipërme plotëson kriteret ligjore për regjistrim, pasi duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme vendimet e gjykatëve ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme³⁹⁶.

Vendimet e K.K.K.P, në këtë rast, janë vendime të organeve kompetente shtetërore, të cilave iu është dhënë autoritet dhe kompetencë nga ligji për shqyrtimin dhe kthimin e pronave subjekteve të shpronësuar nga regjimi komunist, pra, janë krijuar si

³⁹⁴ “Raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet”, nr. 673/10 prot., datë 30.01.2015, f. 4, i Kontrollit të Lartë të Shtetit, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Gjatë këtyre auditimeve, janë konstatuar shkelje në procedurat e regjistrimit të vendimeve të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pasi sipas tyre, këto vendime komisioni janë bazuar kryesisht në vendime të gjykatës, të dala pas datës 01.11.1994, që kanë për objekt përcaktimin e kufijve dhe vendndodhjes së pronës dhe këto vendime nuk kanë në përmbajtje të tyre dhënien e titullit të pronësisë. Ky arsyetim i audituesve vjen në kundërshtim me sistemin e regjistrimit, pasi audituesi nuk bën një ndarje të saktë midis procedurës së nxjerrjes së aktit administrativ nga organet e ngarkuara nga ligji për nxjerrjen e tij dhe përcjelljes së aktit për regjistrim në ZVRPP. Gjithashtu, audituesit nuk marrin parasysh faktin që ZVRPP nuk legjitimohet për shqyrtimin e ligjshmërisë dhe vlefshmërisë së aktit.

³⁹⁵ Neni 5 i ligjit nr. 33, datë 21.03.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

³⁹⁶ Neni 193/h i Kodit Civil të 1994.

institucione për zgjidhjen dhe rregullimin e situatës së jashtëligjshme të krijuar mbi këto prona nga regjimi komunist shumëvjeçar³⁹⁷.

ZVRPP nuk ka kompetencë për të goditur për pavlefshmëri ose për të shqyrtuar vlefshmërinë e një akti juridik, që është K.K.K.P, hartuar nga një organ administrativ i ngarkuar me ligj për të lëshuar këtë akt. Vetëm organi administrativ më i lartë ose gjykata mund të shqyrtojë vlefshmërinë e këtyre akteve, që konsiderohen tituj ekzekutivë të detyrueshëm për regjistrim³⁹⁸. Mosregjistrimi i këtyre akteve të fitimit të pronësisë do të sillte cenim të sigurisë juridike, pasi e drejta e pronësisë është një e drejtë kushtetuese.

Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Kushtetuese, e cila arsyeton se, ZVRPP është e ngarkuar me mbajtjen e regjistrit publik, në të cilin pasqyrohet pronësia mbi një pronë të paluajtshme dhe transferimet e ndryshme që i bëhen asaj³⁹⁹. Prona nuk mund të transkriptohet te personat e tretë, nëse pasuria nuk është e regjistruar paraprakisht në favor të tjetërsuesit të kësaj pasurie⁴⁰⁰. Çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë⁴⁰¹. Në këtë kuptim, gjykata vlerëson të drejtë arsyetimin se, e drejta e pronës, e fituar përmes një akti administrativ apo vendimi

³⁹⁷ Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 24, datë 13.03.2002.

³⁹⁸ Sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, numër 9235, datë 29.07.2004, i ndryshuar.

³⁹⁹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, numër 17/2010: “Regjistrimi ka qëllim kryerjen e transaksioneve të vlefshme të transferimit të pronësisë ku kërkohen elemente të natyrës publike, siç janë forma noteriale dhe regjistrimi në regjistrin e pronësisë”.

⁴⁰⁰ Neni 195 i Kodit Civil të 1994.

⁴⁰¹ Vendimi nr. 75, datë 19.04.2002, i Gjykatës Kushtetuese. “E drejta e pronësisë, si një e drejtë kushtetuese e fituar në momentin e lëshimit të një akti nga organi kompetent shtetëror, i ngarkuar nga ligji për krijimin e këtij akti, nuk mund të cenohet nga veprimtaria dhe procedura e një organi tjetër të administratës, siç është veprimtaria e ZVRPP (nëpërmjet mosregjistrimit të saj), përveçse një procedurë gjyqësore, pasi kjo do të sillte mungesë të transparencës dhe cenim të sigurisë juridike, si dhe të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të njohura në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut”.

gjyqësor të formës së prerë, nuk mund të cenohet përmes një procedure administrative, përveçse një procedure gjyqësore.

ZVRPP nuk krijon tituj pronësie, regjistrimi ka thjesht efekt deklarativ dhe publikimi⁴⁰².

Sipas këtij arsyetimi, regjistrimi nuk ka vlerë krijuese, në kuptimin që regjistrimi nuk është element i perfeksionimit të aktit të fitimit të pronësisë dhe as kusht për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme. Regjistrimi nuk eliminon nulitetin apo pavlefshmërinë e aktit administrativ të regjistruar në regjistrin publik.

Ashtu si veprimet juridike civile, edhe aktet administrative klasifikohen në absolutisht të pavlefshme dhe relativisht të pavlefshme. Edhe tek akti administrativ ndeshet koncepti i shpalljes së pavlefshmërisë absolute dhe deklarimi i pavlefshmërisë relative. Në rastin kur akti administrativ vjen në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, kemi të bëjmë me akte absolutisht të pavlefshme. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm konsiderohet se nuk ka ekzistuar ndonjëherë, nuk sjell pasoja juridike, pasi ai është nul⁴⁰³. Është shkalla e cenimit të ligjit ajo që i klasifikon aktet administrative në absolutisht dhe relativisht të pavlefshme, në ndryshim nga pavlefshmëria civile, ku janë vetë dispozitat ligjore ato që kanë përcaktuar rastet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të veprimeve juridike, pra, nuk kanë të bëjnë me shkallën e shkeljes së ligjshmërisë. Në pavlefshmërinë civile, mjafton të vërtetohet që veprimi juridik është kryer në kundërshtim me ligjin apo në mashtrim të ligjit, që ai të konstatohet si absolutisht i pavlefshëm. Në zbatim të parimit të ligjshmërisë, disa akte administrative të pavlefshme e kanë cenuar ligjin më pak se disa të tjera dhe kjo i kategorizon ato në relativisht të pavlefshme.

⁴⁰² Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 06.01.2009.

⁴⁰³ Neni 117 i Kodit të Procedurës Administrative.

Në disa raste, praktika gjyqësore, në lidhje me pavlefshmërinë e akteve administrative absolutisht të pavlefshme disponon me anulueshmërinë e aktit, ndërkohë që këto akte nuk mund të anulohen, pasi ato vetvetiu janë nul, që nga momenti i krijimit të tyre dhe ato nuk mund të efektojnë asnjë pasojë ligjore që nga krijimi. Një akt pa vlerë nuk mund të deklarohet se është pa vlerë, por vetëm konstatohet nga gjykata fakti i pavlefshmërisë të tij⁴⁰⁴. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të praktikës gjyqësore vërehet se, në kërkesën drejtuar gjykatës në shumë raste, është kërkuar anulueshmëria e akteve administrative absolutisht të pavlefshme. Pra, gjatë shqyrtimit të vlefshmërisë së akteve administrative, vërehet një ndërthurje e elementeve të pavlefshmërisë absolute dhe relative, pa bërë një ndarje të qartë të tyre, në ndryshim nga pavlefshmëria civile.

Akte administrative absolutisht të pavlefshme konsiderohen ato, të cilat janë nxjerrë nga organet administrative në shkelje të rëndë të ligjit, procedurës apo formës ligjore të përcaktuar. Pavlefshmëria e këtij akti, në këtë rast, mund të shprehet nëpërmjet revokimit dhe shfuqizimit nga organi hierarkik më i lartë si dhe gjykata⁴⁰⁵. Në këtë rast, revokimi i aktit bëhet nëpërmjet konstatimit të pavlefshmërisë absolute të tij. Me konstatimin dhe vërtetimin e pavlefshmërisë, gjykata, në këtë rast, zgjidh dhe pasojat, që kanë shkaktuar këto akte. Një akt administrativ i pavlefshëm nuk mund të bëhet asnjëherë i vlefshëm me asnjë veprim juridik të mëvonshëm të palëve pjesëmarrëse, siç mund të jenë pëlqimi dhe aprovimi apo zhdukja e mëvonshme e shkakut të pavlefshmërisë. Gjithashtu, këtë akt nuk e bën të vlefshëm as kalimi i afatit të parashkrimit⁴⁰⁶.

⁴⁰⁴ Sadushi. S, "Teoria e Aktit Administrativ", 2000:150.

⁴⁰⁵ Neni 124 i Kodit të Procedurave Administrative.

⁴⁰⁶ Sadushi. S, "Teoria e Aktit Administrativ", 2000:153.

Sipas Kodit të Procedurës Civile, është parashikuar si afat parashkrimi, afati 30-ditor nga dita e vënies në dijeni për atakimin në gjykatë të aktit administrativ⁴⁰⁷. Në këtë rast, nuk përcaktohet nëse ky afat 30-ditor për kundërshtimin e aktit i referohet aktit absolutisht të pavlefshëm apo atij relativisht të pavlefshëm, pasi duke qenë se akti absolutisht i pavlefshëm nuk bëhet i vlefshëm me asnjë veprim juridik të mëvonshëm, ai nuk mund të bëhet i vlefshëm, as si rezultat i kalimit të afatit të parashkrimit. Secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të ngrihet në çdo kohë⁴⁰⁸.

Në praktikën gjyqësore vërehen raste kur vetëm një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme, por duke qenë se pjesa që anulohet është shumë e rëndësishme, akti konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, pasi pa këtë pjesë, ky akt nuk mund të realizojë qëllimin e tij⁴⁰⁹. Megjithatë, rastet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të aktit administrativ nuk përcaktohen në dispozitat ligjore, por ky klasifikim bëhet nëpërmjet analizës gjyqësore. Pavlefshmëria e akteve administrative klasifikohet në⁴¹⁰:

- a) akte administrative absolutisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin).
- b) akte administrative relativisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin).

-Akti konsiderohet si absolutisht i pavlefshëm⁴¹¹:

- a) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar.

⁴⁰⁷ Neni 328 i Kodit të Procedurës Civile.

⁴⁰⁸ Neni 117 i Kodit të Procedurave Administrative.

⁴⁰⁹ Neni 117/3 i Kodit të Procedurave Administrative.

⁴¹⁰ Neni 115 i Kodit të Procedurave Administrative.

⁴¹¹ Neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative. Në bazë të analizës së dispozitave ligjore, vërehet se nuk ka një përcaktim dhe një dallim të qartë midis pavlefshmërisë absolute dhe relative të aktit administrativ, por kusht për këtë klasifikim është shkalla e shkeljes së ligjit, nga ajo më e rënda, kundërshtimi flagrant i ligjit, në atë më të lehtë, kundërshtimin e ligjit.

b) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore.

c) Kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

- Një organ administrativ i caktuar ka tagrat e tij të njohura nga ligji për nxjerrjen e akteve administrative, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Organi administrative, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, nuk duhet të tejkalojë këto tagra dhe të dalë jashtë kompetencave, për të cilat është njohur nga pushteti shtetëror, pasi në këtë rast, aktet administrative të nxjerra prej tij, nuk efektojnë asnjë pasojë juridike. Pra, organi administrativ duhet të jetë i njohur nga ligji dhe i identifikuar prej tij.

- Çdo organ administrativ, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, vepron brenda kompetencave dhe kufijve të dhëna nga ligji, për ushtrimin e veprimtarisë administrative në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe detyrave të ngarkuara. Asnjë institucion nuk mund të ushtrojë të drejtat e një organi tjetër administrativ, pasi ushtrimi i kompetencave tej kufirit të lejuar nga ligji, përbën cenim të parimit të ligjshmërisë nga administrata publike dhe si rezultat, krijimin e akteve administrative absolutisht të pavlefshme⁴¹².

- Gjatë nxjerrjes së një akti administrativ, organet kompetente të administratës publike, duhet të respektojnë formën dhe procedurën e përcaktuar nga ligji për nxjerrjen e aktit, pasi shkelja e formës dhe procedurës do të sjellë pavlefshmërinë absolute të aktit.

Nëse mosrespektimi i formës dhe procedurës nuk do të sillte ndryshim në vendimmarrje, në lidhje me aktin administrativ, rrjedhimisht nuk do të efektonte pavlefshmërinë e aktit. Por një mosrespektim i rëndë në formë dhe procedurë, do të sjellë nulitetin e plotë të aktit administrativ. Është gjykata ajo që shqyrton rast pas rasti,

⁴¹² Sadushi. S, "Teoria e Aktit Administrativ", 2000:156.

rëndësinë që ka luajtur respektimi i formës dhe procedurës për nxjerrjen e aktit administrativ dhe faktin nëse ky mosrespektim përbën shkak për pavlefshmëri.

Në parim, para se t'i drejtohen gjykatës, palët e interesuara duhet të ezaurojnë rrugën administrative⁴¹³.

Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë mbajtur një qëndrim të ndryshëm përsa i përket ankimimit administrativ për vendimet e Zyrave Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave⁴¹⁴. Sipas arsyetimeve të këtij Vendimi, për kundërshtimin e akteve administrative, konkretisht vendimet e K.K.K.P, nuk është gjithmonë i domosdoshëm ezaurimi i rrugës administrative, pasi shqyrtimi i vlefshmërisë së këtyre akteve bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, përsa kohë që, pala paditëse nuk bën pjesë në subjektet e shpronësuara, për të cilët është shprehur vendimi i K.K.K.P.⁴¹⁵. Kolegjet e Bashkuara, nëpërmjet këtij vendimi, kanë ndryshuar dhe qëndrimin e tyre të mëparshëm⁴¹⁶.

⁴¹³ Neni 137 i Kodit të Procedurave Administrative: “Ankimimi Administrativ”. Zakonisht, akti administrativ absolutisht i pavlefshëm, revokohet nga organi administrativ më i lartë dhe nga gjykata. E drejta e revokimit të aktit nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë, ndodh vetëm për aktet administrative relativisht të pavlefshme.

⁴¹⁴ Vendimi nr. 2, datë 21.01.2011: “Subjektet e shpronësuara kanë detyrim që t'i drejtohen organit administrativ, A.K.K.P-së, vetëm në dy situata:

Së pari, në rastin kur subjektet e shpronësuara paraqesin për herë të parë kërkesë për njohjen dhe kthimin e pronës, në cilësinë e ish-pronarit.

Së dyti, në rastin e ankimit për vendimin e dhënë në emër të tyre mbi kërkesën e tyre nga ish-Zyra Rajonale e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës. Gjithsesi edhe në këto dy raste çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, pra detyrimi për t'iu drejtuar rrugës përkatëse administrative të kërkesës nuk ekziston, nëse nga subjekti i shpronësuar pretendohet që, për të njëjtën pronë, ish K.K.K.P apo A.K.K.P. kanë disponuar më parë për njohjen dhe kthimin e pronës një subjekti tjetër”.

⁴¹⁵ Mban të njëjtin qëndrim vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 4, datë 24.03.2005.

⁴¹⁶ Vendimi Unifikues nr. 2, datë 06.01.2009: “Ankimi administrativ, parashikuar në nenin 18 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, duhet kuptuar njësoj si për ankimet nga subjekti kërkuar që ndjek procedurën e plotë administrative dhe nuk paraqiten subjekte të tjerë kërkuar, ashtu dhe për ankimet nga një subjekt i ri pretendues kundër aktit administrativ, të dhënë në favor të një subjekti tjetër, por që prek interesat e tij për të njëjtën pronë dhe nuk ka qenë palë në procedurën e plotë administrative të nxjerrjes dhe ankimit të aktit. Në të dyja rastet, subjektet e shpronësuara janë të detyruara të ndjekin procedurën e ankimit administrativ dhe vetëm pasi të jetë ezauruar plotësisht kjo rrugë ligjore, mund t'i drejtohen gjykatës”.

Gjithashtu, në funksion të kësaj linje arsyetimi, ka ecur edhe Gjykata Kushtetuese⁴¹⁷.

Në lidhje me juridiksionin e detyrueshëm për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, për kundërshtimin e vendimeve të ish K.K.K.P-ve, që nuk i kanë njohur apo kthyer pronën ish-pronarit për arsye se, me një vendim të mëparshëm, ia kanë njohur një subjekti tjetër të shpronësuar, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se, nëse subjekti kërkues nuk është dakord me vendimin e Komisionit, ai ka të drejtë ta kundërshtojë këtë vendim drejtpërdrejt në gjykatë⁴¹⁸. Pra, juridiksioni për shqyrtimin e vlefshmërisë së këtyre akteve, i takon gjykatës⁴¹⁹.

- Akti administrativ relativisht i pavlefshëm

Akti administrativ relativisht i pavlefshëm sjell pasoja juridike, derisa palët e prekura prej tij, kërkojnë anulimin e aktit në rrugë administrative apo gjyqësore, brenda afateve ligjore të përcaktuara për atakimin e tij, pasi kërkesa për anulimin e akteve administrative relativisht të pavlefshme i nënshtrohet afateve të parashkrimit. Që në momentin që akti administrativ anulohet si i pavlefshëm, ai i pushon pasojat juridike. Aktet administrative relativisht të pavlefshme mund të revokohen nga vetë organi që i ka krijuar ato, duke rregulluar shkakun e pavlefshmërisë e duke i kthyer në akte të vlefshme, pasi shkelja e ligjit për këto akte është më e lehtë se tek aktet absolutisht të pavlefshme. Aktet administrative quhen relativisht të pavlefshme, kur ato janë nxjerrë

⁴¹⁷ Vendimi nr. 27, datë 26.05.2010, i Gjykatës Kushtetuese ka shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën dispozitat e ligjit 9235, datë 29.07.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, përse i përket ankimit administrativ ndaj vendimeve të ish K.K.K.P, si dhe kompetencës së Drejtorit të A.K.K.P për të cenuar edhe kryesisht vendimet e ish K.K.K.P. Sipas Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i vendimeve të K.K.K.P nga A.K.K.P sjell cenim të parimit të sigurisë juridike. Revokimi dhe shfuqizimi i këtyre akteve nga organi epror A.K.K.P është i pabazuar, pasi mungon një interes i ligjshëm shtetëror për nxjerrjen e këtyre akteve dhe aktet që shfuqizohen apo revokohen nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ. Vendimi i K.K.K.P, që nuk është ankimuar brenda afateve ligjore, merr formë të prerë dhe bëhet titull ekzekutiv.

⁴¹⁸ Vendimi nr. 27, datë 27.07.2009, i Gjykatës Kushtetuese: “Vendimet e organeve të administratës ka të drejtë t’i kundërshtojë në gjykatë, përveç kërkuesve, edhe çdo person tjetër që pretendon për vete të drejta pronësie në lidhje me pronën përkatëse”.

⁴¹⁹ Këtë qëndrim ka mbajtur edhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara, nr. 2, datë 19.02.2014.

në kundërshtim me ligjin, por megjithatë, nuk janë absolutisht të pavlefshme⁴²⁰. Aktet administrative do t'i konsiderojmë relativisht të pavlefshme⁴²¹:

a) Kur përmbajtja e aktit administrativ nuk përputhet me përmbajtjen e ligjit.

Nëse organet e administratës publike nxjerrin akte për subjekte të ndryshme, duke iu dhënë të drejta, apo duke iu mohuar një të drejtë, në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit, ky akt është relativisht i pavlefshëm.

b) Kur përmbajtja e aktit administrativ nuk përputhet me qëllimin e ligjit.

Akti administrative, në çdo kohë që del, ka një qëllim të caktuar për arritjen në një pasojë të caktuar. Nëse qëllimi i aktit nuk është në përputhje dhe në zbatim të ligjit dhe kjo ngelet gjithmonë në çmim të organit që gjykon aktin, ai deklarohet si relativisht i pavlefshëm.

c) Kur akti administrativ nxirret nga organi kompetent nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit, kanosjes dhe dhunës fizike.

Në këtë rast, akti administrativ nxirret nga organi kompetent sipas procedurës dhe formës së përcaktuar në ligj, në përputhje të plotë me qëllimin që ka ligji, por në këtë rast, vullneti i organit kompetent është i vesuar (njësoj si në pavlefshmërinë civile). Pra, në këtë rast, mungon elementi më i rëndësishëm i një marrëdhënieje juridike, që është vullneti, pasi organi kompetent nuk ka vullnet të lirë për të krijuar këtë akt administrativ.

Në lidhje me shqyrtimin e vlefshmërisë së akteve administrative, të nxjerra nga organet e ngarkuara nga ligji, kontratave administrative dhe disponimin e gjyqësorit shqiptar në

⁴²⁰ Neni 118 i Kodit të Procedurave Administrative. Duke iu referuar kësaj dispozite, vërehet se nuk ka një përcaktim të qartë të rasteve të pavlefshmërisë relative, siç kishte në rastin e pavlefshmërisë absolute të aktit dhe në ndryshim nga pavlefshmëria civile.

⁴²¹ Sadushi. S, "Teoria e Aktit Administrativ", 2000:161.

lidhje me vlefshmërinë e tyre, praktika gjyqësore njeh raste kur Gjykata Kushtetuese e Republikës ka marrë në shqyrtim një çështje të tillë, në lidhje me kushtetueshmërinë e vendimit gjyqësor për shqyrtimin e vlefshmërisë së aktit administrativ.

Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë⁴²² ka marrë në shqyrtim çështjen me palë kërkuese Th.Ll., me subjekte të interesuara, Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Sarandë, me objekt: “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë së Vendimit, numër 422, datë 09.07.2013, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”.

Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesi, në bazë të kontratës së sipërmarrjes ka ndërtuar një godinë banimi, shumëkatëshe mbi truallin me sipërfaqe 462 m². Nga kjo sipërfaqe trualli, 262 m² ishte blerë me kontratën e shitblerjes, nr. 552/421, datë 07.12.2006, lidhur midis Bashkisë Sarandë dhe shtetaseve L.D., B.D. dhe E.D. Pas mbarimit të ndërtimit, kërkuesi, në bazë të lejes së shfrytëzimit dhe dokumentacionit shoqërues, përcjellë nga Bashkia Sarandë, ka kërkuar regjistrimin e këtij objekti në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Sarandë. Regjistrimi i këtij objekti është refuzuar nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Tiranë, me aktin administrativ urdhërin numër 270 datë 04.04.2008, pasi është konstatuar se, kontrata e shitblerjes së truallit është lidhur në kundërshtim me ligjin për shitblerjen e trojeve, si dhe nenin 195 të Kodit Civil, duke qenë se Bashkia Sarandë nuk e ka pasur të regjistruar këtë sipërfaqe trualli në regjistrat hipotekorë në momentin që e ka disponuar me kontratë shitjeje. Gjithashtu, vlen të theksohet se, për qytetin e Sarandës është një fenomen dhe një problem i konstatuar fakti që, Bashkia Sarandë ka

⁴²² Vendimi nr. 40, datë 10.03.2015, i Gjykatës Kushtetuese.

shitur mbi 8000 sheshe me kontrata të tilla administrative, fakt i cili është konstatuar shkelje nga audite të ndryshme të ushtruara në këtë Zyrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, por nuk rezulton të jetë ndërmarrë një masë konkrete për rregullimin e kësaj situate.

Kjo është arsyeja pse është hartuar urdhëri numër 270, datë 04.04.2008, për refuzimin e regjistrimit të këtij objekti, i cili nuk siguron marrëdhëniet me truallin, mbi të cilin është ngritur.

Në lidhje me këtë çështje objekt gjykimi, praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrim të ndryshëm⁴²³.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arsyeton se, urdhëri numër 270, datë 04.04.2008, i nxjerrë nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Tiranë, është në përputhje të plotë me ligjin, pasi trualli prej 260 m² i përket shtetit dhe nuk mund të tjetërsohej nga Bashkia Sarandë, pa përfunduar procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve.

⁴²³ Me vendimin nr. 748, datë 16.07.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka disponuar: “Anullimin e urdhërit nr. 270, datë 04.04.2008, të Kryeregjistruesit si të pabazuar në ligj e në prova. Detyrimin e palës së paditur të regjistrojë objektin. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 544, datë 04.11.2008. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: Ndryshimin e vendimeve të dy gjykatave dhe rrëzimin e kërkesë padisë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në konkluzion se, përfundimet e arritura nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit janë të pabazuara në ligj, sepse në regjistrat e pasurive të paluajtshme regjistrohen vetëm pasuritë e paluajtshme, pronësia e të cilave është përfituar me anën e rrugëve ligjore dhe jo si në rastin objekt gjykimi, ku më shumë se gjysma e truallit është përfituar me anën e një veprimi juridik të kryer në kundërshtim me ligjin. Pavlefshmëria absolute e një veprimi juridik nuk mund të ndreqet me asnjë lloj veprimi të mëvonshëm. Në nenin 3 të ligjit “Për shitblerjen e trojeve”, janë përcaktuar rastet përjashtimore, kur mund të realizohet kalimi i trojeve të lira nga pronë shtetërore në pronë private dhe në asnjë nga këto raste nuk përfshihet kontrata objekt gjykimi.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se, ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë⁴²⁴.

Sipas asyetimeve të Gjykatës Kushtetuese, procesi nuk konsiderohet i parregullt, kur Kolegji Civil mbi të njëjtat prova e fakte të gjykuara më parë, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Gjykata e Lartë nuk mund të lërë pa arsyetuar provat e shqyrtuara më parë nga gjykatat e faktit, ashtu si nuk mund të pranojë prova, të cilat nuk janë administruar më parë. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se një veprim juridik i kryer në kundërshtim me ligjin, me nenin 3 të ligjit 7980/1995 “Për shitblerjen e trojeve”, është një veprim absolutisht i pavlefshëm, ndërkohë që gjykatat e faktit, e kanë konsideruar kontratën në fuqi, përsa kohë ajo nuk është kontestuar nga palët pjesëmarrëse apo persona të tretë që cenohen prej saj.

Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se, hetimi gjyqësor ka qenë i paplotë dhe provat të pamjaftueshme, në këtë rast, ajo duhet ta kthente çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave dhe jo të shqyrtonte çështjen si një gjykatë e faktit. Sipas këtij arsyetimi, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar nga ligji.

Në lidhje me pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, mosthirrja e këtyre

⁴²⁴ -Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat e shkallëve më të ulëta dhe duke vendosur në kundërshtim me to.

-Kolegji Civil ka vendosur pa thirrur dhe pa dëgjuar palët e interesuara në kontratën e shitblerjes.

-Kolegji Civil ka gabuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit për pavlefshmërinë e kontratës administrative dhe të veprimit juridik në thelb të çështjes.

-Me qëndrimin ndaj fitimit të pronësisë së mbajtur në vendimin që kundërshtohet, Kolegji Civil ka cenuar parimin e sigurisë juridike në lidhje me pronën e fituar kohë më parë.

palëve nuk cenon parimin e kontradiktoritetit, pasi pretendimet e kërkuarit, në këtë rast kanë të bëjnë me subjekte, të cilat nuk janë palë në çështjen e themelit.

Në lidhje me pretendimin, për zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit, për pavlefshmërinë absolute të kontratës administrative të shitjes, gjykata ka theksuar se, mënyra e vlerësimit të provave dhe zbatimi i ligjit material është atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa Gjykata Kushtetuese vlerëson, nëse procesi në tërësinë e tij dhe marrja e provave, ka qenë i rregullt. Problemi i interpretimit dhe zbatimit të ligjit, nuk hyn në juridiksionin Kushtetues, për këtë arsye, ky pretendim i kërkuarit nuk qëndron.

Vërehet se, praktika gjyqësore në raste të tilla, gjatë shqyrtimit të vlefshmërisë së akteve administrative, nuk shprehet për vlefshmërinë e kontratës administrative, që është fillesa e nxjerrjes së aktit administrativ, pasi gjykata shprehet për aq sa kërkohet në çështjen e themelit, anulimin e aktit administrativ.

Theksojmë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata Administrative Gjirokastrë kanë shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të kërkesave të tilla, pasi rezulton se, ndërtimet në qytetin e Sarandës e kanë përfituar truallin mbi të cilin janë ngritur, në bazë të këtyre kontratave administrative të shitjes, me palë shitëse Bashkinë Sarandë, kontrata të cilat janë me fuqi ligjore, përsa kohë që gjatë shqyrtimit të akteve administrative⁴²⁵, gjykata nuk është shprehur kryesisht për pavlefshmërinë e tyre.

Gjatë shqyrtimit të praktikës gjyqësore në lidhje me këto akte administrative vërehet se, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në pjesën më të madhe të rasteve ka disponuar me anulimin e tyre, ndërsa në raste shumë të rralla, si vendimi i mësipërm, i ka konsideruar

⁴²⁵ Akteve të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme “Urdhër për refuzim regjistrimi” të objekteve shumëkatëshe, pasi nuk sigurojnë marrëdhëniet me truallin.

këto akte administrative të vlefshme⁴²⁶. Përderisa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme dhe për rëndësinë, që paraqet kjo çështje në lidhje me investimet dhe ndërtimin, ndoshta është rasti që Gjykata e Lartë të unifikojë praktikën gjyqësore, duke shqyrtuar dhe analizuar vlefshmërinë e këtyre kontratave administrative. Kjo pasi, vërehet se, që nga viti 2006, kur audit i Kontrollit të Lartë të Shtetit⁴²⁷, i ka konsideruar këto kontrata administrative, si të lidhura në kundërshtim me ligjin dhe ka lënë si detyrë mosregjistrimin e tyre në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, objektet shumëkatëshe janë regjistruar me anën e vendimeve gjyqësore, të cilat i kanë shpallur të pavlefshme urdhërat për refuzimin e regjistrimit. Vlefshmëria e kontratave dhe pasojat që ato kanë efektuar për palët, nuk është shqyrtuar në asnjë rast nga gjyqësori, ndërkohë që, procedura administrative e regjistrimit të objekteve, e cila është kompetencë e organit administrativ të ZVRPP, urdhërohet në të gjitha rastet nga gjyqësori.

Teza që afirmon anulueshmërinë e kontratës administrative, ka qenë objekt shqyrtimi dhe nga praktika gjyqësore italiane⁴²⁸. Neni 1441 i Kodit Civil Italian konfirmon se, aktet administrative të bëra në kontekstin e procedurës publike, që paraprijnë nënshkrimin e një kontrate administrative, nuk janë tjetër veçse mjete integruese të kapacitetit dhe vullnetit të administratës, prandaj vëset e tyre kur përkthehen në vese të vullnetit, nuk mund të sjellin gjë tjetër përveçse anulueshmërinë e kontratës⁴²⁹.

⁴²⁶ Ka disponuar në të njëjtën mënyrë dhe vendimi nr. 323, datë 29.04.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

⁴²⁷ “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, nr. 582/3 prot., datë 27.09.2006, i Kontrollit të Lartë të Shtetit, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

⁴²⁸ Kasacioni Civil Italian, seksioni I, vendimi nr. 14901, datë 17.11.2000, Kasacioni Civil Italian, seksioni I, vendimi nr. 2842, datë 28.03.1996 dhe Kasacioni Civil Italian, seksioni II, vendimi nr. 1885, datë 21.02.1995.

⁴²⁹ F. Passagnoli. G, “Nullita Speciali”, 1995:231.

Mbështetësit e interesit të administratës pohojnë se kjo zgjidhje është ajo që saktëson raportet juridike, për këtë arsye, zgjidhja e kontratës bëhet vetëm në interes të administratës publike, duke rregulluar dhe pasojat⁴³⁰. Anulueshmëria e kontratës administrative në të mirë të interesit publik, ka konfirmuar faktin se, nuliteti bëhet një instrument kontrolli administrativ, pasi akti, përveçse është jo konform ligjit, vendos në rrezik dhe vlerat e komunitetit⁴³¹.

⁴³⁰ Poli. V, “Principi Generali e Regime Giuridico dei Contratti Stipulati dalle Pubbliche Amministrazioni”, Relazione Presentata al IV Coloquio entre el Consejo de Estado de Italia y el Tribunal Supremo de Espana sobre, Madrid 1-4.06.2002, in Giustizia-Amministrativa.

⁴³¹ Kasacioni Civil Italian, Seksioni I, vendimi nr. 5114, datë 06.04.2001.

Kapitulli VII: Roli i gjykatës në trajtimin e institutit të pavlefshmërisë së veprimeve juridike dhe në zbatim të pasojave (risitë unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara)

7.1 Praktika gjyqësore në lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike dhe pasojat

Është e qartë se veprimet juridike absolutisht të pavlefshme janë nul, nuk sjellin asnjë pasojë juridike të synuar nga palët kontraktore, ndërsa veprimet juridike relativisht të pavlefshme prodhojnë pasoja deri në momentin e shpalljes të pavlefshmërisë së tyre nga gjykata. Pra, për këto veprime, merr një rëndësi të veçantë vendimi gjyqësor që i shpall ato të pavlefshme. Por, që gjykata të shprehet në lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike, ajo duhet të iniciohet nga palët në proces, me anën e paraqitjes së kërkesë padisë. Gjithashtu, palët në këtë proces kanë barrën e provës për të vërtetuar pretendimet dhe prapësimet e tyre, pra, për të provuar elementet e parashikuar në ligj për pavlefshmërinë e veprimeve juridike. Gjatë zhvillimit të gjykimit civil kontradiktor midis palëve, gjykata qëndron pasive, drejton procesin duke dalë në fund me një vendim. Gjkata nuk mund të kërkojë apo të orientojë palët për marrjen e një prove, të cilën ata nuk kanë dëshiruar ta paraqesin në proces.

Të anulueshme janë ato veprime juridike të cilat janë të vlefshme, gjersa gjykata, me kërkesë të të interesuarit, i shpall si të pavlefshme⁴³². Duket qartë se, veprimi juridik do të shpallet i pavlefshëm vetëm nëse palët e pretendojnë një gjë të tillë dhe në bazë të kësaj kërkesë shprehet gjyqësori. Përsa kohë palët nuk e kërkojnë një gjë të tillë nga

⁴³² Neni 94 i Kodit Civil të 1994.

gjkata, veprimi juridik vazhdon të sjellë pasoja juridike për palët, edhe pse ai mund të jetë i pavlefshëm, gjykata nuk vendos kryesisht.

Në nenin 107 të Kodit Civil, parashikohet që me shpalljen e veprimit juridik të pavlefshëm, gjykata zgjidh dhe pasojat e këtij veprimi⁴³³. Gjithsesi, kjo duhet të kërkohej nga palët në gjykim. Gjkata, në bazë të zgjidhjes së kërimit të parë, do të disponojë me vendim dhe për kërkimin e dytë. Gjithashtu, në bazë të nenit 108 dhe 109 të Kodit Civil, është përcaktuar se, në rastin kur veprimi juridik konstatohet i pavlefshëm, për shkak se është kryer nga një i mitur, që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç apo shpallet i pavlefshëm, pasi është kryer nga një i mitur që ka mbushur moshën 14 vjeç, pa pëlqimin e prindit apo të kujdestarit, si dhe në rastin kur është kryer nga një person, të cilit i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar pa pëlqimin e kujdestarit apo nga një person, i cili, në kohën e kryerjes së veprimit juridik, nuk ka pasur ndërgjegjen e veprimit të kryer, gjykata, në të gjitha këto raste, do të vendosë që secila palë t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur kjo gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka pasur zotësi për të vepruar, detyrohet t'i shpërblejë palës tjetër dëmin që ka pësuar, për shkak se veprimi juridik konstatohet apo shpallet i pavlefshëm. Pra, në këto raste, legjislatori ka përcaktuar mënyrën e zgjidhjes së pasojave të veprimit juridik, nëpërmjet restitucionit të dyanshëm, si dhe shpërblimin e dëmit nga pala që ka qenë në keqbesim. Në këtë mënyrë, i jepet një mbrojtje ligjore palës më të dobët të veprimit juridik⁴³⁴.

⁴³³ Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm, për arsye se është bërë me mashtrim, kanosje nga nevoja e madhe ose sepse mungon forma e kërkuar nga ligji, secila nga palët duhet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe kur nuk është e mundur t'i kthehet po ajo gjë, t'i paguhet vlefta e saj.

⁴³⁴ Neni 674 i Kodit Civil të 1994.

Praktika gjyqësore disponon me qëndrime jo të unifikuara, në lidhje me trajtimin e pasojave të pavlefshmërisë, kryesisht asaj absolute të veprimeve juridike të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre në mashtrim të ligjit. Në disa raste, edhe pse të pakta në numër, gjykata disponon për zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë, pa u kërkuar nga palët në gjykim⁴³⁵.

Gjithashtu, në praktikën gjyqësore vërehen raste kur vetë palët i drejtohen gjykatës me kërkesë thjesht konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik dhe në raste të tjera, përveç konstatimit të pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, kërkohet dhe zgjidhja e pasojave të veprimit juridik të pavlefshëm. Në disa raste, edhe pse palët kanë kërkuar rregullimin e pasojave, gjykata nuk shprehet në lidhje me to⁴³⁶.

Në praktikën gjyqësore vërehen raste kur me anën e padisë është kërkuar⁴³⁷: “pavlefshmëria absolute e kontratës së shitblerjes, pavlefshmëri e regjistrimit në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Sarandë, detyrimin e të paditurit Z.V.R.P.P Sarandë, të fshijë nga regjistri hipotekor pasurinë e regjistruar në emër të të paditurit. Detyrimin e Z.V.R.P.P Sarandë të regjistrojë si bashkëpronësi, në pjesë të barabarta, pasurinë apartament banimi, në emër të të gjithë bashkëpronarëve”.

Gjykata, në këtë rast, ka vendosur: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes dhe zgjidhjen e pasojave të kësaj kontrate, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, fshirjen e regjistrimit të kësaj prone nga regjistrat e Z.V.R.P.P Sarandë. Rrëzimin e padisë për pjesën e kërimit ligjor të pavlefshmërisë së regjistrimit të pronës

⁴³⁵ Gjatë periudhës 2006-2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në 13 raste ka disponuar kryesisht për zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë pa kërkesë të palëve, dhe nga këto në 2 raste ka disponuar me kthim në të ardhurat e shtetit.

⁴³⁶ Gjatë periudhës 2006-2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në 15 raste nuk ka disponuar për rregullimin e pasojave edhe pse kjo është kërkuar nga palët.

⁴³⁷ Vendimi gjyqësor nr. 747 datë 29.05.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

në Z.V.R.P.P Sarandë dhe detyrimin Z.V.R.P.P Sarandë të regjistrojë në bashkëpronësi, pronën në pjesë të barabarta”.

Vërehet se, në këtë vendim, është shqyrtuar njëkohësisht konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes dhe zgjidhja e pasojave nga gjykata. Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur⁴³⁸: “Prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, në lidhje me pjesën e objektit të padisë për detyrimin e Z.V.R.P.P Sarandë të regjistrojë në bashkëpronësi në pjesë të barabarta pasurinë objekt gjykimi dhe ndryshimin e vendimit për pjesën tjetër, duke rrëzuar kërkesë padinë”.

Gjykata e Apelit i çmon jo të drejta konkluzionet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi në objektin e padisë përfshihet pretendimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, të kontratës së shitblerjes së sendit të paluajtshëm, rregullimi i pasojave të pavlefshmërisë absolute dhe detyrimi i Z.V.R.P.P për të kryer një veprim të caktuar të veprimtarisë administrative kompetente. Sipas Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme, iu mungon thelbi ligjor dhe për këtë shkak, konsiderohen si inekzistente, nul, në lidhje me pasojat juridike që ato efektojnë.

Konstatimi i nulitetit të veprimeve juridike nuk kërkon një iniciativë procedurale të posaçme. Ndërmarrja e iniciativës procedurale të ngritjes së padisë, duke pretenduar gjyqësisht vetëm konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, nuk është e drejtë. Gjykata inicohet lidhur me kërkimin e pavlefshmërisë relative të veprimit juridike ose veprimeve juridike të anulueshme. Veprimet juridike absolutisht të pavlefshme nuk mund të konstatohen nga gjykata përmes një vendimi përfundimtar, pasi nuliteti i këtyre lloj veprimesh shtrihet prej momentit të realizimit të tyre, duke

⁴³⁸ Vendimi nr. 476, datë 08.12.2009, i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

konsideruar se nuk kanë sjellë asnjëherë efektet ligjore të pritshme. Vetëm për veprime juridike relativisht të pavlefshme është e domosdoshme iniciativa e palëve, e cila shoqërohet me ngritjen e një padie në gjykatë⁴³⁹.

Gjithashtu, në lidhje me këtë çështje, paraqet rëndësi debati lidhur me interesin e ligjshëm të paditëses në pretendimet e saj drejtuar gjykatës. Padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur⁴⁴⁰. Interesi është përfitimi personal që do të kishte mbajtësi i së drejtës subjektive të pretenduar ose të shkelur, duke kërkuar, me anë të gjykatës, rivendosjen e kësaj të drejte. Interesi i ligjshëm duhet të jetë direkt. Në rastin konkret, interesi direkt i palës paditëse, është të njihet bashkëpronare në pasurinë e paluajtshme dhe më tej të realizojë pushtetin e saj për sendin në bashkëpronësi apo në pjesën takuese. Ky konkluzion del nga tërësia e kërkimeve të palës paditëse, ku përfshihet edhe kërkimi për detyrimin e Z.V.R.P.P të regjistrojë pasurinë në bashkëpronësi të të gjitha palëve ndërgjyqëse. Rrjedhimisht, interesi i palës paditëse nuk mund të realizohet përmes pretendimit të pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes, pasi pasoja e kësaj pavlefshmërie të kontratës së shitblerjes, është kthimi i apartamentit të banimit në pronësi të autoritetit shtetëror dhe kështu, nuk realizohet interesi direkt i palës paditëse.

Pra, iniciativa procedurale do të ishte ngritja e pretendimit për njohjen e së drejtës së bashkëpronësisë mbi pasurinë e paluajtshme objekt gjykimi. Vetëm në këtë mënyrë realizohet efektivisht interesi i ligjshëm i palës paditëse, pasi mungesa e interesit të ligjshëm të palës paditëse, në pretendimin drejtuar gjykatës, sjell rrëzimin e padisë. E njëjta gjë vlen dhe përsa i përket rregullimit të pasojave të pavlefshmërisë së veprimit

⁴³⁹ Vendimi 13, datë 09.03.2006, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁴⁴⁰ Neni 32/a i Kodit të Procedurës Civile.

juridik. Në këtë rast, gjykata, gjatë trajtimit të çështjes së themelit për njohjen e së drejtës së bashkëpronësisë, kryesisht mund të shqyrtojë dhe pavlefshmërinë e veprimit juridik dhe të zgjidhë pasojat e tij.

Praktika Gjyqësore i trajton veprimet juridike dhe kontratat si marrëveshje të vullnetshme që sjellin pasojat e dëshiruara, në bazë të përputhjes së vullnetit të palëve pjesëmarrëse. Ky vullnet i lirë nuk mund të imponohet dhe të detyrohet nga askush. Në asnjë rast, nuk mund të imponojë gjykata palët të lidhin një kontratë, në ndryshim kjo nga trajtimi që bën praktika gjyqësore në lidhje me një akt administrativ. Organi kompetent i ngarkuar nga ligji për nxjerrjen e tij, mund të urdhërohet nga gjyqësori për t'u shprehur në lidhje me kërkesën e palës, nëpërmjet nxjerrjes së aktit administrativ. Pra, gjyqësori urdhëron organin administrativ, që të shprehë një vullnet të caktuar në lidhje me kërkesën në fjalë. Këtë qëndrim kanë mbajtur dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke arsyetuar⁴⁴¹: “Çdo individ, pasi të ketë ezauruar rekursin administrative, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me padi, për detyrimin e organit administrativ për nxjerrjen e aktit administrativ brenda kompetencave të tij, me qëllim realizimin e një të drejte të pretenduar”.

Një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton asnjë lloj pasoje dhe gjykata, gjatë shqyrtimit të çështjes, nuk jep vendim për deklarimin e tij absolutisht të pavlefshëm, por kufizohet vetëm në vërtetimin e pavlefshmërisë absolute dhe duke u nisur nga kjo, zgjidh pasojat e kërkuara. Nëse palët heqin dorë nga kërkimet e tyre për pasojat juridike, gjykata realisht nuk duhet të shprehet me vendim për to, pasi padia është mjeti mbrojtës i interesave të paditësit dhe për aq sa kërkon paditësi.

⁴⁴¹ Vendimi nr. 686, datë 11.05.2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjykata inicohet në të gjitha kërkimet nga palët, megjithatë, po t'i referohemi nenit 106 të Kodit Civil për pasojat e pavlefshmërisë së veprimeve juridike, shohim se palët nuk kanë interes legjitim në lidhje me pasojat, pasi, kur veprimi juridik vjen në kundërshtim me ligjin ose është bërë me qëllim mashtrimi të ligjit, çdo gjë që palët i kanë dhënë njëra-tjetrës, merret dhe kalon në të ardhurat e shtetit dhe kur nuk është e mundur të merret po ajo gjë, kërkohet vlefja e saj. Në këtë rast, zgjidhja e pasojave të veprimit absolutisht të pavlefshëm, nëpërmjet kthimit në të ardhurat e shtetit, cenon rolin pasiv të gjykatës, pasi ajo merr rol aktiv, duke u shprehur për këto pasoja, edhe pse nuk kërkohet në disponimin që bëjnë palët nëpërmjet kërkesë padisë. Asnjë nga palët nuk ka ndonjë interes të ligjshëm të kërkojë që gjykata të disponojë me kthimin në të ardhurat e shtetit dhe gjykata vendos vetë kryesisht.

Ky përcaktim për zgjidhjen e pasojave të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm, ndeshet dhe në legjislacionet e mëparshme në Shqipëri dhe ndoshta ka të bëjë me atë që, kur veprimi juridik vjen në kundërshtim me ligjin apo është bërë në mashtrim të ligjit, kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave ligjore dhe cenim të interesave të shtetit, të cilat ishin thelbësore për kohën. Këto veprime të pavlefshme konsiderohen të jenë të dëmshme për shtetin, për shkak të qënies në konflikt me ligjin. Si rrjedhojë, palët, në një marrëveshje të tillë, duke qenë se kanë dëmtuar interesat e shtetit, duhet të kthejnë gjithçka që kanë shkëmbyer në mashtrim të ligjit, në natyrë ose në vlerë monetare, kur shkëmbimet janë të pamundura për t'u kthyer në natyrë⁴⁴². Në këtë rast, gjykata merr rol aktiv duke mbrojtur interesat ligjore të shtetit. Ndoshta, kjo dispozitë ka ngelur nga tradita e legjislacionit shqiptar të mëparshëm ose ndoshta është gjetur si një zgjidhje e rastit kur palët nuk kanë interes të drejtpërdrejtë që të kërkojnë zgjidhjen e pasojave të

⁴⁴² Nathanaili. A, "E Drejta Civile e R.P. të Shqipërisë", pjesa e përgjithshme, vëllimi I. Tiranë, 1974:278.

këtyre veprimeve absolutisht të pavlefshme, gjë që gjykata e zgjidh këtë kryesisht. Gjithsesi, gjatë periudhës 2006-2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vetëm në dy raste ka disponuar me kthim në të ardhurat e shtetit. Më së shumti, praktika gjyqësore parashikon “restitutio ad integrum” si zgjidhje të pasojave. Parimi i aplikuar nga gjykatat shqiptare, është kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme, si pasojë e veprimit absolutisht të pavlefshëm⁴⁴³.

Edhe doktrina pranon zbatimin e restitucionit të dyanshëm, në të dyja llojet e pavlefshmërisë, asaj absolute dhe relative. Palët lirohen nga detyrimet dhe çdo gjë që njëra palë i ka dhënë tjetrës, mund të kërkojë kthimin. Në këtë kuptim, veprimi juridik relativisht i pavlefshëm, barazohet me atë absolutisht të pavlefshëm⁴⁴⁴.

Në ndryshim nga veprimet relativisht të pavlefshme që deklarohen të tilla nga gjykata, ato absolutisht të pavlefshme konstatohen dhe vërtetohet pavlefshmëria e tyre nga gjykata. Ndërsa, përsa u përket pasojave, midis dy llojeve të pavlefshmërive, asaj absolute dhe relative, ato zbatohen njësoj nga gjykata dhe nuk ka ndonjë ndryshim në zbatim, thjesht bëhet klasifikimi i pasojave në bazë të llojit të pavlefshmërisë. Këto janë përcaktuar në Kodin Civil, nga neni 106 deri në nenin 110. Si në rastin kur gjykata konstaton, ashtu dhe në rastin kur deklaron pavlefshmërinë e veprimit juridik, shprehet dhe për pasojat. Megjithatë, në rastin e deklarimit të veprimit juridik të pavlefshëm, palët kanë interes të ligjshëm, që krahas pavlefshmërisë të bëjnë dhe një kërkim të dytë për zgjidhjen e pasojave juridike, interes të cilin nuk e kanë në rastin e pavlefshmërisë absolute për veprimet e kryera në kundërshtim me ligjin dhe ato në mashtrim të ligjit. Në këtë rast, logjikisht, duke qenë se mungon interesi i ligjshëm, gjykata duhet të

⁴⁴³ Semini. M, (2013). “Pavlefshmëria e Veprimeve Juridike nën Këndvështrimin e Kodit Civil, Doktrinës dhe Praktikës Gjyqësore”, Revista “Jeta Juridike”, nr. 4.

⁴⁴⁴ Gjata. R, “E Drejta Civile”, Tiranë, 2010:161.

vendosë rrëzimin e kërkesë padisë, nëse nuk kemi një kërkim të dytë nga pala, pasi gjykata disponon për sa kërkohet. Megjithatë, kjo logjikë rrëzohet nga neni 106 i Kodit Civil.

Do të ishte një inicim i kotë i gjykatës thjesht konstatimi i një veprimi të pavlefshëm, dhe nuk ka kuptim nëse nuk do të zgjidheshin pasojat e shkaktuara nga ky veprim, pasi qëllimi kryesor i palëve të interesuara është zgjidhja e pasojave, në të kundërt, ky vendim do të ngjante me një vendim gjykate për vërtetim fakti.

Sipas analizës statistikore dhe krahasuese të bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, rezultoi se pasojat aplikohen njësoj për të dyja llojet e pavlefshmërive, asaj absolute dhe relative, duke u shprehur për kthimin e palëve në gjendjen fillestare dhe restitucionin e dyanshëm. Vetëm në dy raste është disponuar me kthim në të ardhurat e shtetit.


Shkaqet që shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik janë të ndryshme. Në bazë të analizës së 21 vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për periudhën 2000-2011, përsa u përket shkaqeve, veprimet juridike absolutisht të pavlefshëm janë klasifikuar⁴⁴⁵: a) Për shkak se veprimi vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit neni 92/a, në konkurrim me një dispozitë urdhëruese të Kodit Civil. b) Për shkak se vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit neni 92/a dhe me parimet e së drejtës apo me dispozita

⁴⁴⁵ Semini. M, (2013). “Pavlefshmëria e Veprimeve Juridike nën Këndvështrimin e Kodit Civil, Doktrinës dhe Praktikës Gjyqësore”. Revista “Jeta Juridike”, nr. 4. Sipas këtij punimi, janë marrë në studim Vendimet Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 932, dt. 22.06.2000, nr. 24, dt. 13.03.2002, nr.1, dt. 24.03.2005, nr. 6, dt. 24.01.2007, nr. 5, dt. 20.01.2009 dhe Vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 32 dt. 12.04.2001, nr.8, dt. 26.03.2004, nr. 9, dt. 01.04.2005, nr. 13, dt. 09.03.2006, nr. 67, dt. 08.10.2002, nr.76, dt.09.10.2002, nr. 4, dt. 01.02.2006, nr.39, dt. 14.11.2003, nr. 41, dt. 13.11.2003, nr. 15, dt. 15.03.2002, nr. 17, dt. 15.03.2002, nr. 36, dt. 30.05.2002, nr.42, dt. 28.06.2002, nr.71, dt. 08.10.2002, nr. 84, dt. 13.11.2002, nr. 23, dt. 13.04.2002.

urdhëruese të parashikuara në ligje të tjera. c) Për shkaqe të tjera të pavlefshmërisë të parashikuara nga neni 92 i Kodit Civil, pikat e tjera: b, c, d.

Shkaqet e këtyre pavlefshmërive lidhen me qëllimin e palëve, objektin e kontratës, legjitimitetin e palëve dhe formën e kontratës.

Raporti midis shkaqeve që shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të veprimeve juridike, në formë grafike, paraqitet si më poshtë:



Veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm, i kryer në kundërshtim me ligjin dhe në mashtim të ligjit, vërtet është nul dhe nuk sjell asnjë pasojë juridike të dëshiruar nga palët, por kjo nuk do të thotë se ai nuk ka sjellë pasoja të tjera faktike. Në këtë rast, veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk sjell dhe është i paaftë të sjellë ato pasoja që palët kanë synuar nëpërmjet tij, p.sh., kalimi i pronësisë së pasurisë së paluajtshme pa aktin noterial. Neni 106 i Kodit Civil nuk u referohet pasojave që kanë dëshiruar palët, nëpërmjet veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm, por pasojave të tjera faktike, që kanë ardhur nga veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm, pra, asaj çka kanë shkëmbyer palët midis tyre. Pra, në rastin e veprimeve juridike absolutisht të

pavlefshme, ndeshemi me dy lloje të ndryshme pasojash, ato që palët kanë synuar dhe ato që kanë ardhur realisht nga veprimi. Në rastin e dytë, gjykata duhet të zgjidhë pasojat me anën e kthimit në të ardhurat e shtetit të çdo gjëje që palët kanë përfituar nga ky veprim juridik, që konstatohet absolutisht i pavlefshëm, pasi vjen në kundërshtim të ligjit apo është bërë në mashtrim të ligjit.

Aktualisht, praktika gjyqësore, për pasojat e pavlefshmërisë së veprimeve juridike relativisht të pavlefshme është e konsoliduar tashmë dhe nuk ka nevojë për unifikim, pasi nuk jemi para praktikave të ndryshme gjyqësore në lidhje me zgjidhjen e pasojave të këtyre veprimeve. Vetë Kodi Civil i ka përcaktuar rastet e ndryshme të shkaktimit të pavlefshmërisë relative të veprimeve juridike dhe zgjidhjen e pasojave të tyre, si dhe shpërblimin e dëmit. Ndërsa, në rastin e pavlefshmërisë absolute sipas këtij Kodi, nuk kemi një praktikë të unifikuar, pasi gjykata, në disa raste, shprehet thjesht për konstatim të pavlefshmërisë, duke qenë se veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm trajtohet nul pa pasoja juridike dhe në disa raste, gjykata shprehet dhe për zgjidhjen e pasojave.

Duke qenë se praktika gjyqësore, lidhur me veprimin juridik absolutisht të pavlefshëm, në raste të ngjashme ka mbajtur qëndrime të ndryshme, është arritur në konkluzionin se, është rasti për njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me veprimin juridik absolutisht të pavlefshëm, mjetet e mbrojtjes juridike, llojin dhe natyrën e padisë që mund të ngrihet nga palët, si dhe zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë trajtuar rastin me palë paditëse⁴⁴⁶: Shoqëria “Dinamika” sh.p.k, të paditur: H. C. dhe Komuna Finiq, me objekt: “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes, datë 09.12.2003 dhe

⁴⁴⁶ Vendimi nr. 5, datë 30.10.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

kontratës së shitjes numër 512, datë 10.12.2003, lidhur midis palës së paditur, Komuna Finiq dhe H. C”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka pranuar kërkesë padinë⁴⁴⁷. Gjykata e Apelit Gjirokastër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë⁴⁴⁸. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka ngritur për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara, për efekt të njësimit të praktikave të ndryshme gjyqësore, këto çështje:

- Nëse kërkitimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik duhet patjetër të bëhet gjatë gjykimit në themel të një çështjeje, pra, i shoqëruar në çdo rast nga një çështjeje themeli apo mund të paraqitet para gjykatës, edhe si kërkim më vete.
- Në rastin e konstatimit nga gjykata të pavlefshmërisë së veprimit juridik, zgjidhja e pasojave të pavlefshmërisë duhet të bëhet kryesisht nga gjykata apo vetëm mbi bazën e një kërkesë të palëve pjesëmarrëse në një veprim juridik.

Kolegjet e Bashkuara, në funksion të këtij unifikimi, kanë arritur në konkluzion se, veprimi juridik që është i pavlefshëm, mund të merret parasysh nga gjykata edhe kryesisht pa u kërkuar nga palët e interesuara, madje edhe kundër vullnetit të tyre. Për konstatimin e një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm, nuk është e nevojshme paraqitja e një kërkesë të posaçme, qoftë kjo padi apo kundërpadi, pasi kjo lloj pavlefshmërie konstatohet kryesisht pavarësisht nga paraqitja në gjykatë e kërkesës. Pavlefshmëria absolute mund të kërkohej në gjykatë nga çdo palë ndërgjyqëse që ka interes.

⁴⁴⁷ Vendimi nr. 841, datë 06.10.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. “Pranimin e kërkesë padisë së palës paditëse “Dinamika” sh.p.k. Pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes, më datë 09.10.2003 dhe kontratës së shitjes nr.634/512, datë 10.12.2003, të lidhur midis palës së paditur Komunes Finiq dhe të paditurit H. C”.

⁴⁴⁸ Vendimi nr. 47, datë 20.02.2007, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, nuk mund të bëhet si një kërkim më vete thjesht konstatim; ai gjithnjë duhet të bëhet gjatë gjykimit në themel të një çështjeje nga gjykata ose si kërkim konstatim i pavlefshmërisë, që shoqëron kërkesën për zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm. Pasojat e ardhura nga përmbushja e një veprimi absolutisht të pavlefshëm, zgjidhen vetëm mbi bazën e kërkesës së palëve ndërgjyqëse për zgjidhjen e pasojave dhe në rastin tjetër kur gjykata konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik kryesisht, zgjidh vetëm ato pasoja që janë objekt i kërkimit të bërë nga palët brenda objektit të padisë apo kundërpadisë, pa u shprehur për pasojat, për të cilat nuk ka një kërkesë konkrete nga palët ndërgjyqëse. Ky fakt nuk i pengon palët apo personat e tretë, që të kërkojnë në një tjetër gjykim, zgjidhjen e atyre pasojave të pakërkuara, për të cilat gjykata nuk është shprehur me një vendim, pasi gjykata, në këtë rast, është shprehur vetëm për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të veprimit juridik. Në lidhje me këto çështje, gjykatat shqiptare mbajnë qëndrime të ndryshme dhe jo të unifikuara.

Nga studimi i kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, dhe analizës statistikore e krahasimore të vendimeve gjyqësore, nuk rezultuan raste që gjykata të konstatonte kryesisht pavlefshmërinë absolute, edhe pas daljes së vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili arsyeton në funksion të konstatimit kryesisht të pavlefshmërisë absolute nga gjykata.

Tërësia e dispozitave ligjore, që rregullojnë pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, e përcaktojnë atë si një veprim i cili, për shkak të shkeljes së ligjit ose për shkaqe të tjera të përcaktuara në legjislacion, nuk ka fuqi juridike dhe është i paaftë të sjellë pasojat juridike të synuara nga palët. Pra, veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm:

- Nuk ka fuqinë e një veprimi juridik të vlefshëm.

- Nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim juridik të mëvonshëm, edhe po të ekzistojë vullneti i palëve.
- Nuk shkakton pasoja juridike të synuara nga palët.
- E drejta për kërkimin e pavlefshmërisë absolute, të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm, nuk parashkruhet.

Kur ekzekutohet një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, ai prodhon efekte, të cilat janë të ndryshme nga efektet apo pasojat e dëshiruara nga palët në një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm. Pikërisht këto efekte, të prodhuara nga një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, rregullohen nga gjykata. Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet⁴⁴⁹. Në nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj”. Pra, sipas këtyre përcaktimeve ligjore, gjykata nuk duhet të dalë dhe të shprehet me një vendim gjyqësor jashtë kërimit të bërë në kërkesë padi. Në këtë rast, gjykata nëse shprehet dhe për zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute, pa kërkesë të palës ose tej asaj çka është kërkuar nga pala, nuk bën gjë tjetër veçse zëvendëson padinë e ngritur me një padi tjetër. Në këtë rast, gjykata ndërhyr në vullnetin dhe pushtetin e palëve, duke ndryshuar elementet e padisë e duke u ofruar palëve një marrëdhënie dhe një zgjidhje tjetër nga ajo e kërkuar, bazuar në fakte të ndryshme apo në një shkak ligjor të ndryshëm nga ai që palët kërkojnë në padi. Shkaku i ligjshëm është një element që identifikon padinë, pasi nuk ka padi pa një shkak. Shkaku i padisë është arsyeja e kërimit gjyqësor të palëve, ajo çka palët pretendojnë të arrijnë me këtë padi. Që padia të merret në konsideratë nga gjykata, ajo, përveç kërimit objektit, duhet të përmbajë dhe shkakun ligjor të saj.

⁴⁴⁹ Neni 6 i Kodit të Procedurës Civile.

Kërkimi drejtuar gjykatës për konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik, pa bërë të qartë të drejtën dhe cenimin që i është bërë kësaj të drejte, është një padi, që në kuptimin material nuk ekziston. Është pikërisht shkak i padisë që nënkupton cenimin e së drejtës së një subjekti dhe që e motivon këtë subjekt të vërë në lëvizje gjykatën.

Për këto arsye, është i drejtë argumenti që gjykata nuk mund të ndryshojë kërkesë padinë e paraqitur nga palët pjesëmarrëse në lidhje me një të drejtë të caktuar dhe sipas këtij argumenti, nuk mundet që vendimi gjyqësor të ketë një përmbajtje të ndryshme nga ajo që kërkohet, pasi një vendim i tillë cenon parimin procedural të përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj që vendoset.

Derisa në një gjykim nuk kërkohet dhe zgjidhja e pasojave, gjykata nuk mund të shprehet në lidhje me pasojat e ardhura nga ekzekutimi i veprimit absolutisht të pavlefshëm. Nëse jemi para faktit kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik dhe gjithashtu, zgjidh pasojat e pavlefshmërisë, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme (*restitutio in integrum*), pa kërkesë të palëve, ajo shkel parimin që drejton një proces gjyqësor, ku çdo padi është në varësi me të drejtën e kërkuar⁴⁵⁰.

Megjithatë, ka dhe raste kur konstatimi i pavlefshmërisë së një veprimi juridik bëhet kryesisht nga gjykata, edhe pse një gjë të tillë nuk e kërkojnë palët. Kjo ndodh kur jemi para shqyrtimit të një padie themeli. Pra, në rastet kur evidentohet nga gjykata, se vlefshmëria e veprimit juridik është një element i rëndësishëm i padisë së ngritur nga palët, gjykata mund të konstatojë kryesisht, gjatë gjykimit të kësaj çështjeje të themelit dhe pavlefshmërinë e këtij veprimi juridik, pavarësisht nga çka kanë kërkuar palët.

Gjithashtu, një kusht tjetër i rëndësishëm për palët në ngritjen e kërkesë padisë, është se ata duhet të gëzojnë legjitimitimin aktiv dhe pasiv, pra, në kërkimet, prapësimet dhe

⁴⁵⁰ Neni 31 i Kodit të Procedurës Civile.

pretendimet e tyre drejtuar gjykatës, palët duhet të kenë një interes të ligjshëm dhe kërkimin ta kundër drejtojnë ndaj personit që cenon këtë interes të ligjshëm. Mungesa e një interesi të ligjshëm do të thotë se, nëse padia nuk i siguron paditësit asnjë avantazh, gjykata duhet ta deklarojë atë si të papranueshme.

Në lidhje me subjektet që mund të kërkojnë pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, përse i përket shprehjes “kushdo që ka një interes”, subjektet e legjitimuar sipas kësaj shprehjeje janë personat e tretë, të cilët, pavarësisht se nuk kanë nënshkruar kontratën, apo nuk kanë pasur dijeni për të, kanë interes legjitim në këtë kërkim për konstatimin e pavlefshmërisë.

Pavlefshmëria e veprimit juridik dhe zgjidhja e pasojave të saj, mund të kërkohej si nëpërmjet padisë, prapësimit, ashtu dhe kundërpadisë, kjo në varësi të pozitës procedurale të palës si paditës apo i paditur. Kundërpadia mund të paraqitet në një proces gjyqësor të filluar ose mund të paraqitet në një gjykim të veçantë⁴⁵¹. Gjykata është e detyruar të zgjidhë mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi⁴⁵². Ajo mund të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa prekur kërkesën, pretendimet e qëllimet e palëve në një proces gjyqësor.

Ky element vërehet dhe në praktikën gjyqësore italiane, ku i jepet rëndësi analizës së gjykatës. Seksionet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit sqarojnë se, në kontekstin e bashkëpunimit midis gjyqtarit dhe palëve, gjyqtari orienton, saktëson dhe vë në dijeni

⁴⁵¹ Këtë qëndrim ka mbajtur vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 4, datë 01.02.2006.

⁴⁵² Neni 16 i Kodit të Procedurës Civile.

palët për çështjet që mund të zgjidhen kryesisht, ndër të cilat përfshihet dhe nuliteti i kontratës⁴⁵³.

Gjykata, në zbatim të nenit 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile, është e detyruar të shprehet për gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet. Në këtë arsyetim, gjatë gjykimit të një padie themeli, edhe nëse nuk ka një kërkim të veçantë për pavlefshmëri, dhe gjykata kryesisht konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik, ajo zgjidh pasojat vetëm për çka është kërkuar në objektin e kërkesë padisë së themelit, por jo tej këtij objekti. Është paditësi ai që, me kërkimet dhe pretendimet e tij, në çdo rast, orienton gjykatën dhe i tregon asaj bazën mbi të cilën duhet të vendosë. Sikurse paditësi, edhe i padituri ka të drejtë të parashtrojë faktet dhe pretendimet e tij. Të dyja palët janë aktive gjatë procesit dhe janë aktorët kryesorë të mbarëvajtjes së një gjykimi dhe të dhënies së vendimit. I padituri të drejtat e tij i realizon nëpërmjet prapësimit dhe kundërpadisë. Ngritja e një prapësimi në gjykim zgjeron lëndën e çështjes në shqyrtim, duke përfshirë fakte të reja nga ato të ngritura nga paditësi, por nuk ndryshon kufijtë e objektit të padisë. Pra, gjykata, gjatë shqyrtimit të një padie themeli, edhe kur konstaton kryesisht pavlefshmërinë e veprimit juridik, i zgjidh pasojat vetëm brenda objektit të padisë.

Edhe në praktikën gjyqësore italiane vihet re konstatimi kryesisht i nulitetit pa u kërkuar nga palët⁴⁵⁴. Në gjyqësorin italian është ngritur për diskutim problemi, nëse nuliteti mund të zgjidhet kryesisht, jo vetëm kur është kërkuar anulimi i kontratës, por edhe kur kërkohet përmbushja e kontratës. Në këtë rast, duket sikur fuqia e gjykatësit rritet, pasi zgjidhja kryesisht ka si qëllim të forcojë dhe të mbrojë një interes të ndryshëm dhe superior, karshi atij të palëve. Bëhet fjalë për interesin e konstatimit kryesisht të

⁴⁵³ Seksionet e Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit, vendimi nr. 14828, datë 04.09.2012.

⁴⁵⁴ Seksionet e Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit Italian, vendimi nr. 26242 dhe 26243, datë 12.12.2014.

nulitetit, efikasiteti i të cilit shqyrtohet kur ka lidhje me objektin e kontratës, në çështjen civile në gjykim. Nëse nuliteti nuk do të kishte të bënte me një interes më të lartë se ai i palëve, nuk do të zbatohet zgjidhja kryesisht e kontratës. Në këtë arsyetim, mendimi i gjykatës është se zgjidhja kryesisht bëhet kur nuliteti është shkaktuar nga kundërligjshmëria, ashtu dhe kur nulitet është për shkak forme. Në të dy këto raste, gjykata ka si qëllim ndjekjen e një interesi mbi individual, duke garantuar dhe interesin publik. Ky arsyetim është i pranuar dhe nga doktrina, pasi nuliteti për shkak të shkeljes së normave ligjore dhe mosrespektimit të formës, e tejkalon interesin individual në marrëveshje kontraktuale⁴⁵⁵.

Një kontratë nul nuk duhet të vazhdojë të prodhojë efekte, si ndaj të tretëve, ashtu dhe ndaj palëve, për këtë arsye, organi gjyqësor duhet ta rrëzojë me zgjidhje kryesisht të kontratës. Anulimi dhe zgjidhja, nëse kërkohet nga palët, bën të njohur invaliditetin e kontratës, bazuar në një ves në gjenezë të kontratës, duke eliminuar dhe pasojat që kontrata ka prodhuar për palët. Rezultati, në këtë rast, nuk është i ndryshëm nga ai që do kishte sjellë një deklarament nuliteti kryesisht nga gjykata⁴⁵⁶.

7.2 Mjetet procedurale të mbrojtjes nga pavlefshmëria e veprimit juridik

Mjeti procedural për të kërkuar shpalljen si të pavlefshëm të një veprimi juridik është padia. Si rregull, padia për shpalljen të pavlefshëm të veprimit juridik përfshin në vetvete dy kërkime: deklarament të pavlefshëm të veprimit juridik dhe zgjidhjen e pasojës juridike, që ky veprim ka krijuar, pasi interesi legjitim i palëve në kërkesën drejtuar

⁴⁵⁵ Roppo. V, "Il Contratto, nel Trattato Ludica-Zatti", 2011:708.

⁴⁵⁶ Rizzo. N, "Accertamento Della Nullita e Azioni di Impugnazione del Contratto", Rivista-Diritto Civile Contemporaneo, Anno II, No. 1, Gennaio-Marzo, dt. 15.03.2015.

gjykatës nuk është thjesht deklarimi i veprimit juridik të pavlefshëm, por rregullimi i pasojave negative që janë krijuar për palët pjesëmarrëse të prekura nga ky veprim, i cili deklarohet i pavlefshëm. Zgjidhja e pasojave, në këtë rast, nuk cenon aspak rolin pasiv të organit të drejtësisë, pasi ajo disponon për atë çka kërkon pala në kërkesën e saj dhe që ka të bëjë me zgjidhjen e pasojave.

Pavlefshmëria mund të pretendohet nga çdo palë ndërgjyqëse, edhe ndërmjet prapësimit. I padituri, ndërmjet prapësimit në një gjykim të filluar, mund t'i kundër drejtojë paditësit arsyet, që nga pikëpamja e faktit apo ligjit i bëjnë të papranueshme kërkimet e tij të paraqitura në padi. I padituri, me anën e prapësimit, nuk del me pretendime të veçanta dhe gjykimi i çështjes kufizohet vetëm brenda kuadrit të kërtimeve të paditësit, të shprehura në objektin e padisë.

Prapësimi, në ndryshim nga kundërpadia, nuk parashkruhet. Kjo ndeshet dhe në Kodin Civil Italian, ku parashikohet se, anulimi i kontratës nuk mund të kërkohej nëse kanë kaluar pesë vjet, por veprimi mund të prapësohet edhe nëse kanë kaluar pesë vjet, në qoftë se vetëm atëherë pala tjetër kërkon ekzekutimin e kontratës⁴⁵⁷.

E ndryshme nga prapësimi është kundërpadia, e cila, jo vetëm që zgjeron objektin e hetimit gjyqësor, por edhe kufijtë e vendimit. Ajo del jashtë kufijve të padisë dhe është jo vetëm pjesë e arsytimit të vendimit gjyqësor, por dhe e dispozitivit të vendimit.

Në një gjykim ku është pranuar që, bashkë me padinë të gjykohej edhe kundërpadia, pushimi i gjykimit të padisë, pavarësisht nga shkak, nuk passjell vetvetiu edhe pushimin e gjykimit të kundërpadisë. Gjykimi i kundërpadisë mund të vazhdojë

⁴⁵⁷ Neni 1442/4 i Kodit Civil Italian.

normalisht dhe gjykata në vendimin përfundimtar, shprehet si për kërkimet e padisë, ashtu dhe për ato të kundërpadisë, si të ishin gjykuar në dy gjykime të veçanta⁴⁵⁸.

Shpallja e një veprimi juridik si të pavlefshëm, për shkak të veseve të vullnetit të palës, mund të kërkohet në çdo kohë nëpërmjet kundërpadisë. Kështu p.sh., kur paditësi kërkon me padi nëpërmjet gjykatës përmbushjen e detyrimit që i padituri ka ndaj tij, i padituri mund të kërkojë shpalljen të pavlefshëm të veprimit juridik, se ka qenë në kushtet e lajthimit.

Megjithatë, sipas qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjykata nuk mund të lejojë dhe të formulojë ndërgjyqësinë duke ngritur kundërpadinë kundër një personi të tretë, që nuk është palë në procesin gjyqësor⁴⁵⁹.

Në procesin gjyqësor midis palës paditëse shoqërisë “Cicek” sh.p.k dhe palës së paditur Portit Detar të Shëngjinit, rezulton se është lidhur një kontratë për dërgimin e një sasi mielli, një pjesë e të cilit nuk do të tërhiqej direkt, por do të magazonohej e do të mbahej në ruajtje nga Porti Detar. Shoqëria “Cicek”, duke pretenduar se këtë sasi mielli nuk e ka tërhequr ajo apo një person i autorizuar prej saj, ka ngritur padinë kundër Portit Detar për shpërblim dëmi. Porti Detar ka paraqitur një kërkesë me shkrim, që e ka quajtur kundërpadi, duke thirrur si të paditur firmën “England” sh.p.k, të cilën gjykata e ka pranuar, pasi sipas Portit Detar, kjo sasi mielli është tërhequr nga kjo shoqëri. Kolegjet e Bashkuara kanë arsyetuar se, në zbatim të nenit 21 të K.Pr.C: “Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.”.

⁴⁵⁸ Këtë qëndrim ka mbajtur Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 4, datë 01.02.2006.

⁴⁵⁹ Vendimi nr. 901, datë 21.06.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në rastin konkret, mosmarrëveshja që ka lindur midis paditësit dhe të paditurit ka të bëjë me detyrimin për pagimin e një shume, që përbën dëmin e shkaktuar dhe gjykata është e detyruar të shprehet në përfundim të gjykimit për pranimin ose mospranimin e kërkesës së paditësit ndaj të paditurve. Gjkata nuk mund të dalë jashtë kufijve proceduriale të gjykimit midis palëve dhe nuk mund të ndërtojë e të gjykojë një ndërgjyqësi të ndryshme nga ajo që kërkojnë palët, pasi cenohet roli pasiv i gjyqësorit në shqyrtimin e çështjeve. Duke mos u shprehur në lidhje me kërkimet e paditësit, gjykata e lë pa zgjidhur çështjen objekt konflikti, ndërsa duke thirrur si të paditur një palë të tretë, që nuk ka qenë objekt gjykimi, ka dalë jashtë kufijve të gjykimit, duke shkelur parimin procedural të disponibilitetit të kërtimeve të palëve.

Në këtë rast, nuk mund të ngrihej kundërpadi, pasi i padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkitur i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensim⁴⁶⁰. Gjkata, kur gjykon një padi dhe një kundërpadi, duke i bashkuar ato në një çështje të vetme, si rregull, nuk mund të thërrasë si paditës apo të paditur, persona të tjerë me kërtime të veçanta nga ato të padisë apo kundërpadisë, pasi këta persona mund të thirren për t'u bashkuar me paditësat apo të paditurit, me kërtime të përbashkëta⁴⁶¹.

Në rastin konkret, pretendimet e palës së paditur përmbajnë më shumë elementet e prapësimit, që, nëse do të vërtetoheshin nga të paditurit, atëherë çështja do të zgjidhej duke rrëzuar kërkesë padinë. Në këtë rast, gjykata duhet të vlerësonte vlefshmërinë e kontratës së shitjes si dhe nëse pronësia e mallit të shitur i ka kaluar vërtet blerësit “England” sh.p.k dhe cili është çasti i kalimit të pronësisë. Nëse rezulton se me këtë

⁴⁶⁰ Neni 160/1 i Kodit të Procedurës Civile.

⁴⁶¹ Neni 161 dhe 162 i Kodit të Procedurës Civile.

kontratë shitjeje, malli i është dorëzuar blerësit “England” sh.p.k, atëherë kontrata e depozitës, midis depozituesit firmës “Cicek” sh.p.k dhe depozitarit Portit Detar quhet e përfunduar.

7.3 Legjitimimi i palëve në ngritjen e padisë

Në një gjykim civil kontradiktor për shpalljen të pavlefshëm të veprimit juridik, ka dy palë ndërgjyqëse dhe neni 94 i Kodit Civil përdor termin “...gjykata, me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme”, ndërsa neni 95 përcakton, “...pala e mashtruar mund të kërkojë shpalljen të pavlefshëm të veprimit juridik”, pra, inicimi i gjykatës bëhet nga palët dhe gjykata nuk vepron me iniciativë.

Nëse i referohemi pavlefshmërisë së veprimit juridik të kryer si rezultat i mashtrimit, kanosjes, lajthimit, gjykatën mund ta iniciojë pala që është mashtruar, kanosur ose ka vepruar nën ndikimin e lajthimit. Duke iu referuar shprehjes, pala e interesuar, arrijmë në konkluzion se, kërkesën drejtuar gjykatës nuk mund ta bëjë pala që ka bërë lajthimin, mashtrimin, kanosjen dhe shfrytëzimin e situatës së nevojës së madhe. Gjithashtu, ky është rezultat dhe i qëllimit të ligjvënësit, për të mbrojtur vullnetin e lirë e të pandikuar të palës së dëmtuar nga këto forma të paligjshme të vesimit të vullnetit. Si kërkues në gjykatë, mund të jetë jo vetëm personi fizik, por dhe ai juridik ose përfaqësuesi i palës. Interesi për të ngritur padi është një element shumë i rëndësishëm i padisë dhe ky interes është një interes procedural, i cili shërben si instrument i përmbushjes së interesit material të palës, që është cenuar apo shkelur nga sjellja e palës tjetër apo nga gjendja faktike ekzistuese e paligjshmërisë. Interesi për të ngritur padi vjen si rezultat i marrëdhënies midis situatës së kundërligjshme të pretenduar nga pala dhe disponimit gjyqësor që kërkohet për të rregulluar pasojat e kësaj situatë të kundërligjshme.

Mungesa e një interesi të ligjshëm do të thotë se, nëse padia nuk i siguron paditësit asnjë avantazh, gjykata duhet ta deklarojë atë si të papranueshme. Çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një interes i ligjshëm apo një e drejtë, nëpërmjet padisë, objektit dhe shkakut të saj, gjatë procesit gjyqësor, duhet të identifikojë marrëdhënien juridike nga i burojnë të drejtat apo interesin ligjor të shkelur, personin që e ka cenuar në të drejtën apo interesin legjitim, veprimet apo mosveprimet e të paditurit, që i kanë mohuar apo cenuar të drejtën, si dhe të drejtën që synon të realizojë, e cila duhet të jetë konkrete dhe të ketë lindur para ngritjes së kërkesë padisë.

Në ndryshim nga kërkitimi për pavlefshmëri relative të veprimit juridik, pavlefshmërinë absolute mund ta pretendojnë një rreth më i gjerë subjektesh. Kështu, p.sh., në një çështje civile, pala paditëse ka kërkuar nga i padituri që të paguajë shumën e kontratës së shitblerjes, si dhe përqindjen e interesave, ndërsa pala e paditur ka pretenduar pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitblerjes. Gjkata ka arsyetuar se i padituri, në çdo kohë, mund të kërkojë që veprimi juridik të konstatohet absolutisht i pavlefshëm. Nuk ka asnjë rëndësi fakti, nëse i padituri është ose jo palë në kontratën e parë dhe nuk ka rëndësi nëse për kontratën e parë nuk është kërkuar pavlefshmëria e saj para gjykatës. Megjithatë, vërtet pavlefshmërinë absolute mund ta pretendojë kushdo, edhe një i tretë që nuk është palë në një veprim juridik, por ai duhet të provojë se ka një interes të ligjshëm që duhet mbrojtur⁴⁶².

⁴⁶² Neni 32 i Kodit të Procedurës Civile.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar çështjen me objekt⁴⁶³:

“Konstatimi i pavlefshmërisë së pjesshme të kontratës së dhurimit, nr.1080 rep dhe 524 kol, datë 09.10.1982. Detyrimin e të paditurës të më njohë pronar për 1/5 pjesë në një truall, shtëpi banimi”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë padie, vendosi pranimin e saj. Deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të Kontratës së Dhurimit, për 1/12 pjesë të saj. Detyrimin e palës së paditur të njohë paditësin bashkëpronar në 1/12 pjesë të saj. Gjykata e Apelit Tiranë vendosi: “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e kërkesë padisë”. Pas Rekursit dhe Kundërekursit të ushtruar nga palët ndërgjyqëse, kjo çështje kaloi për unifikim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në zbatim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, në këtë rast, edhe pse paditësi nuk është palë në kontratë, ai legjitimohet të kërkojë pavlefshmërinë e kontratës, pasi ka interes direkt dhe legjitim në çështjen objekt padie, që konsiston në njohjen pronar në këtë pasuri të dhuruar, duke qenë se është trashëgimtar i nënës së tij.

Kolegjet e Bashkuara, paraprakisht, morën në shqyrtim vendimet dhe arsyetimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke qenë se trualli është blerë pas lidhjes së martesës së prindërve të palëve ndërgjyqëse, dhe shtëpia është ndërtuar pas martesës së tyre, ajo duhet trajtuar si pasuri martesore në

⁴⁶³ Vendimi nr. 5, datë 08.01.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: Nga rrethanat e çështjes rezulton se palët ndërgjyqëse janë motër e vëlla dhe trashëgimtarë të prindërve të tyre. Babai i tyre, pasi është martuar në vitin 1936, ka blerë në vitin 1937 një kopsht, të cilin e ka regjistruar në emrin e tij, sipas akt njoftunisë dhe mbi të ka ndërtuar shtëpinë, regjistrimi i së cilës është bërë po në emër të tij. Të paditurës iu kërkua që të vinte e të jetonte në shtëpinë e prindërve më qëllim që të kujdesej për nënën e sëmurë dhe rezulton se, me vdekjen e nënës, babai, me kontratë dhurimi, ia dhuron shtëpinë vajzës së tij. Paditësi pretendon se, prindërit e tij e kanë në bashkëpronësi në pjesë të barabarta shtëpinë dhe babai nuk mund ta dhuronte atë si të ishte vetëm prona e tij.

bashkëpronësi të të dy prindërve, referuar kjo dhe Kodit Civil të 1929, që ishte në fuqi në momentin e fitimit të kësaj pasurie. Sipas arsyetimeve të Gjykatës së Apelit, prona e dhuruar është vetëm kontribut i dhuruesit të saj, gjë që vërtetohet dhe nga “akti i njoftunisë”. Gjithashtu, kjo gjykatë ka konstatuar se, që nga momenti i përpilimit të kontratës së dhurimit dhe deri në ngritjen e padisë, kanë kaluar 27 vjet dhe sipas nenit 114 të Kodit Civil, kjo padi është parashkruar.

Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, nga gjykatat e shkallëve më të ulëta i janë bërë interpretime të ndryshme Kodit Civil të 1929, herë e trajtojnë si pasuri bashkëshortore çdo gjë që është fituar pas martesës dhe herë e trajtojnë si pronë të bashkëshortit në emër të të cilit është blerë apo regjistruar.

Në Kodin Civil të 1929, regjimi juridik i pasurisë martesore është përcaktuar në titullin e III “Kontrata e Martesës”⁴⁶⁴. Sipas këtij Kodi, pasuria e vënë gjatë martesës, nuk konsiderohet si pasuri në bashkëpronësi vetëm për shkak të martesës, kjo për faktin se, secili bashkëshort, gjatë martesës, kishte të drejtë të kishte pasuri ekskluzive të tij të luajtshme dhe të paluajtshme, si “Dota”, “Pasuria parafernale” dhe “Bashkëpasunimi midis bashkëshortëve”⁴⁶⁵. Sipas Kodit Civil të vitit 1929, kur mungojnë pakte të posaçme të hartuara me akt publik të Noteri para martesës dhe prona e vënë gjatë martesës figuron në emrin e njërit prej bashkëshortëve, kjo pronë i takon bashkëshortit në emrin e së cilit është regjistruar⁴⁶⁶.

Kolegjet e Bashkuara, në rastin konkret, arsyetojnë se, përderisa mungojnë pakte të posaçme të hartuara me akt publik para Noterit dhe para martesës, trualli dhe shtëpia

⁴⁶⁴ Nenet 1321-1389 të Kodit Civil të 1929.

⁴⁶⁵ Nenet 1331, 1368, 1376 të Kodit Civil të 1929.

⁴⁶⁶ Neni 1377-1378 të Kodit Civil të 1929. Ekzistenca e titullit të pronësisë, vetëm në emër të njërit prej bashkëshortëve është provë që pronësia mbi këtë send nuk është rezultat i fitimeve të bashkëpasunimit dhe për pasojë pronësia i mbetet atij bashkëshorti, që ka titullin e pronësisë.

figurojnë të regjistruara në emër të S. A., ajo është pasuri e vënë me të ardhurat personale vetëm të tij. Duke qenë se trualli objekt i kontratës së dhurimit ka qenë vetëm në emër të S. A., edhe disponimi që ka bërë ky pronar i vetëm dhe i ligjshëm nëpërmjet kontratës së dhurimit, është një veprim juridik i vlefshëm, pasi nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arsyetojnë se, nga ana e Gjykatës së Apelit është arsyetuar gabim në lidhje me faktin që padia është parashkruar. Sipas qëndrimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara “Pavlefshmëria absolute konstatohet nga gjykata edhe kryesisht, duke zgjidhur pasojat në padinë që po gjykon”⁴⁶⁷.

Pala paditëse, edhe pse nuk është palë në kontratën e shitblerjes legjitimohet në ngritjen e padisë, pasi në zbatim të disponimeve të bëra në nenin 32 të Kodit të Procedurave Civile, ka interes legjitim që i është cenuar. Padia e njohjes së bashkëpronësisë është një padi që nuk parashkruhet, për këtë arsye, qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Apelit Tiranë, në rastin konkret, është i gabuar⁴⁶⁸. Gjykata e ka trajtuar gabim si padi për shpalljen e pavlefshmërisë relative të veprimit juridik, pasi, në një rast të tillë, veprimi është në gjendje të krijojë pasoja juridike të dëshiruara deri në momentin, që kërkohet gjyqësisht nga palët, nëpërmjet kërkesë padisë, brenda afatit të parashkrimit, anulimi i këtij veprimi juridik dhe zgjidhja e pasojave. Kjo nuk mund të bëhet kryesisht nga gjykata dhe kjo lloj padie parashkruhet. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e

⁴⁶⁷ Këtë qëndrim kanë mbajtur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 13, datë 09.03.2006. Në rastin konkret, padia është ngritur për njohjen e bashkëpronësisë në një pasuri të paluajtshme bashkëpronësi, e cila pretendohet se është mohuar me një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm. Pra, është kontrata e dhurimit si veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, e cila ka cenuar të drejtën e bashkëpronësisë së palës paditëse në këtë proces.

⁴⁶⁸ Neni 113 i Kodit Civil të 1994.

konsideruan kontratën e dhurimit si një veprim juridik të vlefshëm, të hartuar në zbatim të ligjit, pasi ka disponuar pronari i vetëm i kësaj pasurie.

Nëse gjykatës i drejtohet një kërkesë për pavlefshmërinë e veprimi juridik dhe pala e ka transkriptuar pronën te një i tretë, atëherë padia do të ketë përsëri si të paditur palën me të cilën është kryer veprimi juridik i pavlefshëm, ndërsa personi i tretë, të cilit i ka kaluar sendi me këtë veprim juridik të pavlefshëm, duhet të thirret si palë, në cilësinë e personit të tretë.

7.4 Parashkrimi i padisë për pavlefshmërinë e veprimit juridik

Padia për shpalljen të pavlefshëm të veprimit juridik, parashkruhet me kalimin e afatit pesë vjeçar. Pra afati i parashkrimit për shpalljen e pavlefshmërisë relative është një afat i posaçëm, në dallim nga afati i përgjithshëm i parashkrimit të padive, i cili është dhjetë vjeçar⁴⁶⁹.

Nëse i referohemi parashikimit të bërë në nenin 103 të Kodit Civil, për afatin pesëvjeçar të parashkrimit të padisë për shpalljen e veprimit juridik të pavlefshëm, kuptohet se ky afat pesëvjeçar i referohet pavlefshmërisë relative, pra, veprimeve të anulueshme. Gjithashtu, në legjislacion parashikohet edhe momenti nga i cili fillon afati për ngritjen e padisë sipas rrethanave dhe fakteve konkrete, që karakterizojnë veprimin juridik të pavlefshëm⁴⁷⁰. Pra, nëse u referohemi dispozitave ligjore shohim se, nuk parashikohet një afat i posaçëm për parashkrimin e padisë, në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë

⁴⁶⁹ Neni 114 i Kodit Civil të 1994.

⁴⁷⁰ Për veprimet juridike të pavlefshme të kryera nga persona, të cilëve u është hequr apo kanë pasur zotësi të kufizuar për të vepruar, afati i parashkrimit të padisë fillon nga dita që këta persona janë bërë madhore apo iu është kthyer zotësia për të vepruar me vendim gjykate. Për veprimet juridike të kryera në mashtrim, kanosje apo lajthim afati i parashkrimit fillon që nga dita që mashtrimi apo lajthimi u zbulua ose kanosja ka pushuar, por jo më vonë se tre vjet nga dita që është kryer veprimi juridik.

absolute të veprimit juridik. E drejta e pronësisë, në çdo kohë, i takon pronarit, edhe nëse pasuria mund të jetë transkriptuar në bazë të një veprimi juridik të pavlefshëm apo të mbahet padrejtësisht në mënyrë të paligjshme nga poseduesi jopronar. Padia për kërkimin e sendit, e ngritur nga pronari joposedues kundrejt poseduesit jopronar është një padi e paparashkrueshme⁴⁷¹.

Sipas qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vlerësohet se⁴⁷²: “paparashkrueshmëria e padisë së rivendikimit ka kuptim që ajo mund të ngrihet kurdoherë, pavarësisht nga periudha që ka kaluar, që nga çasti kur pronari i sendit nuk e ushtron posedimin mbi të dhe aq kohë sa e drejta e pronësisë mbi këtë send të mos ketë kaluar për ndonjë shkak tjetër ligjor te ndonjë subjekt tjetër, si në rastin e parashkrimit fitues”.

Gjatë gjykimit të një padie themeli, gjykata mund të shqyrtojë dhe të konstatojë pavlefshmërinë e veprimit juridik nëpërmjet të cilit është përfituar pasuria nga njëra prej palëve në gjykim. Pronësia nuk mund të humbasë nga mospërdorimi, edhe sikur pronari të mos e ketë përdorur sendin e vet për një kohë të gjatë. Nëse do të pranohej parashkrimi i padisë së rivendikimit, kjo mund të sillte një situatë ku pronari të cenohej dhe të mos kishte mundësi të ushtronte të drejtat e tij mbi sendin, për shkak të kalimit të afatit, ndërsa poseduesit jopronar, ndoshta dhe në keqbesim, do t'i krijohesh mundësia për të gëzuar i qetë sendin dhe për t'u bërë pronar në bazë të parashkrimit fitues.

Nga ana tjetër, parashkrimi fitues (me titull apo pa titull), është një nga mënyrat e fitimit të pronësisë⁴⁷³. Nëse plotësohen kushtet e parashikuara në këto dispozita ligjore, padia e rivendikimit rrëzohet, por kjo jo për shkak të parashkrimit shues, por pasi kjo mënyrë

⁴⁷¹ Neni 296 i Kodit Civil të 1994.

⁴⁷² Vendimi nr. 5, datë 31.05.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁴⁷³ Nenet 168 dhe 169 të Kodit Civil të 1994.

fitimi pronësie përbën shkakun ligjor që pronari i mëparshëm i sendit humbet të drejtën e tij të pronësisë mbi sendin. Sipas këtij argumentimi, vlerësohet se në këto raste nuk është parashkrimi i së drejtës së padisë shkak i rrëzimit të padisë, por është fakti se paditësi e ka humbur të drejtën e tij të pronësisë, për shkak se i padituri ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues.

7.5 Rregullimi i pasojave të nulitetit absolut (rast përjashtimor në praktikën gjyqësore)

Veprimet juridike absolutisht të pavlefshme, në rastin kur vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, vërtete janë nul dhe nuk sjellin asnjë pasojë juridike, por kjo nuk do të thotë se ato nuk kanë krijuar pasoja juridike për palët dhe personat e tretë. Këto veprime nuk mund të sjellin pasojat e dëshiruara për palët dhe janë nul, por realisht ato kanë sjellë pasoja juridike. Veprimet juridike absolutisht të pavlefshme, të kryera në kundërshtim me ligjin apo në mashtrim të ligjit, nuk bëhen të vlefshme me asnjë veprim juridik të mevonshëm. Në praktikën gjyqësore ka raste kur është mbajtur një qëndrim i ndryshëm në lidhje me këtë çështje.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁴⁷⁴, në lidhje me fitimin e pronësisë nga Sindikatat e Pavarura, në bazë të dekretit të Presidentit, nr. 204, datë 05.06.1992, kanë arsyetuar se, duke qenë që ky dekret nuk është kundërfirmuar nga Kryeministri dhe nuk është miratuar nga Kuvendi, nuk ka fuqi juridike, është nul. Për rrjedhojë, edhe çdo marrëveshje që kanë bërë sindikatat për disponimin e pasurisë, është nul. Sindikatat e Pavarura, në këtë rast, janë bërë pronare nëpërmjet një akti që vjen në kundërshtim me

⁴⁷⁴ Vendimi nr. 5, datë 23.03.2004, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

ligjin, për këtë arsye, ky veprim është absolutisht i pavlefshëm dhe kjo ngelet pronë ekskluzive e shtetit.

Në këtë rast, në lidhje me mosmarrëveshjet midis Sindikatave të Pavarura dhe ish-pronarëve është argumentuar se, Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e kanë ushtruar veprimtarinë e tyre mbi bazën e ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, pasi nuk mund të zbatonin një dekret që nuk kishte fuqi ligjore. Dekreti nr. 204 nuk legjitimonte kalimin e pronësisë nga shteti te Bashkimi i Sindikatave, për këtë arsye, është nul dhe në këtë rast, ish-pronarët kanë prioritet në lidhje me pronat e tyre përfituar nga ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.

Pavarësisht se veprimet juridike, të cilat vijnë në kundërshtim me dispozitat ligjore janë nul dhe nuk sjellin asnjë pasojë juridike, në këtë rast, vërejmë se, vetë ligji ka ndërhyrë për rregullimin e pasojave të një veprimi juridik nul. Me ligjin nr. 8340, datë 06.05.1998, “Për mosmiratimin e dekretit nr. 204, datë 05.06.1992”, është lënë pa fuqi ligjore ky dekret, ndërsa me ligjin 8340/1, datë 06.05.1998, “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr. 204, datë 05.06.1992, është tentuar nga ligjvënësi që të rregullohen pasojat që ka sjellë ky dekret. Kjo pasi, ligjvënësi, duke ditur situatat që ishin krijuar, faktin që ai kishte sjellë pasoja dhe që Sindikatat e Pavarura kishin vepruar në mirëbesim, ka dashur të rregullojë pasojat me ligjin 8340/1. Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë se, rregullimi sipas këtij ligji, iu referohet vetëm atyre pasojave që nuk cenojnë të drejtën e pronësisë së ish-pronarëve, pasi ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” shfuqizon çdo ligj që vjen në kundërshtim me të⁴⁷⁵.

Pra, ligji 8340/1 nuk ka të bëjë me të drejtat e fituara nga ish-pronarët, por vetëm me pasuritë e tjera, të cilat janë disponuar nga Sindikatat e Pavarura dhe kanë sjellë pasoja

⁴⁷⁵ Këtë qëndrim ka mbajtur vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lart nr. 85, viti 2001.

juridike, si rezultat i këtyre disponimeve të bëra. Ligji 8340/1 bën një kapërcim dhe një rregullim të pasojave të shkaktuara nga një akt juridik nul, duke u shprehur se prona u ngelet sindikatave, kur Komisioni i Kthimit të Pronave nuk kishte disponuar në favor të ish-pronarëve, deri në hyrjen në fuqi të ligjit 8340/1. Ky rregullim që bën ligji është një përjashtim, pasi i jep vlerë një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm, i cili, sipas legjislacionit dhe doktrinës nuk mund të efektojë pasoja dhe të bëhet i vlefshëm, me asnjë veprim të mëvonshëm.

7.6 Vlefshmëria e dhurimit midis bashkëshortëve në raport me bashkëpronësinë, dhe vlefshmëria e dhurimit të së drejtës së parablerjes

Në praktikën gjyqësore të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është ngritur për diskutim pyetja, se çfarë vlere ka kontrata e dhurimit e lidhur midis bashkëshortëve në raport me bashkëpronësinë. A konsiderohet sendi i dhuruar në këtë rast pronë ekskluzive e njërit bashkëshort, duke nënkuptuar se bashkëshorti tjetër jep pëlqimin e plotë për çdo veprim, që bashkëshorti përfitues kryen me atë pronë, duke përfshirë edhe tjetërsimin e saj apo ky është një veprim juridik fiktiv, që nuk ka sjellë asnjë pasojë lidhur me statusin e bashkëpronësisë së pronës së bashkëshortëve, pavarësisht disponimit që bën njeri bashkëshort karshi bashkëshortit tjetër?

Kolegjet e Bashkuara, në lidhje me këtë çështje arsyetojnë se⁴⁷⁶: “Shkaku i kontratës së dhurimit është qëllimi, për t’i sjellë dobi ekonomike palës tjetër, pa ndjekur asnjë përfitim si shkëmbim. Nëse do të pranohej kthimi i një pjese të sendit të dhuruar dhuruesit, kjo do të ndryshonte shkaku të kontratës së dhurimit, elementin psikologjik të saj, duke vënë në dyshim vullnetin e dhuruesit”.

⁴⁷⁶ Vendimi nr. 3, datë 01.02.2006, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në rastin e dhurimit midis bashkëshortëve, të sendeve vetjake të bashkëshortit dhurues apo sende të bashkëpronësisë, sendi i dhuruar do të kalojë në pasurinë vetjake të bashkëshortit përfitues, pra, këto sende nuk bëjnë më pjesë në bashkëpronësinë midis bashkëshortëve. Titullar i sendit të dhuruar është vetëm bashkëshorti përfitues i dhurimit. Sendi i përfituar nuk bën pjesë në bashkëpronësinë bashkëshortore dhe bashkëshorti pronar mund ta tjetërsojë atë, pa marrë pëlqimin e bashkëshortit tjetër.

Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë marrë në shqyrtim çështjen me objekt⁴⁷⁷: “Konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit, nr. 2670/954, datë 05.08.1995, duke urdhëruar ZVRPP të bëjë çregjistrimet përkatëse”.

Në Kolegjet e Bashkuara është shtruar për diskutim çështja nëse kontrata e dhurimit në ligjin tonë është konsideruar, në çdo kohë, si e drejtë reale që quhet e lidhur në momentin e dorëzimit të sendit. Dhurimi nuk mund të përmbajë veçse pasurinë e tashme të dhuruesit. Në qoftë se përfshin pasurinë e ardhshme, dhurimi është i pavlefshëm përse i takon kësaj⁴⁷⁸. Dispozitat e Kodit Civil parashikojnë se dhurimi është një kontratë, me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi, pa shpërblim, palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat ajo i pranon⁴⁷⁹.

Në lidhje me këtë çështje dhe në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arsyetuar se: “e drejta e parablerjes së ish-pronarit dhe e drejta e kompensimit konsiderohen të drejta reale të krijuara me ligj dhe si të tilla, ato mund të disponohen me anën e kontratës së dhurimit. Në këtë rast, një kontratë e tillë konsiderohet e vlefshme”. Kontrata e dhurimit është konsideruar kontratë

⁴⁷⁷ Vendimi nr. 23, datë 13.03.2002 dhe datë 01.04.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁴⁷⁸ Neni 762 i Kodit Civil të 1994. Në rastin konkret, shtetases S. B., i është njohur, me vendimin e K.K.K.P., e drejta e pronësisë në 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore të ish-pronarit. Kjo shtetase, 1/7 pjesë të pasurisë së saj trashëgimore, duke përfshirë dhe të drejtën e parablerjes, ia dhuron shtetasit H. B.

⁴⁷⁹ Neni 761/1 i Kodit Civil të 1994.

reale, në kuptimin që, e drejta e pronësisë kalon në çastin e dorëzimit të sendit që përbën objektin e saj. Nga kjo bën përjashtim rasti kur ndodh që objekt i kontratës së dhurimit nuk janë sendet, por të drejta të tjera reale mbi sendet. Në këtë rast, kontrata e dhurimit merr karakter konsensual, pra, quhet e lidhur që në momentin që dhuruesi të ketë shprehur në formën e kërkuar nga ligji, vullnetin e tij për të bërë dhurimin dhe pranuesi të ketë shprehur vullnet për pranimin e këtij dhurimi, në të njëjtën formë.

7.7 Funkzioni i transkriptimit të veprimeve juridike në regjistrat e pasurive të paluajtshme

Regjistrimi i kontratave në regjistrat publikë ka efekt deklarativ dhe njohës, pasi transkriptimi apo regjistrimi bën të njohur për të tretët, faktin që pronari i pasurisë së paluajtshme ka një titull pronësie të regjistrueshëm, sipas nenit 192 dhe 193 të Kodit Civil. Regjistrimi ka vlerë deklarative dhe nuk ka vlerë krijuese. Regjistrimi nuk siguron vlefshmërinë dhe efikasitetin e titullit të pronësisë. Ky sistem siguron vetëm faktin që shitësi figuron si pronar në bazë të të dhënave të regjistrimit, por nuk garanton, në mënyrë absolute, vlefshmërinë e të drejtës së pronarit dhe se ky i fundit është pronar i ligjshëm. Kjo pasi, sistemi i regjistrimit nuk krijon të drejta, por është një sistem i publikimit deklarativ⁴⁸⁰. Regjistrimi garanton prioritetin në kohë, që nënkupton se akti që regjistrohet i pari në regjistrin publik ka vlerë mbizotëruese⁴⁸¹. Regjistrimi nuk është element vlefshmërie dhe kusht për fitimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme. Regjistrimi nuk eliminon nulitetin apo pavlefshmërinë e veprimit juridik të regjistruar në regjistrin publik.

⁴⁸⁰ Neni 5 i ligjit nr. 33, datë 21.03.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

⁴⁸¹ Neni 37 i ligjit nr. 33, datë 21.03.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Edhe legjislacioni italian i bën të njëjtin trajtim transkriptimit të kontratës ⁴⁸².

Transkriptimi është trajtuar si mjeti i nevojshëm për të dhënë publicitetin e kontratës ose për ta bërë të njohur për të tretët, pasi kontrata, edhe pa u transkriptuar është e vlefshme dhe krijon efekte midis palëve: “Me formën e kontratës nuk duhet të ngatërrojmë një formalitet tjetër të zakonshëm në lidhjen e kontratës, që është transkriptimi në regjistrat e posaçëm publikë” (Galgano. F, “E Drejta Private”, 1999:257).

Sipas legjislacionit italian, nëse shumë persona blejnë, me anën e kontratave të njëpasnjëshme, të njëjtin send nga i njëjti person, vlerë mbizotëruese ka ai, i cili e ka transkriptuar kontratën edhe po të ketë qenë i fundit që e ka blerë sendin. Ky person mund të kundërshtojë blerjen e personave të tjerë dhe këta persona, megjithëse e kanë fituar më parë sendin, nuk mund ta kundërshtojnë kontratën e tij, sepse e kanë transkriptuar më vonë ⁴⁸³. Pra, sipas këtij arsyetimi, një person që e bën publike kontratën e tij, ka përparësi karshi çdo kontrate tjetër, pasi në këtë moment bëhet i njohur për të tretët fakti që kjo pasuri është e personit në favor të të cilit është regjistruar kontrata.

Edhe në legjislacionin tonë njihet “Përparësia në regjistrim”, konkretisht parashikohet: “Përparësia në regjistrim përcaktohet në varësi nga radha e paraqitjes, në mënyrë të përshtatshme të dokumentave të tyre te regjistruesi, pavarësisht nga data e përpilimit të tyre. Regjistruesi nuk mund të pranojë asnjë regjistrim të ri të një pasurie të paluajtshme, nëse për këtë pasuri ka një regjistrim të mëparshëm të një titulli”⁴⁸⁴.

⁴⁸² Neni 2643 dhe 2683 i Kodit Civil Italian.

⁴⁸³ Neni 2644 i Kodit Civil Italian.

⁴⁸⁴ Neni 37 i ligjit 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Pra, sipas këtij arsyetimi, dokumenti që paraqitet i pari për regjistrim ka përparësi karshi të tjerëve dhe gjithashtu pronari, në këtë rast, e bën të njohur pronësinë e tij karshi të tretëve si dhe fiton të drejtën për ta transkriptuar atë.

Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme⁴⁸⁵.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë marrë në shqyrtim çështjen gjyqësore me objekt⁴⁸⁶: “Detyrimin e të paditurve të më lirojnë banesën time të blerë me kontratën e shitblerjes numër 225 kol, datë 25 04.1998, si dhe detyrimin e tyre të më njohin si pronar të ligjshëm të kësaj banese”. Nga të dhënat e nxjerra nga dosja gjyqësore, rezulton se paditësi ka blerë nga F. N. dhe T. N., me kontratën e mësipërme, një shtëpi banimi. Paditësi Gj. N. nuk e ka regjistruar këtë kontratë pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme.

Në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, janë shtruar për diskutim këto çështje:

1. Cili është interpretimi ligjor i nenit 83 të Kodit Civil?
2. Regjistrimi i aktit noterial të sendit të paluajtshëm, është kusht pa të cilin nuk mund të fitohet pronësia mbi sendin?
3. Nëse mund të ngrihet padi për të drejtat reale nga personi që pretendon se ka titull pronësie të ligjshëm mbi sendin e paluajtshëm, por që nuk e ka të regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme?

Në çështjen objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, ka disa dispozita të Kodit Civil, të cilat bien ndesh me njëra-tjetrën; në këto kushte, është i nevojshëm unifikimi i praktikës gjyqësore. Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe

⁴⁸⁵ Neni 195 i Kodit Civil të 1994.

⁴⁸⁶ Vendimi nr. 1, datë 06.01.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht në ligj⁴⁸⁷.

Në zbatim të kësaj dispozite, ngrihen për diskutim disa probleme: a) Cilat janë kushtet për vlefshmërinë e veprimit juridik? b) Cili do të konsiderohet si moment i fitimit të pronësisë, momenti i nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nga palët para Noterit apo ai i regjistrimit të pronës pranë regjistratit përkatës të pasurive të paluajtshme? c) Cili është efekti i regjistrimit të kontratës së tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme? d) Çfarë efektesh ka kontrata midis palëve dhe çfarë efekti ka regjistrimi ose mosregjistrimi i saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme për palët e treta?

Një veprim juridik, për të qenë i vlefshëm, duhet të plotësojë tre kushte. Palët që kryejnë veprimin juridik duhet të kenë zotësinë për të vepruar. Vullneti i brendshëm duhet të përputhet me vullnetin e shprehur dhe veprimi juridik duhet të realizohet në formën e kërkuar nga ligji. Në rastin e transferimit të pasurisë së paluajtshme, forma është një element mjaft i rëndësishëm në legjislacionin tonë, pavarësisht se, parimi i përgjithshëm i sistemit modern është ai i lirisë kontraktore. Kontrata për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme, duhet të bëhet me akt noterial për faktin se, është pikërisht noteri ai që vërteton vullnetet e deklaruara të palëve. Paditësi e ka fituar pronësinë në bazë të kontratës së shitblerjes të realizuar para noterit, që përbën një nga mënyrat e fitimit të pronësisë, pasi pronësia fitohet me anë të kontratës, pa qenë i nevojshëm të bëhet dorëzimi i sendeve⁴⁸⁸.

⁴⁸⁷ Neni 83 i Kodit Civil të 1994.

⁴⁸⁸ Neni 164 i Kodit Civil të 1994.

Kontrata e shitblerjes, që të jetë e vlefshme, duhet të plotësojë disa kushte dhe konkretisht pëlqimin e palëve, shkakun e ligjshëm, formën e kërkuar ligjore dhe objektin e kontratës, i cili duhet të jetë i përcaktuar, i përcaktueshëm dhe i ligjshëm⁴⁸⁹.

Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara gjykojnë se, kontrata e shitblerjes numër 1036 rep dhe 225 kol, datë 15.04.1998, plotëson të gjitha kushtet për të qenë një veprim juridik i vlefshëm. Për lidhjen e kësaj kontrate është dhënë pëlqimi para Noterit, objekti është i përcaktuar qartë dhe veprimi juridik është i veshur në formën e kërkuar ligjore, që është akti noterial. Në funksion të unifikimit të kësaj praktike gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se: “Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme është i vlefshëm në rast se plotëson të gjitha kushtet e parashikuara në nenet 79, 663, 659 të Kodit Civil”.⁴⁹⁰

Në lidhje me çështjet e ngritura për diskutim, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se çasti i kalimit të pronësisë, është çasti i lidhjes së kontratës ose momenti i realizimit të veprimit juridik. Në legjislacionin tonë, pranohet sistemi i lidhjes së kontratës si rregull i përgjithshëm, përveç sendeve që maten dhe peshohen, pra, sendet e përcaktuara në gjini⁴⁹¹.

Momenti i fitimit të pronësisë për blerësin është në të njëjtën kohë humbje e pronësisë për shitësin⁴⁹² dhe pronësia fitohet nga blerësi vetëm nëse shitësi është pronar i sendit, pasi asnjë nuk mund t’u trasferojë të tjerëve më shumë të drejta sesa ka vetë ai.

⁴⁸⁹ Neni 663 i Kodit Civil të 1994.

⁴⁹⁰ Nenet që përcaktojnë kushtet dhe elementët e veprimit juridik dhe kontratës si dhe vlefshmërinë e tyre.

⁴⁹¹ Neni 164 i Kodit Civil të 1994.

⁴⁹² Kjo del dhe nga përmbajtja e kontratës, pasi në kontratë, palët përcaktojnë momentin e fitimit dhe të humbjes së pronësisë.

Nuk duhet ngatërruar forma e lidhjes së kontratës për efekt të vlefshmërisë së saj, me formalitetin e transkriptimit ose regjistrimit të saj në regjistrat e pasurisë së paluajtshme. Neni 192 i Kodit Civil përcakton: “Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji.”

Regjistrimi në regjistrat e pasurisë së paluajtshme, kërkohet në rastin e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme, për veprime juridike si kontratat e shitblerjes dhe veprimet e tjera juridike, që kanë lidhje me të drejtat reale mbi sendet e caktuara. Transkriptimi nuk ka asnjë pasojë në lidhje me vlefshmërinë e kontratës, por është një mjet për t’i dhënë publicitet kontratës, për ta bërë të njohur ekzistencën e saj dhe të pronarit ndaj të tretëve. Pra, regjistrimi në regjistrat e pasurisë së paluajtshme ka funksionin e publikimit deklarativ. Kontrata për kalimin e pasurisë së paluajtshme, si një veprim juridik i dyanshëm, në rastin kur plotëson kushtet për vlefshmërinë e saj, edhe nëse nuk regjistrohet në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, është plotësisht e vlefshme midis palëve që e kanë nënshkruar atë. Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik, nuk është një element i vlefshmërisë së kontratës, pasi mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurisë së paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurisë të pavlefshme, por nuk i jep mundësi blerësit ta tjetërsojë atë tek të tretët⁴⁹³.

⁴⁹³ Neni 195 i Kodit Civil: “Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme”. Sipas këtij parashikimi kontrata është e vlefshme dhe me nënshkrimin e kontratës, blerësi bëhet përfitues i pasurisë së paluajtshme dhe legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij kundrejt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë, për të cilën do t’i duhet patjetër regjistrimi në regjistra e pasurisë së paluajtshme.

Fakti që mosregjistrimi në regjistrat hipotekorë nuk përbën shkak për vlefshmërinë e saj, del qartë dhe nga përcaktimet e bëra në ligjin “Për Regjistrimin e Pasurisë së Paluajtshme”⁴⁹⁴. Sipas këtyre përcaktimeve, kontrata mund të regjistrohet në çdo kohë, mjafton të paguhet kamatëvonesa. Nëse mosregjistrimi do ta bënte kontratën të pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk mund të rregullohej më vonë duke u regjistruar prona, pasi pavlefshmëria absolute nuk rregullohet me veprime të mëvonshme. Regjistrimi në regjistrat publikë bën të mundur që një pasuri të mos transkribohet disa herë në emër të disa pronarëve, pra, të mos lidhen me keqbesim nga ana e tjetërsuesit disa kontrata shitblerjeje, fakt i cili eviton pasojat negative ndaj personave të tretë, të cilat janë në mirëbesim dhe nuk kanë dijeni për ekzistencën e kontratave të tjera. Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, arsyetimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, se paditësi në kushtet kur nuk është pronar i sendit nuk mund të ngrejë padinë e rivendikimit, është i gabuar. Në gjykim ka vlerë sqarimi i titullit të pronësisë. Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës⁴⁹⁵. Pra, paditësi legjitimohet të ngrejë padinë e rivendikimit, nëse provon se është pronar mbi pasurinë e paluajtshme.

⁴⁹⁴ “Vonesa në regjistrim”. Neni 39 i ligjit nr. 33, datë 21.04.2012 “Nëse një kërkesë për regjistrim, sipas nenit 38 të këtij ligji, paraqitet më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesa që ka kaluar nga kjo datë, duhet të paguhet kamatëvonesë, e barabartë me 10% të tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300 000 lekë”.

⁴⁹⁵ Neni 296 i Kodit Civil të 1994.

Kapitulli VIII: Konkluzione dhe Rekomandime

Në përfundim të këtij punimi dhe në funksion të qëllimit të tij, pasi u studiua roli i legjislacionit, doktrinës dhe praktikës gjyqësore në rregullimin që i bëhet pavlefshmërisë së veprimit juridik dhe veçanërisht, zbatimit të pasojave të pavlefshmërisë, u analizua trendi i gjykatës, veprimtaria dhe limitet e disponimit të gjyqësorit, në funksion të doktrinës dhe kornizës normative të Kodit Civil, ku rezultoi se, në legjislacion ka vend për përmirësime, në mënyrë që praktika gjyqësore të mos devijojë nga ligji dhe të dyja të ecin në të njëjtin drejtim.

Qëllimi i këtij punimi është evidentimi i problematikave të vërejtura në parashikimet ligjore dhe në praktikën gjyqësore, duke dhënë rekomandime, të cilat dalin nga analiza rishikuese e interpretuese e doktrinës dhe e ligjit, si dhe nga studimi statistikor e krahasues i praktikës gjyqësore, duke ndikuar në përmirësimin e ligjit, në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore.

Ky punim përfundon me pasqyrimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të mëposhtme:

1. Lidhur me kufirin ndarës midis pavlefshmërisë absolute dhe pavlefshmërisë relative, nisur nga raporti midis të drejtës së kërimit nga palët dhe gjykimit kryesisht të çështjes së themelit nga gjykata

- Mund të themi se, veprimet juridike absolutisht të pavlefshme janë nul që nga krijimi i tyre, nuk sjellin pasoja juridike të synuara nga palët kontraktore, ndërsa veprimet juridike relativisht të pavlefshme prodhojnë pasoja juridike dhe kanë vlerë ligjore, deri në momentin e shpalljes së pavlefshmërisë së tyre nga gjykata. Për këto veprime ka

rëndësi të veçantë vendimi gjyqësor, që i shpall ato të pavlefshme. Gjykatës i drejtohet me kërkesë njëra nga palët e interesuara, e cila mund të preket nga veprimi juridik dhe anulueshmëria e këtij veprimi juridik është e kushtëzuar kurdoherë nga paraqitja e kësaj kërkesë. Gjykata nuk vihet në lëvizje nëse njëra nga palët nuk e investon atë dhe si rezultat, veprimi juridik relativisht i pavlefshëm, do të vazhdojë të sjellë pasoja juridike të vlefshme.

- Si rregull, gjykata duhet të vihet në lëvizje nga palët që kanë interes dhe të disponojë për aq sa palët kërkojnë, pa dalë jashtë kërtimeve të tyre, të bëra nëpërmjet padisë, prapësimit apo kundërpadies. Derisa në një gjykim nuk kërkohet dhe zgjidhja e pasojave, gjykata nuk mund të shprehet në lidhje me pasojat e ardhura nga ekzekutimi i veprimit absolutisht të pavlefshëm. Megjithatë, jo në të gjitha rastet ndodh kështu. Ka dhe raste kur konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik bëhet kryesisht nga gjykata, edhe pse një gjë të tillë nuk e kërkojnë palët. Kjo mund të ndodhë gjatë shqyrtimit të një padie themeli, kur sqarimi i vlefshmërisë së veprimit juridik ka lidhje me çështjen e themelit. Në rastet kur gjykata evidenton se vlefshmëria e veprimit juridik është një element i rëndësishëm i padisë së ngritur nga palët, mund të konstatojë kryesisht gjatë gjykimit të çështjes së themelit dhe pavlefshmërinë e veprimit juridik, pavarësisht nga çka kanë kërkuar palët.

2. Lidhur me çështjen se kush e disponon rolin aktiv, kur konstatohet kryesisht pavlefshmëria e veprimit juridik dhe zgjidhen pasojat e tij

- Nëse jemi para faktit kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik dhe gjithashtu zgjidh pasojat e pavlefshmërisë, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme (*restitutio in integrum*), pa kërkesë të palëve, ajo merr rolin aktiv në gjykim

dhe shkel parimin që drejton një proces gjyqësor, ku çdo padi është në varësi me të drejtën e kërkuar⁴⁹⁶.

Gjithsesi, gjatë gjykimit të një padie themeli, edhe nëse nuk ka një kërkim të veçantë për pavlefshmëri dhe gjykata kryesisht konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik, ajo mund të zgjidhë pasojat vetëm për çka është kërkuar në objektin e kërkesë padisë së themelit, por jo tej këtij objekti. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute dhe zgjidhja e pasojave është në funksion të arsyetimit gjyqësor dhe zgjidhjes së çështjes së themelit.

- Për këtë arsye, mund të themi se ky është një qëndrim i drejtë, madje i domosdoshëm, duke qenë se pavlefshmëria e veprimit juridik dhe pasojat e tij janë të lidhura ngushtësisht me zgjidhjen e çështjes së themelit.

3. Praktika gjyqësore, lidhur me konstatimin kryesisht të pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike dhe sa ndiqet qëndrimi unifikues i Gjykatës së Lartë

- Sipas studimit të kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016 dhe analizës statistikore e krahasimore të vendimeve gjyqësore, nuk rezultuan raste që gjykata të konstatonte kryesisht pavlefshmërinë absolute, edhe pas daljes së vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili arsyeton në funksion të konstatimit kryesisht të pavlefshmërisë absolute nga gjykata⁴⁹⁷.

- Për këtë arsye, mund të themi se *legjislacioni duhet t'u krijojë një hapësirë dhe liberalizim gjykatave*, në funksion të analizës dhe arsyetimit gjyqësor të çështjes, jo rolit aktiv të tyre në proces, pasi janë palët orientuesit dhe iniciuesit e procesit.

⁴⁹⁶ Neni 31 i Kodit të Procedurës Civile.

⁴⁹⁷ Vendimi nr. 5, datë 30.10.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Dispozitat e ngurta të ligjeve duhen interpretuar në mënyrë të zgjeruar nga gjykata dhe, në bazë të kësaj analize, duhen bërë përmirësimet përkatëse në legjislacion. Pavlefshmëria mund të zgjidhet kryesisht, jo vetëm kur kërkohet pavlefshmëria e kontratës, por edhe kur kërkohet përmbushja e kontratës.

- Në pamje të parë, duket sikur fuqia e gjykatës orientohet në drejtim të rolit aktiv, por në të vërtetë, zgjidhja kryesisht ka si qëllim të krijojë një farë kontrolli ndaj pavlefshmërive, duke i lënë ato pa fuqi ligjore, në mënyrë që të mos krijojnë më pasoja negative për të ardhmen dhe për personat e tretë. Në fushën e së drejtës private Europiane, gjykata ka detyrimin të zgjidhë kryesisht pavlefshmërinë, në funksion të mbrojtjes së palëve dhe mbrojtjes së një interesi më të lartë se ai i palëve. Është e drejta e palës ta përdorë ose jo në interesin e saj këtë prioritet, që i krijohet nga zgjidhja kryesisht e pavlefshmërisë nga gjykata.

- Në funksion të kësaj analize, ndoshta e drejta e gjykatës për të konstatuar kryesisht pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, gjatë gjykimit të çështjes së themelit, *mund të rekomandohet të bëhet pjesë e dispozitave ligjore*, në mënyrë që të zbatohet detyrimisht nga gjyqësori. Përveç parashikimit që është bërë në ligj për legjitimimin e palëve, duke përcaktuar që pavlefshmëria absolute mund të kërkohet nga cilido që ka interes, *sugjerohet të parashikohet gjithashtu që, pavlefshmëria absolute mund të konstatohet kryesisht dhe nga gjykata ex officio, në mungesë të kërkesës së palës.*

Në këtë mënyrë, praktika gjyqësore do të ecë në të njëjtën rrugë me përcaktimet ligjore.

4. Lidhur me dallimet midis pavlefshmërisë së veprimeve juridike të parashikuara në nenet 92-95 të Kodit Civil, me pavlefshmërinë e parashikuar në nenet 663, 674, 677, 678 dhe 680 të Kodit Civil dhe ndërthurjen e raporteve midis *jus commune* me *jus singularis*

- Kodi Civil aktual është i ndarë në dy pjesë, tipar ky i familjes ligjore gjermanike dhe trashëgimi e Kodit Civil të 1981. Duke qenë se veprimi juridik e përfshin kontratën, marrëdhënien juridike dhe detyrimin, elementet, kushtet dhe rregullat ligjore të përcaktuara në pjesën e përgjithshme për pavlefshmërinë e veprimit juridik, janë të zbatueshme edhe për pjesën e posaçme që u takon kontratave, marrëdhënieve juridike dhe detyrimeve, duke ndërthurur në këtë mënyrë *jus commune* me *jus singularis*.
- Përderisa veprimi juridik ka përparësi ndaj këtyre koncepteve, mund të themi se është e drejtë që Kodi Civil ka bërë një parashikim dhe një rregullim të veçantë për të, në dispozitat e përgjithshme, normat e së cilit mund t'i shtrijnë efektet dhe te konceptet e veçanta, që kanë si bazë veprimin juridik. Pikërisht kjo shtrirje e normave të veprimit juridik, edhe te pjesa e posaçme e Kodit Civil, siguron një garanci të dyfishtë ndaj informalitetit dhe mangësive të vërejtura në sistemin noterial, gjatë hartimit të kontratave dhe akteve të ndryshme juridike, ku ndërthuret pavlefshmëria me falsifikimin, duke sjellë shkelje të dispozitave ligjore urdhëruese dhe vesim të konsensusit të palëve. Për këto arsye, mund të themi se, është e drejtë që Kodi Civil aktual ka ruajtur në strukturën e tij elementin gjermanik të Kodit Civil të 1981 edhe pse, është frymëzuar në hartimin e tij nga Kodi Civil Italian dhe Francez.
- Në praktikën gjyqësore vërehet se, shqyrtimi i pavlefshmërisë së kontratave të ndryshme, në disa raste, i referohet si pjesës së përgjithshme të Kodit Civil dhe parashikimit që bën ai për pavlefshmërinë e veprimeve juridike, ashtu dhe bazës ligjore

të parashikuar në pjesën e posaçme për kontrata të veçanta. Në raste të tjera, praktika gjyqësore, gjatë konstatimit apo shpalljes së kontratës të pavlefshme, i referohet vetëm parashikimit të bërë në dispozitat e posaçme të Kodit Civil. Kjo, në varësi dhe të kërkesës drejtuar gjykatës, ku në disa raste, kërkohet konstatimi i pavlefshmërisë së veprimit juridik specifikuar në kontratën përkatëse dhe në disa raste, kërkesa për pavlefshmëri i referohet vetëm kontratës apo testamentit përkatës.

- Sipas studimit sasior dhe analizës statistikore e krahasuese në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, rezultuan 178 vendime me padi për pavlefshmëri testamenti, 1564 vendime me padi për pavlefshmëri të kontratave, 166 vendime me padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike dhe 381 vendime, ku në objektin e padisë kërkohet pavlefshmëri e veprimit juridik dhe pavlefshmëri e kontratës specifike apo testamentit, pra, paditë ku ka konkurruar pavlefshmëria e veprimit juridik me atë të kontratës (dispozitat e përgjithshme me ato të posaçme të Kodit Civil).

5. Lidhur me analizën se disa dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Civil bien ndesh me dispozitat e pjesës së posaçme

- Kodi Civil e përcakton testamentin si veprimin juridik të njëanshëm të kryer nga trashëgimlënësi, me anën e të cilit, ky disponon pasurinë e tij pas vdekjes. Duke qenë se testamenti është një nënkategori e veprimit juridik, kuptohet që ai është shfaqje e ligjshme e vullnetit të testatorit. Nëse iu bëhet një analizë dispozitave të tjera të Kodit Civil, në lidhje me testamentin, vërehet se vullneti i testatorit nuk është plotësisht i lirë, por ai kufizohet nga këto dispozita, në kundërshtim me nenin 79 të Kodit Civil⁴⁹⁸. Sipas këtyre dispozitave, është i pavlefshëm testamenti i cili disponon në favor të personave

⁴⁹⁸ Nenet 374, 375, 376, 377, 405 dhe 406 të Kodit Civil të 1994.

që janë të pazotë për të trashëguar me ligj, pra, jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë. Gjithashtu, trashëgimlënësi mund të disponojë me testament pasurinë e tij, në favor të çdo personi tjetër, vetëm kur nuk lë të paslindur apo të paralindur, si dhe vëllezër e motra. Vullneti i testatorit është i limituar dhe ai mund të disponojë vetëm brenda rrethit të trashëgimtarëve ligjorë.

- Duke qenë se testamenti është veprim juridik i njëanshëm, ku testatori me vullnet të lirë e të pacenuar shpreh dëshirën e tij për të disponuar pasurinë pas vdekjes, do të ishte më e lehtë për t'u zbatuar ky përcaktim ligjor, nëse do të rishikohej parashikimi i bërë në Kodin Civil, në lidhje me shkaqet që efektojnë pavlefshmërinë e testamentit. Për këtë arsye, *sugjerohet rishikimi i dispozitave ligjore të pjesës së posaçme të Kodit Civil në lidhje me testamentin*, në mënyrë që testatori të disponojë me vullnet të lirë në favor të çdo personi, mjafton që ai të mos cenojë rezervën ligjore.

6. Lidhur me analizën se veprimet juridike, të kryera nga persona të cilëve iu është hequr zotësia për të vepruar, përfshihen në grupin e veprimeve që shpallen të pavlefshme (neni 94/b i Kodit Civil)

- Në Kodin Civil vërehet se veprimet e kryera nga persona të cilët, për shkak të sëmundjeve psikike apo zhvillimit të metë mendor, iu është hequr zotësia për të vepruar, nuk përfshihen në grupin e veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme, të parashikuara në nenin 92 të Kodit Civil, por pavlefshmëria e tyre absolute del nga

analiza e dispozitave ligjore⁴⁹⁹ dhe praktikës gjyqësore. Legjislacioni i mëparshëm e përfshinte këtë rast në veprimet juridike absolutisht të pavlefshme⁵⁰⁰.

- Mund të themi se këto veprimet juridike janë absolutisht të pavlefshme, njësoj si ato të kryera nga persona nën 14 vjeç. Këta persona nuk shprehin vullnet për kryerjen e veprimit juridik, pasi vullneti i tyre nuk është i vesuar, por është inekzistent, për këtë arsye, veprimet e tyre janë absolutisht të pavlefshme.

- Veprimet juridike të kryera nga persona, të cilët nuk kanë zotësi për të vepruar, në legjislacion tonë, përfshihen te veprimet juridike relativisht të pavlefshme⁵⁰¹, por një veprim juridik i kryer nga një person, vullneti i të cilit është inekzistent, nuk mund të shpallet i pavlefshëm, pasi ai është absolutisht i pavlefshëm.

Nga kjo analizë kuptohet se, vesi radikal i vullnetit, në kuptimin e defektit të tij themelor, që ka sjellë inekzistencën e vullnetit, shkakton pavlefshmërinë e veprimit juridik dhe jo anulueshmërinë e tij.

- Për këtë arsye, *ndoshta do të ishte më mirë që pika 94/b e Kodit Civil*, përse u përket veprimeve juridike të kryera nga persona të cilët, për shkak të sëmundjeve psikike apo zhvillimit të metë mendor iu është hequr zotësia për të vepruar, *të parashikohej te veprimet juridike absolutisht të pavlefshme*, pasi vullneti i palës është inekzistent dhe jo i vesuar.

⁴⁹⁹ Neni 10 i Kodit Civil të 1994: “Personi madhor që, për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i zoti, mund t’i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike, me vendim të gjykatës”.

⁵⁰⁰ Neni 17/ç i Kodit Civil të 1981: “Janë të pavlefshme veprimet juridike që janë kryer nga të miturit nën moshën 14 vjeç ose nga persona të cilëve, për shkak sëmundjeje psikike, zhvillimi mendor të metë, u është hequr krejt zotësia për të vepruar”.

⁵⁰¹ Neni 94 i Kodit Civil të 1994.

7. Lidhur me faktin nëse restitucioni është karakteristikë për pavlefshmërinë absolute apo relative parë në këndvështrimin e praktikës gjyqësore

- Në ndryshim nga veprimet relativisht të pavlefshme që deklarohen të tilla nga gjykata, ato absolutisht të pavlefshme konstatohen dhe vërtetohet pavlefshmëria e tyre nga gjykata. Ndërsa, përsa u përket pasojave midis dy llojeve të pavlefshmërive, asaj absolute dhe relative, ato aplikohen njësoj nga gjykata.
- Restitucioni i dyanshëm, në këtë rast, parë në këndvështrimin e praktikës gjyqësore, është karakteristikë e pavlefshmërisë absolute dhe asaj relative. Dallimi midis tyre, sipas disponimit gjyqësor, qëndron vetëm në ndarjen midis konstatimit apo shpalljes të pavlefshëm të veprimit juridik.

Edhe nga doktrina pranohet zbatimi i restitucionit të dyanshëm, në të dyja llojet e pavlefshmërisë, asaj absolute dhe relative. Palët lirohen nga detyrimet dhe, për çdo gjë që njëra palë i ka dhënë tjetrës, mund të kërkojë kthimin. Në këtë kuptim, veprimi juridik relativisht i pavlefshëm barazohet me atë absolutisht të pavlefshëm⁵⁰².

Pasojat e veprimeve juridike të pavlefshme janë përcaktuar në Kodin Civil nga neni 106 deri në nenin 110. Si në rastin kur gjykata konstaton, ashtu dhe në rastin kur deklarohet pavlefshmërinë e veprimit juridik, shprehet dhe për pasojat.

Praktika gjyqësore, në pjesën më të madhe të rasteve, parashikon “restitutio ad integrum”, si zgjidhje të pasojave. Parimi i aplikuar nga gjykatat shqiptare është kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme, si pasojë e veprimit absolutisht të pavlefshëm⁵⁰³.

- Nisur nga studimi i bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, rezultoi se pasojat aplikohen njësoj nga gjykata për të dyja llojet e

⁵⁰² Gjata. R, “E Drejta Civile”, Tiranë, 2010:161.

⁵⁰³ Semini. M, (2013) “Pavlefshmëria e Veprimeve Juridike nën Këndvështrimin e Kodit Civil, Doktrinës dhe Praktikës Gjyqësore”, Revista “Jeta Juridike”, nr. 4.

pavlefshmërive, atë absolute dhe relative, duke u shprehur për kthimin e palëve në gjendjen fillestare dhe restitucionin e dyanshëm. Nga 797 paditë civile për pavlefshmëri të pranuar, vetëm në dy raste është disponuar me kthim në të ardhurat e shtetit, sipas nenit 106 të Kodit Civil, për veprime juridike të kryera në kundërshtim me ligjin, ndërsa në 15 raste, gjykata është kufizuar vetëm në konstatimin e pavlefshmërisë dhe nuk është shprehur për pasojat, edhe pse ishin kërkuar nga palët.

- Nisur nga studimi dhe vështrimi krahasues i vendimeve gjyqësore të gjykatave të ndryshme shqiptare, shohim se nuk ka një qëndrim të unifikuar në zbatim të nenit 106 të Kodit Civil, në lidhje me trajtimin që u bën gjykata pasojave të pavlefshmërisë absolute për veprimet juridike, që vijnë në kundërshtim me ligjin apo bëhen në mashtrim të ligjit. Në këtë rast, pavarësisht se gjykata duhet të shprehet për kalim të të ardhurave në favor të shtetit, sipas nenit 106 të Kodit Civil, disponon me kthimin në gjendjen fillestare, dhe restitucionin e dyanshëm.

8. Lidhur me zbatimin e restitucionit të dyanshëm, si pasojë për të gjitha rastet e pavlefshmërisë absolute dhe relative, të parashikuara në nenin 92 dhe 94 të Kodit Civil dhe faktin a mund të zbatohet analogjia e pasojës së veprimeve juridike të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre të kryera në mashtrim të ligjit

- Nga analiza e kryer, *ndoshta, do të ishte më mirë të mos zbatohet restitucioni i dyanshëm, si analogji e veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin, me ato të kryera në mashtrim të ligjit.* Në këtë rast, palët veprojnë me ndërgjegje dhe vullnet për të përfituar pa të drejtë, në mashtrim të ligjit dhe duke cenuar interesat shtetërore dhe publike, pra, interesat e gjera mbiindividuale. *Prandaj sugjerohet se, ajo që është shkëmbyer midis palëve nga veprimi juridik i kryer në mashtrim të ligjit dhe me*

keqbesim, ndoshta duhet të dëmshpërblejë dëmin që i është shkaktuar pasurisë shtetërore.

9. Lidhur me ecurinë e praktikës gjyqësore në rastet e pavlefshmërisë absolute, kur, si pasojë, duhet të parashikohet kthimi në të ardhurat e shtetit, sipas nenit 106 të Kodit Civil

- Mund të themi se, nëse nga veprimi absolutisht apo relativisht i pavlefshëm, palët kanë përmbushur të drejtat dhe detyrimet midis tyre, pra, veprimi juridik ka sjellë pasojat përkatëse, nuk mjafton që ai thjesht të konstatohet ose të anulohet, por duhet të rregullohen shkëmbimet që kanë kryer palët, në lidhje me një veprim juridik të pavlefshëm.

- Në rastin e anulimit të veprimeve juridike relativisht të pavlefshme, palët kanë interes legjitim për zgjidhjen e pasojave dhe, në bazë të këtij interesi, inicohet gjykata.

Në rastin e konsatimit të pavlefshmërisë absolute dhe zgjidhjes së pasojave me kthim në të ardhurat e shtetit, palët nuk kanë interes të ligjshëm për zgjidhjen e pasojave. Duke munguar interesi i palës në ngritjen e padisë, gjykata duhet të dispononte me rrëzimin e saj, kur nuk shoqërohet me një kërkim tjetër krahas atij të konstatimit të pavlefshmërisë.

- Vërehet se neni 106 i Kodit Civil e kundërshton këtë logjikë dhe i jep gjykatës rol aktiv në rastin e zgjidhjes së pasojave me kthim në të ardhurat e shtetit, kur pavlefshmëria është shkaktuar si rezultat i një veprimi juridik, të realizuar në kundërshtim të ligjit ose në mashtrim të ligjit. Sipas kësaj dispozite, gjykata ka të drejtë ta shqyrtojë kërkesë padinë dhe jo ta rrëzojë atë, edhe kur nuk kemi një kërkim tjetër, krahas atij të konstatimit të pavlefshmërisë.

- Gjykata inicohet në të gjitha kërkimet nga palët, megjithatë, po t'i referohemi nenit 106 të Kodit Civil për pasojat e pavlefshmërisë së veprimeve juridike, shohim se palët nuk kanë interes legjitim të iniciojnë gjykatën në lidhje me pasojat.

Në këtë rast, zgjidhja e pasojave të veprimit absolutisht të pavlefshëm, nëpërmjet kthimit në të ardhurat e shtetit, cenon rolin pasiv të gjykatës, pasi ajo merr rol aktiv duke u shprehur për këto pasoja, edhe pse nuk kërkohet në disponimin që bëjnë palët nëpërmjet kërkesë padisë.

- Ky përcaktim i nenit 106 të Kodit Civil për zgjidhjen e pasojave të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm, është trashëguar nga legjislacioni i kaluar, ku shkelja e dispozitave ligjore dhe cenimi i interesave shtetërore, ishin thelbësore për kohën dhe u sigurohej një mbrojtje e veçantë. Interesi shtetëror ishte mbi atë individual.

Këto veprime të pavlefshme konsideroheshin të dëmshme për shtetin, për shkak të qenies në konflikt me ligjin. Si rrjedhojë, palët, në një marrëveshje të tillë, duke qenë se kanë dëmtuar interesat e shtetit, duhet t'i kthejnë gjithçka që kanë shkëmbyer në mashtrim të ligjit, në natyrë ose në vlerë monetare, kur shkëmbimet janë të pamundura për t'u kthyer në natyrë⁵⁰⁴. Në këtë rast, gjykata merrte rol aktiv duke mbrojtur interesat ligjore të shtetit.

- Nisur nga studimi i bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 2006-2016, rezultuan vetëm dy vendime, ku gjykata ka disponuar kryesisht me kthim në të ardhurat e shtetit, pa kërkesë të palës, për kontrata të lidhura në kundërshtim me ligjin⁵⁰⁵.

⁵⁰⁴ Nathanaili. A, "E Drejta Civile e R.P. të Shqipërisë", pjesa e përgjithshme, vëllimi I. Tiranë, 1974:278.

⁵⁰⁵ Vendimet nr. 1000, datë 06.02.2013 dhe nr. 6505, datë 22.06.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Fakti që, në periudhën dhjetëvjeçare të studimit, u konstatuan vetëm dy vendime që kanë disponuar sipas nenit 106 të Kodit Civil për pasojat, tregon se praktika gjyqësore ka devijuar nga parashikimet ligjore, duke krijuar një precedent të ndryshëm.
- Pra rezulton se, neni 106 i Kodit Civil, në lidhje me kthimin në të ardhurat e shtetit, thuajse nuk zbatohet në praktikën gjyqësore. Pavarësisht se veprimi konstatohet në kundërshtim me ligjin ose në mashtrim të ligjit dhe palët mund të kenë qenë në keqbesim, në praktikën gjyqësore aktuale, vështirë të gjenden raste të zbatimit të pasojave me kthim në të ardhurat e shtetit.
- Vetëm në vendimet penale për pavlefshmëritë, që kanë të bëjnë me falsifikimin e akteve, mund të ndeshen disponime të gjykatës për dënimin e palëve që kanë kryer falsifikimin, me gjobë dhe pagimin e shumave në favor të shtetit⁵⁰⁶. Falsifikimi trajtohet si dëmtim i interesave të shtetit në mashtrim të ligjit, duke qenë se, me anën e këtyre akteve të falsifikuara, shpërdorohet pasuria shtetërore në favor të një pale të caktuar, (p.sh., një kontratë shitjeje e falsifikuar, e lidhur midis njësive të pushtetit lokal dhe një shtetasi të caktuar). Në këtë rast, për t'u zbatuar pasoja e kalimit në të ardhurat e shtetit, keqbesimi i palës konkurren me dëmtimin e interesave shtetërore.
- Duke qenë se besa e mirë është një element i rëndësishëm i të drejtës civile botërore dhe i vullnetit të palëve, mund të themi se, keqbesimi në veprimet juridike të kundërligjshme apo ato në mashtrim të ligjit dhe dëmtimi i interesave shtetërore, do të ishte i mjaftueshëm për t'u zbatuar neni 106 i Kodit Civil, në lidhje me pasojat.

Analizuar në këndvështrimin tjetër, nëse gjykata shprehet dhe për zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute, pa kërkesë të palës ose tej asaj çka është kërkuar apo synuar nga pala, gjykata ndërhyr në vullneti e palëve, duke ndryshuar elementet e padisë dhe

⁵⁰⁶ Vendimi numër 5, datë 15.09.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

shkakun ligjor dhe duke u ofruar palëve një zgjidhje të ndryshme nga ajo e pretenduar prej tyre. Shkaku i ligjshëm është një element që identifikon padinë dhe për këtë arsye, shkaku nuk mund të ndryshohet.

- Në vijim të këtij arsyetimi, *ndoshta do të ishte mirë që pjesë e rregullimeve ligjore të ishte dhe neni 106 i Kodit Civil*, i cili kërkon një rishikim dhe një përmirësim, përderisa është një nen që krijon probleme në lidhje me interesin legjitim të palëve në zgjidhjen e pasojave dhe thuajse është i pazbatueshëm në praktikën gjyqësore. Për këtë arsye, *sugjerohet që ky nen të riformulohet, duke i zgjidhur pasojat nisur nga mirëbesimi i palëve*. Nëse vërtetohet mirëbesimi i palëve në kryerjen e veprimit juridik të pavlefshëm, edhe pse në kundërshtim me ligjin, atëherë, *si pasojë do të ishte mirë të parashikohej restitucioni i dyanshëm*. Nëse vetëm njëra palë ka qenë në mirëbesim, përveç zbatimit të restitucionit të dyanshëm, *pala që ka qenë në mirëbesim do të duhej të shpërblehej për dëmin e shkaktuar, si dhe t'i ktheheshin shpenzimet e pagesat e kryera*, në lidhje me këtë veprim juridik të pavlefshëm, nëse pala tjetër nuk do të arrinte të provonte se nuk ka patur faj dhe dijeni për shkakun e pavlefshmërisë.

- Gjithsesi, në bazë të kësaj analize, përsa i përket zgjidhjes së pasojave midis veprimeve juridike të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre të kryera me keqbesim, në mashtrim të ligjit dhe në cenim të interesave shtetërore, *mund të themi se nuk mund të zbatohet analogjia*. Në këtë rast, nëse palët, me dijeni dhe keqbesim, kanë kontraktuar në mashtrim të ligjit, si dhe kanë sjellë pasoja negative për interesat shtetërore, atëherë, *ndoshta do të ishte më e drejtë që ajo çka ata kanë shkëmbyer nga ky veprim juridik, të kalojë në favor të shtetit për të shpërblyer dëmin e shkaktuar*, pasi është pikërisht subjekti shtetëror ai i cili është cenuar nga ky veprim i pavlefshëm dhe jo palët, të cilat me keqbesim, kanë synuar të përfitojnë pa të drejtë, në dëm të shtetit. Në

këtë rast, mund të themi se, *duke e parashikuar si detyrim ligjor, gjykatës i ngarkohet detyra e zgjidhjes së pasojave, nisur nga parimi i mirëbesimit dhe në funksion të mbrojtjes së interesave të gjera publike dhe shtetërore, të cenuara nga veprimi juridik i pavlefshëm dhe i paligjshëm.*

10. Lidhur me analizën e praktikës gjyqësore nëse, kur konstaton kryesisht pavlefshmërinë, disponohet dhe për pasojat, në të njëjtin vendim gjyqësor apo zgjidhjen e pasojave palët e kërkojnë në një tjetër gjykim

- Nëse gjykata nuk disponon dhe për zgjidhjen e pasojave në të njëjtin proces gjyqësor, kur ajo kryesisht konstaton pavlefshmërinë, gjatë gjykimit të çështjes së themelit, ky fakt nuk i pengon palët apo personat e tretë që të kërkojnë në një tjetër gjykim, zgjidhjen e pasojave të pakërkuara, për të cilat gjykata nuk është shprehur me një vendim, duke qenë se gjykata, në këtë rast, është shprehur vetëm për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik.
- Në funksion të ekonomizimit të gjyqësorit, mund të thuhet se, *ndoshta do të ishte më efektive nëse gjykata, kur konstaton kryesisht pavlefshmërinë gjatë gjykimit të çështjes së themelit, të shprehej dhe për zgjidhjen e pasojave, brenda limiteve të çështjes së themelit.*

11. Lidhur me disponimin e gjykatës, duke u kufizuar në konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik sipas kërkesës së palës, pa u shprehur për pasojat

- Mund të thuhet se, disponimi i gjykatës vetëm për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, pasi kjo është kërkuar nga palët në kërkesë padi, cenon

parimin e interesit legjitim që duhet të kenë palët në ngritjen e padisë, pasi me anën e kësaj padie, palëve nuk u sigurohet asnjë interes i ligjshëm, thjesht konstatohet pavlefshmëria, si vërtetim fakti.

Do të ishte një inicim i kotë i gjykatës thjesht vërtetimi i pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, i cili dihet që është nul që nga lindja e tij dhe nuk ka kuptim, nëse nuk do të zgjidheshin pasojat e shkaktuara nga ky veprim, pasi qëllimi kryesor i palëve të interesuara është zgjidhja e pasojave, në të kundërt, ky vendim do të ngjante me një vendim gjykate për vërtetim fakti.

- Pavlefshmëria absolute mund të kërkohej në gjykatë nga çdo palë ndërgjyqëse që ka interes. Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, nuk mund të bëhet si një kërkim më vete, thjesht konstatim. Ai gjithnjë duhet të bëhet gjatë gjyqimit në themel të një çështjeje nga gjykata kryesisht ose si kërkim konstatim i pavlefshmërisë, që shoqëron kërkesën për zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm.

- Pasojat e ardhura nga përmbushja e një veprimi absolutisht të pavlefshëm zgjidhen vetëm mbi bazën e kërkesës së palëve ndërgjyqëse për zgjidhjen e pasojave dhe, në rastin tjetër, kur gjykata konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik kryesisht, zgjidh vetëm ato pasoja, që janë objekt i kërimit të bërë nga palët brenda objektit të padisë apo kundërpadisë, pa u shprehur për pasojat, për të cilat nuk ka një kërkesë konkrete nga palët ndërgjyqëse.

- Sipas studimit të kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezultoi se praktika gjyqësore, edhe pse ndodhet para një vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të

Gjykatës së Lartë⁵⁰⁷, në lidhje me legjitimitimin e ngritjes së padisë dhe zgjidhjes së pasojave të pavlefshmërisë absolute, në bazë të kërkesës së palës, përsëri, në disa raste, e pranon kërkesë padinë për konstatim të pavlefshmërisë absolute, pa u shoqëruar kërkesa me zgjidhjen e pasojave dhe në disa raste, e rrëzon atë për mungesë të legjitimitit.

- Gjithashtu, praktika gjyqësore disponon me qëndrime jo të unifikuara, në lidhje me trajtimin e pasojave të pavlefshmërisë, nisur nga kërkimi ose jo i palës, në mënyrë të veçantë asaj absolute, të veprimeve juridike të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre në mashtrim të ligjit. Në disa raste, edhe pse të pakta në numër, gjykata disponon për zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë, pa u kërkuar nga palët në gjykim.

Në raste të tjera, edhe pse palët kanë kërkuar rregullimin e pasojave, gjykata nuk shprehet në lidhje me to, por kufizohet vetëm në vërtetimin e pavlefshmërisë.

Kjo pasi, në praktikën gjyqësore, vërehen raste kur vetë palët i drejtohen gjykatës me kërkesë thjesht konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik dhe në raste të tjera, përveç konstatimit të pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, kërkohet dhe zgjidhja e pasojave.

- Sipas analizës statistikore dhe krahasuese, në lidhje me disponimin e gjykatës për pasojat e pavlefshmërisë, nisur nga kërkimi ose jo i palës, gjatë periudhës 2006-2016, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezultoi se, nga 2289 vendimet gjyqësore për pavlefshmëri në total, janë pranuar nga gjykata 797 padi. Përsa i përket rregullimit të pasojave, nga 797 paditë e pranuar, në 769 raste rregullimi i pasojave është kërkuar nga pala dhe është shprehur nga gjykata sipas kërkesës, në 15 raste pasojat janë kërkuar

⁵⁰⁷ Vendimi nr. 5 datë, 30.10.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

nga pala, por nuk janë shprehur nga gjykata, ndërsa në 13 raste pasojat nuk janë kërkuar nga pala, por janë zgjidhur kryesisht nga gjykata.

- Për këto arsye, mund të thuhet se, *detyrimi që kërkesa për konstatim të pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik të shoqërojë kërkesën për zgjidhjen e pasojave të tij, ndoshta duhet përcaktuar si detyrim ligjor, duke e përfshirë atë në dispozitat ligjore.* Në këtë mënyrë, bëhet detyrimisht e zbatueshme, në mënyrë të unifikuar nga praktika gjyqësore, duke u kthyer në një instrument kontrolli për legjitimimin e palëve në ngritjen e padisë dhe zgjidhjen e pasojave të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm. Ky përcaktim bën të mundur që praktika gjyqësore të ecë paralelisht me përcaktimet ligjore.

BIBLIOGRAFIA

1. Literatura

1. Albanese, Antonio. (2003) “Violazione di Norme Imperative e Nullita del Contratto”. Itali: Jovene.
2. Albanese, Antonio. (2008) “Contratto Mercato Responsabilita”. Itali, Milano: Giuffre.
3. Anastasi, A. (2004) “E Drejta Kushtetuese”. Tiranë: Pegi.
4. Benussi, Baltasar. (2012) “Obligimet dhe Kontratat Përgjithsisht”, Komentar i Kodit Civil (Titulli i II i Librit), viti 1931. Tiranë.
5. Bianca, Massimo. (2015) “Diritto Civile”, Il Contratto, vol III. Itali: Giuffre.
6. Cammalleri, Giuseppe. (2014) “Contratto di Intermediazione Finanziari: Nullo in Assenza di Forma Scritta e Sottoscrizione”, Rivista-Filodiritto, Tribunale Bologna, Articolo dt. 04.06.2014.
7. Caringella, Francesco. (2007) “Il Contratto”, Manuale di Diritto Civile, vol I. Itali: Giuffre.
8. Cariota, F. Luigi. (2011) “Il Negozio Giuridico nel Diritto Privato Italiano”. Itali: Edizioni Scientifiche Italiane (ESI).
9. Chabas. J, Francois - Deis-Beaquense, S. (2005) “Aatreintes Generalites”. France: Dalloz.
10. De Cristofaro, Giovanni. (2005) “Il Codice del Consumo” un Occasione Perduta? Rivista-Studium Iuris, Anno 2005, Volume: 10, Pagina 1137-1149.
11. Di Marzio, Fabrizio. (2008) “La Nullita del Contratto”, Enciclopedia. Itali: Cedam.

12. Di Marzio, Fabrizio. (2014) “Illiceita Penale ed Invalidita Contrattuale”, Rivista-Enciclopedia Treccani, Libro Dell Ano del Diritto.
13. Diana, G. Antonio. (2004) “La Nullita Parziale del Contratto”, Il Diritto Privatto Ogi. Itali: Giuffre.
14. Dobjani, Ermir. (2003) “E Drejta Administrative 1”. Tiranë: Libri Universitar.
15. Dollani, Nada. “E Drejta e Krahastuar e Kontratave”. Punim Leksionesh.
16. Elezi, Ismet. (1999) “Mendimi Juridik Shqiptar”. Tiranë: Albin.
17. Falzea, Angelo. (1999) “Efficacia Giuridica”, Capacita. Efficacia Giuridica. Fato Giuridico. Manifestazione. Itali: Giuffre.
18. Fjalori i Shqipes së Sotme. (2002), Botimi i 2-të, Tiranë: Toena.
19. Flour, Jacques – Aubert, L, J – Savaux, E. (2013) “Droit Civil, les Obligations, le Acte Juridique”, Edition 15: Sirey.
20. Foster, Nigel – Sule, S. (2010) “German Legal System and Laws”, Fourth Edition: Oxford University Press.
21. Fox, Viviana. (2003) “Annullamento Degli Atti di Gara ed Invalidita del Contratto D appalto”, Rivista-Altalex, Articolo dt. 17.02.2003.
22. Fromont, Michel. (2009) “Sistemet e Huaja më të Mëdha të së Drejtës”. Tiranë: Papirus.
23. Galgano, Francesco. (1999) “E Drejta Private” Botimi i Parë. Tiranë: Luarasi.
24. Gentili, Aurelio. (2003) “Nullita Annullabilita, Inefficacia (Nella Prospettiva del Diritto Europeo), i Contratti”, Rivista-Associazione Essper Periodici Italiani di Economia, Scienze, Sociali e Storia, Anno: 2003, Fascicolo: 2, Pagina 200-205.
25. Ghestin, Jacques. (1990) “La Notion de Contract”. France: Dalloz.
26. Gjata, Rustem. (2010) “E Drejta Civile”, Tiranë: Albpaper.

27. Hadjiani, Armin. (2002) "Duress and Undue Influence in English and German Contract Law: Comparative Study on Vitiating Factors in Common and Civil Law": Oxford U Comparative L. Forum.
28. Hetemi, J, Mehdi. (1996) "E Drejta me Njohuritë Themelore të së Drejtës Afariste". Prishtinë.
29. Hetemi, J, Mehdi. (1998) "Detyrimet dhe Kontratat". Tiranë: Luarasi.
30. Kanuni i Labërisë. (2006), Tiranë: Toena.
31. Kanuni i Lekë Dukagjinit. (2013), Botimi i IV. Shkodër: Botime Franceskane.
32. Kondili, Valentina. (2008) "E Drejta Civile" Pjesa e Përgjithshme. Tiranë: Geer.
33. Lamani, Alqiviadh. (1962) "Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë". Tiranë.
34. Latifi, Juliana. (2000) "E drejta Civile" Pjesa e Përgjithshme. Tiranë: Ilar.
35. Latifi, Juliana. (2002) "Trashëgimia". Tiranë: Ilar.
36. Luarasi, Aleks. (1999) "Aktet Juridike" Pjesa II. Tiranë: Luarasi.
37. Luarasi, Aleks. (2001) "Aktet Juridike" Pjesa I. Ribotim. Tiranë: Luarasi.
38. Machnikowski, Piotr – Balcarczyk, J – Drela, M. (2011), "Contract Law in Poland", Netherlands: Wolters Kluwer, Law & Business.
39. Malinvaud, Philippe – Fenouillet, D. (2012) "Manuel Droit des Obligations", Edition 12: LexisNexis.
40. Mandro, Arta - Meçaj, V - Zaka, T - Fullani, A. (2006) "E Drejta Familjare". Tiranë.
41. Mandro, Arta. (1998) "E Drejta Romake". Tiranë: Afërdita.
42. Manuale Del Diritto Privato Italiano, (1996), Botimi II. Shkolla e Magjistraturës.

43. Mc Kendrick, Ewan. (2012) "Contract Law", Fifth Edition: Oxford University Press.
44. Merryman, Henry, J. (1993) "The Civil Law Tradition". Tiranë: Libri Universitar.
45. Micklits, W, Hans. (2002) "The New German Sales Law: Changing Patterns in The Regulation of Product Quality", Netherlands: Kluwer Law International.
46. Mirabeli, Giuzepe. (1987) "Commentario del Codice Civile", Libro IV, Itali Torino:Unione Tipografico-Editrice. Shkolla e Magjistraturës.
47. Nathanaili, Andrea - Bicoku, N. (1982) "E Drejta Civile". Tiranë.
48. Nathanaili, Andrea - Papupi, N. (1961) "Disa Çështje mbi Pronësinë dhe Trashëgiminë", Punim. Tiranë.
49. Nathanaili, Andrea. (1974) " E Drejta Civile e R.P. të Shqipërisë" Pjesa e Posaçme, dispensa II. Tiranë.
50. Nathanaili, Andrea. (1974) "E Drejta Civile e R.P. të Shqipërisë" Pjesa e Përgjithshme, Dispensa I. Tiranë.
51. Nathanaili, Andrea. (1974) "E Drejta e Pronësisë në R.P. të Shqipërisë". Tiranë.
52. Nuni, Ardian. (2001) "Veprimet Juridike". Tiranë: Julvin.
53. Nuni, Ardian. (2007) "E Drejta e Biznesit". Tiranë: Morava.
54. Nuni, Ardian. (2009) "E Drejta Civile", Pjesa e Përgjithshme. Tiranë: Morava.
55. Omari, Luan. (1999) "Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike". Tiranë: Elena Gjika.
56. Orientime Unifikuese të ZQRPP "Për Rastet e Praktikat që Kanë të Bëjnë me Problematika të Ndryshme të Paraqitura nga ZVRPP për Vitin 2014". (2015), Unifikimi i Ligjit 33/2012. Tiranë: Albpaper.

57. Passagnoli, Giovanni. (1995) “Nullita Speciali”. Itali: Giuffre.
58. Pasuritë e Paluajtshme. (1996), vëllimi 1 dhe 2. Tiranë: Albal.
59. Picod, Yves. (2004) “Nullite”. France: Dalloz.
60. Pieck, Manfred. (2010) “A Study of the Significant Aspects of German Contract Law”, Annual Survey of International & Comparative Law, volume 3 Issue 1, Article 7, dt. 25.08.2010.
61. Planiol, Marcel – Ripert, G. (1954) “Traite Pratique de Droit Civil Français”. France: Esmen.
62. Poli, Vincenzo. “Principi Generali e Regime Giuridico dei Contratti Stipulati dalle Pubbliche Amministrazioni”, Relazione Presentata al IV Coloquio entre el Consejo de Estado de Italia y el Tribunal Supremo de Espana Sobre, Madrid, 1-4.06.2002, in Giustizia-Amministrativa.
63. Polten, P, Erik. (2011) “A Survey of Canadian and German Contract Law”, Polten & Associates, February 2011.
64. Putti, Maria. Pietro. (2002) “La Nullita Parziale”, Diritto Interno e Comunitario, Itali: Edizioni Scientifiche Italiane (ESI).
65. Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet e KLSH nr. 582/3, datë 27.09.2006, Drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë.
66. Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet e KLSH nr. 673/10, datë 30.01.2015, Drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë.
67. Reimann, Mathias – Zekoll, J. (2005) “Introduction to German Law”, Second Edition, Netherlands: Kluwer Law International.

68. Revista nr. 1, Drejtësia Popullore, (1957) “Pavlefshmëria e Aktit Juridik për Mungesë Forme”.
69. Revista nr. 1, Drejtësia Popullore, (1957) “Veprimet Juridike Pjesë e Rëndësishme e së Drejtës Civile”.
70. Revista nr. 1, Drejtësia Popullore, (1969) “Përfaqësimi për të kryer një veprim juridik”.
71. Revista nr. 3, Drejtësia Popullore, (1958) “Pavlefshmëria Absolute dhe Relative e Veprimeve Juridike ”.
72. Revista nr. 5, Drejtësia Popullore, (1952) “Vlefshmëria e Kontratave të Simuluara”.
73. Revista nr. 5, Drejtësia Popullore, (1958) “Përfaqësimi në të Drejtën Civile”.
74. Revista nr. 5, Drejtësia Popullore, (1961) “Përfaqësimi në Gjyq i të Miturit”.
75. Revista nr. 5, Drejtësia Popullore, (1963) “Përfaqësimi në Gjyq i të Sëmurit Mendor”.
76. Revista nr. 6, Drejtësia Popullore, (1960) “Veprime Juridike të Pavlefshme ”.
77. Revista nr. 6, Drejtësia Popullore, (1963) “Veprimi Juridik i Pavlefshëm”.
78. Revista-Avokatia, (2014) “Veprimi Juridik. Probleme të Teorisë dhe Praktikës Gjyqësore”, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë Shqiptare, shkruar nga Av/Artan Hajdari, dt. 06.05.2014.
79. Rizzo, Nikola. (2015) “Accertamento Della Nullita e Azioni di Impugnazione del Contratto”, Rivista-Diritto Civile Contemporaneo, Anno II, No. 1, Gennaio-Marzo, dt. 15.03.2015.

80. Rodota, Stefano. (2005) “I Saggi, il Codice Civile e il Processo Costituyente Europeo”, Rivista-Associazione Essper Periodici Italiani di Economia, Scienze, Sociali e Storia, Anno: 2005, Volume: 23, Fascicolo: 1, Pagina 21-33.
81. Roppo, Vincenzo. (2011) “Il Contratto, nel Trattato Ludica-Zatti”, Itali: Giuffre.
82. Ruscica, Serafino. (2008) “Il Contratto: Invalidita e Nullita”, Rivista-Altalex, Articolo dt. 26.05.2008.
83. Ruscica, Serafino. (2008) “Nullita del Contratto: Breve Analisi della Recente Casistica Giurisprudenziale”, Rivista-Altalex, Articolo dt. 08.09.2008.
84. Sacco, Rodolfo. (2000) “Le Contrat Sans Volonte, Exemple Italien in: le Role de la Volonte Dans les Actes Juridiques”. Bruxelles: Bruylant.
85. Sadushi, Sokol. (2000) “Teoria e Aktit Administrativ”. Tiranë: Eldor.
86. Sallabanda, Andon. (1973) “E Drejta e Detyrimeve”, vëllimi I. Tiranë.
87. Scalisi, Vincenzo. (2003) “Invalidita e Inefficacia. Modalita Assiologiche Della Nогоzialita”, Rivista-Associazione Essper Periodici Italiani di Economia, Scienze, Sociali, e Storia, Anno 2003, Volume: 49, Fascicolo: 2, Pagina 201-217.
88. Semini, Mariana. (1998) “E drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave”, Pjesa e Përgjithshme. Tiranë: Afërdita.
89. Semini, Mariana. (1998) “E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave”, Pjesa e Posaqme, Tiranë: Afërdita.
90. Semini, Mariana. (2013) “Pavlefshmëria e Veprimeve Juridike nën Këndvështrimin e Kodit Civil, Doktrinës dhe Praktikës Gjyqësore”, Revista-Jeta Juridike, nr. 4.
91. Shehu, Avni. (1998) “Pronësia”. Tiranë: Libri Universitar.

92. Tafaj, Flutura - Tusha, V. (2000) "Procedura Civile", Cikël Leksionesh. Tiranë: Pegi.
93. Tartari, Agim. (2015) "Kushti në Veprimet Juridike Civile", Revista-Avokatia, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë Shqiptare, nr.13 dt. 15.01.2015.
94. Tessitore, Valeria. (2016) "Contratti-Cassazione Civile: Il Contratto puo Essere Firmato con una Sigla Illeggibile", Rivista-Filodiritto, Tribunale Bologna, Articolo dt. 28.01.2016.
95. Tommasini, Rafaele. (1972) "Invalidita" (Diritto Privato), in Enciclopedia del Diritto, vol 22, Milano.
96. Tsitsos, Niko. (1931) "Parimet e Përgjithshme të së Drejtës Civile": Dhorë Koti
97. Valcke, Catherine. (2008) "Convergence and Divergence Between the English French and German Concepts", European Review of Private Law, vol 16, No 1, pp. 29-62, May 2008, Legal Studies Research Series.
98. Venosta, Francesco. (2004) "Le Nullita Contrattuali nell Evoluzione del Sistema", Nullita e Inesistenza del Contratto" vol I. Itali: Giuffrè.
99. Viney, Genevieve. (1982) "Les Obligations la Responsabilite Conditions". France: Ghestin.
100. Wolfgang, Faber – Lurger, B. (2011) "National Reports on the Transfer of Movables in Europe", Volume 4: France, Belgium, Bulgaria, Poland, Portugal: European Law Publishers.
101. Zimmermann, Reinhard. (1996) "The Law of Obligations, Roman Foundations of the Civilian Traditions": Oxford University Press.
102. Zweigert & H.Kotz. (1994) "Njohuri për të Drejtën e Krahësuar", Parimet Themelore. Tiranë: Libri Universitar.

2. Burime Parësore

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, (1998).
2. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, (1950).
3. Kodi Civil i vitit 1929. Tiranë: Toena, (1998).
4. Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i vitit 1981. Tiranë, (1982).
5. Kodi i Procedures Civile të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i vitit 1981. Tiranë, (1982).
6. Kodi i Familjes i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Tiranë, (1982).
7. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë me praktikë gjyqësore i përditësuar me ndryshimet e 2012. Tiranë: Albjuris, (2012).
8. Kodi i Procedures Civile të Republikës së Shqipërisë me praktikë gjyqësore i përditësuar me ndryshimet e 2012. Tiranë: Albjuris, (2012).
9. Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Tiranë: Luarasi, (2001).
10. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë. Tiranë, (2003).
11. Kodi Civil Italian. (1942).
12. Kodi Civil Gjerman. (1900).
13. Kodi Civil Rumun. (2011)
14. Kodi Civil Zvicerian. (1907).
15. Kodi Civil Frances. (1804).
16. Kodi Civil Polak. (1965).
17. Kodi Civil Bullgar.

18. Ligji nr. 2359, datë 15.11.1956, “Mbi Veprimet Juridike dhe Detyrimet”.
19. Ligji nr. 33, datë 21.03.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.
20. Ligji nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar.
21. Ligji nr. 7698, datë 15.04.1993, “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish-pronarëve”, i ndryshuar.
22. Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për Privatizimin e Banesave Shtetërore”
23. Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.
24. Ligji nr. 8386, datë 30.07.1998, “Për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes së Pasurive të Personave Juridike Jobankare që Kanë Marrë Hua nga Publiku i Gjerë”.
25. Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
26. Dekreti nr. 1892, datë 05.07.1954, “Mbi Trashëgiminë”.
27. Dekreti nr. 3167, datë 26.10.1960, “Abrogimin e Ligjës Mbi Disa Ndryshime në Dekretin nr. 1892, datë 05.07.1954, “Mbi Trashëgiminë”.
28. Dekreti “Mbi Pronësinë” datë 18.09.1955.
29. Vendimi numër 1835, datë 25.02.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
30. Vendimi numër 12340, datë 10.12.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
31. Vendimi numër 8762, datë 28.09.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
32. Vendimi numër 10625, datë 25.10.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
33. Vendimi numër 9394, datë 23.09.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
34. Vendimi numër 169, datë 20.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
35. Vendimi numër 5079, datë 08.05.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
36. Vendimi numër 4504, datë 30.05.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
37. Vendimi numër 1169, datë 22.02.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

38. Vendimi numër 940, datë 15.02.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
39. Vendimi numër 624, datë 03.02.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
40. Vendimi numër 6914, datë 13.09.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
41. Vendimi numër 5499, datë 17.05.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
42. Vendimi numër 1000, datë 06.02.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
43. Vendimi numër 6505, datë 22.06.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
44. Vendimi numër 747, datë 29.05.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
45. Vendimi numër 748, datë 16.07.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
46. Vendimi numër 68, datë 20.01.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
47. Vendimi numër 1214, datë 28.12.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
48. Vendimi numër 1424, datë 16.10.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
49. Vendimi numër 841, datë 06.10.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
50. Vendimi numër 1346, datë 03.09.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
51. Vendimi numër 958, datë 25.05.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
52. Vendimi numër 544, datë 04.11.2008 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
53. Vendimi numër 165, datë 16.05.2006 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
54. Vendimi numër 168, datë 29.03.2011, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
55. Vendimi numër 476, datë 08.12.2009, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
56. Vendimi numër 47, datë 20.02.2007 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër.
57. Vendimi numër 298, datë 23.05.2006, i Gjykatës së Apelit Vlorë.
58. Vendimi numër 236, datë 01.02.2012 i Gjykatës së Apelit Tiranë.
59. Vendimi numër 422, datë 09.07.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
60. Vendimi numër 1226, datë 30.10.2007 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
61. Vendimi numër 30, datë 19.02.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

62. Vendimi numër 755, datë 24.04.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
63. Vendimi numër 323, datë 29.04.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
64. Vendimi numër 932, datë 22.06.2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
65. Vendimi numër 23, datë 13.03.2002 dhe datë 01.04.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
66. Vendimi numër 24, datë 13.03.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
67. Vendimi numër 9, datë 16.01.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
68. Vendimi numër 13, datë 09.03.2006, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
69. Vendimi numër 6, datë 24.01.2007, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
70. Vendimi numër 3, datë 27.03.2008, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
71. Vendimi numër 5, datë 08.01.2009 dhe 20.01.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
72. Vendimi numër 686, datë 11.05.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
73. Vendimi numër 901, datë 21.06.2000 dhe 14.07.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
74. Vendimi numër 980, datë 15.09.2000 dhe 29.09.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
75. Vendimi numër 4, datë 24.03.2005 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
76. Vendimi numër 5, datë 23.03.2004 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
77. Vendimi numër 5, datë 15.09.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

78. Vendimi numër 1, datë 06.01.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
79. Vendimi numër 2, datë 06.01.2009 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
80. Vendimi numër 2, datë 19.02.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
81. Vendimi numër 3, datë 01.02.2006 dhe 03.02.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
82. Vendimi numër 4, datë 01.02.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
83. Vendimi numër 2, datë 21.01.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
84. Vendimi numër 5, datë 31.05.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
85. Vendimi numër 3, datë 04.04.2014 dhe 28.04.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
86. Vendimi numër 4, datë 10.12.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
87. Vendimi numër 5, datë 30.10.2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
88. Vendimi numër 1, datë 24.03.2005 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
89. Vendimi numër 32, datë 12.04.2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
90. Vendimi numër 8, datë 26.03.2004 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
91. Vendimi numër 9, datë 01.04.2005 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
92. Vendimi numër 67, datë 08.10.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
93. Vendimi numër 39, datë 14.11.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
94. Vendimi numër 41, datë 13.11.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
95. Vendimi numër 15, datë 15.03.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
96. Vendimi numër 17, datë 15.03.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
97. Vendimi numër 36, datë 30.05.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
98. Vendimi numër 42, datë 28.06.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
99. Vendimi numër 71, datë 08.10.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

100. Vendimi numër 76, datë 09.10.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
101. Vendimi numër 84, datë 13.11.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
102. Vendimi numër 75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese.
103. Vendimi numër 27, datë 27.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese.
104. Vendimi numër 27, datë 26.05.2010 i Gjykatës Kushtetuese.
105. Vendimi numër 40, datë 25.06.2015 i Gjykatës Kushtetuese.
106. Vendimi numër 17, datë 23.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese.
107. Vendimi numër 430, datë 21.01.2000 i Gjykatës së Romës, Itali.
108. Vendimi numër 2275, datë 06.06.2005 i Gjykatës së Romës, Itali.
109. Vendimi numër 2007/1265, datë 14.12.2006 i Gjykatës së Apelit Hamm, Gjermani.
110. Vendimi numër 2006/99, datë 24.08.2005 i Gjykatës së Apelit Oberlandesgericht, Gjermani.
111. Vendimi numër V ZR 56/65, datë 15.03.1967, i Gjykatës Federale Gjermane.
112. Vendimi numër V ZR 399/99, datë 25.05.2000, i Gjykatës Federale Gjermane.
113. Kasacioni Civil Italian Seksioni I, vendimi nr. 20305, datë 09.10.2005.
114. Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 13566, datë 26.05.2008.
115. Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 27412, datë 23.04.2008.
116. Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 29003, datë 16.04.2012.
117. Kasacioni Civil Italian Seksioni II, vendimi nr. 2860, datë 07.02.2005.
118. Kasacioni Civil Italian Seksioni III, vendimi nr. 20592, datë 29.09.2007.
119. Kasacioni Civil Italian Seksioni I, vendimi nr. 8642, datë 10.04.2015.

120. Kasacioni Civil Italian Seksioni II, vendimi nr. 23669, datë 19.11.2015.
121. Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 13577, datë 26.05.2008.
122. Kasacioni Civil Italian Seksioni, III vendimi nr. 20592, datë 29.09.2007.
123. Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 13477, datë 03.06.2010.
124. Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 25047, datë 27.11.2009.
125. Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 19024, datë 29.09.2005.
126. Kasacioni Civil Italian Seksioni II, vendimi nr. 22161, datë 20.10.2014.
127. Kasacioni Civil Italian Seksioni I, vendimi nr. 14901, datë 17.11.2000.
128. Kasacioni Civil Italian Seksioni I, vendimi nr. 2842, datë 28.03.1996 .
129. Kasacioni Civil Italian Seksioni II, vendimi nr. 1885, datë 21.02.1995.
130. Kasacioni Civil Italian Seksioni I, vendimi nr. 5114, datë 06.04.2001.
131. Kasacioni Civil Italian Seksioni III, vendimi nr. 1689, datë 26.01.2006.
132. Kasacioni Civil Italian, vendimi nr. 1868, datë 05.12.2003.
133. Gjykata e Lartë Federale Gjermane, Bundesgerichtshof, vendimi nr. 2008/986, datë 29.01.2008.
134. Gjykata e Lartë Federale Gjermane, Oberlandesgericht Stuttgart, vendimi nr. 5 U 40/14, datë 28.07.2014.
135. Kasacioni Civil Francez Seksioni II, vendimi nr. 1185, datë 11.02.1998.
136. Kasacioni Civil Frances, vendimi nr. 12-28013 dhe 12-28654 co 00466, datë 13.05.2014.
137. Seksionet e Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit Italian, vendimi nr. 14828, datë 04.09.2012.
138. Seksionet e Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit Italian, vendimi nr. 26242 dhe 26243, datë 12.12.2014.

139. Seksionet e Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit Italian, vendimi nr. 18128, datë 13.09.2005.
140. Seksionet e Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit Italian, vendimi nr. 26724 dhe 26725, datë 19.12.2007.
141. Seksionet e Bashkuara të Kasacioni Civil Frances, vendimi nr. 2963, datë 06.09.2002.
142. Këshilli i Shtetit Seksioni V vendimi nr. 6281, datë 13.11.2002, (Itali).
143. Këshilli i Shtetit, Seksioni V, vendimi nr. 490, datë 12/02/2008, (Itali).
144. Këshilli i Shtetit, vendimi nr. 1328, datë. 28/03/2008, (Itali).
145. Këshilli i Shtetit, vendimi nr. 1218, datë. 05/03/2003, (Itali).
146. Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg, dt. 29.09.2009, Çështja “Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë”, Ankimi nr. 35720/04 dhe 42832/06.
147. Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg, dt. 22.08.2006, Çështja “Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, Ankimi nr. 7352/03.
148. Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg, dt. 13.11.2007, Çështja “Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, Ankimi nr. 38222/02.
149. Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Strasburg, dt. 20.07.2010, Çështja “Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, Ankimi nr. 609/07.

3. Burime Interneti

- hudoc.echr.coe.int/eng
- www.gjk.gov.a
- www.gjykataelarte.gov.al
- www.gjykataeapelittirane.al
- www.gjykatatirana.gov.al
- avokatia.al
- www.poltenassociates.com
- www.digitalcommons.law.ggu.edu
- www.sssup.it
- www.altalex.com
- www.treccani.it
- <https://books.google.al>
- dirittocivilecontemporaneo.com
- www.filodiritto.com
- www.biblio.liuc.it
- <https://iris.unife.it>